

KRITERET DHE KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR CAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE PËR DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS

Sevdai Morina

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në shkencat juridike,
me profil e drejtë civile, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Endri Papajorgji

Numri i fjalëve: 59688

Tiranë, Qershor, 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklarojë në përgjegjësi të plotë se tema “Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashëtkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës” është punim origjinal i imi dhe nuk përmban mendime a punë të ndonjë autori tjetër pa citimet përkatëse të tyre.

Sevdai MORINA

ABSTRAKTI

Për shkaktimin e dëmit ekziston rregulla e përgjithshme juridike se, çdo subjekt duhet të përmbahet nga veprimet që mund t'i shkaktojë dëm tjetrit. Kjo rregull është e përgjithshme dhe vlen, si në të drejtën tonë të aplikueshme ashtu edhe në të drejtat tjera në botën bashkëkohore. Edhe legjislacioni ynë juridiko-civil në parimet e veta themelore, ka rregullën imperative se çdokush detyrohet që të heq dorë nga sjelljet me të cilat mund t'i shkaktojë dëm tjetrit. Këto dhe rregullat tjera të shkaktimit të dëmit, kërkojnë një sjellje dhe kujdes të veçantë nga subjektet potenciale për shkaktimin e tij. Kësisoj, do të jepet një kontribut për ruajtjen e integritetit të njeriut, pasurisë së tij në veçanti dhe pasurisë së shoqërisë në përgjithësi, sepse nga vetë njeriu, nga aktiviteti i tij, pastaj nga sendet dhe veprimtaritë e ndryshme, shkaktohen dëme të shumta dhe të mëdha si në njerëz ashtu edhe në pasuri dhe si pasojë e gjithë kësaj lind edhe përgjegjësia për kompensimin e tij. Prandaj, lidhur me ekzistimin e përgjegjesisë civile për dëmin jashtëkontraktor në dy vendet tona, ekzistojnë edhe kritere që duhet plotësuar për të tri bazat e përgjegjesisë civile, të cilat janë edhe objekt trajtimi i këtij punimi doktorat. Përkitazi për këtë, rregullimi i kritereve ndryshe për çaktimin e përgjegjesisë civile të dëmtuesit si debitor për dëmin jashtëkontraktor në mes të legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar, mund të ndikojë në rritjen e pasigurisë së qytetarëve në të dy vendet tona për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga të dëmtuarit! Prandaj, për këto dhe arsye të tjera nga ky punim mund të themi se, rregullat lidhur me përcaktimin e kritereve për ekzistimin e përgjegjesisë civile të dëmi jashtëkontraktor duhet të mbarëstrohen dhe analizohen me kujdes të veçantë.

Fjalët kyçe (thelbësore): dëmi, përgjegjësia civile, faji, subjektive, objektive !

ABSTRACT

For causing the damage there is a general legal rule that every subject should refrain from actions that might harm others. This rule is a general one and applies, whether to our applicable right also to the rights in the modern world. Even our legal and civil legislation in its basic principles, has the imperative rule that anyone is enforced to refrain from behaviors that might harm others. These and other rules about causing harm, require special care and behavior of potential entities for causing it. Thus, this will provide an input for preserving the integrity of human being, his wealth and property in particular and wealth of society in general, because the man himself, by his activity, then from various things and activities, are caused extensive damages in people as well as on real property and as consequence of all this, there exists the responsibility for compensation.

So, in relation to the existence of civil liability for non-contracted harm in both our countries, exists the criteria that needs to be amended for the three basics of the civil liabilities which are the object of study of this Phd paper. Regarding this, consequently, the adjustment of the different criteria for determining the civil liability of the one causing the harm as a debtor for non-contractual damages between Albanian and Kosovo legislation can affect the increase of the insecurity of the citizens in both of our countries for compensation of damage caused by the harmed one. Therefore, for these and other reasons from this paper we can say that the rules regarding the determination of the criteria for the existence of civil liability for non-contractual damage must be handled and analyzed with special care.

Key words (essential): damage, civil liability, fault, subjective, objective!

DEDIKIMI

Njeriu kur mëton a synon diçka, domosdo se bën edhe plane. Mirëpo unë si pjesë e një brezi që përjetoj një rën nga periudhat më të rënda, kur në asnjë çast nuk e ndjenim veten të sigurt, as për shëndetin e as për jetën tonë; kur gjithkush shihnim policinë (milicinë), paramilitarët e lloj-lloj bandash vrashtarë; kur sa herë që shikonim televizorin, shihnim vetëm skena dhune e vrasjesh; kur rruga për shkollë edhe pse jo aq e largët, ishte e pasigurt sa që nuk e dinim a do të arrijmë e si do të ktheheshim prej saj; pra ishte tepër vështirë ta planifikojë të ardhmen. Megjithatë, sa ishin rrethana aq të dhunshme, shtrënguese e të përshkuara edhe me vrasje, ishte një organizim mbarëshqiptar i përshkuar me një unitet të paparë, si dhe me një përkushtim të pathyeshëm qëndrestar! Kush nuk fliste për frikën, por vetëm për të ardhmen e ndërtuar në një vend të lirë e për jetë të sigurt! Në këtë frymë edhe prindërit e mi më edukuan që të mësoj sa më shumë, sepse e ardhmja megjithatë do të jetë e imja dhe e brezit tim! Kështu edhe mësimdhënësit e mi, gjithnjë punuan me përkushtim pa paga (mësimdhënësi ishte edhe im atë), nën kërcënimin e shtypësit mizor! Kudo flitej për lirinë e plotë që po vinte! Ajo erdhi! Pra, si duket ia vlejti që besova e besuam! Zgjedha profesionin i cili merret me të drejtën dhe drejtësinë, por edhe me të padrejtën e padrejtësinë. Sikur të mos ishin, shkelësit e ata që shkaktojnë dëme me siguri se edhe fjala “drejtësi”, nuk do të ishte e nevojshme! Jam munduar që punën time ta kryej me nder e dinjitet, për këtë arritje së pari i falënderoj prindërit e mi, bashkëshorten e fëmijët e mi, mandej mësimdhënësit e mi e miqtë e mi, të cilët nuk më lanë të qetë por më inkurajuan që të eci nëpër këtë rrugë të gjatë! Së fundmi duhet ta theksoj se, e ardhmja i takon brezave që vijnë, pra edhe e fëmijëve të mi, prandaj ky punim le të jetë dedikim për ta!

FALËNDERIM

Një falënderim të veçantë dua ta bëj për udhëheqësin tim në këtë punim doktrate, shumë të nderuarin, Prof. Asoc. Endri Papajorgji, i cili në asnjë moment nuk ka kursyer kohën dhe dëshirën e tij, për të më këshilluar dhe ndihmuar në pasurimin e këtij punimi me material dhe literaturë të dëshiruar e të duhur, ku pa ndihmën e tij ky punim nuk do të ishte kaq i plotë. Ndihma e tij konsistoi në fillim, në krijimin e kontakteve dhe në mbledhjen e materialeve të ndryshme, veçmas për kontributin e dhënë në mënyrë profesionale lidhur me sqarimin, shtjellimin e lëndës, dhe ndihmën e dhënë për temën e shtjelluar.

Faleminderit Prof. Asoc. Hemion Braho dhe Prof. Asoc. Juelda Lamçe, për disponibilitetin dhe informacionet për këtë temë trajtese në këtë punim doktoral.

Faleminderit Universitetit European të Tiranës, faleminderit profesorëve që më kanë dhënë mësim, pastaj stafit administrativ që në mënyrë të vazhdueshme na inkurajuan për të përfunduar studimet doktorale.

Falënderoj në mënyrë të veçantë, familjen time, për kohën që i kam marrë, mbështetjen që më kanë dhënë, durimin dhe përkushtimin që kanë treguar ndaj meje gjatë gjithë këtyre viteve të përgatitjes dhe përfundimit të këtij punimi. Gjithashtu falënderoj shumë edhe kushëririn Muhamedin, për mbështetjen financiare që më ka dhënë gjatë këtyre tri viteve të studimeve doktorale.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË

ABSTRAKTI

DEDIKIMI

FALËNDERIM

LISTA E SHKURTIMEVE

FJALORI

KAPITULLI I: HYRJE.....	15
1.1. Objektivat e studimit.....	17
1.2. Modeli teorik dhe literatura ku bazohet	18
1.3. Argumenti ose hipotezat e punimit dhe pyetjet kërkimore.	19
1.3.1. Hipoteza e punimit.....	20
1.3.2. Pyetjet kërkimore	20
1.4. Metodologjia	21
1.5. Kufizimet metodologjike.....	24
 KAPITULLI II: VËSHTRIM TEORIK LIDHUR ME PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE PËR DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS	 25
2.1. Shqyrtime të përgjithshme	25
2.2. Ngjashmëritë në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore dhe asaj kontraktore ...	32
2.3. Dallimet në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore dhe asaj kontraktore.....	34
2.4. Dallimet në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore dhe asaj penale.....	36

2.5. Debati teorik lidhur me kriteret dhe kushtet që duhen të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor.....	41
2.6. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës franceze.....	44
2.6.1 Përgjegjësia për faj, regjimi i parashikuar nga hartuesit e Kodit Civil Francez.....	45
2.7. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës gjermane.....	45
2.8. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës Italiane.....	46
2.9. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës spanjolle.....	47
2.10. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës zvicerane.....	48
2.11. Llojet e përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor	49
2.12. Përfundime.	51

KAPITULLI III: PËRCAKTIMI I KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË PLOTËSOHEN LIDHUR ME EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË SUBJEKTIVE CIVILE PËR DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS.....

3.1. Shqyrtime të përgjithshme	53
3.2. Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor për dëmin e shkaktuar nga përgjegjësia subjektive.....	56
3.2.1. Shkaktimi i dëmit.....	60
3.2.1.1. Llojet e dëmit	64
3.2.1.1.1. Dëmi pasuror (material).....	65
3.2.1.1.2. Llojet e dëmit pasuror	66
3.2.1.2.3. Dëmi jopasuror (jo material).....	74
3.2.1.2.4. Llojet, format e dëmit jopasuror dhe kushtet për marrjen në shqyrtim.....	79

3.2.2. Veprimi i kundërligjshëm.	97
3.2.2.1. Përfundimi i veprimit antijuridik-kundërligjshëm.....	104
3.2.2.1.1. Dëmi i shkaktuar duke e kryer të drejtën e vet	106
3.2.2.1.2. Dëmi i shkaktuar duke kryer detyrën zyrtare.....	109
3.2.2.1.3. Dëmi i shkaktuar në mbrojtje të nevojshme.....	110
3.2.2.1.4. Dëmi i shkaktuar nga nevoja ekstreme	113
3.2.2.1.5. Dëmi i shkaktuar nga vetëndihma e lejueshme.....	118
3.2.2.1.6. Dëmi i shkaktuar me pranimin e të dëmtuarit.....	120
3.2.3. Faji dhe format për caktimin e tij.....	122
3.2.3.1. Kriteret për përcaktimin e fajit.....	126
3.2.3.1.1. Dashja (dolus)	127
3.2.3.1.2. Pakujdesia (culpa).....	128
3.2.4. Aftësia deliktore (Aftësia e përgjegjësisë).....	133
3.2.5. Lidhja shkakësore (kauzale).....	137
3.2.6. Përfundime	144
3.2.7. Argument	146
3.2.8. Rekomandim	147

**KAPITULLI IV: PËRCAKTIMI I KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË
PLOTËSOHEN LIDHUR ME EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË OBJEKTIVE
CIVILE PËR DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS.....**

4.1. Shqyrtime të përgjithshme	148
4.2. Përgjegjësia objektive për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme.	151

4.3. Subjekti përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga sendet dhe nga veprimtaritë e rrezikshme.....	156
4.4. Baza e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme.....	158
4.5. Argumentet për dhe kundër kësaj baze të përgjegjësisë	160
4.5.1. Argumentet për (pro) këtë përgjegjësi	160
4.5.2. Argumentet kundër kësaj përgjegjësie	162
4.5.3. Rekomandojmë.....	164
4.5.4. Terminologjia.....	164
4.6. Analizë e rasteve të përgjegjësisë civile për sendet dhe veprimtaritë rrezikshme	166
4.6.1. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në organizatat industriale dhe në vendndërtime.....	168
4.6.2. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në trafik	170
4.6.3. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët -”Damnum per animal”	174
4.6.4. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, me akte terroriste, demonstrata dhe manifestime publike.....	177
4.6.5. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar për shkak të mos ofrimit të ndihmës së nevojshme	179
4.6.6. Përgjegjësia lidhur me kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm.....	181
4.6.7. Përfundime	181

KAPITULLI V: PËRCAKTIMI I KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË PLOTËSOHEN LIDHUR ME EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE PËR VEPRIMET E TJETRIT TE DËMI JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS	184
--	------------

5.1. Shqyrtime të përgjithshme	184
5.2. Analizë e rasteve të përgjegjësisë juridiko civile për veprimet e tjetrit kur dëmtuesi u shkakton personave të tretë.....	187
5.2.1. Përgjegjësia juridiko civile e prindërve për fëmijë.	188
5.2.2. Përgjegjësia e personit tjetër për dëmin e shkaktuar nga i mituri (mbikëqyrja).....	193
5.2.3. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar duke u ndodhur në gjendjen që nuk ishte i ndërgjegjshëm për veprimet që kryente	199
5.2.4. Baza e përgjegjësisë së prindërve, kujdestarëve dhe personave që u janë besuar të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar	203
5.2.5. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të punësuarit ndaj personave të tretë.	205
5.2.6. Përgjegjësia juridiko civile e personit juridik për organet e veta.....	214
5.2.7. Përfundime	219
 KAPITULLI VI: KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	221
6.1. Përfundime	221
6.2. Rekomandime	228
 LISTA E REFERENCave / BIBLIOGRAFIA	231

Lista e shkurtimeve:

DPPJ - Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës

DUDNJ - Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

KBGJL - Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë

KCF – Kodi Civil i Francës

KCGJ – Kodi Civil Gjerman

KCI – Kodi Civil i Italisë

KCSH - Kodi Civil Shqiptar

KDZ – Kodi i Detyrimeve i Zvicrës

KEDNJ - Konventa Evropiane për të drejtat e Njeriut

KLD – Kanuni i Lekë Dukagjinit

KPCA - Kodi i Përgjithshëm Civil Austriak

KPCSH - Kodi i Procedurës Civile në Shqipëri

KPSH - Kodi Penal në Shqipëri

KPPSH - Kodi i Procedurës Penale në Shqipëri

KRK – Kushtetuta e Republikës së Kosovës

KRSH – Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

LMD - Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës

LVJD - Ligji mbi Veprimet Juridike dhe Detyrimet

Fjalori

- **Commisio** – kur subjekti ndërmerr veprime të caktuara për të shkaktuar dëmin
- **Compensatio culpa** – kur dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur vetëm nga pakujdesia e dëmtuesit, por edhe i dëmtuari me pakujdesinë e tij ka ndikuar në shtimin e dëmit, me shumë nga sa do të ishte.
- **Culpa** – faji i shkaktuar nga pakujdesia
- **Culpa lata** – pakujdesi e rëndë
- **Culpa levis** – pakujdesi e rëndomtë, e zakonshme
- **Damnum emergens** – dëmi i vërtetë, nënkupton zvogëlimin e pasurisë së tashme të personit të dëmtuar.
- **Damnum per animal** – dëmi i shkaktuar nga kafshët
- **Delikt** – veprim kundërligjor i dikujt që sanksionohet me ligj,
- **Dëmi biologjik** - dëmtimi i shëndetit, cenim i së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut.
- **Dëmi ekzistencial** - Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut, duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare.

- **Dëmi moral** - Dëmi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhembje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi a mundimi shpirtëror, ku rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm.
- **Dolus** – faji i shkaktuar me dashje
- **Kriter m.** - Parim i qartë e i përcaktuar mirë, sipas të cilit jepet gjykimi për diçka, bëhet vlerësimi, klasifikimi, organizimi etj. i diçkaje: norma ku mbështetemi për të vlerësuar një ngjarje a për të përcaktuar diçka. Kriteria të drejta (të qarta). Kriteria të reja. Kriter i gabuar. Sipas këtyre kriterëve. Vë (caktoj) kriterë. Zbatoj kriteret. Rregull, sipas të cilit duhet të kryhet një punë a diçka tjetër; rendi i veprimeve për të kryer një punë.
- **Kusht m.** 1. Rrethanë a gjendje e domosdoshme, nga e cila varet qenia e diçkaje ose zhvillimi i saj; ajo që duhet të jetë a duhet të ndodhë patjetër përpara diçkaje, pa të cilën kjo nuk mund të lindë ose nuk mund të zhvillohet. Kusht i nevojshëm (i domosdoshëm).
- **Lucrum cessans** – fitimi i munguar është dëmi kur i dëmtuari pengohet që ta rrisë pasurinë. Ky është fitimi, ku subjekti i dëmtuar do ta realizonte në të ardhmen, sikur të mos ishte shkaktuar ngjarja e dëmshme.
- **Neminem laedere** – askujt mos t'i shkaktohet dëm.
- **Ommisio** – kur subjekti nuk ndërmerr veprime të caktuara për të evituar dëmin
- **Qui sou iure utitur, nemini facit iniuriam** – kush e realizon të drejtën e vet, askujt nuk i bën padrejtësi.

KAPITULLI I: HYRJE

Me të madhe kohëve të fundit, në doktrinën e së drejtës civile, diskutohet për evoluimin e rregullimit të përgjegjësisë jashtëkontraktuese nga dëmi i shkaktuar. Ndërmerren dhe janë ndërmarrë masa, që në mënyrë sa më adekuate dhe më efikase të kompensohet dëmi që shkaktohet nga njerëzit, prodhimet e tyre dhe veprimtaritë e rrezikshme.

Vetë, dëmi është veprim shumë specifik i cili me paraqitjen e tij e dëmton njeriun në veprimtaritë e tij ekonomike. Atë, madje e dëmton edhe në jetën e tij. Kohë pas kohe njeriut në shoqëri i paraqiten dëme të pasurisë, i keqësohen kushtet ekonomike, i zvogëlohen të ardhurat materiale dhe kështu pasojat që rrjedhin nga dëmet e shkaktuara i kontribuojnë destabilizimit ekonomik të tij.

Rreziku dhe pasiguria nga dëmet e shkaktuara kanë qenë përcjellës dhe pjesë përbërëse e aktivitetit dhe e jetës së përgjithshme të qenies njerëzore. Prania gjithnjë më e madhe e dëmeve të shkaktuara në jetën e përditshme është karakteristikë e posaçme për botën në të cilën jetojmë dhe veprojmë. Njerëzimi me forma të ndryshme gjithnjë, është përpjekur t'i kundërvihet këtij fenomeni. Njerëzit gjithnjë, kanë bërë përpjekje për gjetjen e rrugëve dhe mënyrën e kompensimit të tyre, për evitimin si dhe zbutjen e pasojave nga to. Pra, dëmet të cilat i shkaktohen njerëzimit kanë ekzistuar, ekzistojnë dhe do të ekzistojnë deri sa të ekzistojë njeriu!

Detyrimet nga shkaktimi i dëmit përbëjnë një nga mjetet më të rëndësishme për shpërblimin e dëmit pasuror dhe atij jopasuror që ka ardhur si pasojë e cenimit të të drejtave të subjekteve dhe nevojës për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave lidhur me

jetën, shëndetin dhe nderin e personalitetit të personit. Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm, sepse është një cilësi e lindur bashkë me njeriun dhe që formësohet e kultivohet me formimin e personalitetit të tij. Nga kjo cilësi e veçantë e njeriut, si qenie e vetëdijshme, burojnë të gjitha të mirat vetjake jopasurore, të drejtat dhe interesat e tjera themelore si emri, barazia para ligjit, mbrojtja nga diskriminimi, prezumimi i pafajësisë etj., që janë të drejta të mbrojtura e të garantuara me kushtetutë dhe ligj. Për cenimin e këtyre të drejtave vetjake qoftë të karakterit pasuror apo jopasuror, që njëkohësisht përbëjnë cenim të dinjitetit të njeriut, është parashikuar edhe sanksion pasuror në të holla. Pra, detyrimet nga shkaktimi i dëmit lindin si për shkak të cenimit të të mirave materiale ashtu edhe të mirave vetjake jomateriale (Gjata, 2010:31). Marrëdhëniet jashtëkontraktore kanë një rëndësi të madhe dhe rregullohen në mënyrë të veçantë nga Kodi Civil dhe ligje tjera. Ato janë disa llojesh: si marrëdhënie që krijohen nga begatimi pa shkak, nga pagimi i pa detyruar, nga e drejta e autorit dhe nga shkaktimi i dëmit. Shkaktimi i dëmit është një nga fushat me më shumë probleme dhe që zbatohet shumë shpesh në praktikë (Tutulani-Semini, 2016:201).

Sipas fjalorit të terminologjisë juridike për të drejtat e njeriut dhe atij të gjuhës shqipe, jepen shumë sqarime rreth nocionit të dëmit. Por, ne në vazhdim do t'i sqarojmë këto shpjegime (sqarime) thelbësore rreth nocionit të dëmit:

1) Dëm jashtëkontraktor - është ai dëm civil për të cilin mund të kërkohet kompensim.

Shembulli: *“Makina e saj u shkatërrua për shkak të neglizhencës së dënueshme nga shoferi tjetër. Ajo iu drejtua gjykatës për të kërkuar kompensimin e dëmit, me qëllim që ta*

riparonte makinën e saj” (Fjalorth Terminologjik i të Drejtave të Njeriut, Shqip-Anglisht & Anglisht- Shqip, Unesco, Projekti Finlandez për të Drejtat e Njeriut–Kosovë, Tiranë, 2002, fq, 38).

2) Dëm, i m. Sh. ~E, ~ET. Humbje në mjete, në sende a njerëz që pëson dikush; diçka që prishet tërësisht a pjesërisht; dëmtim. *Dëm i madh (i vogël). Dëme materiale (ekonomike). Dëmet e luftës. Dëmet nga shiu (nga breshëri, nga përmbytjet). Dëme në njerëz. Vlerësoj (çmoj dëmin). Pagoi (lau) dëmin. Doli me dëm. Bëri dëm. Nuk patën dëme. I shpërblyen (i paguan dëmet).* **E keqe** që i vjen dikujt a diçkaje nga një shkaktar i jashtëm a i brendshëm, nga një veprim a nga një gjendje e caktuar, pasojë e keqe (Fjalor i Gjuhës Shqipe, grup autorësh, Rilindja, Prishtinë më 1981, fq, 223).

Shumë sqarime a shpjegime gjuhësore si dhe të dhëna tjera, përkojnë me temën që po e trajtojmë në pikëpamjen e fushës juridiko civile në përgjithësi e në veçanti të asaj detyrimore. Kështu që, zbërthimi i temës sonë, besoj se me shpjegimet fillestare juridike dhe gjuhësore, janë burim frymëzimi i këtij punimi dhe i kësaj teme-trajtese në lëmin e së drejtës civile.

1.1. Objektivat e studimit

Qëllimet dhe synimet kryesore që dëshiroj të arrijë me këtë punim janë:

- Ngritja e njohurive lidhur me përcaktimin e kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile të debitorit për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës;

- Identifikimin e përgjegjësisë civile në bazë të fajit, sipas fajit të supozuar dhe asaj pa faj të debitorit për dëmin jashtëkontraktor në dy vendet tona;
- Identifikimin e kriterëve dhe kushteve që duhen plotësuar për ekzistimin e përgjegjësisë civile të debitorit për dëmin jashtëkontraktor në këto dy shtete;
- Identifikimin e institucioneve dhe individëve që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor në Shqipëri e Kosovë;
- Identifikimin e llojeve të dëmeve jashtëkontraktore që i trajton legjislacioni shqiptar dhe ai kosovar, si dhe format në të cilat paraqiten ato;
- Avansimin e aftësive për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlidhura me përcaktimin e kriterëve, lidhur me ekzistimin e përgjegjësisë civile të dëmtuesit, për dëmin jashtëkontraktor në dy vendet tona;
- Shqyrtimin e mendimeve të ndryshme lidhur me ekzistimin e përgjegjësisë civile të debitorit për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

1.2. Modeli teorik dhe literatura ku bazohet

Me qëllim që këtë çështje ta studioj në mënyrë sa më të gjithanshme, jam munduar që të shtjelloj literaturë sa më të gjerë të kësaj fushe. Për shkak të analizimit dhe trajtimit në mënyrë sa më të hollësishme të kësaj teme në këtë punim doktore jam munduar që të shfrytëzoj të gjitha burimet e mundshme shkencore të nevojshme për mbledhjen e të

dhënave lidhur me llojet e përgjegjësive civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Për një trajtim sa më të suksesshëm të këtij punimi shkencor, gjithsesi e një rëndësie të madhe ishte edhe konsultimi i literaturës bashkëkohore dhe legjislacionit aktual në dy vendet tona. Lidhur me kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor, gjithashtu kam pasur parasysh edhe literaturën dhe legjislacionin e vendeve tjera, së bashku me përvojat e tyre.

1.3. Argumenti ose hipoteza e punimit dhe pyetjet kërkimore

Shkaktimi i dëmit si fakt relevant krijon edhe përgjegjësinë për të. Dëmtuesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar ndaj të dëmtuarit, prandaj edhe thuhet se përgjegjësia për dëmin paraqitet si pasojë e dëmit të shkaktuar. Një gjë e tillë është edhe normale në këto marrëdhënie, sepse çdokush duhet t'i ketë pasojat nga sjelljet e veta. Përgjegjës mund të jetë si subjekti që është shkaktues i dëmit apo edhe dikush tjetër që është në marrëdhënie të veçantë me shkaktuesin e tij. Pra, përgjegjës konsiderohet edhe poseduesi i sendit të rrezikshëm ose organizuesi i aktivitetit të rrezikshëm. Funksionimi i përgjegjësisë në këto dhe në raste të tjera u ofron mbrojtje të caktuar viktimave si dhe dënon dëmtuesin potencial. Për këto dhe arsye të tjera nga ky trajtim i kësaj dukurie mund të themi se, rregullat lidhur me bazën e përgjegjësisë jashtëkontraktore civile duhet të mbarështrohen dhe analizohen me kujdes të veçantë.

Përkitazi për këtë, hipoteza themelore dhe pyetjet kërkimore në këtë punim janë:

1.3.1. Hipoteza

1. Nëse bëhet unifikimi i kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile të dëmtuesit si debitor për dëmin jashtëkontraktor nga ana e legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar, atëherë mund të krijohet siguri më e madhe për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga të dëmtuarit si kreditor në të dy vendet tona!

1.1. Rregullimi i kriterëve dhe kushteve ndryshe, për caktimin e përgjegjësisë civile të dëmtuesit si debitor të dëmi jashtëkontraktor në mes legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar, mund të ndikojë në rritjen e pasigurisë së qytetarëve në të dy vendet tona lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar nga të dëmtuarit!

1.2. Nëse shtohet rritja e pasigurisë së qytetarëve për realizimin e kompensimit të dëmit jashtëkontraktor nga të dëmtuarit, atëherë ajo mund të ndikojë edhe në zhvillimin e gjithmbarshëm socioekonomik në të dy vendet tona!

1.3.2. Pyetjet kërkimore

1. A përcaktohen në mënyrën e duhur kriteret dhe kushtet për caktimin e përgjegjësisë civile të dëmtuesit si debitor për dëmin jashtëkontraktor nga ana e legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar ?

2. Cilat kushte dhe kriteret duhet plotësuar për të ekzistuar përgjegjësia civile e debitorit si shkaktues i dëmit të dëmi jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës ?
3. Si rregullohet përgjegjësia subjektive civile e debitorit të dëmi jashtëkontraktor në dy vendet tona dhe cilat kushte dhe kriteret duhet plotësuar për të ekzistuar ky lloj i përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor ?
4. Si rregullohet përgjegjësia objektive civile e debitorit të dëmi jashtëkontraktor në dy vendet tona dhe cilat kushte dhe kriteret duhet plotësuar për të ekzistuar ky lloj i përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor ?
5. Si trajtohet përgjegjësia civile e debitorit për veprimet e tjetrit të dëmi jashtëkontraktor në dy vendet tona për dëmet që u shkaktohen personave të tretë dhe cilat kushte dhe kriteret duhet plotësuar për të ekzistuar ky lloj i përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor ?

1.4. Metodologjia

Me qëllim që këtë çështje ta studiojë sa më mirë, kam përdorur disa metoda kërkimore. Po ashtu, gjatë punimit të temës, i kam pasur parasysh edhe këta faktorë:

- 1) përmbajtjen e analizuar të materialit të mbështetur në literaturë;
- 2) përshkrimin dhe interpretimin e normave përkatëse ligjore; dhe
- 3) përdorimin e këtyre metodave në punim, si:

- a) metodën deskriptive (përshkruese),
- b) metodën krahasuese,
- c) metodën e analizës,
- d) metodën e sintezës dhe
- ç) metodën empirike.

Metoda deskriptive (përshkruese) - Kjo metodë është përdorur në këtë punim shkencor lidhur me përshkrimin e problemit që është objekt trajtimi. Kjo metodë ka zënë vend në punim, sepse kam bërë përshkrimin e të dhënave që kanë të bëjnë me trajtimin e kësaj teme. Kjo metodë për qëllim kryesor ka pasur përshkrimin e mendimeve doktrinare, dispozitave ligjore ashtu siç janë dhe aktualisht ekzistojnë në të dy legjislacionet e vendeve tona! Me anë të kësaj metode, jam munduar të bëj përshkrim të hollësishëm dhe të plotë të mendimeve doktrinare si dhe të dispozitave ligjore lidhur me rregullimin e kritereve dhe kushteve të llojeve të përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në dy shtetet tona.

Metoda krahasuese (komparative) - Me anë të metodës krahasuese kemi bërë peshimin e elementeve krahasuese, veçoritë e përbashkëta ose dallimet që i kanë legjislacionet e dy shteteve tona lidhur me përcaktimin e kritereve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës. Këtë metodë e kam përdorur shumë, sepse me përdorimin e saj kam mundur të arrijë deri te konkluzionet dhe rekomandimet.

Metoda e analizës - Me anë të kësaj metode kemi bërë zbërthimin elementeve krijuese, të mendimeve, sepse kjo metodë është qasje e kërkimit shkencor dhe e shpjegimit të së

vërtetës nëpërmjet zbërthimit të dispozitave ligjore dhe krijimeve mendore të ndërlikuara (kuptimet, gjykimet, dispozitat ligjore, konkluzionet) në elemente më të thjeshta dhe në pjesë përbërëse të secilit kriter dhe lloj të përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në dy vendet tona. Me anë të kësaj metode kam bërë mbledhjen e të dhënave të ndryshme lidhur me trajtimin kritereve, llojeve dhe kushteve që duhen plotësuar për të ekzistuar përgjegjësia civile e dëmit jashtëkontraktor në dy vendet tona. Pra, me anë të mbledhjes të dhënave të ndryshme si ato nga aspekti doktrinar ashtu edhe nga ai praktik, kam bërë studime për të dalluar modelet dhe parimet që mund të më drejtojnë në nxjerrjen e përfundimeve në këtë punim!

Metoda e sintezës - Nëpërmjet kësaj metode kam arritur të krijojë lidhjen e mendimeve të thjeshta në tërësi të qartësuar. Më ka shërbyer që të bëj lidhjen e mendimeve të autorëve të ndryshëm të fituara nga analiza, lidhur me përcaktimin e kritereve për ekzistimin e përgjegjësisë civile të debitorit për dëmin jashtëkontraktor dhe kushtet që duhet të plotësohen për të ekzistuar ajo. Me anë të kësaj jam nisur nga mendimet e thjeshta në ato më të ndërlikuara sepse rëndësia e analizës në këtë punim identifikohet në fazat e studimit të punimit, ndërkaq ajo e sintezës është e ndërlidhur me fazën e sublimimit të rezultateve në këtë punim.

Metoda empirike - Kjo metodë më ka mundësuar që të bazohem në përvojë duke u mbështetur në nxjerrjen e konkluzioneve apo gjykimeve për objektin e trajtimit tonë. Rezultatet që janë fituar nëpërmjet kësaj metode, janë mjaft të rëndësishme, veçanërisht për jetësim praktik.

1.5. Kufizimet metodologjike

Zgjedhja e metodave të kërkimit rëndom nënkupton edhe pranimin e kufizimeve të tyre gjatë punës kërkimore. Kufizimet kryesore të këtij studimi kanë të bëjnë, veçanërisht me atë se: punimi shtrihet në periudhën kohore të aplikimit të së drejtës pozitive të dy vendeve tona, përkatësisht Kodit Civil aktual në Shqipëri dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në Kosovë. Në disa raste (të pakta) për qëllime krahasimore dhe të dobishme jam shërbyer edhe me legjislacionin e vendeve evropiane si: Francës, Gjermanisë, Italisë, Austrisë, Spanjës e Zvicrës. Gjithashtu, punimi më tepër kufizohet në përcaktimin e kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile subjektive, objektive dhe asaj për veprimet e tjetrit të dëmi jashtëkontraktor në dy shtetet tona. Pra, studimi thellohet në tre llojet e përgjegjësisë juridiko civile, në atë subjektive civile (sipas fajit), objektive civile (pa faj) dhe në përgjegjësinë civile për veprimet e tjetrit (sipas fajit të supozuar). Punimi nuk është analizuar nëpër periudha të ndryshme historike të trajtimit të kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen lidhur me çaktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në dy vendet tona. Ndërsa sa i përket vështirësive për këtë punim doktoral, vlen të theksojmë se ato kanë të bëjnë, veçanërisht me autorët e pakët shqiptarë në lidhje me trajtimin e problemit si dhe me vështirësitë që kam hasur për mbledhjen e të dhënave jurisprudenciale.

Si përfundim, duke marrë në konsideratë kufizimet në metodologjinë e kërkimit, mund të themi se është e pamundur që në këtë punim të mund të përfshihen të gjitha llojet e dëmeve që shkaktohen dhe mendojë se ky studim është i rëndësishëm e i përshtatshëm për t'i dhënë përgjigje problemit të kërkimit në kushtet e kufizimeve të burimeve dhe kohës.

KAPITULLI II: VËSHTRIM TEORIK LIDHUR ME PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE PËR DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS

2.1. Shqyrtime të përgjithshme

Pjesa më e madhe e detyrimeve lindin në bazë të kontratës, që do të thotë se kontrata është burim (shkak) kryesor i lindjes së detyrimeve. Mirëpo, përveç që përgjegjësitë krijohen nga kontratat, ato krijohen edhe jashtë kontratave, respektivisht sipas ligjit (Bilalli & Kuçi, 2009:325). Pra, detyrimet mund të lindin edhe pa u lidhur kontrata, që nënkupton se ato krijohen nga shkaqe të tjera, që janë veprimet ose mosveprimet e njerëzve, për të cilat nuk është veçori shfaqja e vullnetit si palë (Gjata, 2010:12). Përgjegjësia jashtëkontraktore për dëmin lind me veprimin e dëmshëm që krijon një marrëdhënie ndërmjet dëmtuesit dhe të dëmtuarit, respektivisht ndërmjet personave që më parë nuk ka ekzistuar marrëdhënia e detyrimeve (Krasniqi, 2015:156). Me veprime të njëanshme ose me mosveprime të caktuara, e drejta parashikon pasoja juridike, pavarësisht nga vullneti i atij që ka kryer ose nuk ka kryer veprimin. Shembull: kur personi A, i shkakton një dëm (thyen xhamin e dritares) personit B, personi A detyrohet t'i shpërblejë dëmin personit B, pavarësisht a ka dëshiruar të përgjigjet për dëmin (Gjata, 2010:12). Pra, përveç kontratës, si burim i rëndësishëm i detyrimeve, ekziston si burim edhe shkaktimi i dëmit dhe detyrimi që ky dëm të shpërblehet (Nuni & Mustafaj & Vokshi, 2008:94-95). Për dallim nga kontratat, ku pajtimi i vullnetit në mes të subjekteve të caktuara është kusht i përgjithshëm për krijimin e

marrëdhënieve të detyrimeve, te shkaktimi i dëmit detyrimi krijohet nga fakti se dëmi i është shkaktuar tjetrit. Kësisoj për këtë ekziston edhe obligimi se, dëmin e shkaktuar duhet ta kompensojë dikush. Shkaktimi i dëmit është një shprehje që gjen vend në shumë dispozita ligjore të Kodit Civil shqiptar, duke filluar që nga subjektet, nga e drejta e pronësisë, kontratat, detyrimet, begatimi pa shkak, e të tjera. Në disa raste ai del në formën e dëmit kontraktor dhe në disa raste në formën e dëmit jashtëkontraktor (Tutulani-Semini, 2016:161). Përgjegjësia civile është shprehje, e cila më së shpeshti përdoret për emërtimin e detyrimit për shpërblim të dëmit, megjithëse kjo shprehje mund të ketë domethënie më të zgjeruar (Mamuti, 2013:64). Respektivisht, kjo mund të kuptohet edhe si përgjegjësi për të cilën në të drejtën civile parashihen disa sanksione tjera, dhe jo vetëm shpërblim i dëmit. Situata është e ngjashme, sikurse te personi fizik ashtu edhe tek ai juridik, sepse përgjegjësia krijohet për shkak të fajit të tyre dhe rrezikut të krijuar (Mamuti, 2013:64).

Dëmi duhet të jetë shkaktuar me veprime konkrete (qoftë të bëra, qoftë të pabëra), si kusht i përgjithshëm, gjithnjë i pranishëm për përgjegjësi civile juridike. Duhet, pra, që me veprime konkrete të jetë lënduar një e mirë e caktuar që ka dhe mund të ketë në rastin konkret vlerë materiale ose jomateriale ose cenim të një interesi të mbrojtur legjitim me ligj ose me ndonjë dispozitë tjetër juridike konkrete (Kadriu, 2003:7). Nëse dëmi mund të shkaktohet edhe me lëndimin e integritetit të njeriut, atëherë përgjegjësia për dëmin si institucion shumë i rëndësishëm juridik në të drejtën civile mund të ketë përmbajtje dhe rëndësi edhe më të madhe (Kadriu, 2003:7). Një delikt mund të përkufizohet gjerësisht si një veprim i gabuar që shkakton dëm dhe për këtë i dëmtuari ka të drejtë të kompensohet (Borkowski & Du Plessis, 2004:419). Termi “delictum” kishte domethënie të gjerë.

Tregonte çdo veprim antiligjor që sanksionohej me ndonjë dënim apo me disa pasoja të tjera negative, që i kërcënoheshin kryesit të veprimit antiligjor apo delikuentit (Puhan, 1968:366). Pra, përgjegjësia deliktore civile krijohet me rastin e shkaktimit të dëmit. Vetë fakti i shkaktimit të dëmit, krijon detyrimin për shpërblimin e tij nga ana e shkaktuesit të tij. Dëmi që shkaktohet me veprimin ose mosveprimin e njeriut, krijon përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, përkatësisht përgjegjësinë deliktore civile, ku prej këtu pala e dëmtuar fiton të drejtën që të kërkojë shpërblimin, qoftë të dëmit material apo atij jomaterial (Mamuti, 2013:66). Gjithashtu, kur dëmi shkaktohet nga përdorimi i sendeve apo ushtrimi i veprimtarisë së rrezikshme, të cilat paraqesin burim të shtuar të rrezikut, lind përgjegjësia deliktore civile. Kjo përgjegjësi paraqitet si pasojë e shkeljes së parimit për të mos shkaktuar dëm. I dëmtuari me rastin e shkaktimit të dëmit, është në pozitën e kreditorit, pasi për këtë lind e drejta që të kërkojë kompensimin e tij, kurse subjekti përgjegjës është në pozitën e debitorit, pasi ai duhet të bëjë zhdëmtimin. Detyrimi për zhdëmtim paraqitet si detyrim primar dhe i vetëm i debitorit me rastin e shkaktimit të dëmit (Mamuti, 2013:66). Subjekti i së drejtës si shkak i sjelljes së tij, në raste të caktuara subjektit tjetër të së drejtës, mund t'i shkaktojë: humbje pasurore, dhembje fizike e shpirtërore dhe në përgjithësi mund t'i shkaktojë dëm material ose moral. Në secilin rast të tillë, dëmtuesi është i përgjegjshëm dhe i obliguar për kompensim të dëmtuarit në një anë, si dhe i dëmtuari është i autorizuar për të kërkuar zhdëmtimin adekuat (Smaka & Gojani, 2012:316). Veprimi të dëmi jashtëkontraktor mund të jetë në formë të deliktit civil që nënkupton shkaktimin e tij ndaj tjetrit me veprim dëmtues i cili nuk është cenim i ndonjë detyrimi kontraktor të mëhershëm, dhe në atë mënyrë ndërmjet dëmtuesit dhe të dëmtuarit, lind detyrimi origjinar i pavarur i dëmtuesit për ta zhdëmtuar të dëmtuarin (Smaka & Gojani, 2012:316).

Në lidhje me nocionin e përgjegjësisë deliktore civile, nuk ekziston terminologji unike. Ky konstatim vlen si për të drejtën tonë pozitive ashtu edhe për të drejtat tjera (komparative) si në doktrinë, ligje dhe në praktikën gjyqësore. Prandaj, në lidhje me këtë si në shkencën juridike, në ligje ashtu edhe në praktikën gjyqësore përdoret nocioni, “shkaktimi i dëmit” (Alishani, 1989:599). Ky emërtim është më i mirë, sepse ka kuptim më të gjerë. Për këtë thuhet kështu, sepse kur përdoret ky term aty përfshihet si dëmi që shkaktohet nga veprimi deliktor, ashtu edhe nga ai kontraktor, si dhe të gjitha trajtat e dëmit që mund të shkaktohen në marrëdhënie të ndryshme juridike (Alishani, 1989:599). Mirëpo ne për objekt studimi nuk i kemi kontratat, por një marrëdhënie tjetër juridike të detyrimit që sipas legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar njihet, si veprim i paligjshëm me anë të shkaktimit të dëmit në personin ose në pasurinë e tij (neni, 608 i KCSH). Nga përkufizimi i detyrimeve që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor, nga elementet e tij përbërëse duhet pasur parasysh se, detyrimi për shpërblimin e dëmit nuk lind vetëm me shkaktimin e dëmit, pasi që duhet të ekzistojnë edhe elementet e tjera, si kundërligjshmëria e sjelljes, lidhja shkakësore e faji, të cilat nuk mund të merren parasysh pa praninë e dëmit të shkaktuar (Gjata, 2010:28). Pra, shkaku qëndron në shkaktimin e dëmit, ndërsa shpërblimi i tij në përgjegjësinë për të. Nga kjo shihet se në Kodin Civil shqiptar në fuqi është dhënë përkufizim mjaft i gjerë i kuptimit të detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmit. Kështu në paragrafin e parë të nenit 608 të KCSH thuhet: ”Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar”. Pra, një nga parimet themeltare të bashkëjetesës në shoqërinë njerëzore është ndalimi për t’i shkaktuar dëm tjetrit - “*alterum non laedere*” ose “*neminem laedere*”. Zbatimi i tij gjen rregullim të përgjithshëm në KCSH dhe në veçanti në dispozitat për përgjegjësinë civile

jashtëkontraktore të parashikuara nga nenet 608 e vijues të tij. Në bazë të kësaj përgjegjësie, e njohur si “përgjegjësia akuilane” “*lex Aquilia de damno*”, cilido që shkelë të drejtat dhe interesat e ligjshme të një tjetri detyrohet ta dëmshpërblejë atë. Nëpërmjet dëmshpërblimit synohet, pikërisht rivendosja e plotë e të dëmtuarit “*restitutio in integrum*” në gjendjen e mëparshme “*status quo ante*”, në të cilën ai do të gjendej nëse nuk ndodhte fakti i paligjshëm (Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007). Prandaj, në zbatim të neneve 608, 625, 643/a e vijues të Kodit Civil, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se: “Çdo subjekt i cenuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore nga fakti i paligjshëm edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv, për të kërkuar “*ius proprius*” dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vet paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm” (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007).

Këtë lloj të përgjegjësisë civile mund ta definojmë në dy kuptime:

1. përgjegjësinë deliktore civile në kuptimin e gjerë dhe në
2. përgjegjësinë deliktore civile në kuptimin e ngushtë.

Në kuptimin e gjerë, përgjegjësia për dëmin do të thotë detyrë që të shpërblehet dëmi, i cili është shkaktuar. Të jesh përgjegjës d.m.th, të kesh borxh dëmshpërblimin. Përkitazi për këtë çështje, përgjegjësia për dëmshpërblim quhet edhe përgjegjësi deliktore civile (Milosheviç, 1977:143). Ndërsa në kuptimin e ngushtë, përgjegjësia deliktore civile është

kur i shkaktohet dëm tjetrit me veprimin kundërligjor dhe me fajin e dëmtuesit, pra të atij që e kryen veprimin, prandaj përgjegjësia për dëmin paraqitet si pasojë e dëmit të shkaktuar (Milosheviç, 1977:143). Secili subjekt i së drejtës është i detyruar që të përmbahet nga veprimet dëmtuese për subjektin tjetër. Përkitazi për këtë, nëse i shkatohet dëm subjektit tjetër, atëherë atë është i detyruar t'ia kompensojë (Smaka, 1996:175). Përgjegjës mund të jetë subjekti si shkaktues i dëmit, ose ndonjë tjetër, që është në marrëdhënie të veçantë me shkaktuesin e dëmit, në rend të parë poseduesi i sendit të rrezikshëm ose organizuesi i veprimit të rrezikshëm (Dauti, 2008:145). Përgjegjësia e këtyre subjekteve është përgjegjësi juridiko civile, sepse ajo është e rregulluar me norma juridike të së drejtës civile në kuptimin objektiv. Pra, ekziston rregull e përgjithshme juridike në përgjegjësinë civile, që çdo subjekt duhet të përmbahet nga veprimet e veta që mund t'i shkaktojë dëm tjetrit (Dauti, 2016:152). Është e ndaluar në të gjitha rendet juridike në botë, që tjetrit t'i shkaktohet dëmi (Radisic, 1979:161). LMD në Kosovë, në nenin 9 përmban rregullën imperative, se “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktojë dëm tjetrit”.

Dëmi mund të shkaktohet në mënyrat më të ndryshme, në varësi të mënyrave të sjelljes së subjektit që shkakton atë. Kur themi “subjektit”, duhet të kemi parasysh si personat fizik ashtu edhe ata juridik pa dallim, madje edhe vetë shtetin në tërësi (organet e të cilit shkaktajnë dëmin), pasi siç dihet edhe shteti është subjekt i posaçëm i marrëdhënieve juridike civile (Gjata, 2010:28-29). Sjellja e subjektit që shkakton dëmin mund të jetë me veprim ose mosveprim: Me veprim dëmi shkaktohet, kur subjekti ndërmerr veprime të caktuara “*commisio*” p.sh: then xhamin e shtëpisë, ndërsa me mosveprim dëmi shkaktohet

kur subjekti nuk ndërmerr veprim të caktuar “*ommissio*”, si p.sh. mosmarrja e masave të parashikuara në ligj për sigurimin teknik në punë, ose për mbrojtjen e kalimtarëve gjatë periudhës së ndërtimeve, që ka sjellë si pasojë lëndimin e punëtorit ose të kalimtarit (Gjata, 2010:29).

Shkaktimi i dëmit nga sendet, përfshin të gjitha rastet e dëmit të shkaktuar nga sendet e caktuara, të cilat paraqesin rrezik të shtuar për rrethin e caktuar shoqëror, p.sh: dëmi i shkaktuar nga helmet, eksplozimi i gazrave, rryma elektrike, etj, (Dauti, 2016:154). Shkaktimi i dëmit nga ndodhitë natyrore përfshinë rastet, si p.sh: rrufeja, stuhia, vërshimet e lumenjve, orteqet e borës, tërmetet, etj. Mirëpo për dëmin e shkaktuar nga ngjarjet natyrore nuk lind detyrimi për shpërblimin e tij, përveç kur është parashikuar në kontratën e sigurimit të pasurisë ose personit, shpërblimi me vërtetimin e rastit (një prej ngjarjeve të paparashikuara), si përmbytjet, tërmetet, shembje toke, vjedhje, etj (Gjata, 2010:29). Ai mund të paraqitet edhe në mënyra tjera, si p.sh: me rastin e shkaktimit të lëndimit trupor ose vrasjes së personit fizik, cenimit të autoritetit, prestigjit të ndonjë subjekti, etj.

Lidhur me shkaktimin e dëmit, është bërë dallimi i dy llojeve të veprimit ose mosveprimit, me të cilat është shkaktuar ai, *delikti* dhe *gati delikti* “*kuazidelikti*”. Sipas të drejtës franceze (që këto institucione i ka marrë nga e drejta romake), delikt quhet dëmi i shkaktuar me dashje “*dolus*”, kurse gati delikt është ai dëm i cili është shkaktuar nga pakujdesia “*culpa*” (Milosheviç, 1977:143). Dashja ekziston kur dëmtuesi me veprimin e vet ka dashur t’i shkaktojë dëm tjetrit, ose e ka pasur me dije se me veprimin e tij, tjetrit mund t’i shkaktohet dëmi (Gorenc, 2010:184). Pra, në këtë rast shkaktuesi i dëmit vepron me dije dhe me qëllim. Ai, me veprimin e tij e dëshiron pasojën, dhe dëmin që i shkaktohet tjetrit.

Ndërsa, pakujdesia nënkupton veprimin e pakujdesshëm të dikujt, ku në këtë rast nuk kërkohet si te dashja, vetëdija për pasojat e mundshme të dëmshme, për përgjegjësinë e shkaktuesit të dëmit. Këtu vetëm se duhet konstatuar se dëmtuesi a ka qenë sa duhet i kujdesshëm në veprimin e vet.

Në përgjegjësinë deliktore civile janë të njohura dy lloje të përgjegjësisë juridike civile: përgjegjësia deliktore civile, që d.m.th. se dëmi është pasojë e veprimit deliktor (dëmi jashtëkontraktor) dhe përgjegjësia juridike kontraktore, që d.m.th. se dëmi shkaktohet nga cenimi i kontratës.

2.2. Ngjashmëritë në mes të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe asaj kontraktore

Detyrimet lindin nga shkaqe të ndryshme. Këto shkaqe janë fakte juridike, d.m.th. fakte të parashikuara në normat ligjore, vërtetimi ose ndodhja e të cilave shkakton lindjen e detyrimeve (Gjata, 2010:14). Në varësi të llojit të faktit juridik, bëhet edhe klasifikimi i detyrimeve. Kur detyrimi ka si burim kontratën, quhet “detyrim kontraktor”, ndërsa kur burimi i detyrimit është një veprim a mosveprim i paligjshëm, do të kemi detyrim nga shkaktimi i dëmit (Gjata, 2010:14-15). Në praktikë, shpeshherë mund të ngatërrohen rastet kur kemi të bëjmë me përgjegjësi kontraktore apo jashtëkontraktore. Për shembull, një person merr me qira një send individualisht të përcaktuar, të cilin më vonë e dëmton me dashje. Qiradhënësi mund të ngrehë padi qoftë duke u mbështetur te kontrata e qirasë, qoftë në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit (Tutulani-Semini, 2016:160). Lind pyetja: si duhet të veprojnë kjo palë dhe ku ndryshon përgjegjësia kontraktore nga ajo

jashtëkontraktore (Tutulani-Semini, 2016:160)? Nga pikëpamja teorike duhet të kemi parasysh se, kur ka vend që të ngrihet padia që rrjedh nga kontrata duhet që ajo të ngritet, e jo të mbështetet personi në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit. Këtë qëndrim e ka mbajtur edhe praktika gjyqësore e shtetit shqiptar (Tutulani-Semini, 2016:160). Dispozitat e KCSH, bëjnë fjalë për detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit që të zbatohen vetëm në ato raste kur kërkohet shpërblimi i dëmeve jashtë marrëveshjeve kontraktore. Në qoftë se dëmi ka lindur si rezultat i mospërbushjes së një detyrimi të rrjedhur nga kontrata, përgjegjësia për dëmin duhet të përcaktohet sipas kushteve të kontratës së lidhur midis dy palëve (Tutulani-Semini, 2016:160).

Përgjegjësia jashtëkontraktore paraqitet si pasojë e shkeljes së parimit për të mos shkaktuar dëm (Mustafaj, 2016:116), prandaj edhe detyrimi për kompensimin e tij krijohet me cenimin e këtij obligimi ligjor. Pra, nga vetë fakti se dëmi është shkaktuar na lindë edhe marrëdhënia e detyrimit, e cila nuk ka ekzistuar më parë. Te përgjegjësia jashtëkontraktore kuptohet detyrimi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj tjetrit nga një veprim konkret dhe jo nga shkelja e ndonjë detyrimi të mëparshëm (Gjata, 2010:23). Ndërsa përgjegjësia kontraktore nënkupton faktin se, palët kontraktuese nuk e kanë përmbushur obligimin e vet që e kanë marrë me kontratë. Palët kontraktuese në këtë rast fare nuk e përmbushin ose ekzekutojnë detyrën e vet ose nuk e kryejnë ashtu siç janë të obliguara me kontratën e lidhur në mes tyre, prandaj edhe për këtë arsye krijohet detyra për debitorin që t'i a shpërblejë dëmin kreditorit për shkeljen e detyrimit. Pra, "përgjegjësia kontraktore supozon ekzistimin e kontratës, e detyrës kontraktore edhe shkeljen e detyrës së kësaj" (Milosevic, 1977:143).

Sikurse te detyrimet kontraktore, edhe te ato jashtëkontraktore, me rastin e shkakimit të dëmit, lind përgjegjësia civile, qoftë kontraktore ose ajo jashtëkontraktore (Mamuti, 2013:71). Në të dyja rastet, subjekti përgjegjës mund të përgjigjet për bazën e shkallës së fajit, por edhe pa pasur faj, veçanërisht kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe nga veprimtaritë e rrezikshme (Mamuti, 2013:71). Nga e gjithë kjo vijmë në këtë përfundim: Të dy llojet e përgjegjësisë si ajo kontraktore dhe jashtëkontraktore përbëjnë nocionin e përgjithshëm të përgjegjësisë civile. Te këto dy përgjegjësi, si te përgjegjësia jashtëkontraktore ashtu edhe te ajo kontraktore është me rëndësi të theksohet se, si njëra ashtu edhe tjetra, gjë të përbashkët kanë kompensimin e dëmit të shkaktuar. Pra, subjekti i cili i shkakton lëndim trupor tjetrit ose e shkatërron sendin, është i detyruar që ta kompensojë dëmin, po ashtu edhe shitësi, i cili nuk ia dorëzon sendin blerësit pa të meta, ose e dorëzon me të meta fizike, është i detyruar që ta kompensojë dëmin.

2.3. Dallimet në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore dhe asaj kontraktore

Në këto përgjegjësi ekzistojnë edhe dallime të dukshme midis tyre, si p.sh: përgjegjësia jashtëkontraktore sjell detyrën e dëmshpërblimit, e cila krijohet pasi që dëmi është shkaktuar. Ajo është edhe detyra e vetme themelore, të cilën dëmtuesi e ka në detyrimin deliktor civil (Milosevic, 1977:144). Pra, përgjegjësinë jashtëkontraktore e krijon vetë fakti i shkakimit të dëmit, ndërsa përgjegjësia kontraktore ekziston me vetë faktin e cenimit të kontratës për shkak të mosekzekutimit ose të ekzekutimit të parregullt të saj (Dauti, 2008:148).

Rregullat e përgjegjësisë kontraktore janë dispozitive (*ius dispositivum*), sepse palët kontraktuese këto rregulla me anë të kontratës mund t'i përjashtojnë, t'i kufizojnë ose t'i zgjerojnë. Në anën tjetër, rregullat te përgjegjësia jashtëkontraktore janë imperative (*ius imperativum*), dhe këto rregulla nuk mund të përjashtohen, por duhet të zbatohen ashtu siç janë paraparë me ligj (Dauti, 2008:148). Në përgjegjësinë kontraktore, debitori, në rast të cenimit të detyrimit të vet duhet ta përmbushë kontratën dhe të shpërblejë dëmin, kurse në përgjegjësinë jashtëkontraktore detyrimi kryesor është shpërblimi i dëmit (Dauti, 2008:148).

Përgjegjësia jashtëkontraktore (deliktore civile) është më e gjerë se përgjegjësia kontraktore. Për dëmin e shkaktuar me veprim të palejueshëm (delikt civil) përgjigjet jo vetëm shkaktuesi i dëmit, por edhe nxitësi, ndihmësi, pronari, poseduesi dhe organizuesi i veprimtarisë së rrezikshme (Dauti, 2008:148). Në të kundërtën, në përgjegjësinë kontraktore, përgjigjet vetëm pala kontraktuese dhe trashëgimtarët e saj, në qoftë se kontrata nuk është e “*intuitu personae*” (Dauti, 2008:148). Përgjegjësia jashtëkontraktore, është më e gjerë dhe këtu ekziston përgjegjësia sipas parimit të fajësisë (subjektive). Ajo mund të bëhet edhe pa faj (objektive). Po ashtu te kjo përgjegjësi ekziston edhe përgjegjësia për veprimet e të tjerëve, me ç'rast një person shkakton dëm, e për këtë përgjigjet personi tjetër (Millosheviç, 1977:144). Te përgjegjësia kontraktore, jepet përgjegjësia vetëm sipas parimit të fajësisë. Përgjegjësia jashtëkontraktore bazohet në fajin e vërtetuar ose të supozuar, ndërsa përgjegjësia kontraktore bazohet gjithnjë në fajin e supozuar. Te përgjegjësia jashtëkontraktore është rregull se, në rastet kur shumë persona shkaktojnë dëm, ata përgjigjen solidarisht, ndërsa te përgjegjësia kontraktore është rregulla

që të përgjigjen ndaras. Përgjegjësia kontraktore solidare krijohet vetëm nëse është kontraktuar veçmas, ose sipas ligjit të caktuar (Milosevic, 1977:144-145). Sa i përket përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe asaj kontraktore ekziston edhe një dallim në mes tyre, ku dallimi është tek afatet e parashkrimit, p.sh: Afati i parashkrimit të përgjegjësia jashtëkontraktore është tri vjet dhe fillon të rrjedhë prej çastit kur i dëmtuari ka marrë vesh për dëmin e shkaktuar të dëmtuesit, ndërsa ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet. Ndërsa të kontratat afatet e parashkrimit ndryshojnë, varësisht prej kontratave. Afati i parashkrimit të kërkesave prej kontratave fillon të rrjedhë nga arritja e atij detyrimi dhe përfundon afatin e paraparë ligjor për atë detyrë konkrete kontraktore.

2.4. Dallimet në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktore dhe asaj penale

Delikti është dukuri e domosdoshme e cila ndodh në të drejtën dhe do të ishte e vështirë të mendohet rendi juridik ku nuk do të ushtroheshin deliktet (edhe pse në aspektin teorik rendi i tillë është i mundshëm të mos humbë karakterin e rendit juridik) (Llukiç & Koshutiç, 1986:231). Me rregullat e përgjegjësisë penale mbrohet shoqëria në përgjithësi, interesi i përgjithshëm i shoqërisë, kurse me rregullat e përgjegjësisë jashtëkontraktore mbrohet interesi i individit, interesi personal i subjektit të së drejtës, qoftë ai i karakterit material apo personal (Mustafaj, 2016:116). Delikti civil paraqet çdo veprim të palejueshëm me anë të të cilit është shkaktuar dëmi dhe që sjellë detyrën që dëmi i shkaktuar duhet të paguhet, kurse vepra penale është vepër e rrezikshme shoqërore e cila është e përcaktuar sipas ligjit si vepër penale dhe për të cilën është paraparë sanksioni i caktuar (Milosevic, 1977:145). Me

veprim të njëjtë të palejueshëm, është e mundur që në të njëjtën kohë të shkaktohet edhe përgjegjësia jashtëkontraktore dhe vepra penale, p.sh: vjedhja e automobilit (Dauti, 2016:156). Gjithashtu, mund të ndodhë që përgjegjësia civile jashtëkontraktore dhe vepra penale të mos shkaktohen në kohë të njëjtë. Pra, nuk është e domosdoshme njëkohësisht të shkaktohen që të dy këto përgjegjësi. Ndodhë raste kur mund të shkaktohet përgjegjësi jashtëkontraktore e mos të ketë vepër penale P.sh: thyerja e dritares së huaj nga pakujdesia, ose kur ekziston vepra penale e nuk ekziston përgjegjësi jashtëkontraktore psh, tentimi i vjedhjes (Dauti, 2016:156).

Siç dimë veprat penale janë të domosdoshme të jenë të parapara me ligj e po ashtu, edhe sanksionet e caktuara patjetër duhet të jenë të parapara me ligj, sepse në përgjegjësinë penale vlen parimi *"nullum crimen sine lege, nulla poena sine lege"* që dmth se, vepra penale duhet të parashihet me ligjin penal dhe për të duhet të parashihet dënimi i caktuar, ndërsa te përgjegjësi jashtëkontraktore ekziston rregulla e përgjithshme: se ai që dikujt i shkakton dëm ka për obligim kompensimin e tij. Në parim, përgjegjësia penale ka si objekt dënimin e një faji, në raport të drejtë me shkallën e tij ndërsa, objekti i përgjegjësisë civile është, të bëjë të mundur ndreqjen e dëmit, në raport të drejtë me përmasat e tij dhe pavarësisht nga serioziteti ose edhe nga fakti i ekzistencës së fajit (Legier, 2008:128). Numri i veprave penale është i kufizuar, ku me to është e kufizuar edhe përgjegjësia penale, ndërsa numri i delikteve civile është i pakufizuar që d.m.th. se, në përgjegjësinë jashtëkontraktore, delikti nuk është i numëruar në mënyrë taksative. Veprimet deliktore për shkak të llojshmërisë që mund të ndodhin në jetën e përditshme, nuk mund të parashihen të gjitha me ligj, dhe si të tilla, nuk numërohen në mënyrë taksative nga ana e ligjvënësit

(Mamuti, 2013:68). Prandaj në shumicën e rasteve, momentet e shkaktimit të dëmit dhe efektet e tij, ligjvënësi mundohet ti zgjidhë në mënyrë parimore (Mamuti, 2013:68). Sa u përket kushteve të krijimit të tyre, përgjegjësi jashtëkontraktore është më e gjerë se sa përgjegjësia penale. Përgjegjësia penale supozon ekzistimin e veprimit të kundërligjshëm, ndërsa veprimi i kundërligjshëm nuk kërkohet përherë për krijimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore (Millosheviç, 1977:145). Në kontekst të kësaj mund të themi se ekziston përgjegjësia për dëmin nga sendet e rrezikshme edhe pse veprimi i kundërligjshëm nuk ekziston, sepse këtë e arsyeton përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Edhe faji te përgjegjësia penale nuk është i njëjtë me fajin te përgjegjësia jashtëkontraktore, për arsye se te përgjegjësia penale ai është i lidhur për kryerësin e veprës penale, ndërsa te përgjegjësia jashtëkontraktore nuk duhet të jetë i lidhur për dëmtuesin (Millosheviç, 1977:145). Ekzistojnë rastet për veprimet e tjetrit, ku nuk është e nevojshme që të vërtetohet përherë fajësia, mirëpo ajo në disa raste vetëm se supozohet dhe nuk vërtetohet sipas cilësive individuale të dëmtuesit. Kjo gjen mbështetje sipas kriterëve objektive, respektivisht sjelljes së dëmtuesit ndaj sjelljes së njeriut të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm. Pra, nga kjo rrjedh se, faji te përgjegjësia jashtëkontraktore është më i gjerë se te vepra penale, sepse ai caktohet sipas kriterëve objektive (Millosheviç, 1977:145). Një dallim tjetër në mes të përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe asaj penale, ekziston në atë se përgjegjësia jashtëkontraktore ka për pasojë sanksionin pasuror (sanksionin civil) dhe krijon detyrimin për dëmshpërblim, kurse ajo penale sanksionin penal, dënimin i cili është i paraparë me ligjin penal (Millosheviç, 1977:145). Pra, sanksioni i përgjegjësisë penale është personal, kurse sanksioni i përgjegjësisë civile jashtëkontraktore është sanksion pasuror, sepse cenohet pasuria e shkaktuesit të dëmit (Dauti, 2016:156). Qëllimi i sanksionit penal është

pengimi i veprimtarisë së rrezikshme shoqërore, pengimi i ekzekutuesit që të mos bëjë vepër tjetër penale dhe për përmirësimin e tij, ndikimin edukativ në të tjerët që të mos kryejnë vepra tjera të tilla, zhvillimin e moralit dhe disiplinës së përgjithshme në shoqëri. Ndërkaq qëllimi i sanksionit pasuror është që t'i evitojë pasojat e dëmit në pasurinë e personit të dëmtuar respektivisht kompensimin e dëmit të shkaktuar. Sanksioni pasuror dhe ai penal dallohen edhe kur shprehen në para. Atë, që e paguan kryesi i veprës penale paraqet dënimin në para, ndërsa dëmtuesi të shkaktimi i dëmit ka për obligim dëmshpërblimin e tij, gjithashtu në para. Dënimi në para i paguhet shoqërisë, ndërsa dëmshpërblimi në para i paguhet personit të dëmtuar (Millosheviç, 1977:145). Lartësia e dënimit me para në përgjegjësinë penale parashihet sipas ligjit, kurse në përgjegjësinë civile jashtëkontraktore gjykata e cakton shpërblimin me para duke pasur parasysh rrethanat e caktuara (Dauti, 2008:149). Gjykata civile është e lidhur me vendimin e gjykatës penale. Pagimi i dënimit në para si pasojë e dëmit të shkaktuar, kryhet në bazë të aktgjykimit, që merret nga ana e gjykatës, e cila është edhe organi i vetëm i autorizuar që ta kumtojë atë sanksion penal, ndërsa shpërblimi i dëmit në para me vendim të gjykatës nuk është e domosdoshme për t'u konstatuar. Ai mund të caktohet edhe me marrëveshje midis të dëmtuarit dhe dëmtuesit (Millosheviç, 1977:145). Në rast të vdekjes të kryerësit të veprës penale, dënimi në para nuk paguhet nga trashëgimtarët e tij, ndërkaq dëmshpërblimi në para paguhet nga ana e trashëgimtarëve të dëmtuesit, sepse paraqet sanksion pasurie e cila në rast të vdekjes kalon te trashëgimtarët e të vdekurit si edhe çdo detyrim tjetër (Millosheviç, 1977:145). Te përgjegjësia penale në rast të pamundësisë së pagimit të dënimit të caktuar me para, ai mund të zëvendësohet me dënim me burgim, ndërsa dëmshpërblimi në para nuk mund të zëvendësohet me asnjë rast me dënim me burgim,

sepse ai, sipas natyrës është sanksion pasurie (Millosheviç, 1977:145)¹. Në qoftë se dënimi nuk paguhet brenda afatit të caktuar, ai zëvendësohet me burgim, ndërsa në rast se vdes i dënuari, ky dënim nuk mund të trashëgohet. Kompensimi i dëmit i gjykohet të dëmtuarit dhe ai nuk mund të zëvendësohet me dënim me burgim. Po ashtu edhe rregullat e parashkrimit në përgjegjësinë penale kanë afat më të gjatë, se sa rregullat e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore.

Pra, përgjegjësia jashtëkontraktore ose përgjegjësia akuiliane është një përgjegjësi që rrjedh nga rastet e parashikuara shprehimisht në ligjin civil por jo vetëm. Nëse në të drejtën penale prokurori a i dëmtuari akuzues ngre akuzë për veprën penale të kryer, të njëjtën kuptim për analogji merr edhe kur i dëmtuari padit dëmtuesin për dëmin e shkaktuar, përgjithësisht në të drejtat që ligji ia mbron (Mataj, 2015:1). Midis palëve nuk duhet të ketë përgjegjësi të mëparshme kontraktuale pasi në të kundërt do të mbahej përgjegjësi që rrjedh nga kontrata. Në të dy rastet ka dëm të ardhur, porse në të drejtën penale dëmi ka karakter sa individual aq edhe publik për sa kohë merren në mbrojtje nga shteti të drejtat e ligjshme, ndërsa në të drejtën civile, dëmi ka karakter civil dhe vetëm pala e dëmtuar drejtpërdrejt apo jo, ndjek rrugën gjyqësore për të rivënë në vend të drejtën (Mataj, 2015:1).

¹ Kjo e drejtë është e garantuar edhe me Konventa ndërkombëtare. Këtë shprehimisht e gjejmë Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Protokoli nr.4. Në Nenin 1, të këtij protokoli parashihet se “Askush nuk mund të privohet nga liria për të vetmen arsye se nuk është në gjendje të plotësojë një detyrim. Shembull mund të merret rasti kur dikush e humb të drejtën e punës për shkak të vonesës së avio transportuesit. Në këtë rast, personi përgjegjës nuk do të burgoset, por do të detyrohet të kompensojë dëmin e shkaktuar për shkak të mospërmbushjes së obligimit të krijuar në mes të udhëtarit i cili ka pësuar dëm dhe kompanisë avio transportuese. Sanksioni pasuror e ruan ekuivalencën midis pjesëmarrësve në raportin juridiko civil. Pra nëse një palë i zvogëlohet masa pasurore ose i shkaktohet dëm tjetër, ka të drejtë që nga masa pasurore e palës tjetër të kompensojë dëmin e shkaktuar ose të kërkojë kthimin në gjendjen fillestare. (Prof. Dr. Abdullah ALIU, E drejta civile, Pjesa e Përgjithshme, 2008, fq. 14).

2.5. Debati teorik lidhur me kriteret dhe kushtet që duhen të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor

Me bazën e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor nënkuptojmë arsyet për të cilat përgjigjet dikush për dëmin e shkaktuar, që mund të jenë, faji ose kur ai nuk merret parasysh. Faji është baza e përgjegjësisë civile të përgjegjësia jashtëkontraktore (deliktore) dhe ajo kontraktore, ose përgjegjësia kur faji nuk merret parasysh (është për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaria e rrezikshme). Në doktrinë ka autorë që e trajtojnë si bazë të përgjegjësisë edhe drejtshmërinë (Radisic, 1980:163-164). Në rregullat e drejtshmërisë, LMD në Kosovë, në nenin 151, paragrafi 1 dhe 2, thekson se “Në rast se shkaktohet dëmi, të cilin e ka shkaktuar personi, i cili për atë dëm nuk ka qenë përgjegjës, ndërsa shpërblimi nuk mund të nxirret nga personi, i cili e ka pasur për detyrë të kryejë mbikëqyrjen mbi të, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të dëmtuesit dhe të dëmtuarit, ta gjykojë dëmtuesin që ta shpërblejë dëmin tërësisht ose pjesërisht. Në qoftë se dëmin e ka shkaktuar i mituri me aftësi për të gjykuar, i cili nuk është në gjendje ta shpërblejë, gjykata mundet, kur këtë e kërkon drejtshmëria, e sidomos duke marrë parasysh gjendjen materiale të prindërve dhe të dëmtuesit, t’i detyrojë prindërit ta shpërblejnë dëmin, tërësisht ose pjesërisht”. Këto dhe veprimet tjera mund të sajojnë rastet e bazës së përgjegjësisë, të mbështetura në rregullat e drejtshmërisë. Këto veprime mirren si raste korrigjuese të përgjegjësisë për dëmin (Alishani, 1989:609). Mirëpo, nga kjo duket se drejtshmëria nuk duhet të merret si bazë e përgjegjësisë, sepse ajo është ideal i të drejtës në çdo sistem juridik, ku rëndom supozon zbatimin e drejtë të rregullave juridike, mandej përmirësimin e veprimeve të padrejta të shkaktuara, duke ndikuar në krijimin e ideve të shumta në fusha të ndryshme të së drejtës

(Alishani, 1989:609). Rastet e përgjegjësisë, sipas rregullave të drejtshmërisë, janë veprime kur kjo përgjegjësi mund të ekzistojë nën kushte të caktuara. Sipas asaj që u theksua kuptohet se, këto janë raste të caktuara që çmohen nga ana e gjykatës, por nuk përmenden si bazë e veçantë e përgjegjësisë civile për dëmin (Alishani, 1989:609).

Në të kaluarën dhe në të drejtën bashkëkohore baza e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor ka zgjuar dhe zgjon interesim midis shumë autorëve në fushën e së drejtës civile. Pikërisht, këtu mund të vërehet se kanë ekzistuar autorë dhe të drejta që bazën e përgjegjësisë e kanë sajuar në fajin e shkaktuesit të dëmit (Alishani, 1989:609). Nga ana tjetër, në të drejtat e mëvonshme ka pasur autorë që kanë mbrojtur idenë e përgjegjësisë pa faj, në bazë të rrezikut të krijuar, si dhe grupit tjetër që mbron idenë e ekzistimit të bazës së përgjegjësisë sipas fajit dhe të asaj pa faj (Alishani, 1989:609). Këto mendime kanë bërë të mundshme që më lehtë të vërehen anët negative dhe pozitive të vetëm një baze të përgjegjësisë, edhe atë sipas fajit ose pa faj (Konstantinovic, osnov odgovornosti za prouzrokovanu stetiu, Arhiv, br, 1-2, Beograd, 1976, fq,139 dhe Alishani, Osnovni koncept ZOO, Pravo, br, 3-4, Prishtinë, 1982, fq, 142). Me fjalë të tjera këto dy mendime ekstreme kanë bërë të mundshme, që së pari këto teori të zhvillohen deri në nivelin më të lartë, duke ndihmuar që shumë lehtë të vërehen mungesat e tyre. Gjithashtu, nga ana tjetër, më lehtë vërehen rastet e përdorimit ekskluziv të njërës bazë, që mund të sjellë padrejtësi të ndryshme (Alishani, 1989:609). Më vonë kanë filluar t'i përkrahin dy bazat e përgjegjësisë civile, atë subjektive (sipas fajit) ashtu edhe atë objektive (pa faj), ku që të dyja kanë fushën e vet të zbatimit (Machiedo, osnov odgovornosti za prouzrokovanu stetiu “ Gradjanska odgovornost”, Beograd, 1966, IDN, fq, 31-32).

Në këtë mënyrë mund të thuhet se, ekzistojnë të drejta të ndryshme në të drejtën bashkëkohore. Ka asosh, ku me dispozita ligjore nuk përkrahen të dy bazat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Mirëpo praktika gjyqësore dhe doktrina e tyre, përkrahin bazën e përgjegjësisë sipas fajit ashtu edhe atë pa faj (Alishani, 1989:609). Kjo ka qenë dhe është e domosdoshme në fazën e tanishme të zhvillimit ekonomik dhe jetës së njeriut bashkëkohës në shoqërit e civilizuara (Weil Alex, Droit Civil, les obligations, Paris, 1971:606-612 & Starck, Boris, Droit Civil, les obligaciones, Paris, 1972:28-32). Këtu duhet theksuar se, ende ka autorë që mendojnë se baza e përgjegjësisë civile në çdo sistem është subjektive, e plotësuar me rastet e përgjegjësisë objektive (Enciklopedija imovinskog prava i prava udruzenog rada III, Beograd, 1978, fq, 425). Disa mendojnë se për të drejtën bashkëkohëse, si në të drejtën tonë, ashtu edhe në të drejtën krahasuese, duhet të jenë dy baza të përgjegjësisë civile, ku në to duhet të sillet krejt teoria e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar (Alishani, 1989:610).

Në legjislacionin civil shqiptar nuk janë dhënë përkufizime të përgjithshme për të gjitha llojet e detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmit. Kjo shpjegohet me faktin se këto lloj detyrimesh nuk mund të përfshihen në një përkufizim gjithëpërfshirës, sado i gjerë që mundë të jetë (Gjata, 2010:32). Prandaj në Kodin Civil, është dhënë përkufizimi i përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit me të gjitha elementet (kushtet) përbërëse të kësaj përgjegjësie. Pra, elementi i parë është dëmi i shkaktuar ndaj tjetrit në personin ose pasurinë e tij; elementi i dytë, është kundërligjshmëria e veprës (veprimi ose mosveprimi); elementi i tretë, është lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes së kundërligjshme dhe dëmit, si dhe elementi i katërt, është faji i personit që ka shkaktuar dëmin. Në rast se mungon cildo

prej këtyre elementeve, si rregull nuk lindë përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit (Gjata, 2010:32 & Semini, 2016:201). Autorë të tjerë lidhur me kushtet për dëmin e shkaktuar, përmendin këto elemente: që të shkaktohet dëmi, që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin e kundërligjshëm, që të ekzistojë faji i dëmtuesit, që të ekzistojë aftësia deliktore dhe që të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit (Dauti, 2016:158).

2.6. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës franceze

Sipas të drejtës franceze përgjegjësia jashtëkontraktore ekziston kur një person i shkakton dëm një tjetri, ku viktima mund t'i kërkojë dëmshpërblim. Kështu ndodhë jo vetëm kur dëmi shkaktohet nga veprimi personal (faj me dashje ose nga pakujdesia), por edhe kur shkaktohet nga sendet nën zotrimin e tij ose të personave që punojnë për të (përgjegjësia për veprimet e tjetrit) (Legier, 2008:127). Përkitazi për këtë, objekti i përgjegjësisë civile është ta rivendosë viktimën në gjendjen e mëparshme me anë të dëmshpërblimit në natyrë, nëse kjo është e mundur, ose me të njejtën vlerë (pagesa e dëmshpërblimit dhe e interesave të quajtura kompensuese, p.sh. në rastet e dëmtimeve trupore (Legier, 2008:127). Përgjegjësia është civile në kuptimin që ajo sjell një detyrim të një natyre civile, detyrimin për të riparuar dëmin. Kjo karakteristikë e dallon atë nga përgjegjësia penale. Përgjegjësia është jashtëkontraktore kur rrethanat zhvillohen jashtë kuadrit të kontratës. Atëherë, themi se ajo buron nga një *delikt civil ose quasi-delikt* (Legier, 2008:127).

2.6.1. Përgjegjësia për faj ose pa faj, regjimi i parashikuar nga hartuesit e Kodit Civil Francez

Për autorët e Kodit Civil, (1804) ka vetëm një burim përgjegjësie: fajin. Parimi parashikohet në nenin 1382 ku thuhet se: “çdo veprim i çfarëdoshëm i njeriut, i cili u shkakton një dëm të tjerëve, e detyron atë që e ka shkaktuar me fajin e tij ta ndreqë atë”. *Delikt civil* është një faj i kryer me dashje (neni, 1382); ndërsa *quasi-delikti*, të dëmi jashtëkontraktor është një faj i kryer pa dashje, nga pakujdesia ose neglizhenca (neni, 1383) (Legier, 2008:127). Në përgjithësi, faji duhet provuar (neni, 1382-1383) por për disa raste të caktuara hartuesit e Kodit kanë parashikuar, prezumimin e fajit (Legier, 2008:128).

2.7. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës gjermane

Rregullat për ekzistimin e përgjegjësive civile për dëmin jashtëkontraktor klasifikohen në këto kategori: rasti i përgjegjësive së personit (në bazë të fajit-subjektive), përgjegjësia për faj të prezumuar, (përgjegjësia për veprimet e tjetrit) dhe së fundmi përgjegjësia e cila për juristët gjerman nuk ka më karakterin e një përgjegjësie fajtoze, përgjegjësia për rreziqe (përgjegjësia pa faj-objektive) (Fromont, 2009:43). Kodi Civil Gjerman për veprimet që përpiqen të përfitojnë abstenim për një akt të paligjshëm ose pushimin e një rasti që rrjedh nga një akt i paligjshëm, parashikon veprime të tilla vetëm atëherë kur akti i paligjshëm cenon një të drejtë absolute, të tillë si e drejta e pronësisë ose e emrit (Fromont, 2009:46). Ndërsa jurisprudenca ka tendencë ta zgjerojë fushën e këtyre veprimeve, ku veprimet e tilla t'i pranojë ndryshe nga aktet joligjore, të cilat cenojnë të drejtat e personalitetit apo të drejtën e ndërmarrjes për të funksionuar qetësisht, veçanërisht ndryshe nga deklaratat e

shpërndara nga mediet (Fromont, 2009:46). Por, parimi i përgjithshëm i përgjegjësisë për fajin e shkaktuar është ndryshuar duke i'u përgjigjur nevojës në rritje për të mbrojtur pjesë të mëdha të komunitetit nga varfërimi që mund t'i shkaktojë një aksident. Ekzistojnë statute të veçanta për tipa të rëndësishëm aksidentesh, të cilat i japin viktimës kompensim për humbjen e tij, pa pasur nevojë që ai të provojë fajin e të paditurit, si, psh: aksidentet industriale, hekurudhore, ajrore si dhe shumë të tjera (Swegert & H. Kotz, 1994:204-205).

2.8. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës Italiane

Sipas nenit 2043 të Kodit Civil Italian, çdo person që ka shkaktuar një dëm të paligjshëm me dashje ose nga pakujdesia, duhet ta dëmshpërblejë. Kjo dispozitë huazon nga e drejta franceze klauzolën e përgjithshme të përgjegjësisë dhe nga e drejta gjermane kërkesën e dyfishtë të paligjshmërisë dhe fajit (Fromont, 2009:60). Me dëm të paligjshëm jurisprudenca gjermane nënkupton çdo dëm material dhe jo vetëm dëmet e shkaktuara ndaj objekteve të caktuara ose personave, por edhe dëmin financiar. Mirëpo sipas shembullit gjerman, dëmshpërblimi i dëmit moral është i përjashtuar, me përjashtim të rasteve kur dëmi shkaktohet nga disa lloj shkeljesh penale (neni, 2049) (Fromont, 2009:60). Kodi Civil Italian ka parashikuar disa regjime përgjegjësie për faj të një tjetri psh: personi që ka ngarkim një të pa aftë ose një fëmijë, përgjigjet për dëmet e shkaktuar nga ata (nenet, 2046-2048) me përjashtim të rasteve kur ai arrin të provojë se i kishte marrë të gjitha masat për të shmangur dëmin; drejtuesi i punimeve përgjigjet për të gjitha dëmet e shkaktuara nga të punësuarit e tij, gjë që bie në kundërshtim me të drejtën gjermane (Fromont, 2009:60-61).

Kodi civil Italian ka parashikuar, gjithashtu disa regjime përgjegjësie pa faj që lidhet me sendet nga përgjegjësia, nëse arrin të provojë se i kishte marrë të gjitha masat për ta shmangur dëmin, si: rasti i përgjegjësisë që lidhet me aktivitete të rrezikshme (neni, 2050) ose me ndërtesat që janë pronë e tij (neni, 2053), pastaj nga kafshët ose objektet që i ka ose i ka pasur në ruajtje (neni, 2051-2052) (Fromont, 2009:61). Në raste të tjera vetëm prova e përdorimit të objektit në kundërshtim me dëshirën e pronarit të tij e çliron këtë të fundit nga përgjegjësia, si rasti i pronarit të automjeteve motorike (neni, 2054). Shumë ligje të veçanta kanë parashikuar përgjegjësinë pa faj: Ligji i 6 korrikut 1986 e përkufizon këtë përgjegjësi në lidhje me dëmet ekologjike (Fromont, 2009:61). Duke ndjekur kështu shembullin gjerman, me një dekretligj të datës 24 maj 1988 është bërë përshtatja e kësaj përgjegjësie me të drejtën komunitare për përgjegjësinë e produkteve për dallim me të drejtën franceze, bashkimi i përgjegjësisë kontraktuese me përgjegjësinë me faj është i mundshëm (Fromont, 2009:61).

2.9. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës spanjolle

Përgjegjësia me faj bazohet në një klauzolë të përgjithshme, të ngjashme me nenin 1382 të Kodit Civil francez: “Ai që me veprimin ose mosveprimin e tij i shkakton një personi tjetër një dëm për faj të tij ose të pakujdesisë së tij, është i detyruar të shpërblejë dëmet e shkaktuara” (neni, 1902). Dëmi moral është i dëmshpërblyeshëm ashtu si edhe dëmi material (Fromont, 2009:70). Mirëpo, nuk ka dispozita të ngjashme me nenin 1384 të Kodit Civil francez në lidhje me përgjegjësinë për kundërt sendeve, por vetëm dispozita të

veçanta. Kodi Civil ka parashikuar vetëm një numër të caktuar përgjegjësishë për faj të prezumuar, ashtu edhe në fushën e përgjegjësisë në lidhje me objektet (pikërisht në lidhje me nënkontraktuesit, neni-1902), ashtu edhe në fushën e përgjegjësisë pa faj (pikërisht për kafshët, ndërtesat, dëmet ndaj fqinjve, sendet që bien nga ndërtesat, neni-1905) (Fromont, 2009:70). Disa ligje speciale kanë krijuar regjimin e përgjegjësive pa faj: përgjegjësia në aksidente automobilistike (ligji i 1968-së), përgjegjësia ndaj produkteve (ligji i 1994-së) (Fromont, 2009:71).

2.10. Përgjegjësia jashtëkontraktore sipas të drejtës zvicerane

Sipas të drejtës Zvicerane ekzistojnë burime të ndryshme të përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor, si p.sh. përgjegjësia që buron nga personi është përgjegjësi për faj (Fromont, 2009:86). Sipas nenit 41, të kodit të detyrimeve “ai që i shkakton një dëm, një personi tjetër me veprime të paligjshme me dashje apo nga pakujdesia, duhet ta dëmshpërblejë”. Faji është, gjithashtu një akt i kritikueshëm që meriton qortim të ashpër. Faji vlerësohet sipas personalitetit të autorit (aftësia e të reflektuarit) edhe sipas rrethanave (mundësia e të vepruarit duke respektuar ligjin) (Fromont, 2009:86-87). Përgjegjësia e punëdhënësit për veprimet e të punësuarve është në parim një përgjegjësi për faj të prezumuar, meqenëse prodhuesi mund të çlirohet nga përgjegjësia e tij nëse arrinë të provojë, “se ai i ka marrë të gjitha masat e duhura për të shmangur një dëm të tillë, ose masat e marra nuk kanë mundur të pengojnë dëmin e ndodhur” (neni, 55) (Fromont, 2009:87). Mirëpo përveç faktit se, mungesa e fajit nga ana e punëdhënësit përkufizohet në

mënyrë kufizuese nga ligji aktual (miratuar në vitin 1971), praktika nuk i pranon lehtë provat që e shfajësojnë punëdhënësin, për më tepër nuk është e nevojshme që punëmarrësi të ketë bërë faj. Për këtë arsye doktrina zvicerane përgjegjësinë objektive, e njeh si përgjegjësi pa faj (Fromont, 2009:87). Përgjegjësia e personave që mbajnë kafshë përkufizohet në mënyrë shumë të ngjashme me atë të punëdhënësit për veprime të punëmarrësit; përgjegjësia e pronarit të ndërtesës varet nga ekzistenca e të metave në ndërtim ose në mirëmbajtje (nenet 56 deri në 59) (Fromont, 2009:87). Në vitin 1999 është botuar një planprojekt reforme për përgjegjësitë dhe aktivitetet veçanërisht të rrezikshme, që rregullonte edhe përgjegjësinë që rrjedh nga veprimtaria e ndihmësve. Gjithashtu, pranohet jo zyrtarisht ajo që juristët francez e quajnë bashkimi i përgjegjësisë kontraktuese dhe me faj, që në fakt s'është veçse një mundësi zgjedhjeje (Fromont, 2009:87).

2.11. Llojet e përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor

Vlerat njerëzore shprehen vetëm atëherë, kur i përgjigjen shkallës më të lartë të civilizimit e të zhvillimeve bashkëkohore. Megjithatë, përpjekjet për një nivel më të lartë të mbrojtjes së këtyre vlerave vazhdojnë edhe sot, duke filluar nga mbrojtja juridike, që u jepet atyre, e cila mund të jetë shumëdimensionale (Pjetra, 2013:32). Mbrojtja juridiko-civile e vlerave njerëzore, konkretisht ekzistenca e përgjegjësisë juridike-civile për dëmin e shkaktuar është segment i rëndësishëm në kuadër të sigurimit të një niveli më të lartë mbrojtjeje të të mirave njerëzore të mbrojtura juridikisht (Pjetra, 2013:32). Përcaktimi i pozitës juridike të personit përgjegjës dhe i të dëmtuarit në marrëdhëniet juridike, që lindin me shkaktimin e dëmit, rezulton që të jetë një prej vlerave kryesore për të garantuar sigurinë juridike (Pjetra,

2013:32). Për shkak të kompleksitetit të marrëdhënieve të detyrimit, problem kryesor ka qenë dhe mbetet çështja e përcaktimit të përgjegjësisë. Në praktikën gjyqësore, çështja e konstatimit të përgjegjësisë së subjektit përgjegjës shpesh herë mbetet shumë e ndërlikuar, sepse dëmet që mund t'iu shkaktohen njerëzve mund të jenë me natyrë të ndryshme, sa i përket të mirës materiale, që mund të cenohet, sikurse është dëmtimi i pronës, dëmtime fizike apo psikike, dëm moral etj. (Pjetra, 2013:33). Problematika e dëmit, zë një vend të rëndësishëm në sferën e të drejtës së detyrimeve. Përgjegjësia për shkaktimin e një dëmi është parakushti bazë për kompensim dhe cakton kufijtë e zhdëmtimit (Pjetra, 2013:35). Është tradicionale të thuhet se kush e shkaktonte dëmin me fajin e vet, përgjigjet për dëmin e shkaktuar (përgjegjësia subjektive). Por kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, ekziston përgjegjësia për sendet ose veprimtaritë e rrezikshme (përgjegjësia objektive), ndërsa kur dikush përgjigjet për veprimet e tjetrit, ekziston përgjegjësia për të tjerët. Prandaj, caktimi i kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor si dhe llojet e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore që do t'i trajtojmë në kapitujt në vijim të këtij punimi janë: përgjegjësia subjektive civile dhe kriteret që duhet plotësohen për ekzistimin e saj **(përgjegjësia sipas fajit)**; përgjegjësia objektive dhe kriteret që duhet plotësohen për ekzistimin e saj **(përgjegjësia pa faj)** dhe përgjegjësia për të tjerët dhe kriteret që duhet plotësohen për ekzistimin e saj **(përgjegjësia sipas fajit të supozuar)**.

2.12. Përfundim

Nga vështrimi teorik i këtij kapitulli pamë se nevoja për rregullimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor është e një rëndësie të madhe, sepse jemi dëshmitarë të përditshmërisë sonë në të cilën dëmi u shkaktohet subjekteve në forma të ndryshme. Pra, ai shkaktohet në vetë njeriun, në pasurinë e tij dhe në interesat legjitime të mbrojtura.

Nga trajtimi i këtij kapitulli vërejtëm se shkaktimi dëmit është burim i veçantë i marrëdhënieve juridiko civile, andaj edhe trajtohet në legjislacionet civile, me theks të veçantë edhe në legjislacionin tonë civil, përkatësisht në fushën e së drejtës detyrimore si, në KCSH ashtu edhe në LMD në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, u pa se përgjegjësia civile për dëmin jashtëkontraktor aplikohet në një fushë të gjerë të jetës së përditshme, ajo shkaktohet në mënyra të ndryshme dhe nga persona të ndryshëm qoftë persona fizik apo juridik. Pra, krijohet në mënyra të ndryshme të personit të caktuar, me sjellje dhe veprime me të cilat ndërmerret diçka si një bërje e ndonjë veprimi konkret ose mosbërje, respektivisht sjellje pasive e subjektit.

Po ashtu në këtë kapitull që trajtuam, pamë se individi dhe pasuria e tij mbrohen edhe me norma juridike nga sferat e tjera të së drejtës si, normat e së drejtës penale, ato administrative, nga normat e së drejtës së punës etj. ku në këtë mënyrë arrijmë në forma të ndryshme të përgjegjësisë, me ç'rast treguam ngjashmëritë dhe dallimet në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktuese dhe asaj kontraktuese, si dhe dallimet në mes të përgjegjësisë civile jashtëkontraktuese dhe asaj penale.

Në fund arrijmë në këtë përfundim se kur është fjala për përgjegjësinë civile për dëmin jashtëkontraktor, kemi të bëjmë me përgjegjësi krejt tjetër e cila ndryshon nga përgjegjësitë tjera të lartpërmendura, pra kjo është përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar nga marrëdhëniet jashtëkontraktuese. Nga kjo duket qartë se, me këtë lloj të përgjegjësisë juridiko civile njerëzve dhe pasurisë së tyre duhet t'u ofrohet mbrojtje e nevojshme për dëmet që u shkaktohen nga të tjerët.

KAPITULLI III: PËRCAKTIMI I KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË SUBJEKTIVE CIVILE PËR DËMIN JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

3.1. Shqyrtime të përgjithshme

Përgjegjësia subjektive civile për dëmin e shkaktuar, është lloj i përgjegjësisë juridike civile, në të cilën personi përgjegjës përgjigjet për dëmin që e ka shkaktuar me veprimin e tij deliktor, që nënkupton se ai është fajtor për dëmin e shkaktuar (Dauti, 2016:175). Përgjegjësia subjektive ose ndryshe siç njihet si “përgjegjësia sipas fajit”, është një prej bazave të përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar. Kjo përgjegjësi të shkaktimi i dëmit, ka ekzistuar në të kaluarën, ekziston në të drejtën bashkëkohore dhe do të ekzistojë në të ardhmen si në të drejtën tonë ashtu edhe në të drejtën krahasuese (Alishani, 1989:610). Në të vërtetë përgjegjësia sipas fajit është një trashëgimi kulturore në të drejtën e detyrimeve, e cila paraqet shprehjen e sigurisë relative më të plotë juridike dhe të lirisë në qarkullim (Konstantinovic, 1966:8 & Machiedo, 1966:32). Sipas kësaj përgjegjësie, dëmtuesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas fajit. Faji i tij në të kaluarën duhej të provohet nga ana e të dëmtuarit, sepse ai paraqiste kërkesën për dëmshpërblim. Te përgjegjësia subjektive ose përgjegjësia sipas fajit, roli i të dëmtuarit ishte aktiv, kurse roli i dëmtuesit pasiv (Alishani, 1989:610). E gjithë kjo e rëndonte pozitën e të dëmtuarit. Andaj, këtë pozitë të vështirë të dëmtuarit në doktrinë e quajnë “vërtetimi i gjendjes së mjerueshme”, sepse shpesh ndodhte në praktikë që i dëmtuari të mos mund të provojë fajin e dëmtuesit

dhe të mbetet pa shpërblim të dëmit të pësuar. Pra, i dëmtuari duke mos qenë fare fajtor për dëmin që ka pësuar, nuk mund të realizojë shpërblimin e dëmit ngase nuk ka mundur të vërtetojë fajin e dëmtuesit (Alishani, 1989:611). Sipas kësaj le të nënkuptohet se, në rastet kur i dëmtuari nuk ka mundur të vërtetojë fajin e dëmtuesit ka mbetur pa shpërblim. Prandaj kjo bazë e përgjegjësisë, ka filluar të tregohet e pamjaftueshme, sepse ka pasur raste kur i dëmtuari në shumë raste mbetej në pozitë të vështirë (Alishani, 1989:611). Për këtë arsye disa të drejta në disa raste të shkaktimi i dëmit, kanë filluar të përkrahin idenë e fajit të supozuar. Pra, kur dëmtuesi i shkakton dëm të dëmtuarit, supozohet faji i dëmtuesit dhe kuptohet që dëmtuesi ka të drejtë të pohojë se nuk është fajtorë për dëmin e shkaktuar (Alishani, 1989:611). Barra e vërtetimit kalon në anën e dëmtuesit, pra siç duket ka qenë një përparim në aspektin e zhvillimit të së drejtës (Stojanovic, 1966:17).

Përgjegjësia subjektive është një nga bazat e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar, sipas të cilës dëmtuesi përgjigjet në qoftë se veprimet e tij janë ndërmarrë, ekskluzivisht me faj të tij (Mamuti, 2013:72). Bazuar dhe në “Parimet evropiane të së drejtës deliktore”, që parashihen të kushtet e përgjegjësisë të bazuara në faj, thuhet se një person është përgjegjës në bazë të fajit, atëherë kur kryen shkelje të qëllimshme ose nga pakujdesia dhe nuk ka sjellje standarde që kërkohet prej tij (Mamuti, 2013:72). Në këtë drejtim kanë vepruar dhe veprojnë disa të drejta, kështu vepron LMD në Kosovë, i cili në nenin 136 thekson se “kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Këtu supozohet se faji ekziston në bazë të vetë faktit se te personi i tretë është shkaktuar pasoja e kundërligjshme. Kjo dispozitë e liron të dëmtuarin që të provojë se, ekziston faji i dëmtuesit ose personit përgjegjës për veprime të tij (dëmtuesit).

Gjithashtu nga kjo dispozitë shihet se mosekzistimi i fajësisë së dëmtuesit, ka si pasojë pamundësinë e zbatimit të kësaj dispozite të përgjegjësisë subjektive civile për dëmin e shkaktuar. Pra, sipas përgjegjësisë subjektive, dëmi është jo vetëm si pasojë e aktivitetit të personit që shkaktoi atë, por edhe manifestim i dëshirës së tij që atë ta shkaktojë (Hetemi, 1998:81).

Në doktrinë mendojnë se rregulla për fajin e supozuar si bazë e përgjegjësisë civile për dëmin, është kontribut i veçantë për mbrojtjen e pasurisë, sepse ky qëndrim bën të mundshëm që riparimi i dëmit në shumicën e rasteve të shpërblehet (Alishani, 1989:611). Në sistemin e fajit të supozuar, dëmtuesi nuk do të përgjigjet në qoftë se, provon se nuk ka qenë fajtor për dëmin e shkaktuar. Në praktikën gjyqësore ka dhe do të ketë raste të ndryshme, ku një person nuk do të përgjigjet për dëmin sepse nuk ka qenë fajtor (Alishani, 1989:611). Pra, për sjelljen e tij në shoqëri, në rrugë, në komunikacion etj, dëmtuesi duhet të provojë ekzistimin e standardit të sjelljes, si një shtëpiaku të mirë, ekonomiku të mirë dhe eksperti të mirë. Kujdesin e këtyre duhet kërkuar gjatë kryerjes së punëve të veta, dhe nëse vërtetohen nga ana e dëmtuesit se ato kanë ekzistuar, atëherë ai do të lirohet nga përgjegjësia për dëmin (Alishani, 1989:611-612).

Fusha e zbatimit të përgjegjësisë sipas fajit është e dukshme. Para së gjithash, kjo bazë e përgjegjësisë civile caktohet te përgjegjësia për veprimet e palejueshme të dëmtuesit. Kuptohet se këtu nuk hyjnë rastet e përgjegjësisë, kur dëmi shkaktohet nga sendi i ose veprimtaria e rrezikshme si dhe baza e përgjegjësisë sipas fajit të supozuar e cila bën pjesë në llojin e përgjegjësisë për të tjerët (Alishani, 1989:612). Kjo përgjegjësi ndryshe quhet edhe “përgjegjësi sipas fajit”, sepse mbështetet në fajin e subjektit që e ka shkaktuar dëmin.

Faji në përgjegjësinë subjektive ka rol të dyfishtë: ai nga njëra anë është kusht thelbësor i kësaj përgjegjësie dhe nga ana tjetër është bazë e kësaj përgjegjësie (Dauti, 2008:167).

3.2. Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor për dëmin e shkaktuar nga përgjegjësia subjektive

Kur është fjala për përgjegjësinë subjektive civile, patjetër duhet që t'i theksojmë kushtet e që duhet të plotësohen për të ekzistuar ky lloj i përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar. Këto duhen të plotësohen në mënyrë kumulative. Pra, që të lindin detyrimet nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të konkurojnë disa kushte së bashku (Semini, 2006:251) Përcaktimi i këtyre kushteve, zë vend të rëndësishëm edhe në trajtimet teorike. Në kontekst të kësaj, duhet të theksojmë se kushtet e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar nuk janë unike, por ato dallohen në rastet kur përgjegjësia krijohet sipas bazës së përgjegjësisë subjektive dhe në ato kur përgjegjësia krijohet sipas bazës objektive.

Në legjislacionin civil shqiptar nuk janë dhënë përkufizime të përgjithshme për të gjitha llojet e detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmit. Kjo shpjegohet me faktin se këto lloj detyrimesh nuk mund të përfshihen në një përkufizim gjithëpërfshirës, sado i gjerë që mundë të jetë (Gjata, 2010:32). Prandaj në Kodin Civil, është dhënë përkufizimi i përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit me të gjitha elementet (kushtet) përbërëse të kësaj përgjegjësie. Pra, elementi i parë është dëmi i shkaktuar ndaj tjetrit në personin ose pasurinë e tij; elementi i dytë, është kundërligjshmëria e veprës (veprimi ose mosveprimi); elementi i tretë, është lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes së kundërligjshme dhe dëmit, si

dhe ai i katërt, është faji i personit që ka shkaktuar dëmin. Në rast se mungon cilido prej këtyre elementeve, si rregull nuk lind përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit (Gjata, 2010:32). Nga praktika gjyqësore shqiptare, del qartë se janë katër kushtet e kërkuara për të pasur një dëm jashtëkontraktor (Republika e Shqipërisë, Gjykata e Apelit, Tiranë, Nr.3434/639 i Regjistrir Themeltar si dhe Nr. 89/150 i Vendimit).

Një autor tjetër, në lidhje me supozimet e përgjithshme juridike që duhet të plotësohen me rastin e shkaktimit të dëmit, përmend: subjektet e marrëdhënies së detyrimit, përgjegjës për dëmin; veprimin e dëmshëm të dëmtuesit; dëmin; lidhjen kauzale; si dhe kundërligjshmërin (Crnic, 2008:4). Vetëm pasi të plotësohen të gjitha kushtet e lartpërmendura, për kreditorin lind e drejta subjektive që të pretendojë dëmshpërblim nga debitori i tij. Po mungoi njëri nga kushtet e lartpërmendura, nuk lind përgjegjësia civile subjektive dhe detyrimi për shpërblimin e dëmit, përveç rasteve kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme apo ushtrimi i veprimtarive të rrezikshme, pasi këtu përgjegjësia lind edhe pa faj (Mamuti, 2013:38).

Në kuadër të lindjes së përgjegjësisë civile, autorë të tjerë përmendin këto kritere që duhet plotësuar për ekzistimin e përgjegjësisë jashtëkontraktuese, e ato janë: që të shkaktohet dëmi, që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin e kundërligjshëm, që të ekzistojë faji i dëmtuesit, që të ekzistojë aftësia deliktore dhe që të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit (Dauti, 2001:157).

Teoricienët e së drejtës civile kanë shkuar edhe më larg duke i përcaktuar kushtet për lindjen e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar nga baza subjektive, kushtet e

përgjegjësisë për të tjerët dhe ato të përgjegjësisë objektive (Mamuti, 2013:38). Për të ekzistuar përgjegjësia për të tjerët, duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet dëmi; atë ta shkaktojë personi që është në lidhje të veçantë juridike me personin përgjegjës; të ekzistojë lidhja kauzale midis veprimit që është ndërmarrë dhe dëmit të shkaktuar; si dhe dëmi të shkaktohet nga lëshimet eventuale të personit përgjegjës (Alishani, 2002:456-479). Ndërkaq për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga baza objektive, duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet dëmi; dëmi të jetë shkaktuar nga përdorimi i sendit të rrezikshëm ose ushtrimit të veprimtarisë së rrezikshme; të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet veprimit të sendit të rrezikshëm ose veprimtarisë së rrezikshme dhe efekteve të dëmit; si dhe duhet të ekzistojë kundërligjshmëria (Mamuti, 2013:38). Qëndrimi im është që të ndahen kushtet e përgjegjësisë civile që duhet të plotësohen për secilën lloj të përgjegjësisë civile. Andaj që të ekzistojë përgjegjësia subjektive civile (përgjegjësia në bazë të fajit) për dëmin e shkaktuar, duhet të plotësohen këto kushte:

1. që të shkaktohet dëmi (pra dëmi të jetë shkaktuar)
2. që dëmi të jetë i shkaktuar me veprimin e kundërligjshëm
3. që të ekzistojë faji i dëmtuesit
4. që të ekzistojë aftësia deliktore dhe
5. që të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.

Të gjitha këto kushte duhet të ekzistojnë, patjetër, kur është fjala për përgjegjësinë subjektive. Mirëpo në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit krahas përgjegjësisë së drejtpërdrejtë (subjektive) të personit që e ka shkaktuar atë me faj, janë përfshirë edhe

detyrimet për dëmin e shkaktuar nga persona të tjerë, si dhe detyrimet pa faj, si raste përjashtuese të parashikuara me ligj (Gjata, 2010:32). Prandaj në vazhdim do të bëjmë trajtimin dhe shtjellimin për secilin kusht në mënyre të veçantë.

Para se të fillojmë me shtjellimin e këtyre kushteve, vlen të bëjmë një shpjegim dhe dallim të shkurtër në lidhje me llojet e përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe kriterëve që duhen plotësuar për ekzistimin e saj. Pra, fjala është për përgjegjësinë subjektive, objektive dhe për veprimet e tjetrit. P.sh: në përgjegjësinë objektive (përgjegjësia për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme) faji nuk merret parasysh, prandaj për këtë njihet edhe si përgjegjësi pa faj. Në rastet kur është fjala për përgjegjësinë për të tjerët, ka raste kur faji supozohet dhe ka karakter absolut, ose kur faji nuk merret fare parasysh. Pra, nga kjo rrjedh se ekzistojnë edhe rastet nga përgjegjësia për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme, si dhe rastet e përgjegjësisë për veprimet e personave të tjerë. Qartazi duket se, dëmi dhe lidhja kauzale midis veprimit dhe dëmit, paraqet kushtin e përgjithshëm në të gjitha rastet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Në fund konstatojmë se, dëmi i shkaktuar me veprim të kundërligjshëm, faji, lidhja shkakësore dhe aftësia e deliktit paraqesin kushtet e detyrueshme të përgjegjësisë subjektive civile, pra, kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të ekzistuar përgjegjësia sipas fajit (subjektive).

Nga rrjedha e gjithë kësaj në vazhdim, do t'i shpjegojmë të gjitha kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të ekzistuar përgjegjësia subjektive civile të dëmi jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës.

3.2.1. Shkaktimi i dëmit

Përgjegjësia civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, nuk mund të kuptohet pa këtë të fundit. Ekzistenca e dëmit, si kusht për lindjen e përgjegjësisë, përcakton në të njëjtën kohë dhe karakteristikat e kësaj përgjegjësie, llojin e dëmit të shkaktuar, mënyrat dhe mundësitë e reagimit për kërkimin e shpërblimit apo zëvendësimit të tij (Muskaj, 2013:15). Në jetën e përditshme, në shtëpi, rrugë, punë e mjedise të tjera, njerëzit mund të ndodhen nën ndikimin e veprimeve dhe ngjarjeve të ndryshme që mund të sjellin si pasojë dëmtimin e shëndetit, jetës apo të pasurisë së tyre. Elementi i parë për lindjen e detyrimeve nga shkaktimi i dëmit është vetë qenia e dëmit. Termi “dëm”, nga pikëpamja juridike është i gjerë, prandaj nuk është e lehtë të jepet kuptimi i tij në mënyrë përgjithësuese (Gjata, 2010:32). Në radhë të parë duhet dalluar dëmi në kuptimin juridik nga ai në kuptimin e përgjithshëm laik. Në kuptimin laik në shoqëri, me dëm nënkuptohet edhe çdo shqetësim ose gjendje e pakëndshme që krijohet, si p.sh. kur thuhet: ”sa keq që janë dëmtuar rrugët e qytetit nga shiu i dendur” (vis maior), e ka dëmtuar shëndetin nga alkooli ose nga duhani” etj (Gjata, 2010:33). Në kuptimin juridik me dëm, nënkuptohet cenimi që subjekti i së drejtës përjeton në të mirat e tij të mbrojtura nga e drejta. Këto të mira të cenuara e të mbrojtura nga e drejta mund të jenë pasuria, të drejtat ose dinjiteti i personit si dhe fitimi i munguar që priste të realizonte në kushtet normale (neni 1293 i Kodit Civil Austriak) (Gjata, 2010:33).

Çdokush ka të drejtë të kërkojë evitimin e burimit të rrezikut nga shkaktimi i dëmit të konsiderueshëm. Në të kundërtën i nënshtrohet përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar (Baraliu, 2010:461). Shkaktimi i dëmit është kushti më me rëndësi për lindjen e detyrimeve

nga vetë ai. Pra, ai është vendimtar për krijimin e përgjegjësisë juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rrjedhin të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit si fakt juridik, paraqet rrethanë të caktuar e cila sjell deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve. Termi “dëm” përdoret edhe për të treguar dëmin që i bëhet pasurisë, së njeriut, dinjitetit e nderit të tij (Sallabanda, 1961:301). Pra, dëmi paraqet njërin nga kushtet e përgjithshme të përgjegjësisë jashtëkontraktore. Nuk ka përgjegjësi jashtëkontraktore, nëse nuk i është shkaktuar dëmi ndonjë personi ose pasurisë së dikujt. Nga kjo konstatohet se nuk ka dëmshpërblim nëse nuk ka dëm dhe kompensimi i dëmit duhet bërë në atë mënyrë duke i kompensuar të gjitha dëmet që janë shkaktuar të dëmtuarit si kreditor (Belegu, 2015:241).

Fjala “dëm” në praktikë përdoret në kuptime të ndryshme, e në të drejtën nënkuptohet si dëm pasuror, material, monetar apo ekonomik në një anë dhe si dëm jomaterial, moral joekonomik apo si dëmi ideal në anën tjetër (Smaka, 2008:28). Në Kodin Civil Shqiptar nuk është dhënë përkufizimi i dëmit si nocion i përgjithshëm juridik (Gjata, 2010:137). Në nenin 486 të këtij kodi thuhet: ”Dëmi që duhet të shpërblehet nga debitori për moszekutimin e detyrimit përbëhet nga të gjitha humbjet e pësuar nga pakësimi i pasurisë si dhe fitimi që mund të nxirrej në kushtet e zakonshme të tregut (fitimi i munguar)”. Me këtë dispozitë qartësohet se, në shpërblimin për riparimin e dëmit përfshihen edhe shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të parandaluar ose për të pakësuar dëmin, shpenzimet për të përcaktuar dëmin dhe përgjegjësinë, si dhe ato që janë bërë të nevojshme për të gjetur një zgjidhje jashtëgjyqësore (Gjata, 2010:137). Ky është kuptimi më i përgjithshëm dhe më i plotë i dëmit, si për marrëdhëniet kontraktore, ashtu

edhe për ato jashtëkontraktore, ku bëjnë pjesë edhe detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit. Pra, nga kjo shihet se KCSH në përcaktimin e kuptimit të dëmit, është mjaftuar me përfshirjen në të, të detyrimit për shpërblimin material, duke mos përcaktuar edhe kuptimin e përgjithshëm të nocionit dëm (Gjata, 2010:137-138). Gjithashtu, KCSH në Nenin 608, nocionin e dëmit e përkufizon në këtë mënyrë: "Personi, që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira". Kjo dispozitë parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim, si dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë (Deliaj & Mitrush, 2009:4). Mirëpo, nëse një person pretendon se i është shkaktuar dëm, por, nuk arrinë të vërtetojë ekzistencën e këtij dëmi apo nuk arrinë t'i jap një vlerësim ekonomik këtij dëmi, nuk do të jemi përpara dëmit jashtëkontraktor në kuptim të nenit 608 të KCSH, dhe si rrjedhojë nuk do të kemi lindje të marrëdhënieve juridiko civile të detyrimit ndërmjet atij që ka pësuar dëm dhe shkaktarit të këtij dëmi (Skrame, 2011:96). Ndërkaq, në nenin 609 parashikohet që: "Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar (Deliaj & Mitrush, 2009:4). Ndërkaq LMD në Nenin 137 për dëmin thekson: "Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i

humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Po ashtu edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit në nenin 735 për dëmin thotë kështu: ”Dami ka çmim por jo giobë”. Gjithashtu, edhe në nenin 739 të KLD thuhet se, ”Dami ka çmim por jo pushkë”. Nga interpretimi i këtyre dispozitave rreth nocionit të dëmit material dhe atij jomaterial, shohim se objekt mbrojtjeje juridike nga shkaktimi i dëmit material është pasuria ekzistuese që paraqet zvogëlim të saj, por edhe pengimi i rritjes së pasurisë. Ndërkaq objekt mbrojtjeje juridike nga shkaktimi i dëmit jomaterial, është personaliteti i një subjekti dhe shprehet si dhembje fizike, psikike, shpirtërore ose frikë. Nga kjo shihet se dëmi mund të shkaktojë pasoja si në pasuri, ashtu edhe në personalitetin e të dëmtuarit, sepse në kuptimin ekonomik dëmi është humbje e pasurisë pa marrë parasysh mënyrën e humbjes. P.sh: dëmi i shkaktuar nga vërshimet, zjarri, tërmeti. Ndërkaq në kuptimin juridik konsiderohet se, dëmi është humbje e të mirave, të cilat juridikisht janë të mbrojtura (Dauti, 2008:151).

Dëmi është shkelje e të drejtave subjektive ose e interesave të ndokujt të shkaktuara me veprim të dëmshëm. Mirëpo nëse shkatërrohet sendi i askujt ose i braktisur (P.sh. dikush e hedh në rrugë frigoriferin sepse e ka blerë të riun) edhe pse është kryer veprimi i dëmshëm, përgjegjësia për dëmin nuk ekziston, sepse nuk është shkelur e drejta subjektive e askujt (Gorenc, 2010:182-183). Pra, dëmin e paraqet vetëm ajo shkelje, e cila i është shkaktuar personit tjetër, kundër vullnetit të tij dhe që i sjell obligimin për dëmshpërblim personit përgjegjës. Prandaj, nisur nga parimet themelore të gjykimit të mosmarrëveshjeve civile, si dhe nga vetë natyra e interesave të ligjshme të mbrojtura në padinë për kërkimin e dëmshpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin

unifikues se, “në gjykimet me objekt, detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit, nëse paditësi kërkon dëmshpërblimin “për të gjitha dëmet” apo “për të gjitha dëmet pasurore e jo pasurore”, atëherë kjo mënyrë kërkimore, përbën disponimin e tij për kërkimin e dëmshpërblimit për çdo figurë të dëmit pasuror e jo pasuror (Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrat Themeltar, Tiranë, 2007). Por nëse kërkesëpadia përmban kërtime për dëmshpërblimin e figurave konkrete të dëmit jashtëkontraktor, gjykata ka detyrimin t’i përmbahet në gjykim dhe vendim të këtyre kërtimeve specifike. Megjithatë, gjykata duhet te orientojë e kërkojë nga palët të japin shpjegime rreth natyrës së mosmarrëveshjes në funksion të qartësimit të kërtimeve e prapësimeve për të drejtat dhe interesat e ligjshme të cenuara (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrat Themeltar, Tiranë, 2007).

3.2.1.1. Llojet e dëmit

Dëmet e shkaktuara mund të jenë të ndryshme. Në varësi të kritereve të ndryshme kemi lloje të ndryshme dëmsh si dhe mënyra të ndryshme shpërblimesh për secilin lloj. Duke u nisur nga lloji i objektit të dëmtuar apo pasoja e ardhur nga shkaktimi i dëmit, kemi (Semini-Tutulani, 2001:144):

- Dëme pasurore apo materiale, që shkaktohen ndaj pasurisë dhe që janë gjithmonë me karakter material. Pra, lidhen me zvogëlimin e vlerës së një pasurie, prone apo të një sendi të caktuar. Ky zvogëlim vjen nga prishja e sendit, nga thyerja e tij apo nga keqpërdorimi i pasurisë apo pronës (Semini-Tutulani, 2001:144), dhe
- Dëme jo pasurore, jo materiale, morale, që janë ato lloje të dëmeve të cilat nuk

mund të shihen, nuk janë materiale, por janë shpirtërore. Dëmet jo pasurore, jo materiale, morale, lidhen me shëndetin dhe jetën natyrore apo private të njerëzve, me ndjenjat, me emrin dhe dinjitetin e tyre, etj (Semini-Tutulani, 2001:144).

3.2.1.1.1. Dëmi pasuror (material)

Me dëmin material kuptojmë cenimin e vlerave pasurore të ndonjë personi fizik apo juridik. Dëmi material shkaktohet më së shpeshti me asgjësimin, dëmtimin apo marrjen e sendit, bërjen të pamundur ose vështirësimin e shfrytëzimit të sendit, për mënjanimin e të cilave kërkohen shpenzime. Kemi të bëjmë me dëm material edhe në rast të shkaktimit të lëndimeve trupore si, psh; cenimi i integritetit fizik, humbja e aftësisë për punë, për të cilin shkak mund të humbasin të ardhurat mbi bazë të punës, si dhe në rast të shkaktimit të vdekjes së ndonjë personi (DPPJ, 2015:511). Dëmi material është dëmi që shkaktohet në bazë materiale ose në lëndë të para (Kabashi & Shehu & Lama, 2015:143).

Dëmi pasuror (material, ekonomik, monetar), është ai dëm që shkaktohet me cenimin e interesave pasurore të dëmtuarit, në të dy format e tij: dëmi real dhe fitimi i munguar (Gjata, 2010:34). Thelbi i dëmit pasuror është dëmi në pasuri, që do të thotë dëm në të drejtën subjektive pasurore. Për t'u quajtur dëm pasuror, nuk është e domosdoshme që objekti i sjelljes së dënueshme të jetë vetëm personi i dëmtuar, p.sh. në rast vdekjeje, lëndimi trupor, dëmtimit të shëndetit ose lëndimi i dinjitetit (Gjata, 2010:139). Lëndimi i personit në vetvete nuk përbën bazë për shpërblimin (ndreqjen) e dëmit, por kjo e drejtë buron nga pasojat e lëndimit të tillë, qoftë si dëm pasuror, qoftë si dëm jo pasuror (Gjata, 2010:139). Ai, paraqitet edhe si, pakësim i mjeteve publike, përkatësisht i pasurisë së tjetrit

(dëmi i zakonshëm) ose pengimit të zhvillimit apo të rritjes së pasurisë së tjetrit (fitimi i humbur) (Smaka, 2008:37). Dëmi në sende, mund të krijohet edhe duke mos e bërë të mundshme ose duke e vështirësuar përdorimin dhe shfrytëzimin, si dhe në paraqitjen e ndonjë pengese për evitimin e së cilës duhet të bëhen shpenzime, që përndryshe nuk do të ishin bërë (Milosevic, 1977:148). Pra, duke shkaktuar humbje në pasurinë e subjektit të dëmtuar. Dëmi material mund të paraqitet edhe në rastin kur ndonjë personi i shkaktohet lëndimi trupor, dëmtimi i shëndetit (i cili i ka krijuar shpenzime të shërimit), pa aftësinë e përhershme për punë, humbjen e të ardhurave personale etj. Ai ekziston edhe në rastin e vdekjes së një personi që ndodh me fajin e dikujt (Milosevic, 1977:148). Dëmtuesi që e shkakton vdekjen e të dëmtuarit është i obliguar që atij t'i a kompensojë shpenzimet e zakonshme të varrimit. Personi të cilin i vdekuri e ka mbajtur apo rregullisht e ka ndihmuar, si dhe ai që në harmoni me ligjin ka pasur të drejtë të mbahet apo të ndihmohet prej tij, ka të drejtë në kompensim të dëmit që e pëson me humbjen e mbajtjes përkatësisht të ndihmës (Smaka, 2008:39). Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor apo të dëmtimit shëndetësor, kompensimi, zakonisht caktohet në formë të rentës momentale-përvjetshëm apo për kohë të caktuar (Smaka, 2008:39). Pra, në të gjitha këto raste krijohet drejtpërdrejtë, humbja në pasurinë e personit të dëmtuar.

3.2.1.1.2. Llojet e dëmit pasuror

Llojet e dëmit pasuror, si objekt trajtese në këtë punim janë: a) dëmi i vërtetë, b) fitimi i munguar, c) dëmi abstrakt, ç) dëmi konkret, d) dëmi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, e) dëmi ekzistues, i ardhshëm dhe eventual, si dhe, f) dëmi i parashikuar dhe i paparashikuar.

a) Dëmi i vërtetë “*damnum emergens*”- nënkupton zvogëlimin e pasurisë së tashme të personit të dëmtuar. Për këtë lloj dëmi përdoren emërtime të ndryshme, si: dëm real, dëm i thjeshtë, dëm pozitiv etj. Ky lloj dëmi mund të paraqitet edhe në situatat kur ai shkaktohet nga delikti dhe nga shkelja e detyrimeve kontraktore. Në të vërtetë shkaktohet kur zvogëlohet aktiva e subjektit tjetër, që d.m.th. dëmi i vërtetë rezulton nga cenimi i të drejtës pasurore ose interesit pasuror të dëmtuarit (Mamuti, 2013:40). Pra, ai nënkupton zvogëlimin e pasurisë së ndonjë subjekti që e posedon ai në momentin e caktuar, ku ky zvogëlim i pasurisë së subjektit të dëmtuar paraqet dëmin e vërtetë. Edhe në qoftë se është shkaktuar pakësimi i masës ekzistuese të pasurisë, atëherë kjo masë quhet “dëm real” (i vërtetë) (Gams, 1981:322). Pakësimi i pasurisë ekzistuese mund të ndodhë me pakësimin e aktivës dhe shtimin e pasivës, si p.sh. me zhdukjen e ndonjë sendi që ka pasur në pronësi, me kufizimin e një të drejte (ngarkimi i pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, me hipotekë ose barrë), në pengimin e ushtrimit të një të drejte, p.sh. zhveshja nga posedimi mbi sendin për një kohë dhe pamundësinë e gëzimit të sendit gjatë kësaj kohe (Gjata, 2010:34). Vlerësimi i dëmit të vërtetë bëhet në mënyrë të thjeshtë, pasi që bëhet vetëm dallimi i vlerës së pasurisë së të dëmtuarit para dhe pas shkaktimit të dëmit. Këtu paraqitet dallimi në kuptimin negativ, varfërimi i palës së dëmtuar, pasi zvogëlimi i pasurisë me rastin e shkaktimit të dëmit të vërtetë bëhet, duke zvogëluar vlerën e pasurisë për atë sa është vlera e sendit të vjedhur apo dëmtuar. Pjesë të dëmit të vërtetë, paraqesin edhe shpenzimet e bëra nga ana e të dëmtuarit në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të caktuara me qëllim që të shmanget rreziku nga shkaktimi i dëmit (Galev & Anastasovska, 2009:651). LMD në nenin 137 për dëmin e vërtetë, thekson se “...Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm)...”. Dëmi i vërtetë ekziston kur thyhet dritarja në banesën e huaj,

shkatërrohen rrobat e huaja etj. Në këto raste është shkaktuar dëmi i vërtetë me zvogëlimin e aktivës së subjektit tjetër. Pra, dëmi i vërtetë është dallimi i thjeshtë ndërmjet pasurisë së të dëmtuarit para shkaktimit të dëmit dhe pas tij (Dauti, 2016:160), sepse me dëmin e shkaktuar personit të dëmtuar i është zvogëluar pasuria në krahasim me gjendjen e tij para ndërmarrjes së veprimit të dëmshëm.

b) Fitimi i munguar “*lucrum cessans*”, nënkupton atë që do të fitohet nga pasuria nëpërmjet përdorimit normal të saj po të mos ishte shkaktuar dëmi jashtëkontraktor (Nuni & Mustafaj & Vokshi, 2008:100). Është dëmi kur i dëmtuari pengohet që ta rrisë pasurinë. Ky është fitimi, ku subjekti i dëmtuar do ta realizonte në të ardhmen, sikur të mos ishte shkaktuar ngjarja e dëmshme. Ky lloj dëmi është shtimi i pasurisë, që sipas rrethanave të zakonshme ose të veçanta të rastit konkret, me siguri do të vinte po të mos ishte sjellja e dëmtuesit, p.sh. një shoqëri detyrohet të ndërpresë prodhimin, për shkak të dëmtimit të makinerive të saj (Gjata, 2010:34). Në një rast të tillë, nga e njëjta sjellje mund të shkaktohet, si dëmi efektiv (dëmtimi i makinerive) dhe fitimi i munguar (ndërprerja e prodhimit). Disa legjislacione parashikojnë detyrimin e dëmtuesit të shpërblejë dëmin efektiv dhe fitimin e munguar, vetëm kur ka vepruar me qëllim të keq (me dashje) ose me pakujdesi të rëndë; në qoftë se ka vepruar me neglizhencë të zakonshme, detyrohet të shpërblejë vetëm dëmin efektiv (neni 1324 i Kodit të Përgjithshëm Civil Austriak) (Gjata, 2010:34-35). E drejta gjermane, franceze dhe italiane, parashikon detyrimin e dëmtuesit ta shpërblejë si dëmin efektiv, ashtu edhe fitimin e munguar, pavarësisht a ka vepruar me një shkallë më të lartë, apo më të ulët të fajit. Ky qëndrim mbahet edhe nga KCSH (Gjata, 2010:35). Neni 137 i LMD-së, thekson se fitimi i humbur nënkupton “parandalimin e

shtimit të pasurisë”. Pra fitimi i humbur paraqet pasurinë e ardhshme të personit të dëmtuar, të cilën sipas ecjes së rregullt të gjërave do ta realizonte, nëse nuk do të ishte shkaktuar dëmi. Kështu p.sh: nëse shoferit taksist i është djegur automobili me fajin e ndonjë personi, në këtë rast, vlera e automobilit paraqet dëmin e vërtetë, ndërsa shuma e të hollave të cilën do ta fitonte duke kryer shërbime me atë automobil, paraqet fitimin e humbur (Milosevic, 1977:149). Nga kjo konstatojmë se, dobia e humbur përbëhet nga pengimi i rritjes së pasurisë së të dëmtuarit, përkatësisht pasuria e tij nuk është e shtuar, ndërsa sipas të gjitha gjasave i dëmtuari do të realizonte këtë dobi sipas rrjedhës së ngjarjeve, sikur dëmtuesi të mos kishte shkaktuar dëmin.

c) Dëmi abstrakt- është ai lloj i dëmit material, që caktohet në mënyrë abstrakte e jo sipas dëmit të pësuar me të vërtetë, duke u caktuar në mënyrë paushalli ose me përqindje. Me të personit të dëmtuar i bëhet e mundshme, që ta marrë lehtë dëmshpërblimin e vërtetuar (Milosevic, 1977:150). Në këto raste, detyrimi për zhdëmtim, zakonisht është i një lartësie më të madhe se sa vlera reale e dëmit (Mamuti, 2013:42).

ç) Dëmi është konkret kur është provuar ekzistenca e tij, madje edhe vetë vlera e dëmit, duke krijuar kushtet për realizimin e të drejtës së shpërblimit (Gjata, 2010:36). Pra, është ai dëm, i cili vërtetohet përherë sipas rrethanave konkrete, të cilat ekzistojnë në rastin e caktuar. Dëmi konkret ekziston kur të dëmtuarit i paguhen shpenzimet për ndreqjen e sendit të dëmtuar. Llogaritja konkrete e dëmit, është shprehje në të holla e caktuar në mbështetje të vlerës në treg të sendit të dëmtuar. Pra, është ai lloj dëmi që realisht është evident dhe që mund të vërtetohet sipas rregullave konkrete të tregut, të cilat ekzistojnë në momentin e shkaktimit të dëmit (Mamuti, 2013:42). Lartësia e tij përcaktohet për çdo rast veç e veç, në

bazë të rrethanave konkrete ku duhet të vlerësohet me para. Dëmi konkret është vetëm ai, të cilin pala pretendente mund ta vërtetojë me saktësi. Konkretizimi dhe vlerësimi i lartësisë së dëmit konkret, mund të bëhet duke i përdorur të gjitha mjetet e provës, siç janë: këqyrja në vendin e ngjarjes tek sendi i dëmtuar, dëshmitarët, eksperti, dokumentet, qoftë publike a private, pranimin nga vetë shkaktuesi i dëmit, etj (Mamuti, 2013:42). Këtë lloj ndarje, disa autorë më shumë e pranojnë si mënyrë e shpërblimit të dëmit, bazuar në rregullat e përcaktimit të lartësisë së të njëjtës, se sa lloj i veçantë i dëmit, pavarësisht rasteve kur duhet të kompensohet në natyrë, apo edhe kur duhet të kompensohet në para (Mamuti, 2013:42).

d) Dëmi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë. I drejtpërdrejtë është ai dëm, në të cilin është cenuar ndonjë vlerë juridike e të dëmtuarit (Gojani, 2013:63), ndërsa i tërthortë është dëmi i cili e godet pasurinë e të dëmtuarit në tërësi, si p.sh: në dëmtimin e lëndimeve trupore, dëmi i drejtpërdrejtë përfshin shpenzimet e mjekimit, shërbimet e ndryshme për shërim, ndërsa fitimin e humbur të dëmtimi i shëndetit do të paraqiste humbjen e të ardhurave personale. Ndërkaq nëse dëmi u është shkaktuar sendeve të të dëmtuarit, si dëm i drejtpërdrejtë konsiderohen shpenzimet lidhur me riparimin e sendit të dëmtuar, kurse dëmin e tërthortë e paraqet fitimin e humbur nga përdorimi i atij sendi (Milosevic, 1977:149). I drejtpërdrejtë është ai lloj dëmi, pasojat e të cilit kanë ardhur drejtpërdrejt nga veprimi i kundërligjshëm i dëmtuesit apo nga lëshimet eventuale, që sikur t'i kishte ndërmarrë nuk do të vinte deri te efektet e dëmshme (Mamuti, 2013:42). Nga dëmi i drejtpërdrejtë, njëkohësisht paraqiten si veprimi i dëmshëm ashtu edhe efektet e dëmit. Në këtë lloj dëmi veprimi i dëmshëm, paraqitet si shkak i drejtpërdrejtë i shkaktimit të dëmit.

P.sh: nga veprimi goditës me gurë thyhet xhami i dritares a drita e veturës etj (Mamuti, 2013:42).

Në teori ka mendime të ndryshme për dallimin e dëmit të drejtpërdrejtë nga ai i tërthortë. Një gjë e tillë nuk është e rregulluar me ligj, prandaj është objekt kundërshtimesh midis juristëve. Jo rrallë ndeshet përkufizimi që dëm të drejtpërdrejtë e quan atë që është pasojë e drejtpërdrejtë e sjelljes së dënueshme, p.sh. thyerja e xhamave të dritareve të bodrumit ku janë vendosur prodhime të ndryshme bujqësore, si fasule, patate, etj. Krahas dëmit të shkaktuar drejtpërdrejtë me thyerjen e xhamave janë ngrirë produktet. Kjo pasojë e fundit është quajtur dëm indirekt apo i tërthortë (Gjata, 2010:36).

e) Dëmi ekzistues, i ardhshëm dhe eventual, dëmi *ekzistues* është ai, kur është shkaktuar dëmi dhe pasojat e të cilit kanë ardhur, p.sh. vuajtja e përjetuar, sendi i zhdukur ose i dëmtuar (Gjata, 2010:36). Dëmi i *ardhshëm* është ai që do të vijë me siguri në të ardhmen, qoftë si vazhdim i dëmit që përjetohej, p.sh. vuajtja shpirtërore për shkak të vdekjes së të afërmit, do të vazhdojë edhe në të ardhmen; humbja e fitimit të ardhshëm, për shkak të humbjes së aftësisë për punë (Gjata, 2010:36). Është ai lloj i cili ende nuk është paraqitur, por besohet se me siguri do të shkaktohet, edhe pse nuk dihet saktë kur dhe sa do të jenë pasojat (Mamuti, 2013:43).

Paraqitja e sigurt e pasojave është e lidhur me veprimin e dëmshëm që ka shkaktuar dëmin momental ndaj një të mire materiale apo jomateriale, dhe sipas llojit të dëmit besohet në paraqitjen e dëmtimeve shtesë në të ardhmen (Mamuti, 2013:43). Kështu kemi rastin kur nga goditja e veturës është dëmtuar një person, por nga lëndimet e marra, përveç dëmit

ekzistues (dhembjeve fizike, frikës, shpenzimeve mjekësore) do ketë nevojë të bëjë edhe amputimin e disa gjymtyrëve të trupit në të ardhmen, apo nga goditja do të mbetet me pasoja edhe për të ardhmen (Mamuti, 2013:43). Te dëmi i ardhshëm pasoja duhet të paraqitet në një periudhë më të vonshme pas veprimit të dëmshëm, i cili po ashtu mund të jetë qoftë me natyrë materiale, qoftë jomateriale (Mamuti, 2013:43). Praktika gjyqësore kosovare në një rast ka vërtetuar se i padituri ka tentuar ta dhunojë paditësen e mitur (6 vjeç). Me këtë veprim është cenuar dinjiteti i fëmijës në atë mënyrë që rrethi ku jeton do ta shohë ndryshe atë, dhe gjithnjë do të flasin se ndaj asaj se është tentuar të kryhet dhunimi. Pavarësisht, nga fakti që paditësja në kohën e ndodhjes së kësaj ngjarje ka qenë fëmijë, tek ajo është cenuar nderi i vajzërisë, ashtu që për këtë arsye ajo në të ardhmen do të vuajë shpirtërisht nga kjo, e duke pasur parasysh mentalitetin e njerëzve në rrethin ku jeton paditësja, dhe shkallën e cenimit të dinjitetit të personalitetit, dhimbjet shpirtërore të shkaktuara janë të intensitetit të lartë dhe do të jenë të pranishme për një kohë të gjatë². Për dëmin *eventual*, nuk mund të kërkohej shpërblimi, deri sa të mos vërtetohet ardhja e dëmit (Gjata, 2010:36). Në KCSH në fuqi, është njohur edhe shpërblimi i dëmit të ardhshëm dhe atij *eventual*, si dhe ai i paparashikuar në kohën e shkaktimit të tij. Kështu, në paragrafin e dytë të nenit 640 të këtij Kodi thuhet: “...Shpërblehen edhe shpenzimet që kanë qenë të nevojshme për përcaktimi e masës së dëmit...”. Këtu janë pasur parasysh rastet kur masa e dëmit nuk mund të përcaktohej në kohën e shkaktimit të tij (Gjata, 2010:37). Sipas nenit 643 të KCSH, kur është shkaktuar vdekja e personit, dëmi që duhet të shpërblehet përbëhet nga shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, shpenzimet e varrimit, etj.

² Gjykata e Qarkut Prizren, vendimi C.nr. 246/82 (aktgj.i vërtetuar nga Gjyk. Supr.e Kos., Komentari i LMD, 2013:261.

Ky është shpërblim për dëmin e ardhshëm, që do të vijë me siguri. Ndërsa, shpërblimi për dëmin eventual parashikohet në nenet 642 e 644 të KCSH. Shpërblimi për dëmin mund të shtohet në të ardhmen, po të rëndohet shëndeti i të dëmtuarit në krahasim me kohën e caktimit të shpërblimit ose edhe për shkak të uljes së pagës së të dëmtuarit. Këto janë rrethana, të cilat nuk dihet a do të vërtetohen në të ardhmen (Gjata, 2010:37).

f) Dëmi i parashikuar dhe i paparashikuar - Dëmtuesi detyrohet të shpërblejë edhe dëmin që nuk mund të parashikohej në kohën kur kryhet akti i dëmit. Dëmi i *paraparë* është ai dëm të cilin ka mundur ta parashohë dëmtuesi, në momentin e marrjes së veprimit të dëmshëm apo lëshimit të veprimit, nga i cili ai është shkaktuar si pasojë e atij veprimi (Mamuti, 2013:43). Praktika gjyqësore shqiptare në një vendim gjyqësor vjen në përfundim se kur ndërmjet palëve në proces nuk ka ekzistuar ndonjë marrëdhënie juridike dhe marrëdhënia e krijuar me shkaktimin e dëmit është marrëdhënie jashtëkontraktore, ashtu edhe dëmi i shkaktuar është dëm jashtëkontraktor (neni 608 i Kodit Civil) dhe në situata të tilla dëmtuesi përgjigjet për dëmet që shkakton tjerëve³. Ky lloj dëmi mund të paraqitet si dëm ekzistues dhe si dëm i ardhshëm. Të shpeshta janë rastet në praktikë, të shkaktimit të

³ Gjykata e Apelit në Tiranë, Akti, Nr.4145/1126, Në vendimi Nr.1210, me datë.23.05.2013, vendosi lënien në fuqi të Vendimit nr.6468, dt.22.06.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me të drejtë kishte vlerësuar faktin për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar ndërmjet palëve në kontest dhe kishte vendosur pranimin e padisë si dhe detyrimin e të paditurit të shpërblej paditësin për dëmin e shkaktuar, në vlerën prej 674.706 lekë. Në cilësinë e paditësit është Shoqëria “Albtelekom” sh.a, ndërsa në cilësinë e palës së paditur është Ndërmarrja e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Tiranë, e cila gjatë ushtrimit të aktivitetit të vet kishte dëmtuar në disa raste rrjetin telefonik me të cilin ofron shërbimin paditësi, në këtë rast Shoqëria “Albtelekom” sh.a, të cilit i është shkaktuar dëmi në infrastrukturën e telefonisë fikse nga pala e paditur gjatë kryerjes së punëve. Një vendim të tillë e arsyeton qartë Ligji Nr. 9918, dt.19.05.2008, për komunikimet Elektronike në nenin 95 parashikon se “Për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të rrjetit ekzistues...çdo person fizik a juridik që kryen punime ndërtimi e gërmimi, përpara fillimit të punimeve detyrohet të njoftoj sipërmarrësin e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Në rast se punimet duhet të kryhen në mënyrë të pashmangshme, të gjitha shpenzimet për mbrojtjen, shmangien, riparimin...përballohen nga subjekti që kryen punimet”. Andaj edhe një rregullim i tillë ligjor i bën të pabazuara pretendimet e të paditurit për mungesë përgjegjësie.

dëmit të paraparë, p.sh: shitja e qumështit të pa pasterizuar në temperatura të larta, dihet saktë se do shkaktojë pasoja në helmimin e njerëzve, apo më të shpeshta janë rastet e ndezjes së zjarreve në pyje gjatë temperaturave të larta, ku dihet me siguri se në qoftë se nuk e fikë zjarrin në fund do ketë për pasojë ndezjen e pyllit (Mamuti, 2013:43)⁴. Ndërsa dëmi *i papaparë* është ai dëm tek i cili dëmtuesi nuk e ka paraparë apo nuk ka mundur ta parashohë shkaktimin e pasojës në momentin e ndërmarrjes së veprimit të dëmshëm (Mamuti, 2013:43)⁵.

3.2.1.2.3. Dëmi jopasuror (jo material)

Për dëmin jomaterial në teori dhe në praktikë shpesh përdoren edhe fjalët; dëm jopasuror, joekonomik dhe moral, për dallim nga dëmi material për të cilin përdoren edhe termat; dëm ekonomik dhe dëm pasuror. Teoria shkencore dhe legjislacionet e vendeve të ndryshme përdorin emërtime të ndryshme për dëmin jomaterial. Emërtimet ndonjëherë kanë refleksion të drejtëpërdrejtë gjatë përshtatjes së këtyre shprehjeve nga gjuhë të huaja, kurse ndonjëherë është kushtëzuar nga depërtimi i neologjizmave nga formulimet ligjore të ligjeve të huaja në sistemin juridik konkret: dëmi jomaterial, jopasuror, moral, ideal, dëmi për shkak të vdekjes, lëndimi trupor, dëmtimi i shëndetit (Taleska, 2006:18). Dëmi jopasuror nënkupton: cenim të drejtave ose interesave vetjake ndaj të dëmtuarit, që nuk

⁴Ky lloj dëmi, përveç nga deliktet mund të shkaktohet edhe me rastin e mospërbushjes së kontratës apo përbushjes së parregullt të saj. Kjo ndodh kur debitori e di saktë se me rastin e mospërbushjes së prestimit obligator cilat do të jenë pasojat për kreditorin. Psh: nëse furnizuesi për një lloj ushqimi të rëndësishëm të ndonjë restoranti, nuk e dërgon porosinë në kohë para ditëve të festave, pronarit të restorantit do t'i shkaktohet dëm, që ka për pasojë humbjen e imazhit të mirë dhe do t'i reflektohet në humbjen e klientelës. Krejt këto janë pasoja që lehtë mund të parashikohen nga njeriu i zakonshëm (Mamuti, 2013:43).

⁵ Ky lloj dëmi shumë është prezent tek detyrimet kontraktore, ku ndonjëra nga palët kontraktuese shpesh vjen në situatë të ndryshimit të rrethanave dhe ti vështirësohet apo pamundësohet përbushja e detyrimit kontraktor të cilën rrethanë nuk ka mundur ta parashoh (Mamuti, 2013:43).

shprehet në pasurinë e tij. Si zakonisht, ky përkufizim nuk shpreh gjithçka të nevojshme për kuptimin e plotë të dëmit jopasuror (Gjata, 2010:162). Në teori e legjislacione të ndryshme nuk është dhënë përkufizimi i këtij nocioni, por është shpjeguar në mënyra të ndryshme. P.sh.: thuhet se është shkaktim i vuajtjeve fizike ose psikike ndaj tjetrit, ose dëmi jo pasuror duhet të shpërblehet vetëm në rastet e parashikuara në ligj, etj (Gjata, 2010:163).

Institucioni i shpërblimit të dëmit jopasuror, si institut juridik ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve dhe të vetë praktikës gjyqësore, duke shkaktuar mjaft debate teorike. Madje edhe në kohët e sotme këto debate nuk kanë pushuar (Gjata, 2010:163). Në legjislacionin modern dhe në tetori, krahas termit dëm jopasuror, është quajtur edhe dëm jomaterial. Por, më i afërt me terminologjinë juridiko-civile evropiane, mbisundues është termi “dëmi jopasuror” (Gjata, 2010:164).

Nga pikëpamja juridiko-etike, ekzistojnë debate për bazueshmërinë e shpërblimit të dëmit jopasuror (Gjata, 2010:163). Kundërshtarët e nevojës së shpërblimit vënë në dukje pamundësinë e gjetjes së masës objektive për vlerësimin e vuajtjeve fizike, shpirtërore ose frikës që dikush e ka përjetuar. Ata, insistojnë se, në dëmet jopasurore kemi të bëjmë më disa vlera njerëzore, të cilat nuk mund të ndreqen me pagesën në para (Gjata, 2010:164). Shpërblimi në para që merr i dëmtuari, nuk duhet kuptuar si ekuivalent të një vlere të cenuar ose të humbur. Ato (paratë) duhet t’i sigurojnë të dëmtuarit mundësinë e realizimit të vlerave e kënaqësive tjera, të cilat e ndihmojnë për të përballuar më lehtë krizën shpirtërore që i është shkaktuar si pasojë e cenimit (Gjata, 2010:165). Të paktën, mund të zbusë atë ndjenjë të pakëndëshme që i dëmtuari përjeton, të ofrojë deri diku kompensimin e kënaqësisë së humbur në jetë. Edhe praktika gjyqësore ka pranuar se shpërblimi i dëmit

jopasuror nuk është shpërblim në kuptimin e plotë të fjalës, por vetëm një mënyrë e mundshme për të pakësuar pjesërisht pasojat negative që janë shkaktuar. Këtij qëllimi për ndreqjen e dëmit jopasuror, në mënyrë të tillë që të arrihet mbrojtja sa më e plotë e viktimës, i shërben parashikimi në nenin 625 të Kodit Civil, sipas të cilit, gjykata para se të vendosë lidhur me kërkesën për shpërblim dhe për shumën që do të caktojë, duhet të kujdesen për rëndësinë e vlerës së cenuar të tjetrit dhe për qëllimin për të cilin shërben ky shpërblim (Gjata, 2010:165). Shpërblimi i dëmit jopasuror synon të rivendosë në vend dhe të rikthejë “qetësinë e prishur” të dëmtuarit. Sipas teorisë kompensuese, funksioni i dëmshpërblimit të dëmit moral konsiston në mundësinë për të vënë në ekuilibër dhimbjet e pësura me kënaqësi relativisht të përafërta, mbi bazën e modelit të dëmshpërblimit të dëmit pasuror (Teliti, 2013:203). Mangësitë e kësaj teorie nxorren në pah funksionin “për arritjen e kënaqësisë” përmes dëmshpërblimit, duke krijuar kushte dhe situata alternative, përmes të cilave minimizohet dhimbja e dëmit të shkaktuar. Qëllimi i kompensimit të dëmit është dhënia e një shume të hollash në proporcion me dëmin e shkaktuar, në mënyrë për ta ngushëlluar për dëmin e pësuar (emocional ose ekzistencial), me synimin për të rikrijuar kushte të përafërta me ato që humbi (Teliti, 2013:203). Një përcaktim i tillë qëndron në mesin e studiuesve që duan të klasifikojnë dëmin jopasuror në kufijtë e dëmit moral dhe të mbështetësve të një figure më të gjerë dëmi jopasuror, me funksion rikthimin e kënaqësisë (Teliti, 2013:203).

Për dallim nga dëmi material që vjen si rezultat i dëmtimit të të mirave materiale, dëmi jomaterial rezulton nga cenimi i të drejtave jomateriale, siç janë: cenimi i lirisë, privatësisë, nderit, shkaktimi i dhembjeve fizike, psikike apo të frikës, përkatësisht nga cenimi i të

mirave personale të njeriut që i garanton rendi juridik (Mamuti, 2013:45). Që nga shekulli i XIX, legjislacionet dhe praktikat gjyqësore të shumicës së vendeve pranojnë shpërblimin e dëmit jomaterial, në bazë të rregullës së përgjithshme se çdo dëm duhet të shpërblehet, nëse në vetvete ka disa karakteristika të dëmit (Mamuti, 2013:45). Disa autorë, gjatë shek XX mendonin se “dëmi jomaterial ekziston gjithmonë kur kompensimi me para, nuk arrinë ta bëjë atë (kompensojë) në mënyrë adekuate dhe ta vlerësojë objektivisht, pasi paratë në raport me dëmin e shkaktuar nuk mund ta plotësojnë funksionin e tyre si ekuivalent (François Givord, “La Reparation du prejudice moral” I cthèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi 14 novembre 1938, à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz, Paris).

Sa i përket emërimit të dëmit jomaterial, autorë të ndryshëm përdorin emërtime tjera, si: dëmi jopasuror, për shkak të vdekjes, të lëndimit trupor apo shëndetit, mandej dëmi jo në para, ideal apo moral. Mirëpo duhet pasur parasysh se ekuilibrin shpirtëror apo ç’ekuilibrimin nuk i përfshin as termi “jopasuror” e as ai “moral”, pasi është me elemente thjesht subjektive, ndërkajmë i saktë do të ishte termi, “dëm jomaterial” (Mamuti, 2013:45). Në të gjitha vendet e Evropës dhe vendet e tjera me demokraci në zhvillim, ka një tendencë të zgjerimit të konceptit të dëmit jomaterial, duke përfshirë shkeljen e çdo të drejte subjektive, nisur nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta për jetë, reputacion dhe emër të mirë, nderin, pacënueshmërinë e shëndetit fizik e psikik dhe privatësinë (Mamuti, 2013:45). Nga kjo shohim se, përveç dëmit material (i pasurisë) kemi edhe dëmin moral, i cili ka të bëjë me lëndimin e të drejtave personale, të cilat nuk mund të shprehen në mënyrë pasurore. Pra, dëmi jomaterial ekziston në rastet kur shkelen të mirat personale të personave të caktuar.

Dëmi material mund të përlllogaritet në mënyrë objektive dhe me saktësi të plotë me përdorimin e metodave të përgjithshme dhe operacioneve matematikore, për dallim nga dëmi jomaterial të cilit nuk mundet saktësisht t'i përcaktohet vlera dhe lartësia e tij, sepse më vete ngërthen ndryshime të brendshme dhe subjektive që dallojnë, varësisht nga personi (Mamuti, 2013:47). Rrethanat e rastit të shkaktimit të dëmit, veçanërisht lartësia (intensiteti) e dhembjeve, frikës dhe kohëzgjatja e tyre, janë vendimtare në përcaktimin e llojit të dëmit moral dhe vëllimit të tij. Mirëpo edhe në rastet kur ndonjë personi i vdes një i afërm, konsiderohet se për personat e mbijetuar të familjes së ngushtë, përfshirë bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit, u është shkaktuar dëm jomaterial (Mamuti, 2013:47). E njëjta gjë ndodhë edhe në ato raste, kur vëllezërit dhe motrat e të dëmtuarit kanë qenë në bashkësi të përhershme jetësore, me çka konsiderohet se edhe atyre u është shkaktuar dëm moral (Mamuti, 2013:47). Dëmi moral do të shkaktohet edhe në rast të shkaktimit të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi, me të cilin përveç dhembjeve fizike dhe psikike që krijohen për të dëmtuarin, gjithashtu krijon edhe dhembje psikike bashkëshortit, pastaj fëmijëve dhe prindërve ndaj të dëmtuarit, i cili ka përjetuar invaliditet të rëndë (Mamuti, 2013:45).

Dëmtimi moral (jo material, jo pasuror, ideal), është secila trajtë e dëmit e cila nuk e godet subjektin e së drejtës në pasuri dhe as në trupin e tij. Të mirat joekonomike apo jopasurore, janë interesat morale apo ideale që shprehen në pasurinë morale të subjekteve të së drejtës në formë: të nderit, respektit, autoritetit, prestigjit, dinjitetit personal e familjar, prirjeve legjitime dhe të integritetit fizik e moral (Smaka, 2008:28). Në praktikë ato manifestohen, rëndom në trajtë të cenimit të afeksioneve, të zvogëlimit të gjasave për martesë, të

çoroditjes fizike apo morale, të dhunimit, të shkakimit të dhembjeve fizike apo shpirtërore, të frikës, të dëmtimit të nderit e prestigjit etj (Smaka, 2008:28).

3.2.1.2.4. Llojet, format e dëmit jopasuror dhe kushtet për marrjen në shqyrtim të tij

Në nenin 625 të KCSH (ndryshuar me ligjin 17/2012) në lidhje me shpërblimin e dëmit jopasuror, është parashikuar se “Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet: kur a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij; b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; c) është cenuar e drejta e emrit; ç) është cenuar respektimi i jetës private; d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror”. Këta persona nuk kanë të drejtën të kërkojnë shpërblimin e dëmit, në qoftë se: fyerja është bërë kur personi ka qenë gjallë dhe nëse është marrë shpërblimi për fyerjen e bërë. Të dyja këto kushte duhet të konkurrojnë me njëra tjetrën (Tutulani-Semini, 2016:206). Nga mënyra e formulimit të përmbajtjes së kësaj dispozite lihet të kuptohet se, në të janë përfshirë vetëm personat fizik dhe është lënë pasdore fakti se edhe personat juridik mund të pësojnë dëm jopasuror dhe të përgjigjen për të (Gjata, 2010:166). Fjalja e parë e dispozitës fillon me fjalën “Personat” pa u shtuar fjala “fizik”, që do të thotë se nuk përjashtohen nga e drejta e shpërblimit për dëmin jopasuror as personat juridik. Pra, edhe personat juridik krahas të drejtave pasurore gëzojnë edhe të drejta vetjake jopasurore, cenimi i të cilave duhet shpërblyer, si p.sh: për shkak të humbjes së “emrit të mirë”, të veprimtarisë së tij (Gjata, 2010:166). Praktika gjyqësore shqiptare në një rast vëren se e paditura, deputete në Kuvendin e Shqipërisë, bën një deklaratë për shtyp

në një prej mediave audiovizive të vendit me të cilën deklaratë pala paditëse pretendoi përpara gjykatës se i ishte shkaktuar dëm jopasuror, duke u cenuar në emrin e mirë dhe reputacionin që gëzonte si shoqëri, si pasojë e veprimeve të kundërligjshme të të paditurës, gjegjësisht deklaratave të pavërteta, të bëra me qëllim për të denigruar emrin dhe reputacionin e shoqërisë “Ferar” sh.p.k.⁶.

Nga përcaktimi i dëmit jopasuror në nenin 625 të KCSH, vijmë në përfundim se janë pranuar si forma të dëmit jopasuror, vetëm ato që janë të njohura ligjërisht. Ashtu si në legjislacionet e tjera, format e dëmit jopasuror, janë renditur vetëm në mënyrë taksative e jo si shembuj (Gjata, 2010:168). Rrjedhimisht, kuptohet që përfundimi i vetëm është se, në praktikën gjyqësore mund të ndreqen vetëm ato dëme jopasurore që janë parashikuar në

⁶ Këtë situatë mund ta skjarojmë më mirë me një rast nga praktika gjyqësore lidhur me kompensimin e dëmit jopasuror jashtëkontraktor nga Gjykata e Apelit në Tiranë, Nr.1032, Regjistri Themeltar, Vendimi Nr.1138, me datë. 11.05.2012. Me këtë Vendim kjo Gjykatë vendosi lënien në fuqi të Vendimit Nr.429, dt.24.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me të drejtë kishte vlerësuar faktin për përcaktimin e vlerës së dëmit të shkaktuar ndërmjet palëve në kontest dhe kishte vendosur pranimin pjesërisht të padisë si dhe detyrimin e të paditurës të i shpërblej palës paditëse dëmin jopasuror në shumën prej një milionë lekë. Në cilësinë e paditësit është Shoqëria “Ferar” sh.p.k, ndërsa në cilësinë e palës së paditur është E. V deputete në Kuvendin e Shqipërisë. E paditura, deputete në Kuvendin e Shqipërisë, bën një deklaratë për shtyp në një prej mediave audiovizive të vendit me të cilën deklaratë pala paditëse pretendoi përpara gjykatës se i ishte shkaktuar dëm jopasuror, duke u cenuar në emrin e mirë dhe reputacionin që gëzonte si shoqëri, si pasojë e veprimeve të kundërligjshme të të paditurës, deklaratave të pavërteta, të bëra me qëllim për të denigruar emrin dhe reputacionin e shoqërisë “Ferar” sh.p.k. Nga shqyrtimi i rrethanave të çështjes, e paditura nëpërmjet deklaratave të saj, duke përmendur palën paditëse, shoqërinë “Ferar” sh.p.k., si të lidhur në forma të ndryshme me Ministrin e Ekonomisë dhe duke u favorizuar nga ky i fundit në forma të ndryshme, ka cenuar reputacionin e kësaj shoqërie si një aktor tepër aktiv në tregun e ndërtimeve dhe emrin që kishte krijuar për një periudhë afro shtatëmbëdhjetë vjeçare, duke e etiketuar si një shoqëri e cila realizon përfitime nëpërmjet ryshfeteve. Gjykata çmon se e paditura E.V i ka shkaktuar shoqërisë “Ferar” sh.p.k., dëm jopasuror, duke e cenuar në emrin dhe reputacionin që gëzon kjo shoqëri. Shkaktuesi i dëmit është një person publik, deputete në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Duke qënë i tillë ai mbart në vetvete një rrezik më të madh për dëmin që mund t’i shkaktohet personit të dëmtuar, pasi deklaratat e një personi të veshur me pushtet politik kanë një peshë dhe vlerësim më të madh në sytë e publikut, se deklaratat e çdo qytetari të thjeshtë. I dëmtuari shoqëria “Ferar” sh.p.k., është një subjekt ekonomik me një karrrierë të gjatë në tregun shqiptar, kryesisht në fushën e ndërtimeve. Duke qënë një shoqëri me një aktivitet të gjerë, dëmi që mund t’i shkaktohet si pasojë e këtyre deklaratave është më i madh se sa në njëjtën situatë ndaj një subjekti të vogël ekonomik apo një individi. Gjykata arrin në përfundimin se deklarata është bërë me dashje dhe me qëllim për të diskredituar palën paditëse në sy të opinionit publik. Kjo tregon për një rrezikshmëri më të lartë dhe njëkohësisht për një dëm më të madh që mund t’i jetë shkaktuar potencialisht palës paditëse.

KCSH ose në ligje tjera (Gjata, 2010:168). Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit jopasuror, sipas nenit 625 të KCSH, ekziston në ato raste kur dëmi paraqitet në një nga këto forma: (Tutulani-Semini, 2016:206):

- a) si dëmtim i shëndetit në formë plagosjeje ose vdekjeje,
- b) në formën e cenimit të nderit ose të personalitetit të një personi,
- c) në formën e fyerjes së kujtimit të një të vdekuri.

a) dëmi i shkaktuar ndaj jetës dhe shëndetit të personit - Personi i dëmtuar, krahas dëmit të drejtpërdrejtë pasuror, të atypëratyshëm ose të mëvonshëm, mund të pësojë edhe atë jopasuror, siç janë vuajtjet fizike dhe vuajtjet shpirtërore të tilla që i shkaktojnë ankthe, pagjumësi e pasoja të tjera (Gjata, 2010:168-169). I dëmtuari, krahas shpërblimit, bie fjala për pakësimin ose humbjen e aftësisë për punë, mund të kërkojë me të drejtë edhe shpërblimin e dëmit jopasuror. Në Kod nuk jepet kuptimi i fjalëve “dëmtimi i shëndetit” dhe as që bëhet ndonjë përkufizim i tij. Kjo do të thotë se i është lënë teorisë dhe praktikës për ta zgjidhur (Gjata, 2010:169). Ajo që mund të thuhet si e padiskutueshme në këtë dispozitë është fakti se, ndryshe nga disa legjislacione të huaja, nuk kufizohen llojet e pasojave të dëmtimit të shëndetit (Gjata, 2010:168). Këto pasoja për të cilat mund të kërkohej shpërblimi për dëm jopasuror, mund të jenë nga më të ndryshmet si: vuajtjet shpirtërore dhe vuajtjet psikike, ndjenja e përbuzjes nga ana e të tjerëve për shkak të shëmtimit të fytyrës, si prerja e veshit, hundës, verbimi i syrit, lënia e shenjave të përrjetshme në fytyrë që e shëmtojnë etj (Gjata, 2010:169). Por në to mund të përfshihen edhe vuajtjet fizike nga dhembjet e tilla të organeve të ndryshme, që i shkaktojnë të

dëmtuarit edhe pagjumësinë kronike, etj. Këto vuajtje shpirtërore a psikike dhe dhembjet fizike, duhet të jenë të një shkalle të caktuar dhe me karakter të përhershëm. P.sh. nga dëmtimi i shëndetit, i dëmtuari bëhet invalid i shkallës së dytë, d.m.th. i pa aftë për çdo punë (Gjata, 2010:169). Ky invaliditet është një fakt i mjaftueshëm për të gëzuar edhe shpërblimin jo pasuror, pasi ky invaliditet i rëndë mund t'i shkaktohen pasoja të ndryshme si ankthe e deri në humbjen e dëshirës për të jetuar. Ky shpërblim duhet dalluar nga pensioni i invaliditetit, ashtu si edhe nga çdo shpërblim pasuror. Dispozita në fjalë pranon vetëm shpërblimin për dëmin jo pasuror të drejtpërdrejtë, d.m.th. vetëm të personit që i është shkaktuar kjo pasojë nga dëmtimi i shëndetit dhe jo edhe për dëmin e tërthortë, d.m.th. për vuajtjen e personit që i është dëmtuar shëndeti (Gjata, 2010:169). Për përcaktimin e drejtë dhe më të saktë të intensitetit të vuajtjeve fizike apo psikike e shpirtërore, është e nevojshme edhe marrja e mendimit të kualifikuar të ekspertëve përkatës, si mjeku ligjor, psikiatri, psikologu, etj. Mendimi i tyre ka rëndësi jo vetëm për intensitetin e shpeshtësinë e dhembjeve e vuajtjeve, por edhe për kohëzgjatjen e tyre. Shpërblimi i dëmit, pas sqarimit të plotë të rrethanave, vendoset në një shumë të përgjithshme të caktuar për të gjitha dhembjet e vuajtjet, pasi ato që i përjeton i dëmtuari pas mjekimit kanë ndikim të veçantë edhe në uljen e veprimtarisë jetësore (Gjata, 2010:170).

Praktika gjyqësore merr parasysh, rrethanat e mbi të gjitha karakterin e lëndimit që ka përjetuar i dëmtuari, i rëndë apo më i lehtë, në analogji me termat e së drejtës penale, bazuar kryesisht në paraqitjen e ekspertëve; shqetësimet që kanë shoqëruar mjekimin, si qëndrimi i palëvizshëm në gjendje të shtrirë, kryerja e nevojave fiziologjike, dhembjet gjatë rehabilitimit, përdorimi i kukëzave (patericave) ose karrocës, përsëritja e operacioneve;

veçoritë subjektive të të dëmtuarit, p.sh. kur i dëmtuari është i mitur dhe i pamësuar ende jashtë mjedisit familjar, llojet e dëmtimeve, të cilat, kur janë shkaktuar në vende të ndjeshme të trupit e sidomos në fytyrë, do të ndikojnë në masën e shpërblimit etj (Gjata, 2010:170).

Një problem më vete përbën mungesa e kriterëve të gjithëpranuara, që mundësojnë përcaktimin e tyre sa më objektivisht të karakterit të cënimeve, e sidomos fuqia e dhimbjeve dhe zgjatja e tyre (Gjata, 2010:170). Në veçanti, për përcaktimin e masës së shpërblimit, duhet të merret parasysh fakti nëse i dëmtuari do të përjetojë vuajtjet fizike edhe në të ardhmen, si dhe shqetësimet e shkaktuara nga mjekimi gjatë gjithë jetës (Gjata, 2010:170). Por, sipas praktikës, nuk mund të njihet si shpërblimi jopasuror për dhembjet fizike të lehta, qoftë nga fuqia, qoftë nga zgjatjet (Alishani, 1989:758-760). Pra, kur një person kryen një veprim ose mosveprim nga ai i cili rrjedh një dëmtim i shëndetit, një plagosje, një sëmundje, etj, atëherë shkaktari i dëmit mban përgjegjësi për shpërblimin e dëmit. Pra, ai do të paguajë të gjitha shpenzimet për mjekimin e personit të dëmtuar dhe kthimin e tij në atë gjendje që ka qenë para se të shkactohej dëmi (Tutulani-Semini, 2001:147). Ndërsa, kur veprimi apo mosveprimi është i një shkalle të tillë që ka sjellë humbjen e jetës së një personi, atëherë shkaktari i dëmit duhet t'i mbulojë të gjitha shpenzimet materiale që do të bënte familja e të ndjerit, sikur vdekja e tij të kishte qenë për shkaqe natyrore (Tutulani-Semini, 2001:147). Me shpenzime të duhura që i përgjigjen rrethanave familjare e personale të të vdekurit, nënkuptohet shpenzimet që do të bënte familja, sikur vdekja të kishte qenë natyrale (Tutulani-Semini, 2002:298)

b) dëmi i shkaktuar nga cenimi i nderit dhe personalitetit të personit – Ekzistenca e sanksioneve civile dhe penale, në rast të cënimit të integritetit fizik, tregon më së miri që legjislatori i kushton rëndësi mbrojtjes së tyre (Latifi, 2009:48). Në këtë lloj dëmi, dëmtuesi duhet me veprimin e vet të shkaktojë cenimin e të drejtave të personalitetit të njeriut, i cili është kusht me rëndësi për realizimin e shpërblimit të dëmit jomaterial në këtë lloj të shpërblimit të këtij dëmi (Alishani, 2008:62). Kur një person cenohet nga dikush që synon uljen e emrit apo reputacionit të tij në familje, në punë apo shoqëri, atëherë shkaktari i dëmit mban përgjegjësi civile (Tutulani-Semini, 2001:147). Ulja e emrit dhe e nderit të një personi mund të vijë nga veprime të ndryshme, si p.sh: përhapja e lajmeve të rreme, e thashethemeve, shpërndarja e fotografive etj. Të gjitha këto veprime, kur shkaktojnë qoftë edhe vetëm fyerjen e një personi, sjellin shpërblimin në të holla të dëmit të shkaktuar. Praktika gjyqësore në Kosovë, në një rast vëren se i padituri pa arsye ka shpifur se paditësja me rastin e lidhjes së bashkësisë martesore nuk ka qenë e virgjër. Paditësja pohon se i njëjti pa asnjë arsye në natën e martesës ka cenuar personalitetin dhe moralin e paditëses e që është dëshmuar edhe me dokumentacion mjekësor. Andaj në këtë situatë paditësja pohon se ka ndier dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të nderit dhe personalitetit të saj⁷. Ulja e emrit të mirë dhe e reputacionit (autoritetit) mund t'i shkaktohet jo vetëm njerëzve, por

⁷ Në vendimin C.nr. vep.29/08 të datës 26.01.2008 të Gjykatës Komunale në Kamenicë/Republika e Kosovës, theksohet se paditësja me të paditurin kanë lidhur bashkësi jashtëmartesore më datë 29.10.2006 dhe më vonë me rastin e lidhjes së bashkësisë martesore i padituri ka cenuar nderin dhe personalitetin e paditëses. I padituri pa arsye ka shpifur se paditësja me rastin e lidhjes së bashkësisë martesore nuk ka qenë e virgjër. Paditësja pohon se i njëjti pa asnjë arsye në natën e martesës ka cenuar personalitetin dhe moralin e paditëses e që është dëshmuar edhe me dokumentacion mjekësor. Andaj në këtë situatë paditësja pohon se ka ndier dhimbje shpirtërore për shkak të cenimit të nderit dhe personalitetit të saj. Gjykata në rastin e theksuar vendosi që të aprovoj pjesërishtë kërkespadinë e paditëses në vlerë prej 5,000.00 €, edhe atë shumën prej 2,000.00€ për cenim të nderit dhe personalitetit të paditëses si dhe shumën prej 3,000.00€, për dhimbjet shpirtërore që ka pësuar paditësja. Si satisfaksion paditëses për këto dy lloje të dëmeve jomateriale, Gjykata me të drejtë vendosi që i padituri t'i paguajë paditëses shumën në vlerë prej 5,000.00 €.

edhe subjekteve tregtare, shoqatave, fondacioneve dhe institucioneve (Tutulani-Semini, 2001:147). Për shkak të cenimit në nderin e personalitetit (neni 625 shkronja “b” e KCSH-së), i dëmtuari, krahas të drejtës së shpërblimit të dëmit pasuror, gëzon edhe të drejta të tjera me karakter shpërblimi e mbrojtjeje, si: shpërblimin për dëmin jopasuror të pësuar, ndreqjen ose heqjen e të dhënave të rreme ose të pasakta në vendimin e pushimit të çështjes penale ose në një akt administrativ, publikimin e vendimit për riparimin e dëmit jopasuror (nenet 329, 399 të KPPSH, etj). Se cilën formë do ta përdorë i dëmtuari, është në disponimin (vullnetin) e tij. Ai mund të përdorë disa ose edhe të gjitha format e mbrojtjes e shpërblimit, njëkohësisht (Gjata, 2010:178).

Në praktikën gjyqësore janë ndeshur shpesh raste të kërimit të shpërblimit për shkak të cenimit të nderit e personalitetit, pa e shtrirë kërkesën në fushën e së drejtës penale. Këto raste zakonisht ose sipas përjetimit të të dëmtuarit përbëjnë cenim më të rëndë dhe me karakter publik të dinjitetit e nderit të personit, që kanë sjellë si pasojë vuajtje të madhe shpirtërore (Gjata, 2010:178). Pra, shpërblimi i dëmit jopasuror nuk është shpërblim në kuptimin e plotë të fjalës që shuan gjithçka, por vetëm një mënyrë për të zvogëluar pasojat e shkaktuara. Mendojmë se ky lloj shpërblimi duhet kufizuar në ato raste kur shkalla e cenimit të nderit e dinjitetit është e lartë, që për nga ndikimi, kohëzgjatja dhe rrethanat e mjedisit, kanë shkaktuar dukshëm cenimin e nderit e dinjitetit të personit. Në këtë vështrim duhet pasur parasysh qëllimin e shpërblimit, rëndësia shpirtërore e tij për t’i shërbyer rivendosjes ose ndreqjes së ekuilibrit të tronditur në fushën shpirtërore. Gjithsesi, duhet treguar kujdes për të drejtën vetjake të cenuar (Gjata, 2010:178). Në përcaktimin e masës së

shpërblimit, është e kuptueshme që rol vendimtar do të ketë forca dhe zgjatja e vuajtjeve që përjeton i dëmtuari.

Për të arritur në përfundim sa më të drejtë, duhet pasur kujdes për rrethanat në të cilat është bërë cenimi, numrin e njerëzve të pranishëm, zakonet e vendit ku i dëmtuari jeton, nivelin kulturor etj. P.sh: një gjest i caktuar në një vend përbënë cenim të nderit ose dinjitetit, në një vend tjetër jo, ose pa ndonjë ndikim të veçantë (Gjata, 2010:179). Pra, nuk është themelore nëse cenimi verbal i nderit a dinjitetit të personit bëhet me sajimin e një ngjarjeje diskriminuese, që ka edhe karakterin e shpifjes, apo me vënie në dukje me fjalë ose me gjeeste për një rrethanë të rëndë të së kaluarës së të dëmtuarit ose të dëmtuarës. Por kjo duhet të ketë karakterin e një sulmi të rëndë në nderin e dinjitetin e tyre, që shkakton si pasojë vuajtje shpirtërore për një kohë të gjatë ku disa herë mund të ndikojnë më shumë ose më pak në mjedisin shoqëror (Gjata, 2010:179)⁸.

Një formë e veçantë e vuajtjes shpirtërore, për shkak të cenimit të nderit të personalitetit, është kur cenimi bëhet në mjetet e informimit publik (Gjata, 2010:180). Sipas nenit 22.1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, liria e shprehjes është e garantuar. Po ashtu, është e garantuar liria e shtypit, radios dhe televizionit (neni, 22.2). Megjithatë, kjo liri nuk është

⁸ Në praktikën gjyqësore shqiptare është shqyrtuar penalisht një rast ekstremisht i jashtëzakonshëm. Një person i ka dërguar një letër një gruaje ku i kujtonte asaj raste të dashurisë së tyre para 30 vjetëve. Përmbajtjen e letrës e mësuan bashkëshorti e pjesëtarët e tjerë të familjes. Gruaja pësoi një tronditje aq të madhe, sa arriti të bëjë vetëvrasje. Nga ky shembull duhet të nxjerrim përfundimin se, personi mund të cenohet në nderin e dinjitetin e tij, jo vetëm kur përhapen të pavërtetat, por edhe kur i thuhet të vërtetat, që kanë karakter fyes e denigrues dhe që i shkaktojnë vuajtje të madhe shpirtërore. Po ashtu, nuk është me rëndësi vendimtare a ka qenë sjellja e dëmshme me dashje apo nga pakujdesia, pasi kemi të bëjmë me një sjellje objektivisht fyes ndaj tjetrit. Nga ana tjetër, nuk është pranuar njohja e së drejtës së shpërblimit si satisfaksion për vuajtje të pësura nga fyerja, poshtërimi dhe humbja e rasteve për t'u martuar, për shkak të fillimit të bashkëjetesës së faktit (jashtëmartesore), për arsye se nuk vërtetohet ekzistenca e përgjegjësisë për dëmin jopasuror. Ky qëndrim është i drejtë, sepse paditësja me vullnetin e saj ka hyrë me këtë bashkëjetesë dhe kjo në vetvete nuk është diskredituese për njeriun, ku nuk shkakton tronditje shpirtërore përmendja e këtij fakti. Në qoftë se është përdorur ndonjë shprehje me karakter fyes (fjalë banale a poshtëruese) ndaj saj si njeri, që shkaktojnë tronditje të fortë shpirtërore, është një çështje tjetër që nuk ka lidhje me bashkëjetesën (Shih më gjërësisht, Gjata, 2010:178-180)

e pakufizuar, sepse çdo qytetarit i garantohet respektimi dhe mbrojtja e jetës vetjake e familjare, dinjitetit, nderit (nenet 35, 37 e 42) (Gjata, 2010:180). Në zbatimin praktik këto të drejta mund të ndeshen, por zgjidhja duhet kërkuar në ekuilibrin ndërmjet së drejtës së mjeteve të informimit publik për të publikuar të vërtetën e plotë për sjelljen e çdo njeriu dhe së drejtës së atij personi për mbrojtjen e jetës vetjake e familjare, të dinjitetit e nderit. Për këtë çështje, Këshilli i Evropës ka miratuar edhe një rezolutë me deklaratën për mjetet e informimit publik dhe të drejtat e njeriut (Gjata, 2010:180). Në këtë rezolutë tërhiqet vëmendja se ekziston mundësia e konfliktit ndërmjet shfrytëzimit të së drejtës për lirinë e informimit publik dhe të shprehjes me të drejtën e respektimit të jetës vetjake, të garantuar me nenin 8 të Konventës mbi të Drejtat e Njeriut⁹. Shfrytëzimi i të drejtës së parë nuk mund të ndërpresë të drejtat e dyta (të drejtat e njeriut). Sipas rezolutës, e drejta e respektimit të privatësisë qëndron para së gjithash në mundësinë për të jetuar sipas bindjes së vet. Privatësia shtrihet në jetën private, familjare e shtëpiake, në integritetin fizik e moral, nderin e dinjitetin, mospublikimin e të dhënave të panevojshme e të papërshtatshme (papëlqyeshme), në mos shpalljen e pa autorizuar të fotografive private, në mbrojtjen

⁹ Neni 8, i Konventës Për të Drejtat e Njeriut..., parashikon: 1. Çdo person ka të drejtë që t'i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij. 2. Autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 10 i kësaj Konvente parashikon: 1. Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të vendosin një regjim autorizimesh për institucionet e radiodifuzionit, të kinemasë ose të televizionit. 2. Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund tu nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji, që në një shoqëri demokratike përbëjnë masat e nevojshme për sigurimin kombëtar, integritete territoriale ose sigurimi publik, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

kundër spiunazhit, në mbrojtjen nga shfrytëzimi qëllimkeq i bisedave private dhe nga përhapja e informatave të marra ose të bëra të ditura nga individët në mirëbesim. Vihet në dukje se nuk mund të pretendojnë privatizimin e vet ata që me veprimet e tyre nxisin përhapjen e tyre (Gjata, 2010:180-181).

c) dëmi i shkaktuar nga fyerja e kujtimit të një të vdekuri - Kur emri dhe kujtimi i një personi që ka vdekur, përgojohet nëpërmjet fjalimeve, bisedave, shtypit, botimeve, etj, atëherë të afërmit të tij u lind e drejta të kërkojnë shpërblimin e dëmit të ardhur (Tutulani-Semini, 2001:147). Mjafton që personat e afërt të ndjehen të fyer dhe të lënduar për kujtimin e të afërmit të tyre të vdekur, ku konsiderohet se ky dëm është ai që duhet të shpërblehet (Tutulani-Semini, 2001:147). Por, kur një fyerje e të njëjtit lloj ose e ngjashme i është bërë personit të vdekur, që kur ka qenë gjallë dhe për këtë ky i fundit ka kërkuar një herë shpërblim dëmi, atëherë të afërmit e tij nuk kanë të drejtë ta kërkojnë përsëri kompensimin kur rifyhet pas vdekjes (Tutulani-Semini, 2001:148). Në shkronjën “d” të nenit 625 të KCSH, është parashikuar edhe një shkak tjetër më vete i dëmit jopasuror, ai i fyerjes së kujtimit për të vdekurit. Në këtë dispozitë thuhet: Personi që pëson dëm jopasuror ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet, kur: “Është cenuar kujtimi i një të vdekuri ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror”. Për të gëzuar të drejtën e kërimit të shpërblimit jopasuror, siç del nga përmbajtja e vet dispozitës së sipërme, duhet të ekzistojnë disa kushte (Gjata, 2010:185). Në radhë të parë duhet që me fyerje të cenohet kujtimi që ruajnë personat e gjallë më të afërm të të vdekurit. Këtu është në radhë të parë bashkëshorti, i cili ka bashkëjetuar me të deri në çastin e vdekjes së tij. Krahas bashkëshortit, të drejtën e kërkesës së shpërblimit e kanë

trashëgimtarët e tij ligjor, të shkallës së parë dhe të dytë, pavarësisht a thirren në trashëgimi: fëmijët, fëmijët e fëmijëve dhe të paslindurit e tjerë që trashëgojnë me zëvendësim, prindërit, si dhe personat e pa aftë për punë, të cilët të paktën një vjet para vdekjes së personit kujtimi i të cilit është fyer, bashkëjetonin me të si anëtarët e familjes dhe në ngarkim të tij (neni 363 të KCSH) (Gjata, 2010:185-186). Në radhë të dytë, duhet që fyerja të jetë bërë kur i vdekuri nuk ka qenë gjallë. Në të kundërt, po të ketë qenë gjallë kur është fyer dhe të mos ketë pasur pengesë ligjore për kërkimin e shpërblimit të dëmit, nuk mund të kërkohet nga personat e përmendur ky shpërblim dëmi (Gjata, 2010:186). Gjithashtu, sipas kësaj dispozite, e drejta e kërkimit është e patrashëgueshme. Kjo do të thotë se e drejta e shpërblimit jopasuror, nuk mund t'i kalojë me trashëgim personave të tjerë. Pra, vëllezërit e motrat, gjyshi a gjyshja, përjashtohen (Gjata, 2010:186). Edhe në këtë rast vlen parimi që fyerja e kujtimit ndaj të vdekurit të ketë shkaktuar vuajtje shpirtërore tek personat e afërm që u përmendën. Kjo do të dalë nga rrethanat, si marrëdhënia shpirtërore ndërmjet të vdekurit gjatë kohës që ka qenë gjallë dhe të afërmeve të tij, kujdesit të tyre dhe respektit që kanë treguar ndaj tij (Gjata, 2010:186).

Për një periudhë kohe të gjatë, dëmi jopasuror është evidentuar vetëm me dëmin moral. Por gjatë viteve të fundit teoria dhe praktika gjyqësore ka evidentuar dy figura të reja të dëmit jopasuror. Fituan kuptim të ri, dëmi ndaj shëndetit ose dëmi biologjik dhe u pranua dëmi ekzistencial si një figurë e posaçme e dëmit jopasuror (Pjetra, 2013:52-53). Edhe me vendimin Nr.12 të datës 13 dhe 14 shtator 2007 të Gjykatës së Lartë, kategorisë së dëmit jopasuror, ju dhanë përmasa të reja, duke vënë përkrah figurës së dëmit moral edhe figurën e atij jopasuror ekzistencial, po ashtu edhe biologjik (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrat Themeltar, Tiranë, 2007). Dispozita e nenit 625 të KCSH është interpretuar e

zbatuar në pajtim me parimet themelore kushtetuese për të drejtat e njeriut, duke mbajtur parasysh e reflektuar edhe vetë procesin dinamik të ndërgjegjësimit e të emancipimit të shtetit e të shoqërisë në njohjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sikurse është trajtuar më sipër në këtë vendim, sipas neneve 3,..15 e vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet mbrojtja e posaçme dhe e barabartë e të mirave pasurore dhe atyre jopasurore të njeriut (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrat Themeltar, Tiranë, 2007). Në këtë kuptim, edhe te neni 608 e vijues i KCSH, synohet riparimi i plotë të çdo dëmi të pësuar në mënyrë të paligjshme, pra jo vetëm në pasurinë në kuptimin e ngushtë ekonomik, por edhe në të mirat jopasurore që mëshirojnë vlerat e vet njeriut. Pra, nëpërmjet këtij vendimi është pranuar që në kategorinë e dëmit jopasuror, parashikuar në nenin 625 të KCSH, përfshihen tri figura:

- figura e dëmit moral,
- figura e dëmit biologjik dhe
- figura e dëmit ekzistencial (Deliaj & Mitrushi, 2009:2).

Lidhur me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, nëse analizojmë nenin 625 të KCSH, ku parashikohet e drejta e personit për të kërkuar dëmshpërblim nëse cenohet në “nderin e personalitetin e tij”, ku cenimi i “nderit” dhe “fyerja e kujtimit ndaj të vdekurit” janë shfaqje konkrete të dëmit moral në rrethana specifike e të lidhura ngushtë me vetë personin e lënduar, KBGJL arrijnë në përfundimin unifikues, se: “Dëmi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhembje e vuajtje shpirtërore apo gjendje

ankthi a mundimi shpirtëror, ku rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti, ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht (ius proprius) edhe secilit prej familjarëve të afërt të personit që ka humbur jetën apo të cenuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjenjësore dhe e bashkëjetesës. Dëmi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm” (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007).

Dëmtimi i shëndetit vjen si pasojë e cenimit të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Të drejtat e njeriut për jetën dhe shëndetin janë të drejta objektive që lindin dhe janë të padhunueshme e të pandashme me vetë ekzistencën e tij (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007). Prandaj të tilla ato mbrohen e garantohen si të drejta themelore të njeriut nga Kushtetuta (neni, 3, 15/1 dhe 21). Mbrojtja e shëndetit të njeriut mëshirohet jo vetëm në detyrimin e shtetit për kujdesin shëndetësor (neni, 15/2 dhe 56), por edhe në të drejtën për të realizuar këtë mbrojtje në gjykatë (neni, 42/2), ndërmjet të tjerave, duke detyruar cilindo që cenon integritetin e tij fizik e psikik të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007). Ndërmjet fushave të së drejtës objektive që sanksionojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga veprimet a mosveprimet e paligjshme ndaj të tretit, edhe në KCSH, posaçërisht në shkronjën “a” të nenit 625, parashikohet se: “Personi që pëson një dëm të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet kur ... a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të

integritetit fizik ose psikik të tij..” (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrimit Themeltar, Tiranë, 2007).

Dëmtimi i shëndetit, i njohur nga jurisprudenca edhe si “dëmi biologjik” apo “dëmi për shëndetin”, është figurë e posaçme e dëmit jopasuror dhe si i tillë, objekt kërkimi të pavarur të dëmshpërblimit përkatës. Për dallim nga dëmet pasurore, dëmi biologjik nuk ka vlerë ekonomike në tregun e lirë, sepse cenimi i tij nuk kompensohet në natyrë dhe as nuk ka çmim në para. Mirëpo për efekt të mbrojtjes së shëndetit, lehtësimit dhe rehabilitimit fizik e social i të dëmtuarit në të ardhmen, personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit biologjik detyrohet t’i paguajë atij një dëmshpërblim në të holla, në mënyrë të pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore, që eventualisht i dëmtuari ka pësuar për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrimit Themeltar, Tiranë, 2007).

Për arsyet e mësipërme, KBGJL arrijnë në përfundimin unifikues se: Dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën në thelb, cenimin e të mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja “a” e nenit 625 të KCSH, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari, për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm. Gjithashtu, KBGJL arrijnë në përfundimin unifikues se: Meqenëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues, të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 18 të Kushtetutës, gjykata duhet të garantojë një gjykim uniform, duke bërë vlerësim të njëjtë të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit biologjik, për çdo formë e shkallë konkrete të cenimit të përhershëm a të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit, nëse mosha është e njëjtë dhe po i njëjtë është edhe lloji i

dëmtimit shëndetësor fizik a psikik të pësuar (KBGJL, Vendimi Nr.12, Nr. 3 i Regjistrimit Themeltar, Tiranë, 2007). Në vijim, nisur nga arsyetimet e mësipërme, KBGJL arrijnë në përfundimin unifikues se: Dëmshpërblimi për dëmtimin e shëndetit sipas nenit 625/a të KCSH, kërkohet në mënyrë të pavarur nga kërkimi për dëmin pasuror të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, i parashikuar në nenin 641 të KCSH. Sipas kësaj dispozite, interesi pasuror i cenuar përkohësisht apo përgjithmonë, si rrjedhojë e dëmtimit të shëndetit nga fakti i paligjshëm, është e drejta e njeriut, e parashikuar në nenin 49 të Kushtetutës, për të fituar mjetet e jetesës, pra edhe për të garantuar e shtuar pasurinë, nëpërmjet punës së ligjshme të zgjedhur me vullnetin e lirë të tij. Njëkohësisht, përbën interes të ligjshëm të cenuar edhe pakësimi i pasurisë së të dëmtuarit në formën e shpenzimeve që ai përballon për përkujdesje dhe në veçanti, për mjekimin e shëndetit të cenuar, si rrjedhojë e pandërprerë e të njëjtit fakt të paligjshëm (KBGJL, Vendimi Nr.12, Nr. 3 i Regjistrimit Themeltar, Tiranë, 2007). Në sferën e cenimeve me natyrë jopasurore në të drejtat e personalitetit të mbrojtura nga KRSH dhe KCSH, përfshihen edhe raste e gjendje të tjera subjektive të natyrës psikofizike, që nuk gëzojnë mbrojtje nëpërmjet dëmshpërblimit të dëmit moral dhe atij biologjik (KBGJL, Vendimi Nr.12, Nr. 3 i Regjistrimit Themeltar, Tiranë, 2007).

Në nenin 625/a të KCSH, në kategorinë e dëmit jopasuror, krahas figurave të dëmit në shëndet dhe dëmit moral, përfshihet figura tjetër autonome e **dëmit ekzistencial**, ndryshe dëmi për cilësinë e jetës. Dëmi ekzistencial shkaktohet si rrjedhojë e cenimit të vlerave komplekse të padhunueshme të qenies njerëzore, të normalitetit dhe cilësisë së jetës së njeriut, të fushës së ndjenjave dhe të solidaritetit reciprok në kuadër të familjes, si dhe të

shprehjes së lirë e të plotë të aftësive të qenies njerëzore për të zhvilluar personalitetin, për t'u shfaqur e realizuar në shoqëri edhe në kuadër të njësisë bazë të saj, sikurse është familja (nenet 53 dhe 54 të Kushtetutës) (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrat Themeltar, Tiranë, 2007). Në Shqipëri, Vendimi Unifikues i KBGJL, dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007, nr. 12, për herë të parë integroi në jurisprudencën shqiptare figurën e dëmit ekzistencial, që njihej pak ose aspak në radhët e gjyqtarëve apo juristëve të tjerë. Nëpërmjet këtij vendimi evidentohet qartazi përpjekja e Gjykatës së Lartë për të konfiguruar dëmin ekzistencial si figurë të posaçme dëmi, duke aprovuar në këtë mënyrë jurisprudencën e huaj në favorizimin e ekzistencës së dëmit ekzistencial dhe shpërblimit të tij (Deliaj & Mitrushi, 2009:3). Kuptimi i dëmit ekzistencial, shpjegohet në mënyrë të detajuar (të hollësishme) nga gjykata (Deliaj & Mitrushi, 2009:3). Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i hapi rrugë gjykatave të niveleve më të ulëta për ta njohur figurën e dëmit ekzistencial. Ky vendim, në pjesën e pranimi të dëmit ekzistencial shënon një avancim për t'u vlerësuar të Gjykatës së Lartë, duke qenë se një koncept i tillë u përafhua në jurisprudencën shqiptare në një periudhë, ku ende ende një farë ngatërrimi në gjykatat shqiptare në lidhje me nocionin e dëmit jopasuror (Deliaj & Mitrushi, 2009:3). Kështu, gjykatat e niveleve më të ulëta në çështjet gjyqësore që paraqiten për zgjidhje, rast pas rast, kanë për detyrë që të zbërthejnë kuptimin e këtij dëmi dhe të evidentojnë ekzistencën (praninë) e tij (Deliaj & Mitrushi, 2009:3). Prandaj, mbështetur në këtë arsyetim, KBGJL arrijnë në përfundimin unifikues, se: Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut, duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i

shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qenien e tij apo mund ta karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Dëmi ekzistencial, duke mos pasur natyrë thjeshtë ndjenjësore e të brendshme, është objektivisht i vërtetueshëm (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007).

Dëmi ekzistencial shkakton pasoja të ndryshme nga dëmi moral dhe biologjik. Ai shkakton pasoja që nuk lidhen me vlerat ekonomike, por me marrëdhënie shoqërore, familjare dhe prindërore, dëmton aftësitë kreative, sportive, kulturore, artistike të personit të dëmtuar, dëmton aftësinë e tij për të punuar, etj (Pjetra, 2013:53). Përveç të tjerave, dëmi ekzistencial cenon të dëmtuarin në marrëdhëniet dhe interesat e jetës familjare, sociale, kulturore, sportive, të veprimtarisë zbavitëse, argëtimit, të çlodhjes, etj. të cilat çdo individ ka të drejtë t'i gëzojë dhe që ndikojnë në mënyra e shkallë të ndryshme, në varësi të ndjeshmërisë dhe formimit të personalitetit të gjithsecilit, në sferën psikike të të dëmtuarit, duke bërë që të alternohen në një masë të prekshme në kuptimin negativ, duke u shfaqur në botën e jashtme, vetë marrëdhëniet e tij familjare, sociale, kulturore, afektive, etj (KBGJL, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrisë Themeltar, Tiranë, 2007).

Gjithashtu edhe LMD, në Nenin 137 thekson se “si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Rastet e cënimit të pasurisë morale apo ideale të subjektit të së drejtës, janë të shumëta dhe të manifestuara në trajta të ndryshme.

Pra, dëmi jopasuror, ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të personalitetit, përkatësisht të të drejtave dhe interesave subjektive. Andaj, ai që tjetrit ia cenon nderin si dhe ai që trillon apo transmeton (bartë) të pavërteta për të kaluarën, për dijeninë apo zotësinë e tjetrit, nëse e di apo sipas rrethanave normale duhet të dijë se, thëniet e tilla janë të pasakta, me ç'rast me të tjetrit i shkakton dëm, atëherë atij duhet t'ia zhdëmtojë dëmin. Përkitazi me këtë, në rastin e cenimit të vlerave personale, gjykata mundet që në shpenzimet e dëmtuesit të urdhërojë, që dëmtuesi të tërheqë deklaratën me të cilën e ka dëmtuar të dëmtuarin apo të bëjë diç tjetër në mënyrë, që i dëmtuari të zhdëmtohet përshtatshëm (Smaka, 2008:39). Lidhur me përgjegjësinë civile, për dhembjet fizike dhe shpirtërore të pësuar, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, çoroditjes, të cenimit të prestigjit, të nderit, të lirisë apo të të drejtës së personalitetit, të vdekjes së personit të afërm apo për shkak të frikës së përjetuar, dhe kur gjykata konsideron se rrethanat e rastit konkret e veçanërisht kur intensiteti i dhembjes dhe i frikës, si dhe kohëzgjatja e tyre këtë e justifikon, atëherë ajo do të gjykojë kompensimin adekuat, pavarësisht nga dëmi material si dhe mangësia e tij (Smaka, 2008:40).

Nga analiza dhe kuptimi i këtyre dispozitave ligjore si dhe mendimeve të këtyre autorëve shohim se, ky dëm shkaktohet pavarësisht nga dëmi material, por në të shumtën e rasteve paraqitet së bashku me atë material, p.sh: lëndimi trupor, shëmtimi, dhembja fizike etj. Pra, nëse dëmtuesi i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit, ka për detyrë t'ia kompensojë shpenzimet e shërimit dhe shpenzimet e tjera në lidhje me këtë, si dhe fitimin e humbur (lucrum cessans) përshkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së shërimit. Në këtë rast, kemi të bëjmë me dëmin material. Mirëpo pos kësaj, gjykata mund të caktojë edhe një

shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e shkaktuara fizike dhe shpirtërore, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material. Pra, dëmshpërblimin për dëmin jomaterial. Me fjalë të tjera, mund të themi se dëmi jopasuror shkaktohet si pasojë e cenimit të integritetit psikofizik të personit që gëzon në vetvete një mbrojtje juridike, me cilësinë e një të mire materiale, pavarësisht nga zotësia e personit për të krijuar pasuri, ose vlera shkëmbimi (Mamuti, 2013:47).

Nga e gjithë kjo që shpjeguam për dëmin jopasuror, mund të përfundojmë se, ky lloj dëmi, i shkakton njeriut ndryshime në rrjedhën normale të jetës, të cilat ndryshime ndikojnë negativisht në personalitetin e tij dhe në veprimtarinë e përditshme, duke nxitur në këtë mënyrë një gjendje jo të mirë shëndetësore dhe shpirtërore prej së cilës prodhohet ankth, depresion dhe vështirësi për përballimin e situatave jetësore. Përfshin çdo dëmtim që shkakton ndryshime tronditëse në mënyrën e të jetuarit të të dëmtuarit, duke ia shmangur mundësitë për të shfaqur personalitetin e tij në marrëdhëniet shoqërore ose në botën e jashtme. Për shkak të një gjendjeje të tillë psikofizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qenien e tij, apo mund ta karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme (Deliaj & Mitrush, 2009:3).

3.2.2. Veprimi i kundërligjshëm

Veprimi i kundërligjshëm, paraqet kushtin e përgjithshëm për lindjen e përgjegjësisë juridike civile. Veprimi i kundërligjshëm, konsiderohet ai veprim apo mosveprim i njeriut

me të cilin cenohen normat juridike imperative apo rregullat e moralit në një shoqëri të caktuar (Mamuti, 2013:53). Me veprim apo mosveprim të kundërligjshëm mund të cenohen edhe interesat të karakterit material edhe interesa të karakterit personal, dhe kjo mund të ndodhë si te personat fizik ashtu edhe te ata juridik (Mamuti, 2013:53). Veprimi i kundërligjshëm konsiderohet veprimi i personit që është në kundërshtim me të drejtën objektive, që ndryshe thuhet se është veprim i ndaluar, për shkakun se personave të tjerë në komunikimin juridik u shkaktohet dëm, si dhe për dëmin e shkaktuar parashihet sanksioni i zhdëmtimit të palës së dëmtuar (Mamuti, 2013:53). Nuk është e thënë se ky ndalim duhet të jetë patjetër penalo juridik dhe përgjithësisht publiko juridik, mjafton që të jetë i ndaluar vetëm nga pikëpamja e të drejtës civile (Gams, 1972:321). Gjatë komunikimit juridik subjektet janë të detyruara që mos të bëjnë veprime të kundërligjshme me të cilat subjekteve të tjera u shkaktojnë dëm, pasi shkelin dispozitat e ligjit me të cilat ndalohej apo urdhërohej një veprim i caktuar dhe se secili është i detyruar që të përmbahet nga këto veprime (Mamuti, 2013:53). Kjo nuk nënkupton që personi të përmbahet dhe të mos ndërmarrë vetëm veprime aktive, por të përmbahet edhe nga qëndrimi pasiv (mosveprimi), në qoftë se me këtë mosveprim mund të kontribuojë në shkaktimin e dëmit apo rritjen e pasojave të dëmit (Kiril Çavdar & Kimo Çavdar, 2008:43).

Disa autorë i përfshijnë në kushtin e njëjtë edhe fajin edhe veprimin kundërligjor, duke e llogaritur fajin si pjesë përbërëse të kundërligjshmërisë. Sipas këtyre juristëve, sa herë që personi kryen një veprim të kundërligjshëm, ai konsiderohet me faj (Mamuti, 2013:53). Kështu që nuk ka nevojë që këto dy elemente të trajtohen si dy kushte të veçanta, pasi të kundërligjshëm e konsiderojnë vetëm atë veprim që mund t'i hidhet fajit të dëmtuesit

(Mamuti, 2013:53). Disa autorë të tjerë mendojnë se duhet të ndahet faji nga kundërligjshmëria si kushte të posaçme për lindjen e përgjegjësisë deliktore civile. Kjo për faktin se në praktikë mund të ndodhë që personi të ketë kryer një veprim antijuridik, por nuk do të thotë që domosdoshmërisht të jetë me faj (Mamuti, 2013:53). Veprimi i kundërligjshëm paraqitet si kusht i domosdoshëm të përgjegjësia penale, pasi pa të nuk mund të ketë as vepër penale, ndërsa të përgjegjësia jashtëkontraktore ekzistojnë situata në praktikë kur personit i shkaktohet dëm, pa ekzistuar veprimi i kundërligjshëm apo faji i shkaktuesit të tij (Mamuti, 2013:53). P.sh: tek rasti i përhapjes së gripit të shpendëve gjatë vitit 2006, nga frika se virusi H5-N1 mund të evoluonte në një epidemi të madhe, që është shfaqur si një kërcënim i mundshëm ndaj njerëzimit dhe si rezultat i kësaj u zhdukën një numër i madh i shpendëve. Në këtë rast, edhe pse kemi shkaktim të dëmit, nuk kemi veprim të kundërligjshëm dhe faj të organit që kryente zhdukjen e shpendëve (Mamuti, 2013:54). Veprim kundërligjor kemi edhe në situatat kur personi gjatë vozitjes me veturë futet në drejtim të ndaluar, por nuk shkakton ndonjë aksident me pasoja, siç është dëmi. Në këtë rast edhe pse kemi shkelje të të drejtës objektive apo të normave juridike, për personin do të lindë përgjegjësia administrative për kundërvajtje, por jo edhe përgjegjësia deliktore civile për shpërblimin e dëmit (Mamuti, 2013:54). Kur flasim për të drejtën objektive, duhet ditur se me këtë nuk përfshihen vetëm normat ligjore, por edhe të gjitha normat e karakterit moral dhe zakonor, të cilat gëzojnë mbrojtje përmes sanksionimit nga vet shteti (Mamuti, 2013:55). Këtu duhet dalluar situatën se jo çdo shkelje e normave juridike ka për pasojë lindjen e përgjegjësive civile, për shembull nëse dikush vozitë me shpejtësi të madhe me veturë nëpër rrugët brenda qytetit, në këtë rast edhe pse kemi shkelje të normave juridike, nuk kemi lindjen e përgjegjësive deliktore civile, por vetëm atë administrative

(kundërvajtëse). Prandaj që të sajohet përgjegjësia civile, duhet që përveç veprimit të kundërligjshëm të personit me të cilin cenohet norma juridike duhet të shkaktohet dhe cenimi i ndonjë të mire pasurore dhe personale të mbrojtur juridikisht (Mamuti, 2013:55). Në legjislacionin civil shqiptar dhe në literaturë, është mbajtur qëndrimi i pandryshuar lidhur me kuptimin e kundërligjshmërisë së sjelljes së personit si subjekt i të drejtës (veprimit ose mosveprimit) (Gjata, 2010:38). Në ligjin “Për veprimet juridike dhe detyrimet”, paligjshmëria e sjelljes nuk është ndarë nga elementi faj. Madje, krijohet bindja se faj është parakushti i paligjshmërisë për t’u përgjigjur për dëmin e shkaktuar personit ose pasurisë së tij (Gjata, 2010:38). Neni 472 i LVJD-së, në paragrafin e parë thekson se “personi që me faj i shkakton dëm, në mënyrë të paligjshme një tjetri, detyrohet të shpërblejë dëmin”. Kuptim të njëjtë kanë dhënë si KCSH i mëparshëm, ashtu edhe KCSH i tanishëm. Këtë bindje e përforcon paragrafi dytë i këtyre akteve normative. Në to thuhet: “Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj”¹⁰. Kjo rrjedh edhe nga neni 608 sipas të cilit “Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar” apo “Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira”. Fakti i paligjshëm, shprehet në kryerjen e një veprimi ose mosveprimi që bie ndesh me rendin juridik ose me zakonet e mira. Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm, është një sjellje e vullnetshme dhe e vetëdijshme e personit. Paligjshmëria është një kategori objektive. Mosnjohja e ligjeve nga një individ, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia civile (Tutulani-Semini, 2002:226). Kodi

¹⁰ Shih nenin 472, paragrafi i parë LVJD, neni 336 të Kodit Civil të vitit 1981 dhe nenin 608 të Kodit Civil të tanishëm.

Civil shqiptar ka parashikuar shkeljen ose cenimin e interesave dhe të drejtave që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira duke mos kufizuar në këtë mënyrë përgjegjësinë civile vetëm në rastet e parashikuara nga ligji (Deliaj & Mitrush, 2009:5).

Kundërligjshmëria e veprimit paraqet kushtin e përgjithshëm të përgjegjësisë deliktore civile për përgjegjësinë subjektive (përgjegjësi për veprimet e veta) dhe për veprimet e personit tjetër (sipas fajit të supozuar). Nga kjo mund të kuptojmë se, kundërligjshmëria nuk është përherë kusht i domosdoshëm i përgjegjësisë deliktore civile, siç ndodhë me rastin e dëmit i cili është i domosdoshëm, ku përherë duhet të ekzistojë për t'u dhënë përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Nga kjo, del përfundimi se po të mungojë elementi faj, kundërligjshmëria nuk mund të jetë element përbërës (Gjata, 2010:38). Prandaj ka mendime se kundërligjshmëria e sjelljes, nuk është kurdoherë element më vete për të gjitha rastet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, madje ka të tjerë që mendojnë se nuk është element i kësaj përgjegjësie. Sipas këtyre nuk mund të flitet për sjellje të kundërligjshme, kur nuk përfshihet në fajin e shkaktuesit të dëmit (Gjata, 2010:38).

Në literaturën shqiptare mbizotëron pikëpamja se, kundërligjshmëria e sjelljes është kategori objektive që nuk duhet të përfshihet në elementin faj. Kjo pikëpamje na duket e drejtë, në radhë të parë për faktin se kundërligjshmëria është kategori objektive dhe si e tillë nuk mund të përfshihet në elementin faj (Gjata, 2010:38). Megjithatë, ndonëse kundërligjshmëria e sjelljes dhe faji janë elemente më vete, si rregull nuk mund të konkurrojnë të veçuar nga njëri-tjetri, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj (Gjata, 2010:39). Pra, kundërligjshmëria e sjelljes së personit presupozon dëmin e shkaktuar edhe si rregull me faj. Por nuk na duket aq me vend pikëpamja se kjo

kundërligjshmëri që shkakton dëmin, para se gjithash, qëndron në faktin se sjellja vjen në kundërshtim me të drejtën në kuptimin objektiv. Kjo kundërligjshmëri qëndron në faktin se shkel një të drejtë subjektive të mbrojtur me ligj. P.sh. shkilet e drejta e pronarit, duke u zhveshur nga posedimi mbi sendin (Gjata, 2010:39). Kjo e drejtë subjektive mbrohet me normat e së drejtës. Pra, vetëm kur cenohen të drejtat subjektive, të cilat janë të mbrojtura nga e drejta objektive, sjellja do të quhet e kundërligjshme. Norma juridike ka karakter të përgjithshëm dhe si e tillë ajo merr jetë dhe zbatohet vetëm kur shkelet një e drejtë subjektive e mbrojtur prej saj. Prandaj nisemi nga fakti konkret, dëmi i shkaktuar tek norma juridike (Gjata, 2010:39). Pra, se a ekziston paligjshmëria si prezumim i përgjegjësisë për dëmin, vlerësohet sipas asaj se a kërkohen për paligjshmërinë vetëm elementet objektive apo subjektive të tyre (Gorenc, 2010:183). Nëse për ekzistimin e paligjshmërisë, kërkohen vetëm elementet objektive, mjafton që dëmtuesi me veprimin e dëmshëm ose me dëmin e shkaktuar ta ketë shkelur normën e rendit juridik, pa marrë parasysh raportin e kryesit kundrejt veprimit dhe dëmit të shkaktuar, ndërsa elementet subjektive të paligjshmërisë janë shfaqur me fajin e kryesit. Për elementet subjektive të paligjshmërisë, nuk mjafton që vetëm me veprimin e dëmshëm të jetë shkelur norma juridike, por kërkohet edhe një shkallë e caktuar e fajit të dëmtuesit (Gorenc, 2010:183). Sipas legjislacionit shqiptar, dëmi quhet i paligjshëm jo vetëm kur shkelen ose cenohen interesat dhe të drejtat e tjetrit që mbrohen nga norma e së drejtës, por edhe kur mbrohen nga zakonet e mira (Gjata, 2010:39). Siç dihet, zakonet e mira krijohen gradualisht në mënyrë spontane në marrëdhëniet e ndryshme midis njerëzve në një shoqëri të organizuar, siç janë marrëdhëniet midis fqinjëve, sjelljet në vende publike, sjellje ndaj të miturve e grave. Këto zakone plotësojnë normat e ligjit, pasi me këto të fundit përfshihen dhe mbrohen ato marrëdhënie

që janë më të rëndësishmet. Siç dihet, zakonet e mira merren parasysh në ato lloj marrëdhëniesh që janë parashikuar shprehimisht në normat juridike, siç parashikohet në marrëdhëniet jashtëkontraktore nga shkaktimi i dëmit (Gjata, 2010:40-41).

Veprimi i kundërligjshëm si kusht i përgjegjësisë deliktore civile, ka për të ekzistuar, jo vetëm kur cenohen normat juridiko-civile, por edhe kur cenohen edhe normat e tjera juridike me të cilat mbrohen interesat materiale të personave fizikë dhe juridikë, si dhe interesat jo materiale (morale) të këtyre personave. Që të krijohet përgjegjësia deliktore civile, duhet që me veprimin njerëzor të cenohet një e drejtë subjektive¹¹ e personit të dëmtuar, të shkelet një e drejtë e huaj subjektive (Milosevic, 1977:151). Pra, përveç kundërligjshmërisë së veprimit, edhe faji paraqet kusht të veçantë të përgjegjësisë jashtëkontraktore. Mirëpo, kundërligjshmëria e veprimit nuk mund të barazohet me fajin e kryesit të veprimit të dëmshëm sepse këto janë dy kushte të veçanta të përgjegjësisë deliktore civile të përgjegjësia subjektive si dhe të përgjegjësia për veprimet e tjetrit. P.sh: kur vozitësi me shpejtësi të palejuar e shkelë ndonjë kalimtar, duke i shkaktuar lëndime trupore (Milosevic, 1977:151). Me këtë rast, veprimi i tij është i kundërligjshëm dhe krijon detyrën e dëmshpërblimit. Situata tjetër kur vozitësi, vozitë me shpejtësi të palejuar por nuk shkakton lëndim trupor të kalimtarëve të rastit. Me këtë rast me veprimin e tij edhe pse i ka cilësitë e veprimit të kundërligjshëm, nuk cenohet asnjë e drejtë e huaj subjektive, pra nuk

¹¹ E drejta subjektive civile nënkupton pushtetin faktik dhe juridik që përmban një a po më tepër autorizime mbi një send, psh; instituti i pronësisë përmban tri autorizime: 1) të drejtën e përdorimit të sendeve, 2) të drejtën e shfrytëzimit të sendeve, dhe 3) të drejtën e disponimit në sende. Pra, e drejta subjektive është autorizim i cili i takon subjektit të së drejtës duke u bazuar në normën juridike për të mbrojtur interesin e vet (Ismaili, 2014:154).

krijohet përgjegjësi juridike deliktore civile, po përgjegjësi për veprën e kundërvajtjes në trafik (Dauti, 2008:156).

Veprimin e kundërligjshëm, mund ta ndërmarë edhe personi i cili nuk do të ishte i vetëdijshëm për sjelljet e veta. Në këto rrethana ai nuk do të përgjigjej, sepse nuk ka aftësi për gjykim e cila është kusht për ekzistimin e fajit të dëmtuesit. LMD në nenin 141 thekson se: “Personi i cili për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit të metë mendor apo të shkaqeve të tjera nuk është i aftë të gjykojë, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që dëmin e ka shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar. Kush i shkakton dëm tjetrit në gjendje të pa aftësisë së përkohshme për gjykim, është përgjegjës për atë, përveç nëse provon se pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tillë. Në qoftë se në këtë gjendje është sjellë me faj të dikujt, për dëmin do të përgjigjet ai që e ka sjellë në gjendje të tillë”.

3.2.2.1. Përfjashtimi i veprimit antijuridik-kundërligjshëm

Legjislacioni civil shqiptar, ashtu si legjislacionet e tjera bashkëkohore, nga parimi i përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar, ka njohur edhe përfjashtime të caktuara. Siç dihet, përfjashtimet nga rregulli i përgjithshëm duhet të jenë të parashikuara shprehimisht në normat juridike (Gjata, 2010:53). Pra, në jetën e përditshme mund t’i shkaktohet një dëm material një personi dhe shkaktuesi i dëmit të mos përgjigjet për shpërblimin e dëmit. Kjo ndodhë atëherë kur nuk ekziston përgjegjësia e dëmtuesit, për arsye se sipas një dispozite të caktuar sjellja e njeriut që ka shkaktuar dëmin nuk quhet e kundërligjshme (Gjata, 2010:53). Ekzistojnë disa raste, në të cilat veprimi i dëmshëm njerëzor nuk ka karakter të

kundërligjshëm, edhe pse dëmi i është shkaktuar personit tjetër. Pra, ekzistojnë situata në të cilat, përkundër faktit se ekziston paligjshmëria, përgjegjësia për dëmin zvogëlohet, e në disa raste edhe përjashtohet. Këto raste, ndryshe njihen me emrin përjashtimi i veprimit antijuridik apo edhe si shkaqe që e përjashtojnë kundërligjshmërinë.

Këto raste janë:

- Dëmi i shkaktuar duke e kryer të drejtën e vet
- Dëmi i shkaktuar duke kryer detyrën zyrtare
- Dëmi i shkaktuar në mbrojtje të nevojshme
- Dëmi i shkaktuar nga nevoja ekstreme
- Dëmi i shkaktuar me pranimin e të dëmtuarit
- Dëmi i shkaktuar nga vetëndihma e lejueshme dhe
- Dëmi i shkaktuar me pranimin e të dëmtuarit.

Siç shihet veprimi është i kundërligjshëm kur është në kundërshtim me normën juridike, moralin shoqëror, me të cilin veprim cenohet ndonjë e drejtë subjektive e të dëmtuarit. Megjithatë, ekzistojnë veprime të njeriut të cilat nuk janë të kundërligjshme, por dëmtuesi është përgjegjës për shpërblimin e dëmit (DPPJ, 2015:512). Një përgjegjësi e tillë ekziston: kur dëmtuesi e shkakton dëmin, duke ushtruar ndonjë të drejtë që i takon, por me rastin e shfrytëzimit të saj nuk bën t'i kalojë kufijtë e lejuar, sepse shfrytëzimi i të drejtës do të kthehej në keqpërdorim të saj (DPPJ, 2015:512).

3.2.2.1.1. Dëmi i shkaktuar duke e kryer të drejtën e vet

Nuk do të konsiderohet veprim i kundërligjshëm nëse një subjekt i shkakton dëm tjetrit, duke kryer të drejtat e veta në kuadër të autorizimeve dhe suazave të ligjit (Dauti, 2008:157). Kur flasim për realizim e të drejtës së vet, kemi parasysh realizimin e të drejtave subjektive që janë në përputhje me dispozitat ligjore pozitive (Mamuti, 2013:59). Sa herë që personi duke vepruar brenda kornizave të ligjit dhe zakoneve të mira realizon të drejtën e vet, por si pasojë e këtij veprimi i shkaktohet dëm palës tjetër, nuk do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit (Mamuti, 2013:59). Personi nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar për faktin se, veprimi i tij nuk cenon dispozitat ligjore dhe nuk prek kufijtë e ligjit. Si i tillë, nuk është kundërligjor, kusht pa të cilin nuk sajohet përgjegjësia juridike civile (Mamuti, 2013:59). Megjithatë, duhet pasur parasysh faktin se raportet shoqërore janë të ndërruarura, dhe se të drejtat e një personi janë të kufizuara nga të drejtat e personit tjetër apo të shoqërisë në përgjithësi. Gjithashtu, sa herë që personi realizon një të drejtë subjektive, duhet të ketë parasysh që mos të tejkalojë kufijtë ligjor, me çka rrezikon dhe cenimin e të drejtës së personave të tjerë (Mamuti, 2013:59). Prandaj, ushtrimi i të drejtave subjektive nuk duhet kuptuar si absolut, pasi shpeshherë varet dhe nga personi dhe mënyra adekuate e realizimit të drejtës së vet. Në të drejtën e sotme, kufizimi i ushtrimit të të drejtave është paraparë në shumë fusha, pasi dhe mundësia e abuzimit me këto është rritur mjaft. Çdo herë, kur personi vepron në kundërshtim me të drejtën e vet, apo ka për qëllim që t'i shkaktojë dëm personit tjetër, kemi situatën e keqpërdorimit të së drejtës (Mamuti, 2013:60). Kjo rregull ka ekzistuar qysh në të drejtën romake, ku thuhej se, “*kush e realizon të drejtën e vet, askujt nuk i bën padrejtësi*” – “*Qui sou iure utitur, nemini facit iniuriam*”. Autorizimet që i ka subjekti nuk duhet të shndërrohen në keqpërdorimin e të drejtave.

Keqpërdorimi i së drejtës nuk e liron subjektin nga përgjegjësia deliktore civile. Kjo do të thotë se duke e ushtruar të drejtën tuaj subjektive, nuk mund t'i shkaktoni dëm tjetrit edhe pse përndryshe do të kishit të drejtë. Në teorinë juridike dhe në legjislacione, ekzistojnë mendime të ndryshme për natyrën e keqpërdorimit të të drejtave (Milosevic, 1977:151-152). Sipas një mendimi, keqpërdorim i së drejtës ekziston, kur dikush e kryen të drejtën e vet me qëllim që tjetrit t'i shkaktojë dëm. Ky mendim është i njohur si teori subjektive. Keqpërdorimi i së drejtës ekziston, kur dikush i kryen të drejtat e veta nga se është shpirtkeq ose me poshtërim (Milosevic, 1977:152). Qysh në të drejtën romake ka ekzistuar rregulla *"malitis non est indulgendum- shpirtkeqësinë nuk duhet duruar"* dhe me rregullën tjetër *"fraus omnia corrumpit- mashtrimi e prish mbrojtjen"* (Dauti, 2008:157). Një mendim tjetër është se, keqpërdorimi i së drejtës ekziston kur e drejta kryhet kundër qëllimit të vet, për të cilin është aprovuar. Ky mendim, është i njohur si teori objektive. Sipas këtij mendimi keqpërdorimi i të drejtave është, kur dikush i kryen të drejtat e veta në mënyrë jonormale, pa marrë parasysh motivet a shkaqet që kryhen në atë mënyrë. Mu për shkak të kryerjes jonormale të së drejtës, titullari duhet të përgjigjet për dëmin që i ka shkaktuar tjetërkujt (Milosevic, 1977:152). Pra, dëmi mund të shkaktohet edhe nga një person që është duke ushtruar një të drejtë të tijën. Shkaktuesi i dëmit nuk do të përgjigjet, në qoftë se e ushtron në pajtim me urdhërimet e ligjit dhe zakonet e mira të rendit. Kjo do të thotë që ushtrimi i një të drejte, duhet të bëhet sipas paracaktimit dhe brenda kufijve normalë të ushtrimit të kësaj të drejte. Në rast se e drejta ushtrohet pa përfillur kufizimet e ligjit, rregullat e fqinjësisë etj. ose me qëllim që t'i shkaktohet tjetrit një dëm, do të ndodhemi para shpërdorimit të së drejtës (Gjata, 2010:54). P.sh. në një apartament në orët e vona të natës bëhet një zhurmë e madhe sa i pengon fqinjët të bëjnë pushimin e natës; ose

kur një person hap një vijë uji në drejtim të oborrit të fqinjit, duke mbuluar me ujë, etj. Në raste të tilla nga shpërdorimi i së drejtës, pengohet tjetri në kryerjen e veprimtarive të caktuara ose në ushtrimin e një të drejte të ligjshme (Gjata, 2010:54-55). Në legjislacionin civil dhe administrativ shqiptar, janë parashikuar kufijtë e ushtrimit të të drejtave subjektive, sidomos atyre të pronësisë, në radhë të parë me dispozita të KCSH, pastaj me ligjin "Për Urbanistikën" dhe rregulloren e miratuar për zbatimin e tij. Kështu sipas nenit 159 të KCSH "Pronari është i lirë në përdorimin e sendit, pa dëmtuar të drejtat e personave të tjerë dhe brenda kufijve që caktohen nga ligji, ose nga zakonet e mira (Gjata, 2010:55). Ai nuk mund t'u krijoj fqinjëve shqetësime të tilla si zhurma, dridhje, futje të tymit, nxehtësive, avujve ose përhapje të tjera të ngjashme, të pengojë gëzimin e pronave të tyre, duke ndryshuar rrjedhat a prurjet ose cilësinë e ujërave që rrjedhin në tokën e tij ose të ujërave nëntokësorë..., përveç kur këto shqetësime nuk kalojnë shkallën e zakonshme të tyre". Kufizime të tjera janë parashikuar në nenet 160 e 161 të KCSH, lidhur me respektimin e rregullave të planeve rregulluese ose në dispozita të veçanta, për lartësinë e largësinë midis ndërtesave, lidhur me mbledhjen e ujërave të strehëve etj (Gjata, 2010:54). Është i pranishëm edhe një mendim ku, keqpërdorimi i të drejtave ekziston, qoftë kur titullari i së drejtës e ushtron të drejtën e vet me qëllim që tjetrit t'i shkaktohet dëm, apo kur e ushtron të drejtën kundër qëllimit për të cilin është aprovuar. Ky mendim njihet si teori subjektive-objektive (Millosheviç, 1977:153). Pra, sipas kësaj teorie keqpërdorimi i të drejtave ekziston, kur e drejta realizohet me qëllim që tjetrit t'i shkaktohet dëm, gjithashtu kur ajo realizohet kundër qëllimit për të cilin është ndërmarrë. LMD e pranon si teori, teorinë objektive për keqpërdorimin e të drejtave. Nga e gjithë kjo rrjedh se, pasoja kryesore e keqpërdorimit të të drejtave është shkaktimi i dëmit, i cili krijon detyrimin e

kompensimit të tij. Nga këto dispozita del qartë se shkelja e tyre përbën shpërdorim të së drejtës, pra jo vetëm që nuk gëzon mbrojtje ligjore, por mund të sjellë edhe detyrimin e tij në rast të shkaktimit të dëmit.

3.2.2.1.2. Dëmi i shkaktuar duke kryer detyrën zyrtare

Gjatë veprimit të personave zyrtar ndodh shpeshherë që të shkaktohet dëmi, por sa herë që të njëjtit veprojnë në suaza të ligjit dhe autorizimeve zyrtare, për shkaktuesin e dëmit nuk lindë përgjegjësia për shpërblimin e tij. Rastet e këtilla janë të shpeshta në praktikë (Mamuti, 2013:60). Në praktikë ndodhë, që një person me veprimet e tij t'i shkaktojë një dëm material tjetrit, ku megjithatë vepra e tij të mos jetë e kundërligjshme. Kjo ndodhë, atëherë kur personi duke kryer një detyrë zyrtare brenda kompetencave të tij të parashikuara me norma juridike nga veprimet që ndërmerr i shkaktohet tjetrit një dëm (Gjata, 2010:53-54). Këto janë, kryesisht rastet kur përfaqësuesit e organeve shtetërore e zbatojnë vendimin e këtyre organeve, si p.sh. kur policia ndërtimore rrëzon ndonjë objekt të ndërtuar ose përmbaruesi për zbatimin e një vendimi të formës së prerë të gjykatës, hap me forcë derën e një banese për ta rivendosur në posedim personin që ka urdhëruar me vendim gjykata (Gjata, 2010:54). Megjithatë, në raste të tilla personat zyrtarë duhet të veprojnë me kujdes dhe sipas rregullave të profesionit, me qëllim që dëmi të jetë sa më i vogël. Në qoftë se, personat zyrtarë sillen me mospërfillje, duke shkaktuar dëme të panevojshme, si p.sh. dëmtimi i një muri të një banese tjetër fqinje me atë që do të rrënohej ose dëmtimi jo vetëm i bravës, por edhe i derës së hyrjes, do të përgjigjen për këtë dëm të shkaktuar. E njëjta vlen

për zjarrfikësit, rojet e objekteve e pasurive të tjera (Gjata, 2010:54). Themelore është që gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, të mos tejkalohen kufijtë e kompetencave që ata kanë.

Në të gjitha rastet e lartpërmendura personi që është duke kryer detyrën zyrtare, pavarësisht faktit të shkaktimit të dëmit, nuk do të përgjigjet. Në qoftë se, një veprim i tillë kryhet nga personi jo zyrtar apo i pa autorizuar, padyshim që për të njëjtin do të lindte detyrimi për kompensim (Mamuti, 2013:60). Andaj në këto raste, veprimi i personit zyrtar duhet të jetë në kuadër të veprimeve të lejuara dhe autorizimeve të cilat i ushtron organi zyrtar. Në të kundërtën, do të lind detyrim për zhdëmtim, sepse veprimi i autorit të dëmit do të kualifikohet si i kundërligjshëm (Mamuti, 2013:60).

3.2.2.1.3. Dëmi i shkaktuar në mbrojtje të nevojshme

Një nga përjashtimet nga pranimi i përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit, është kur dëmi është shkaktuar nga personi në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, përjashtim ky i parashikuar shprehimisht nga neni 611 të KCSH-së, në të cilin thuhet se, “Nuk është përgjegjës ai që shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti”. Në KCSH nuk jepet kuptimi i nocionit “mbrojtja e nevojshme”, prandaj përmbajtjen juridike civile të mbrojtjes së nevojshme dhe të kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, duhet ta analizojmë në pajtim me zbatimin e dispozitave përkatëse të së drejtës penale (Gjata, 2010:54-55). Kështu, në nenin 19 të Kodit Penal Shqiptar është dhënë ky kuptim i mbrojtjes së nevojshme: “Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojë jetën, kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me

rrezikshmërinë e sulmit. Mos përputhja haptazi ndërmjet tyre, përbën kapërcim të mbrojtjes së nevojshme” (Gjata, 2010:56).

Në të drejtën civile, mbrojtja e nevojshme merret parasysh vetëm kur nga ushtrimi i kësaj mbrojtjeje është shkaktuar një dëm. Mbrojtja e nevojshme përbën bazën e përjashtimit nga përgjegjësia dhe si e tillë ekziston vetëm kur ka lindur nevoja për kryerjen e veprimeve të caktuara në përputhje me sulmin e shkaktuesit të dëmit (Gjata, 2010:56). Gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen për shkaktimin e dëmit, ka të drejtë të hetojë se, a është kapërcyer mbrojtja e nevojshme dhe që në lidhje me këtë edhe përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit, me gjithë faktin, se i padituri në procesin penal për ngjarjen e njëjtë, është shpallur i pafajshëm, pasi në atë proces nuk është vërtetuar se ka kapërcyer kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, me gjithë faktin, se i padituri në procesin penal është shpallur fajtor (Gjata, 2010:56). Pra, gjykata nuk është lidhur me vendimin penal për sa i përket vlerësimit a janë kapërcyer kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Ky qëndrim i teorisë dhe praktikës është në përputhje me përmbajtjen e neneve 70 e 71.1 të KPPSH (Gjata, 2010:56). Neni 70, përcakton efektet e vendimit penal të formës së prerë për gjykimin civil dhe administrativ: “Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës, vetëm sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. Vendimi penal që zgjidhë rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale, nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër”. Po kështu, sipas paragrafit të parë të nenit 71, “Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale, vetëm sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për pafajësinë e të pandehurit” (Gjata, 2010:57).

Për t'u pranuar mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të jetë real, pasi mbrojtja nga sulmi fiktiv, i menduar, i supozuar, i cili në fakt nuk ekziston (e ashtuquajtura mbrojtja e nevojshme putative), nuk gjykohet sipas rregullave të mbrojtjes së nevojshme. Përderisa me mbrojtjen e nevojshme mbrohet kurdoherë gjendja ekzistuese, kjo nuk mund të kalojë në veprime që do të krijojnë një gjendje tjetër, në vetëgjyqësi (Gjata, 2010:57).

Nocioni “mbrojtja e nevojshme”, është i ngjashëm me nocionin “nevojë e skajshme”. Nganjëherë, në praktikë nuk është lehtë të dallohen. Në radhë të parë dallimi është në faktin se nevojën e skajshme nuk e nxit sulmi i një tjetri (Gjata, 2010:57). Por dallimi më kryesor qëndron në faktin se, në të drejtën civile mbrojtja e nevojshme e përjashton gjithmonë përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit, ndërsa dëmi i shkaktuar në kushtet e nevojës së skajshme, shpërblehet. Mbrojtja e nevojshme drejtohet, gjithmonë kundër sulmuesit njeri, ndërsa nevoja e skajshme nxitet jo vetëm nga veprimet e njeriut, por edhe nga një ngjarje e natyrës ose nga rreziku i ndonjë kafe (Gjata, 2010:57). Si përfundim, mund të themi se veprimi që shkakton dëmin në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, nuk ka karakter të kundërligjshëm, pikërisht, sepse drejtohet kundër një veprimi të kundërligjshëm për të mbrojtur veten, një tjetër ose pasurinë. Ka mendime se ajo që mbrohet duhet të ketë një vlerë më të lartë se dëmi i shkaktuar, që na duket e diskutueshme. E kemi fjalën për dallime jo të theksuara ndërmjet vlerës së mbrojtur dhe vlerës së dëmit të shkaktuar (Gjata, 2010:57). Kur sulmuesit i shkaktohet dëmi në mbrojtjen e nevojshme, nuk i paguhet kurrfarë dëmshpërblimi (Milosevic, 1977:154).

LMD në Nenin 143, parag, 1 thekson se: “Kush në mbrojtje të nevojshme i shkakton dëm sulmuesit nuk e ka për detyrë ta shpërblejë dëmin, përveç në rastin e tejkalimit të mbrojtjes

së nevojshme”. Edhe KCSH në Nenin 611 thekson se: “Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti”. Te mbrojtja e nevojshme është me rëndësi, se vlera që mbrohet duhet të jetë më e lartë se dëmi që është shkaktuar. Pra, mbrojtja e nevojshme përherë e përjashton përgjegjësinë e personit, i cili i ka shkaktuar dëm sulmuesit, sepse është në konflikt e drejta me të padrejtën, atëherë dëmi i shkaktohet të padrejtës. Nëse dikush është fajtor, që është shkaktuar mbrojtja e nevojshme, atëherë ai ka për obligim që të zhdëmtojë personin të cilit i ka shkaktuar dëmin¹².

3.2.2.1.4. Dëmi i shkaktuar nga nevoja ekstreme (e skajshme)

Në jetën e përditshme ndodhë që të paraqitet nevoja e patjetërsueshme që personi t’i shkaktojë dëm palës tjetër, me qëllim që ta mbrojë një të drejtë të tij apo ndonjë të drejtë të dikujt tjetër (Mamuti, 2013:60). Veprim në nevojë ekstreme (të skajshme), konsiderohet ai veprim i palës me të cilin bëhet largimi nga vetvetja apo tjetri, rrezikun e përnjëhershëm akoma të pa shkaktuar. Pra rreziku i cili nuk mund të shmanget në ndonjë mënyrë tjetër në atë moment (Mamuti, 2013:60). Veprimi i palës në këtë rast nuk është me faj, për faktin se si i tillë lejohet me dispozita të ligjit, por megjithatë pala e dëmtuar duhet të shpërblehet duke u mbështetur në përgjegjësinë objektive apo subjektive (Mamuti, 2013:60). Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose

¹² Marrim shembull: kur një shofer i automobilin për të shmangur ndeshjen e cila do të bëhej me fajin e shoferit tjetër, ka dalë me veturë në trotuar dhe e ka lënduar ndonjë kalimtar, atëherë ai për këtë dëm nuk do të përgjigjet por shoferi tjetër, me fajin e të cilit është shkaktuar rreziku i ndeshjes. Pra, në mbrojtjen e nevojshme ekziston konflikti në mes një veprimi të drejtë me një të padrejtë, kurse në nevojën ekstreme ka konflikt ndërmjet dy të drejtave, ku edhe pasojat e këtij konflikti janë më ndryshe nga ato kur shkaktohen nga konflikti ndërmjet një veprimi të drejtë me një të padrejtë (Georgiev, 1985:418).

pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit. Do të ishte qëndrimi i pa drejtë që dikush të pësojë dëm, vetëm me arsyetimin për të shpëtuar ndonjë të mirë materiale apo personale të dikujt tjetër (Mamuti, 2013:60). Personi që sillet në nevojë ekstreme, për të larguar rrezikun e shkaktimit të dëmit nga ndonjë person tjetër, duhet që të dëmtojë ndonjë të mirë materiale të ndonjë personi të tretë, e jo të atij që ka shkaktuar rrezikun, pasi në këtë rast do të kishim sjellje të personit në mbrojtje të nevojshme. Që të konsiderohet një veprim i palës si veprim i nevojës ekstreme, ai duhet të përmbajë disa karakteristika (Mamuti, 2013:61):

- veprimi për shmangien e rrezikut duhet të ndodhë në kohë të njëjtë, kur paraqitet edhe rreziku i shkaktimit të dëmit;
- të mos kishte tjetër mënyrë për ta mënjanuar rrezikun në atë kohë;
- vlera e të mirave materiale apo personale të shpëtuar, të jenë më të mëdha se sa dëmi që do të mund të shkaktohej nga veprimi i nevojës ekstreme (së skajshme).

Nga kjo arrijmë në këtë përfundim se, që të ekzistojë nevoja ekstreme, duhet patjetër të ekzistojë rreziku i shkaktimit të dëmit dhe detyrimi, për të ndërmarrë veprime për shmangien e atij rreziku në kohë të njëjtë (Mamuti, 2013:61). Në të kundërtën, nuk do të kishim veprim të nevojës ekstreme. Nëse ndodhë që të shkaktohet njëherë dëmi nga veprimi i rrezikshëm, kurse personi të ndërmarrë veprime, veç pas shkaktimit të pasojave, atëherë nuk mund të themi se personi ka vepruar në nevojë ekstreme (Mamuti, 2013:61). Dhe në rastin e shpërblimit të këtij dëmi, nuk do të zbatohet rregulli për situatën e nevojës së skajshme, por rregullat e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për shpërblimin e

dëmit (Mamuti, 2013:61). Të ngjashme e kemi situatën, edhe kur ekziston mundësia kur rreziku i dëmit që mund të shmanget me veprime të tjera, pa pasur nevojë t'i shkaktohet dëm palës që rrezikon, pasi dhe në këtë rast, pala që ka vepruar në mbrojtje të nevojës ekstreme, nuk do përgjigjet bazuar në rregullat e përgjegjësisë së nevojës ekstreme, por në bazë të rregullave të përgjithshme të shkaktimit të dëmit (Mamuti, 2013:61). Në këto raste, personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi që ka shkaktuar rrezikun e shkaktimit të dëmit, nga pronari i sendit ku është shkaktuar rreziku ose nga personi që merret me atë lloj të veprimtarisë që paraqet burim rreziku. Në rast se dëmi është shkaktuar nga nevoja ekstreme, dëmtuesi nuk përgjigjet për dëmin e tillë. Nevoja ekstreme paraqet evitimin e rrezikut nga dëmi prej vetvetes ose prej tjetrit, i cili nuk ka mundur të evitohej në ndonjë mënyrë tjetër. Nevojë ekstreme është gjendja, që ekziston kur dikush i shkakton dëm vetvetes ose tjetrit, duke e mënjanuar rrezikun që i kanoset drejtpërdrejt (Dauti, 2008:158).

Në legjislacionin civil shqiptar, është dhënë kuptimi i nevojës së skajshme si institut juridik. Kështu, sipas nenit 612 të KC, “Personi që ka shkaktuar dëmin duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i aty çastshëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar as nuk mund të mënjanohet prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin (Gjata, 2010:58). Gjykata duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit”. Në thelb këtë qëndrim e ka mbajtur edhe legjislacioni i mëparshëm, por pa dhënë kuptimin e nevojës së skajshme (Gjata, 2010:58). Në paragrafin e dytë të nenit 474 të LVJD, për këtë institut është dhënë ky kuptim: “Personi që në rastin e nevojës

së skajshme i shkakton një dëm një personi tjetër ose një pasurie të huaj, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Por gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes mund ta shkarkojë, plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit” (Gjata, 2010:58). Edhe në nenin 20 të Kodit Penal në Shqipëri është dhënë kuptimi i “nevojës së skajshme”, të përafërt me atë të KCSH. Mirëpo për sa i përket pasojave juridike kanë dallime ndërmjet tyre. Sipas nenit 612 të KCSH, personi që ka shkaktuar dëmin në kushtet e nevojës së skajshme, si rregull detyrohet ta shpërblejë dëmin. Vetëm përjashtimisht, kur konkurrojnë rrethana të posaçme, ligji e lejon gjykatën ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht personin nga detyrimi i shpërblimit të dëmit (Gjata, 2010:58-59). Për t’u pranuar se sjellja e personit ka qenë në kushtet e nevojës skajshme, duhet që ta përballojë një rrezik të dukshëm real, i cili nuk mund të mënjanohet në një mënyrë tjetër dhe me kusht që dëmi i shkaktuar të jetë më i vogël se ai i zbrapsur. P.sh. dikush duke vrapuar nga frika e qenit, shkallmon derën e një personi tjetër (Gjata, 2010:59). Ai detyrohet t’i shpërblejë dëmin e pronarit të derës, megjithëqë për këtë dëm nuk ishte fajtor. Por nga ana tjetër, ky ka të drejtën e regresit ndaj pronarit të qenit. Pra, ligji lejon dëmtimin e pasurisë së tjetrit, kur sendi i personit që vepron në kushtet e nevojës së skajshme ose të një personi që mbrohet, ka vlerë më të madhe se sa pasuria e dëmtuar. Përkitazi për këtë dëmtuesi detyrohet t’i shpërblejë dëmin e shkaktuar (Gjata, 2010:59). Në rastet e tilla, kur gjykata konstaton se, gjendja e nevojës së skajshme ka lindur edhe për fajin e një personi të tretë, personi që ka shkaktuar dëmin në kushtet e nevojës së skajshme, mund të shkarkojë nga detyrimi i shpërblimit të dëmit. P.sh. drejtuesi i automjetit për të shmangur një fatkeqësi ose përplasjen me një automjet përballë tij, devijon në trotuar dhe e dëmton mallin e ekspozuar para dyqanit. Për dëmin do të përgjigjet drejtuesi i automjetit,

me fajin e të cilit ka lindur gjendja e nevojës së skajshme (Gjata, 2010:59). Shembull tjetër: i dëmtuari, të cilit i është dëmtuar pasuria gjatë fikjes së zjarrit në ndërtesë, mund të kërkojë shpërblimin e dëmit si nga pronari i ndërtesës, ashtu edhe nga personi të cilit i është shmangur dëmi. Në rastet kur ka vend për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në kushtet e nevojës së skajshme, mendojmë se në masën e shpërblimit duhet të përfshihet vetëm dëmi efektiv dhe jo edhe fitimi i munguar (Gjata, 2010:59). Në këtë përfundim na dërgon përmbajtja e nenit 612. Vetë personi që vepron në kushtet e nevojës së skajshme nuk quhet fajtor për dëmin e shkaktuar, pasi edhe ligji lejon shkaktimin e një dëmi më të vogël për mbrojtjen e një pasurie me vlerë më të madhe.

Për dallim nga mbrojtja e nevojshme, që nënkupton konfliktin e të drejtës me të padrejtën, në nevojën e skajshme kemi të bëjmë me konflikt ndërmjet dy të drejtave. Në të drejtën krahasuese, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme se cilës të drejtë duhet t'i jepet më tepër peshë (Gjata, 2010:59). Kështu, p.sh., sipas nenit 52 të ligjit Zviceran për detyrimet, nenit 1306/ a të ligjit Austriak, nenit 2054 të KC Italian etj. i lihet gjykatës të vendosë a ka vend dhe në ç' masë duhet të vendoset shpërblimi i dëmit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e ngjarjes, siç janë: shkalla e rrezikut, raporti i madhësisë së dëmit me vlerën e rrezikut etj. (Galgano, 1999:361). LMD në Nenin 143, parag, 2 dhe 3, për dëmin e shkaktuar nga nevoja ekstreme parasheh, "Në qoftë se dikush e shkakton dëmin në gjendje të nevojës ekstreme, i dëmtuari mund të kërkojë shpërblim nga personi që është fajtor për shkaktimin e rrezikut të dëmit ose nga personat nga të cilët është mënjeluar dëmi, por nga këta të fundit jo më tepër se sa kanë pasur përfitim nga kjo. Kush pëson dëm duke mënjeluar rrezikun e dëmit prej tjetrit, ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e atij dëmi, të cilit i

është ekspozuar me arsye”. Gjithashtu, edhe KCSH në Nenin 612, dëmin e shkaktuar nga nevoja ekstreme e parasheh në këtë mënyrë: “Personi që ka shkaktuar dëmin duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i atyçastshëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit”. Nga kjo shihet se subjekti që ka vepruar nga nevoja e skajshme, në qoftë se ka pësuar dëm, ka të drejtë që nga subjekti të cilit ia ka mënjанuar rrezikun të kërkojë shpërblimin për dëmin që ka pësuar, por shpërblimi nuk duhet të jetë më i lartë se dobia që është shpëtuar.

3.2.2.1.5. Dëmi i shkaktuar nga vetëndihma e lejueshme

Mbrojtja ose realizimi i të drejtave subjektive me forcat dhe mjetet vetiake, pa ndihmën e organeve të pushtetit publik, quhet vetëndihmë. Ky është një mjet juridik i jashtëzakonshëm që është lejuar në rrethana të parashikuara në ligj (Gjata, 2010:62). Kjo ndodhë atëherë kur personi, e drejta e të cilit është cenuar dhe vënë në rrezik, ka të drejtë të mbrohet nga ana e organeve të pushtetit, por për shkak të rrethanave të veçanta (rreziku i afërt, ngadalësia e mbrojtjes gjyqësore), mund të mbrojë vetë ose të realizojë të drejtën subjektive (Gjata, 2010:62). Teorikisht kemi të bëjmë me një lloj zëvendësimi të ndërhyrjes së pushtetit. Në legjislacionin civil shqiptar nuk është parashikuar shprehimisht në dispozitë të veçantë vetëndihma e lejuar si në disa legjislacione të tjera (Gjata, 2010:62). Në dispozitat për mbrojtjen e posedimit, poseduesit i është njohur e drejta për të kundërshtuar

aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi dhe kur i merret sendi me dhunë ose fshehurazi, ka të drejtë të marrë atë menjëherë ose në ndjekje e sipër (neni 310 të KCSH) (Gjata, 2010:62). Ky përfundim gjen, pjesërisht mbështetje edhe në paragrafin e tretë të nenit 312 të KCSH-së. Sipas kësaj dispozite: “Pushimi i cenimit të posedimit nuk mund të kërkohet nga presioni që ka fituar posedimin me dhunë ose fshehurazi”.

Vetëndihma është mbrojtje ose realizim i të drejtave subjektive me forcën vetjake pa ndihmën e organeve të pushtetit publik. Kjo mënyrë e mbrojtjes dhe e realizimit të të drejtave manifestohet, kur ekziston rreziku nga ngadalshmëria e mbrojtjes gjyqësore. Në këto raste, vetëndihma paraqitet si zëvendësim i ndërhyrjes së pushtetit (Dauti, 2008:159). LMD në Nenin 144, parag. 1,2 thekson: ”Kush në rastin e vetëndihmës së lejuar i shkakton dëm personit i cili e ka shkaktuar nevojën e vetë ndihmës nuk ka për detyrë ta shpërblejë. Me vetë ndihmë të lejuar nënkuptohet e drejta e çdo personi për të mënjанuar shkeljen e të drejtës kur kanoset rreziku i drejtpërdrejtë, në qoftë se një mbrojtje e tillë është e domosdoshme dhe nëse mënyra e mënjanimi të cenimi të së drejtës i përgjigjet rrethanave në të cilat shkaktohet rreziku”.

Prej atyre që u than më sipër, për vetëndihmën e lejuar në shkaktimin e dëmit, duhet të plotësohen këto kushte: duhet të jetë cenuar një e drejtë subjektive e dikujt ose e një gjendjeje fakti, mënyra e ndalimit të cenimit të së drejtës duhet t’i përgjigjet rrethanave në të cilat ka lindur rreziku (Gjata, 2010:62).

3.2.2.1.6. Dëmi i shkaktuar me pranimin e të dëmtuarit

Në literaturën juridike shqiptare dhe në atë të huaj, është trajtuar çështja e kundërligjshmërisë të veprës së një personi që ka shkaktuar dëmin me miratimin paraprak të të dëmtuarit. Kështu, sipas literaturës shqiptare: “Nuk quhet e kundërligjshme as vepra e një personi që ka shkaktuar dëmin kur vetë i dëmtuari ka dhënë pëlqimin për t’u shkaktuar dëmi (Gjata, 2010:60). Pëlqimi i të dëmtuarit mund të përjashtojë karakterin e kundërligjshëm të veprës, vetëm atëherë, kur vetë pëlqimi të mos jetë i kundërligjshëm”. Për të mbështetur e zbërthyer më tej këtë përfundim, janë dhënë edhe shembuj. Të drejtat vetjake jopasurore janë të patjetërsueshme, prandaj pëlqimi i të dëmtuarit për të cenuar një të drejtë të tillë është i kundërligjshëm; ose pëlqimi i të dëmtuarit për të dëmtuar një pasuri të tij me vlerë të rëndësishme, nuk mund të quhet pëlqim i ligjshëm, pasi këto dëmtime përbëjnë vepër penale, sepse janë të ndaluara. Pranimi paraprak i të dëmtuarit, që t’i shkaktohet një dëm e ka burimin në të drejtën subjektive të tij, p.sh: pëlqimi në fushën e mjekësisë për ndërhyrjet kirurgjike, në sport, etj. Rast i pranimit të të dëmtuarit, është ndërhyrja e mjekut, atëherë kur i dëmtuari ka mundësi të japë pëlqimin (Gjata, 2010:60-61). Prandaj me këtë rast, ai vetë duhet të pranojë për intervenimin kirurgjik, e në qoftë se intervenohet pa pëlqimin e pacientit, mjeku mund të përgjigjet për atë dëm. Ekziston edhe rasti tjetër kur i dëmtuari nuk është në gjendje të japë pëlqimin, atëherë intervenimi kirurgjik bëhet pa pëlqimin e tij. Po ashtu, edhe në rast të shkaktimit eventual të dëmit, atëherë kur mjeku ka vepruar në pajtim me rregullat e profesionit, nuk do të ketë përgjegjësi për dëmin.

Duhet pasur parasysh që dëmi të mos shkaktohet me faj dhe dëmi të mos përbëjë veprë penale. Kur themi faj, ai duhet të jetë në formë të dashjes ose pakujdesisë së rëndë. Siç u tha më sipër, në mjekësi ose në sport, zakonisht dëmi duhet të jetë më i pakët nga shkalla e dobësisë shoqërore (Gjata, 2010:61). Me pavlefshmërinë e marrëveshjes paraprake që përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj, sipas nenit 610 të Kodit Civil, duhet kuptuar pëlqimi paraprak i të dëmtuarit, për t'iu shkaktuar dëmi nga një sjellje e tjetrit, që me ligj është e ndaluar (Gjata, 2010:61). Jo vetëm kaq, edhe kur jepet pëlqimi paraprak nga personi për mungesë të njohurive, për pasojat e një veprimi të caktuar, marrëveshja duhet të quhet e pavlefshme. P.sh. marrëveshja me fqinjin, d.m.th. dhënia e pëlqimit prej tij për ndërtimin e një muri dhe ofrimin e ndihmës për ta ngritur, nuk do të thotë se i dëmtuari ka pranuar edhe për ndërtimin që ka ardhur më pas, si lagështira në mjediset e shtëpisë së tij, kur është vërtetuar se shkak i dëmit është ndërtimi jo profesional i atij muri (Gjata, 2010:61).

Në shumicën e rasteve, pranimi i të dëmtuarit shfaqet me veprime konkludente ose me heshtje, siç ndodhë në ndeshjet sportive, në mjekësi etj (Gjata, 2010:61). Qysh në të drejtën romake ka qenë e formuluar kjo rregull: “Ai që e pranon nuk e pëson padrejtësinë-volenti non fit iniuria”. LMD në Nenin 145, thekson: “Kush në dëm të vet i lejon tjetrit ndërmarrjen e ndonjë veprimi, nuk mund të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky veprim. Është e pavlefshme deklarata e të dëmtuarit me të cilën e ka dhënë pëlqimin që t'i shkaktohet dëmi me veprimin e ndaluar me ligj”. Pëlqimin duhet ta japë personi i cili është i aftë për punë; atëherë, ai pëlqim duhet të jepet para se të ndërmerret veprimi i dëmshëm. Me këtë rast, pëlqimi nuk duhet të jetë në kundërshtim me

normat imperative dhe të moralit shoqëror. Kështu, do të jetë i pavlefshëm pëlqimi i dhënë për dëmin, i cili paraqet vepër penale (vrasje, vjedhje) (Milosevic, 1977:154).

3.2.3. Faji dhe format për caktimin e tij

Për dallim nga përgjegjësia penale, ku faji paraqitet si kusht i domosdoshëm për ekzistimin e përgjegjësisë, pa të cilin nuk ka dhe sanksion penal, te përgjegjësia civile faji nuk paraqet kushtin e domosdoshëm të lindjes së përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, sepse te përgjegjësia civile ekzistojnë situata kur përgjegjësia lind edhe pa faj, siç është rasti me përgjegjësinë objektive, që ndryshe quhet përgjegjësia pa faj (Mamuti, 2013:50). Faji, paraqet elementin e brendshëm subjektiv të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, pasi kjo është një marrëdhënie në mes të vullnetit të dëmtuesit, veprimit të dëmshëm dhe pasojave që shkaktohen nga veprimi i personit (Mamuti, 2013:51). Shkaktuesi i dëmit, kur dëmin e kryen me faj, do të përgjigjet jo për faktin e shkaktimit të dëmit, por për vendimin e tij të brendshëm psikik që ka sjellë në shkaktimin e dëmit (Mamuti, 2013:51). Pra, faji është marrëdhënie (relacion) psikik i kryesit të veprës së vet dhe pasojës së asaj vepre, e cila shprehet me dashje dhe nga pakujdesia. Me fjalë tjera, një person konsiderohet i fajshëm kur psikikisht është i aftë të bëjë dallimin midis veprës së mirë, në një anë, dhe veprës së keqe, të dëmshme, në anën tjetër (Salihu, 2005:292). Kështu, nëse dikush gjuan me gurë, me qëllim që fqinjit t'ia thyej xhamin e dritares, nuk do të përgjigjet në bazë të rregullave të përgjegjësisë subjektive për shkak të thyerjes së xhamit, por për faktin që ka sjellë në vetvete një vendim të tillë dhe të njëjtin e ka zbatuar në praktikë. Dispozitat e ligjit nuk japin kuptimin e fajit, pasi këtë e bën doktrina juridike (Mamuti, 2013:51). Në nenin 140 të

LMD-së, vetëm kalimthi përmendet çështja e fajësisë, ku thuhet: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”. Në këtë ligj përjashtohen rastet, kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, me ç’rast subjekti përgjigjet edhe pa faj”.

Faji është kusht i përgjegjësisë deliktore civile, e në veçanti i përgjegjësisë subjektive. Në disa raste të përgjegjësisë për të tjerët, ai mund të paraqitet si kusht i përgjegjësisë. Pra, faji është kategori subjektive (Dauti, 2008:160). Me anë të fajit vërtetohet marrëdhënia e shkaktuesit të dëmit ndaj veprimit të kundërligjshëm dhe ndaj dëmit si pasojë e tij. Në rast se ekziston dëmi dhe veprimi i kundërligjshëm, por nuk ekziston faji i ndonjë subjekti, ai nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar (Dauti, 2008:160). Fajësia nuk mund të supozohet por ajo patjetër për çdo rast konkret të shkaktimit të dëmit te përgjegjësia subjektive duhet të vërtetohet. Pra, faji është kusht thelbësor i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.

Sipas teorisë, faji ekziston kur personi i caktuar nuk është sjellë ashtu si duhet të sillet një person i arsyeshëm dhe i kujdesshëm në një situatë të caktuar, ndonëse ai person ishte i aftë të kuptonte rëndësinë e veprimeve të veta (Gjata, 2010:41). Ky kuptim i dhënë është mjaft elastik, që praktikisht çon në një standard shoqëror, që do të thotë se kuptimi i fajit si rregull përfshin mosrespektimin e traditave dhe zakoneve të rrënjosura në një rreth shoqëror. Prandaj, kufijtë e fajit nuk janë të pandryshueshëm, ata ndryshojnë me kohën, madje krahas kësaj janë të ndryshëm në mjedise të ndryshme shoqërore. Në të drejtën bashkëkohore nuk është përkufizuar nocioni i fajit, sepse konsiderohet që një përkufizim do të çonte në kuptimin e ngushtë e të pamjaftueshëm të fajit (Gjata, 2010:41). Në teori janë

bërë përpjekje që nocioni i fajit të jepet sa më i përcaktuar. Sipas një mendimi (teoria e unitetit të fajit), faji qëndron gjithmonë në cenimin e ndonjë detyrimi të mëparshëm; ku nuk ka detyrim, nuk mund të bëhet fjalë për fajin (Gjata, 2010:42). Sipas këtij kuptimi, për nocionin faj nuk ka rëndësi a bëhet fjalë për cenimin e detyrimit që buron nga kontrata, apo nga delikti (jashtëkontraktor), por është me rëndësi vetëm fakti se kemi të bëjmë me cenimin e një detyrimi ekzistues (Gjata, 2010:42). Faji si kusht i përgjegjësisë deliktore civile në të shumtën e rasteve nuk është i përcaktuar në legjislaturë, sepse legjislacionet mbështeten në atë se faji është i njohur dhe se është e panevojshme që të përcaktohet kuptimi i tij. Në Kodin Civil të tanishëm, për dallim nga legjislacioni i mëparshëm nuk është dhënë kuptimi i nocionit “faj”, si element i përgjegjësisë jashtëkontraktore dhe as llojet e shkallët e fajit. Në legjislacionin e mëparshëm dallohej, shprehimisht dashja nga pakujdesia në shkaktimin e dëmit, si shkallë e fajit, madje edhe shkalla e pakujdesisë (Gjata, 2010:41). Kështu, p.sh. në nenin 386 të LVJD, si kusht i përgjegjësisë është pakujdesia e rëndë e shkaktuesit të dëmit. Megjithatë, në KCSH aktual është parashikuar si përjashtim se, krahas rrethanave të tjera, merret parasysh në caktimin e masës së shpërblimit të dëmit shkalla e fajësisë. Për një gjë të tillë neni 644 i KCSH, parasheh, se: “kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm, krahas dëmit të shkaktuar, ka pasur edhe një përfitim të dukshëm. Gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar, duke pasur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethanat e tjera të çështjes, mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin”. Po kështu, në nenin 651 paragrafi i dytë të KCSH, i është njohur e drejta gjykatës të pakësojë dëmshpërblimin, kur janë kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë (Gjata, 2010:41). Disa ligje vetëm e konstatojnë se faji ekziston si p.sh, LMD në nenin 140 thekson se: “Fajësia ekziston kur

dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”. Pra, kjo dispozitë njeh shkallët e fajësisë - dashjen ose qëllimin dhe pakujdesinë. Qëllimi ekziston kur dëmtuesi ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dashur të shkaktohet pasoja ose kur ka qenë i vetëdijshëm, që për shkak të veprimeve të tij, mund të shkaktohen pasoja dhe ka pranuar të ndodhin ato (DPPJ, 2015:512). Pakujdesia ekziston kur dëmtuesi nuk ka vepruar me kujdesin e njeriut, mesatarisht të kujdesshëm (pakujdesia ekstreme) ose nuk ka vepruar me kujdesin e njeriut shumë të kujdesshëm (pakujdesia e rëndomtë) (DPPJ, 2015:512). Edhe KCSH në Nenin 608 parag. 2 për fajësinë parasheh: “Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj”. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton që fajësia prezumohet. I takon dëmtuesit barra e provës të vërtetë që nuk ka faj, sepse dëmtuesi më mirë se kushdo tjetër është në gjendje të provojë se, pavarësisht që sjellja e tij mund të ketë qenë e paligjshme, ka qenë i ndodhur në rrethana të tilla të cilat i ka pasur të pamundur për t’i mënjeluar (Deliaj & Mitrushi, 2009:6). Pra, që një veprim ose mosveprim të jetë kryer me faj, kërkohet që personi që ka kryer veprimin ose që nuk ka vepruar, megjithëse ishte i detyruar të vepronte, të ketë zotësi për të vepruar në çastin e kësaj sjelljeje¹³. Për këtë arsye personat që për shkak të sëmundjes psikike ose sëmundjes tjetër mendore, alkoolizimit, miturisë, janë të paaftë për të gjykuar sjelljen e vetë, nuk mund të

¹³ Faji mund të përkufizohet si sjellje, e cila dallohet nga sjellja në gjendjen normale të njeriut. Një person ka bërë diçka që nuk ka qenë nevoja ta bëjë, ose e ka bërë lëshimin për diçka që nuk ka qenë e nevojshme ta bëjë. Pra, nëse sjellja e dëmtuesit nuk është në pajtim me sjelljen e njeriut të kuptueshëm dhe të kujdesshëm, ai ka për t’u konsideruar si fajtor për dëmin e shkaktuar. Një person për t’u shpallur fajtor për dëmin e shkaktuar, është e nevojshme që të gjendet në një gjendje psikike të rregullt (normale) që të mund të përgjigjet për sjelljet e veta. Që një subjekt të jetë fajtor për dëmin e shkaktuar, dëmtuesi duhet që në momentin e shkakimit të dëmit të ketë aftësi për gjykim. Dëmtuesi që nuk është i vetëdijshëm për sjelljet e veta dhe nuk ka aftësi për të gjykuar, nuk do të konsiderohet fajtor, prandaj nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Ndërsa aftësia për gjykim nënkupton aftësinë e kuptimit të domethënies dhe rëndësisë së sjelljeve të veta pra, aftësinë që të sillet në mënyrë të kuptueshme. Personat që për shkak të sëmundjes shpirtërore, zhvillimit të pamjaftueshëm mendor ose për arsye tjera nuk janë të aftë për të gjykuar, nuk përgjigjen për dëmin që mundë t’ia shkaktojnë tjetrit.

jenë fajtorë për dëmin e shkaktuar të tjerëve (Gjata, 2010:42). Ky qëndrim është mbajtur nga Kodi Civil Austriak (paragrafi 1308), ai Gjerman (paragrafi 827 e 828). Përfundimisht, kur një person me vetëdije e ka çuar veten në gjendjen e pa aftësisë për të gjykuar, si p.sh. me përdorimin e alkoolit, narkotikëve, etj. nuk përjashtohet nga faji dhe do të përgjigjet për dëmin që ka shkaktuar në një gjendje të tillë (Gjata, 2010:43). Pra, faji ekziston kur dikush ka bërë diçka që nuk është dashur ta bëjë dhe që nuk do ta kishte bërë njeriu i arsyeshëm ose kur ka lëshuar ndonjë veprim, ku nuk do ta kishte lëshuar njeriu i tillë.

3.2.3.1. Kriteret për përcaktimin e fajit

Përveç lartësisë së vetë dëmit, si kriter për caktimin e shpërblimit të dëmit merret edhe shkalla e fajësisë së dëmtuesit. Sa më i rëndë që të jetë faji, edhe lartësia e dëmshpërblimit do të ishte më e madhe. Duke pasur parasysh se faji presupozon një raport të caktuar psikik të një personi ndaj sjelljes së vet, d.m.th. pasojës. Lidhur me këtë, dallohen dy shkallë themelore të fajit, dashja “*dolus*” dhe pakujdesia “*culpa*”. Sipas peshës së fajit dëmi mund të jetë i shkaktuar me qëllim ose nga pakujdesia. Nëse për rastet e caktuara kërkohen të gjitha parakushtet e përgjegjësisë, si: veprimi i dëmshëm, dëmi, lidhja shkakësore, paligjshmëria, së bashku me faktorët objektiv dhe subjektiv, (shkeljen e normës dhe fajësinë) përgjigjet sipas kriterit subjektiv, përkatësisht të kriterit të fajësisë, prandaj ekziston përgjegjësia subjektive deliktore civile (Gorenc, 2010:184). Nëse për rastet e caktuara, nuk kërkohet elementi subjektiv-fajësia, atëherë përgjigjet sipas kriterit objektiv, përkatësisht shkakut (Gorenc, 2010:184).

3.2.3.1.1. Dashja (dolus)

Është shkalla më e rëndë e fajit, që paraqitet kur dëmtuesi me qëllim i shkakton dëm tjetrit. Në rastet e këtilla dëmtuesi dëshiron dhe i di pasojat e dëmshme të veprimit ose mosveprimit të vet (Dauti, 2008:160). Pra, dashja “*dolus*” ekziston kur dëmtuesi me veprimin e vet ka dashur t’i shkaktojë dëm tjetrit ose e ka pasur me dije se me veprimin e tij, tjetrit mund t’i shkaktohet dëmi. Këtu dëmtuesi vepron me dije dhe me qëllim, ai e dëshiron pasojën, përkatësisht dëmin që i shkaktohet tjetrit. Në këtë rast duhet theksuar se dëmtuesi edhe pse nuk e ka pasur me dije se, veprimi është i kundërligjshëm mjafton që ka ekzistuar mundësia e shkakimit të pasojave të dëmshme dhe që nuk ka hequr dorë nga veprimi për të shkakuar dëmin.

Dashja mund të jetë: e drejtpërdrejtë dhe eventuale. Dashja e drejtpërdrejtë “*dolus directus*” - është kur dëmtuesi me qëllim ka ndërmarrë sjellje të dëmshme dhe ka dashur që nga ky veprim të shkaktohet pasoja. Psh: kur dëmtuesi e thyen xhamin e një veture, dritare, dyqani, etj, (Dauti, 2008:160). Dashja eventuale “*dolus eventualis*” - është, nëse vullneti i dëmtuesit nuk do të drejtohej në të, por prapë se prapë ka lejuar që t’i shkaktohet dëmi subjektit tjetër. Në anën tjetër dashja eventuale, është kur vullneti i dëmtuesit nuk ekziston për shkaktimin e dëmit, megjithatë lejon që të shkaktohet dëmi ndaj tjetrit. Në rast se shkaktohet dëmi me dashje, detyra e dëmshpërblimit të dëmtuesit do të përfshinte shpërblimin e dëmit në tërësi. Pra, dëmin e vërtetë “*damnum emergens*” dhe fitimin e humbur “*lucrum cessans*”. Përgjegjësia për dëmin e shkakuar me dashje nuk mund të përjashtohet (Dauti, 2008:160).

3.2.3.1.2. Pakujdesia (culpa)

Pakujdesia përfshinë të gjitha rastet e fajit në të drejtën civile, krahas dashjes, në kuadrin e së cilës ka një renditje (Gjata, 2010:43). Pakujdesia në të drejtën civile, është shkallë e fajit që ekziston kur një person nuk sillet ashtu si duhet, pra të sillet si njeri i arsyeshëm dhe i kujdesshëm në një mjedis të dhënë. Me një përkufizim negativ, pakujdesia përfshinë të gjitha rastet e fajit kur është përjashtuar dashja (Gjata, 2010:43). Ajo, nënkupton veprimin e pakujdesshëm të dikujt. Te pakujdesia nuk kërkohet si te dashja, vetëdija për pasojat e mundshme të dëmshme. Për përgjegjësinë e dëmtuesit te pakujdesia, nuk është vendimtare qëndrimi i tij subjektiv kundrejt veprimit të dëmshëm (Gorenc, 2010:184).

Format themelore të pakujdesisë janë:

- a) pakujdesia e rëndë “*culpa lata*” dhe
- b) pakujdesia e rëndomtë “*culpa levis*”.

a) Pakujdesia e rëndë “*culpa lata*”- është forma më e rëndë e pakujdesisë në shkallëzimin e fajit, e cila barazohet me dashjen. Me këtë pakujdesi dëmtuesi e shkakton dëmin duke cenuar kujdesin e rëndomtë (Dauti, 2008:161). Pakujdesia e rëndë është kur dëmi është shkaktuar, ashtu që dëmtuesi është sjellë në atë mënyrë që nuk pritej nga cilido person i kujdesshëm, d.m.th. është një sjellje që nuk i lejohet asnjë njeriu normal (Gjata, 2010:43). “Culpa lata është indiferentizmi ekstrem, që të mos tregosh kujdes për diçka që të gjithë tregojnë kujdes” (Ulpiani, Digesta 50,16, Dicta et regulae juris, Novi Sad, fq, 56). Shembull: pakujdesi e rëndë është, në qoftë se vozitësi i automobilit ka vozitur automjetin e

tij me shpejtësi të madhe dhe në gjendje të dehur ose kur vozitësi me shpejtësi të madhe hyn në kthesë dhe kalon në anën e kundërt të rrugës, ku edhe shkakton aksident në trafik.

b) Pakujdesia e rëndomtë - e zakonshme “culpa levis”- përfshinë rastet e tjera të pakujdesisë. Pra, ajo ekziston kur dëmtuesi në veprimin e vet nuk ka qenë sa duhet i kujdesshëm, ashtu siç pritet nga një njeri i kujdesshëm, nikoqir i mirë dhe veprimtar i mirë (Gorenc, 2010:184). Edhe te pakujdesia e rëndë, nëse dëmi shkaktohet me qëllim, detyra e dëmtuesit do të përfshinte kompensimin e dëmit në tërësi, e kjo d.m.th. dëmshpërblimin për dëmin e vërtetë dhe fitimin e humbur. Në rastin kur dëmi shkaktohet vetëm nga pakujdesia e rëndomtë, atëherë dëmtuesi do të kishte borxh vetëm dëmin e vërtetë. Te pakujdesia e rëndomtë dallojmë dy raste: pakujdesinë e vetëdijshme dhe pakujdesinë e pavetëdijshme. Dëmi do të shkaktohej nga pakujdesia e vetëdijshme, atëherë kur dëmtuesi do të parashihte, që sjellja e tij ndaj tjetrit do të shkaktonte dëme me pasoja. Pra, ai është i vetëdijshëm për dëmet me pasojat që do të shkaktohen, duke konsideruar se ato mund të evitohen (shmangen) (Daut, 2008:161). Përkitazi për këtë marrim këtë shembull: vozitësi që nuk vozitë në anën e paraparë të rrugës, është i vetëdijshëm se mund të shkaktohet aksidenti, mirëpo ai beson në aftësitë dhe shkathtësitë e tij për shmangien e aksidentit (Dauti, 2008:162)! Nga kjo kuptohet se, dëmi nga pakujdesia e pavetëdijshme do të ekzistonte, atëherë kur dëmtuesi nuk do të dinte për dëmet dhe pasojat e sjelljes së vet (Dauti, 2016:170). Pra, ai është dashur, gjithsesi të dijë për dëmet me pasojat që do t'i shkaktonte. Refleksion i këtij veprimi është dëmi i shkaktuar ndaj tjetrit. Në rastin e parë i ka parashikuar pasojat e veprimit të vetë, por megjithatë që nuk i ka dëshiruar, ka menduar se do t'i mënjanojë; në rastin e dytë, për shkak të mungesës së vëmendjes së duhur, nuk i ka

parashikuar pasojat që duhet t'i parashikonte (Gjata, 2010:44). Praktika gjyqësore kosovare në një rast të saj për dëmin të cilin e pësojnë qytetarët nga shpërthimi i një bombe të mbetur nga lufta, si pasojë e pakujdesisë për shkak të mos mënjanimit të saj, parasheh se përgjegjëse është komuna ku është gjetur ajo. Në bazë të dispozitave ligjore, komuna ka detyrimin të kujdeset për sigurimin dhe realizimin e kësaj sigurie¹⁴.

Sa i përket çështjes së fajit KCSH në nenit 610 parasheh se, “është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëmin me faj”. Këtë qëndrim mban në përgjithësi legjislacioni i huaj bashkëkohor. Një çështje me rëndësi të veçantë juridike lidhur me fajin është: a duhet provuar faji i dëmtuesit, apo ky faj prezumohet deri sa vetë dëmtuesi të ketë provuar pafajësinë e tij (Gjata, 2010:45)? Në literaturë dhe në Kodin Civil Shqiptar, është pranuar kriteri i prezumimit të fajësisë së dëmtuesit, që do të thotë se atij i bie barra të provojë se nuk ka faj për ardhjen e dëmit (Tutulani-Semini, 2006:254). Ky konkluzion për barrën e provës mbështetet në nenin 608 paragrafi i dytë pjesa e parë e KCSH. Sipas kësaj dispozite, “Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj”. Ky qëndrim është mbajtur edhe në LVJD (neni 472 paragrafi i dytë) dhe në literaturë (Gjata, 2010:45). “Kështu, në zgjidhjen e një çështjeje konkrete rreth përgjegjësisë në detyrimet nga

¹⁴ Gjykata e Qarkut në Prizren në vendimin e saj C.nr.78/81, të datës 03.10.1983, për dëmin e shkaktuar nga një eksplozim bombe thekson se përgjegjëse është komuna në territorin e së cilës është gjetur dhe ka eksploduar bomba. Për dëmin të cilin e pësojnë qytetarët nga shpërthimi i bombave dhe mjeteve tjera luftarake të ngelura nga lufta, përgjegjëse është komuna ku janë gjetur ato. Në bazë të dispozitave kushtetuese, komuna ka detyrimin të kujdeset për sigurimin dhe realizimin e kësaj sigurie. Për këtë arsye komuna në fjalë ka qenë e obliguar të kontrollojë dhe të pastrojë territorin e vet nga materiali eksploziv, në rastin konkret në territorin ku është gjetur dhe ka eksploduar kjo bombë. Bomba ka mbetur nga lufta e zhvilluar në këtë territor. Komuna në fjalë ka mundur të dijë se në këtë territor ka material eksploziv të ngelur nga lufta, prandaj, për dëmin e shkaktuar me vdekjen e një fëmije dhe lëndimin e tjetrit nga eksplozimi i bombës, përgjegjëse është komuna në fjalë ku është gjetur bomba (Komentar i LMD, 2013:170)

shkaktimi i dëmit, kreditori (i dëmtuari) duhet të provojë vetëm sjelljen e kundërligjshme që i shkaktoi dëm, duke provuar edhe masën e këtyre dëmeve. Por nuk i takon atij të provojë edhe fajësinë e tij” (Sallabanda, 1962:166). Në disa legjislacione bashkëkohore, si KCF, KCA, KCGJ dhe KCI, faji i shkaktuesit të dëmit duhet të provohet nga i dëmtuari, në ndryshim nga përgjegjësia kontraktore (Gjata, 2010:45). Në këtë të fundit është debitori ai që duhet të provojë se përmbushja e detyrimit është bërë e pamundur, për shkaqe të pavarura prej tij (mungesa e fajit të vetë) në përgjegjësinë jashtëkontraktore është i dëmtuari ai që duhet të provojë fajin e dëmtuesit (Galgano, 1999:363). Mirëpo, kjo ka krijuar vështirësi për të dëmtuarin, duke mbetur pa u shpërblyer. Prandaj, legjislacione të ndryshme, përfshirë edhe atë shqiptar, kanë pranuar fajin e prezumuar të dëmtuesit, duke i rënë këtij barra e të provuarit të së kundërtës, se sjellja e tij ka qenë në pajtim me urdhërimet e ligjit, duke mos shkelur apo cenuar ato interesa dhe të drejta të tjetrit, të cilat mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira (Alishani, 1989:610-612). Kështu, p.sh. në komentin e nenit 2043 të KCI, ndër të tjera thuhet: ”Nuk ekziston një prezumim që faji t’i ngarkohet atij që e ka shkaktuar dëmin, përderisa barra e provës i takon të dëmtuarit”. “Ai që do të pretendojë një të drejtë, duhet të japë prova për të“. Ky konkluzion mbështetet në nenin 2697 të Kodit Civil Italian dhe në nenin 115 të K.Pr.Civile Italiane. Sipas nenit 2697 të këtij Kodi ”Kush pretendon një të drejtë në procesin gjyqësor, duhet të provojë faktet për themelin çështjes” (Gjata, 2010:46). Për të ilustruar, jepet ky shembull: Gjoni, shofer taksie, shkakton një aksident ku dëmtohen pasagjerja Luka dhe Klaudija si dhe udhëtarja që pret rrugën. Për të parën, taksisti përgjigjet në bazë të kontratës së transportit, ndërsa për të dytën (udhëtarja) përgjegjësia është jashtëkontraktore (nga shkaktimi i dëmit), rrjedhimisht fajësinë e taksistit duhet ta provojë udhëtarja (Gjata, 2010:46). Ky qëndrim si duket është

mbizotërues, pasi është pranuar edhe nga teoria bashkëkohore. Literatura juridike shqiptare, si dhe ajo e disa vendeve të tjera, kanë pranuar fajin e prezumuar të dëmtuesit, duke i takuar këtij barra për të provuar mungesën e fajit. Pra, se sjellja e tij ka qenë në pajtim me urdhërimet e ligjit, duke mos shkelur ato interesa dhe të drejta të tjetrit që mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Të dëmtuarin do ta vinte në vështirësi barra e të provuarit të fajit të dëmtuesit, pasi shpeshherë ai nuk i di rrethanat në të cilat është shkaktuar dëmi, madje mund të mos ketë dijeni për një kohë as për personin që e ka shkaktuar (Gjata, 2010:47). Nga ana tjetër, dëmtuesi është në gjendje të provojë se dëmi është shkaktuar nga rrethana që e kishte të pamundur t'i ndalonte. Siç është thënë, i dëmtuari është i detyruar të provojë dëmin dhe sasinë e tij, si dhe kundërligjshmërinë e sjelljes së dëmtuesit, por jo edhe fajin. Me këtë qëndrim, nuk vihet shenja e barazisë ndërmjet kundërligjshmërisë e sjelljes, si dhe fajit (Gjata, 2010:47). Faji është element subjektiv, shfaqja e vullnetit të dëmtuesit ndaj sjelljes edhe pasojave të shkaktuara. Prandaj, faji është kategori subjektive, dëmtuesi e parashikon ose/dhe sipas rrethanave duhet ta parashikonte ardhjen e pasojave negative (të dëmshme) të sjelljes së tij. Në të kundërt, kur nuk ka parashikuar dhe sipas rrethanave konkrete nuk ishte i detyruar të parashikonte ardhjen e pasojave të tilla, do të quhet se për sjelljen (ka vepruar ose nuk ka vepruar) nuk ka faj. Rrjedhimisht, nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Ky dëm në këto rrethana do të quhet "dëm i rastit" (Gjata, 2010:47).

Në literaturën juridike shqiptare, ka pasur pikëpamje se elementi faj nuk ka rëndësi themelore, pasi mjafton dëmi i shkaktuar nga sjellja e personit, që ky të ketë përgjegjësi. Me fjalë të tjera, drejtësia e do që të përgjigjet shkaktuesi i dëmit, pavarësisht a ka vepruar

me faj apo pa faj (Gjata, 2010:47). Përgjegjësia pa faj nuk është një përjashtim i veçantë në legjislacionin shqiptar, ndaj dhe në detyrimet nga shkaktimi i dëmit, nuk mund të bëhet fjalë për elementin faj (Gjilani, 1958:3). Pikërisht, përkrahësit e kësaj pikëpamjeje vënë shenjën e barazisë midis sjelljes së kundërligjshme që sjell dëmin dhe fajit, gjë që nuk është e saktë. Legjislacioni civil shqiptar, pranon se “përgjegjësia për shkaktimin e dëmit me faj përbën rregullin”. Mirëpo, nga ana tjetër, në shembullin edhe të legjislacionit modern evropian, përgjegjësinë pa faj e quan përjashtim (por jo i veçantë), që ndeshet në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj (Gjata, 2010:48).

3.2.4. Aftësia deliktore (Aftësia e përgjegjësisë)

Aftësia deliktore është kusht i përgjithshëm i përgjegjësisë deliktore civile. Është aftësi e një subjekti që t'i kuptojë veprimet e veta. Aftësia e deliktit është aftësi e personit që të përgjigjet për veprimet e veta (deliktet) me masën e vetë pasurore (Aliu, 2008:124). Që të ekzistojë faji me rastin e shkaktimit të dëmit, që kryerësi të jetë fajtorë, duhet të ketë zotësinë e nevojshme për të gjykuar normalisht, të jetë i aftë të kuptojë rëndësinë e veprimeve të veta dhe pasojave që vijnë nga këto dhe në përgjithësi, është e nevojshme që personi fizik ta ketë të zhvilluar vetëdijen në nivel të mjaftueshëm (Mamuti, 2013:73). Në praktikë, shpesh e ngatërrojnë kuptimin e fajit me aftësinë për të gjykuar. Aftësia për të gjykuar është aftësia e një personi, që të jetë i aftë të kuptojë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij (Mamuti, 2013:74). Kurse, faji është gjendja e brendshme psikike dhe dëshira e personit për të shkaktuar dëm, i vetëdijshëm për pasojat e tij të cilat i dëshiron. Prandaj, thuhet që, nëse dikush duhet të shpallet i fajshëm ai duhet të jetë dhe i aftë për të

gjykuar, pasi për personat e pa aftë nuk mund të lindë kurrfarë përgjegjësie (Mamuti, 2013:74). Aftësia deliktore e personit fizik paraqitet si kusht i përgjithshëm i përgjegjësisë subjektive civile të dëmi jashtëkontraktor. E theksojmë në mënyrë të veçantë vetëm përgjegjësinë jashtëkontraktore, pasi te përgjegjësia kontraktore, aftësia e palëve paraprakisht nënkuptohet (nuk mund të jenë palë në kontratë personat me pa zotësi veprimi) dhe se të drejtat dhe detyrimet lindin vetëm për subjektet e kontratës–inter partes, ku si subjekte, personat fizikë mund të jenë vetëm të moshës madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar. Në të kundërtën, duhet të jenë të përfaqësuar nga persona me zotësi të plotë për të vepruar (Mamuti, 2013:51). Aftësia deliktore paraqet aftësinë e personit fizik që të përgjigjet vetë për pasojat e veprimeve të tij, në qoftë se me këto veprime i ka shkaktuar dëm personit tjetër, pavarësisht nëse lind edhe përgjegjësia penale apo vetëm ajo civile. Se a do të përgjigjet personi për shkaktimin e dëmit, kjo varet nga mosha dhe aftësia e të gjykuarit. Aftësia deliktore arrihet me fitimin e zotësisë së veprimit, do të thotë, me arritjen e moshës madhore (Mamuti, 2013:51).

Aftësia e përgjegjësisë për personat fizikë lidhur me dëmin e shkaktuar varet prej moshës dhe zhvillimit mendor të tij. Ekziston kategorizimi i personave sipas moshës në lidhje me fitimin e aftësisë deliktore: LMD në nenin 142 për këtë çështje thekson: ”I mituri deri në moshën shtatë vjeç, nuk përgjigjet për dëmin të cilin e shkakton. I mituri prej moshës shtatë (7) vjeçare, deri në moshën katërmëdhjetë (14) vjeçare, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç në qoftë se provohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për të gjykuar. I mituri mbasi t’i ketë mbushur katërmëdhjetë (14) vjet, përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin”. Jo të gjithë personat me arritjen e

moshës madhore e fitojnë zotësinë e veprimin dhe aftësinë deliktore, pasi ka persona që e kanë të kufizuar apo u është hequr fare zotësia e veprimit për shkak të sëmundjeve shpirtërore, ngecjes në zhvillimin mendor apo të metave tjera psikike. Kjo kategori e personave nëse e kanë të hequr zotësinë e veprimit, nuk do të përgjigjen për veprimet e tyre (Mamuti, 2013:52). Personi i cili për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit të metë mendor apo të shkaqeve të tjera nuk është i aftë të gjykojë, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç nëse provohet që dëmin e ka shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar (neni 141 të LMD-së). Neni 10 i KCSH e parasheh që: “Personat madhor, që për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimit të metë mendor është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës”. Sa herë që dëmi të shkaktohet nga këta persona përgjegjësia për shpërblimin e dëmit do të bie mbi personin i cili në bazë të ligjit ose vendimit të organit shtetëror apo kontratës është i detyruar që të kryejë mbikëqyrje ndaj tij, qoftë ai të jetë kujdestar apo ndonjë organ tjetër shëndetësor, social apo institucioni tjetër ndëshkues përmirësues (Mamuti, 2013:52). Në praktikë mund të ndodhë që personi të shkaktojë dëm duke qenë në gjendje të dehur apo droguar, në këtë rast, sipas të drejtës, ky person nuk do të lirohet nga detyrim për zhdëmtim duke u thirrur në gjendjen në të cilën ka qenë i pavetëdijshëm për të gjykuar në momentin e shkaktimit të dëmit (Mamuti, 2013:52). Pra, në qoftë se personi ka shkaktuar dëm në gjendje të pa aftësisë të përkohshme për të gjykuar, do të përgjigjet për dëmin, përveç se nëse provon në atë gjendje ka ardhur pa fajin e tij. Personi me fajin e të cilit ka ardhur në këtë gjendje do të përgjigjet për pasojat e dëmit.

Paaftësinë deliktore e kanë subjektet që kanë mungesa mentale. LMD në nenin 141 parag, 2, 3, thekson se: ”Kush i shkakton dëm tjetrit në gjendje të pa aftësisë së përkohshme për gjykim, është përgjegjës për atë, përveç nëse provon se pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tillë. Në qoftë se, në këtë gjendje është sjellë me faj të dikujt, do të përgjigjet për dëmin ai që e ka sjellë në gjendje të tillë”. Nga kjo dispozitë shihet se, personat me të meta mendore nuk mund të jenë fajtorë për dëmin e shkaktuar, sepse nuk mund t’i kuptojnë pasojat e sjelljeve të veta. Pra, ata sipas kësaj nuk përgjigjen për dëmin. Megjithatë, nga kjo rregull ekziston edhe përjashtimi kur personat e pavetëdijshëm mund të jenë fajtor. Në rast se një person i vetëdijshëm është sjellë në gjendjen e personit të pa aftë për gjykim, në atë rast do të konsiderohej se është fajtor edhe përkundër mungesës së kuptueshmërisë. Në të kundërtën, nëse ndonjë tjetër në atë gjendje i ka sjellë personat e këtyllë, atëherë, ai do të jetë fajtor për dëmin e shkaktuar, e jo shkaktuesi i drejtpërdrejt i veprimit të dëmshëm.

Edhe personat juridikë kanë aftësi deliktore dhe përgjigjen për dëmin që i shkaktojnë subjekteve të veta, sepse ata në qarkullimin juridik veprojnë në emër dhe në llogari të personave juridik. Edhe në këtë rast aftësia deliktore paraqitet si kusht i përgjithshëm për lindjen e përgjegjësisë deliktore civile. Pavarësisht, faktit se personat juridik konsiderohen si krijesa artificiale (shoqërore), vetë fakti se si të tilla janë themeluar nga personat fizik dhe në çdo marrëdhënie përfaqësohen nga ta, nënkupton se edhe këta kanë aftësi të shkaktimeve të dëmit, edhe atë që nga momenti i themelimit (Mamuti, 2013:52). Për personat juridik përgjegjësia juridiko civile lind, atëherë kur personi fizik si i punësuar apo si përfaqësues i personit juridik, duke kryer punët për të cilat i janë ngarkuar a besuar, i shkaktojnë dëm personave të tretë (Mamuti, 2013:52). Në këtë rast përgjegjësia civile dhe

faji i personit juridik, rrjedh nga përgjegjësia deliktore civile dhe faji i personit fizik që gjendet në raport të caktuar me personin juridik. Në këto raste përgjegjësia e personit juridik do të matet sipas shkallës së fajit të organeve të tij (Vukovic, 1971:29).

3.2.5. Lidhja shkakësore (kauzale)

Një element tjetër i ngjashëm me të drejtën shqiptare është edhe ekzistenca e lidhjes shkakësore, mungesa e të cilës do të çonte në mungesën e përgjegjësisë juridike (Muçmataj, 2015:199)¹⁵. Lidhja kauzale, është një ndër kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Ajo është lidhja mes ngjarjes për të cilën pala është përgjegjëse dhe pasojave të saj, të cilat paraqesin dëmin. Një person përgjigjet për dëmin e shkaktuar vetëm në rast se, ekziston lidhja kauzale mes veprimeve të tij dhe pasojës së shkaktuar (dëmit). Veprimi është shkak i dëmit, në qoftë se paraqet kusht të drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë dhe nëse, sipas efektit të tij të rregullt, është shkaktuar dëmi (DPPJ, 2015:512). Pra, përveç dëmit, veprimit të kundërligjshëm, fajit, aftësisë deliktore edhe lidhja kauzale, paraqet një nga kushtet e përgjegjësisë deliktore civile. Ndërmjet veprimit të dëmshëm si shkak dhe dëmit si pasojë, patjetër duhet të ekzistojë lidhja shkakësore. Shkak duhet të jetë ngjarja që nënkupton se, pa të nuk do të kishte pasoja të dëmshme. Një person nuk do të përgjigjej për dëmin e shkaktuar, nëse dëmi nuk është shkaktuar si pasojë e veprimit të tij.

¹⁵ “dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejt dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit” (neni 609 i KCSH)

Lidhja kauzale ekziston, midis veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit të shkaktuar (Dauti, 2008:154). Veprimi i kundërligjshëm dhe dëmi njëra ndaj tjetrës, duhet që të jenë si shkak dhe pasojë. Vetëm në rastin e ekzistimit të marrëdhënies së këtillë, do të krijohej detyra e shpërblimit të dëmit në anën e dëmtuesit ose ndonjë personi tjetër përgjegjës. Ajo paraqet raportin e ndërsjellë, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij (Mamuti, 2013:48). Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th. pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron autorin e saj ta shpërblejë dëmin plotësisht (Legier, 2008:158). Lidhja kauzale si kusht i përgjithshëm për lindjen e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit, duhet të ekzistojë sikurse te detyrimet deliktore, edhe te detyrimet kontraktore. Edhe te përgjegjësia objektive apo përgjegjësia për të tjerët, lidhja kauzale paraqitet si kusht i domosdoshëm (Mamuti, 2013:48). Gjithashtu, edhe kur dëmi shkaktohet si rezultat i fuqisë madhore apo nga rasti, përsëri lidhja kauzale duhet të jetë prezent për lindjen e përgjegjësisë. Ajo si kusht për lindjen e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar, përkrahet në mënyrë unike nga të gjitha të drejtat e shteteve perëndimore, megjithatë, shumica e tyre ashtu sikurse edhe legjislacioni pozitiv i Shqipërisë nuk japin ndonjë përkufizim të kuptimit të lidhjes kauzale (Mamuti, 2013:48). Ndërkaq, KCSH në nenin 609, paragrafi 1, thotë: “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit”, kurse paragrafi tjetër thotë: “Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar”.

Lidhja shkakësore është ajo lidhje, që ekziston objektivisht ndërmjet shkakut dhe pasojës së tij. Çështja e lidhjes shkakësore është me mjaft rëndësi për të drejtën (Gjata, 2010:48).

Përsa i përket mënyrës së trajtimit, që dallon nga trajtimi i përgjithshëm i saj, në filozofi dhe shkencat e tjera, çështja e lidhjes shkakësore në të drejtën shtrohet në pyetjen: kur është sjellja e njeriut shkak i dukurive të caktuara, me fjalë të tjera, a mund të merret kjo sjellje si shkak i tillë (Gjata, 2010:48). Nga këndi i vështirimit filozofik, një sjellje e njeriut në vetvete nuk mund të jetë shkak i vetëm i një dukurie, por vetëm një nga kushtet e shumta, të cilat së bashku veprojnë si shkak. Për arsye praktike, për të provuar përgjegjësinë e njeriut për ardhjen e pasojave të caktuara, në mënyrë që ndaj tij të zbatohet sanksioni juridik për të drejtën, është e nevojshme që disa sjellje të njeriut të quhen si shkak i pasojës ose pasojave (Gjata, 2010:48).

Kështu, nga këndi i lidhjes shkakësore, të gjitha sjelljet e njeriut në lidhje me ndonjë pasojë, mund të ndahen në tri lloje. Llojin e parë e përbëjnë sjelljet që, janë indiferente për pasojën, të dytin ato që përbëjnë vetëm kushtet e saj, si dhe të tretin ato sjellje që përbëjnë shkakun e asaj pasoje (Gjata, 2010:48). Është detyrë e teorisë që të ndajë sjelljet që përbëjnë vetëm kushte të zakonshme të pasojës, nga ato që përbëjnë shkakun e saj. Vështirësia qëndron në dallimin midis shkaqeve dhe kushteve. Në këtë drejtim janë krijuar një numër teorish, sipas nevojave e detyrave konkrete praktike dhe në përputhje me rendin juridik. Praktikisht, e drejta si rregull, kërkon që njerëzit të përgjigjen për sjelljet e tyre, vetëm kur ato kanë qenë shkak i pasojës së caktuar. Gjithçka tjetër ia lë shkencës dhe praktikës për ta zgjidhur (Gjata, 2010:49).

Lidhja shkakësore, jo gjithmonë mund të vërtetohet në mënyrë të lehtë dhe të qartë. Kështu, për gjyqtarin në raste të caktuara paraqiten situata të komplikuar, ku mund të konstatohet shumë vështirë kjo lidhje midis veprimit të dëmshëm dhe pasojës së krijuar (Mamuti,

2013:48). Vërtetimi i lidhjes shkakësore është e domosdoshme të konstatohet në të gjitha rastet, qoftë te përgjegjësia personale, për të tjerët apo ajo për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme. Në praktikën gjyqësore preferohet që për këto raste, gjykatësi me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së çështjes për shpërblimin e dëmit, për ta përcaktuar saktë lidhjen shkakësore, duhet të shërbehet me ekspertë të fushave të caktuara për të sjellë një vendim të drejtë (Mamuti, 2013:48). Lidhja shkakësore paraqet kategori objektive, pasi këtu nuk kërkohet që të ekzistojë faji i personit me rastin e veprimit të kundërligjshëm. Pra, lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të dëshmojë për ngjarjen e cila sigurt, është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të personit (Mamuti, 2013:48). Pavarësisht, prej nga vjen veprimi apo mosveprimi i personit, vetë iniciativa apo veprimi i rrethanave të jashtme, e rëndësishme është që ky veprim të jetë adekuat me pasojën e krijuar. Për shkencën dhe praktikën gjyqësore, lidhur me detyrimet jashtëkontraktore që lindin nga shkaktimi i dëmit, është me rëndësi dallimi midis lidhjes shkakësore të domosdoshme nga ajo e rastit (Gjata, 2010:48-49). Lidhja shkakësore, si kategori objektive nga pikëpamja e së drejtës, duhet të analizohet duke u nisur nga sjellja e kundërligjshme e njeriut, a ka qenë veprimi apo mosveprimi i tij shkak determinues dhe i domosdoshëm që ka kushtëzuar ardhjen e pasojës. Në rast se po, kemi lidhje shkakësore të domosdoshme (Gjata, 2010:49). Krahas kësaj, në këtë lidhje të domosdoshme duhet që pasoja të ketë ardhur drejtpërdrejt nga sjellja e kundërligjshme e njeriut. Vetëm në këtë mënyrë, në praktikë arrihet të dallohet kjo lidhje e domosdoshme dhe e drejtpërdrejtë ndërmjet sjelljes së kundërligjshme dhe pasojës së ardhur nga lidhja shkakësore e rastit (Gjata, 2010:49). Lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme midis shkakut dhe pasojës, na çon në përfundimin se pasoja e ardhur duhet të jetë e përputhshme me veprimin e kundërligjshëm. Përderisa dëmi

është pasojë e shumë shkaqeve, në praktikë duhet veçuar ai shkak që nga pikëpamja e së drejtës është vendimtar në çdo rast, pasi normat për shkaktimin e dëmit nuk japin kritere. Kjo ka bërë që të zhvillohen teori të ndryshme, ku vend sundues ka teoria e lidhjes shkakësore adekuate (Gjata, 2010:48-50).

Po japim një shembull ku renditen disa shkaqe që kanë ndikuar në ardhjen e pasojës, p.sh: një person është plagosur nga një aksident rrugor. Për këtë shkak ka qëndruar gjatë i shtrirë në spital dhe nga kjo i është dobësuar organizmi duke i rënë rezistenca, gjë që e ka çuar në sëmundjen e mushkërive dhe si pasojë vdekjen. Siç dihet, këtu kemi një vazhdimësi shkaqesh e pasojash të parashikuara mjekësore (Gjata, 2010:50). Këtu, faktor i drejtpërdrejtë i vdekjes nuk është plagosja në vetvete, por është shkak shtrimi në spital për shkak të plagëve dhe i qëndrimit për një kohë të gjatë. Këtu kemi një konkurrim (mori) shkaqesh, që njëri pas tjetrit kanë çuar deri në vdekje. Asnjëri prej tyre nuk është i rastit, por përbëjnë një vazhdimësi të domosdoshme (Gjata, 2010:50).

Përkundër shembullit të mësipërm, në praktikë është çmuar se nuk ekziston lidhja shkakësore në rastin kur një grua ka marrë plagë të rënda në një aksident rrugor, ndërsa bashkëshorti i saj nga kjo ndodhi, ka pësuar një infrakt miokardi. Mjekët ekspertë kanë çmuar se, ekziston lidhja ndërmjet infraktit të burrit dhe plagëve të gruas së tij. Gjykata ka arritur në përfundim se ekziston lidhja shkakësore adekuate vetëm kundrejt fatkeqësisë rrugore dhe e plagëve të gruas, por jo edhe ndërmjet kësaj ngjarjeje dhe pasojës që ka pësuar bashkëshorti i saj nga sëmundja e infarkt të miokardit, sepse nuk kanë lindur në mënyrë të drejtpërdrejtë të natyrshme (Gjata, 2010:50).

Duke qenë lidhja shkakësore kategori objektive, që e mundëson nxjerrjen e përfundimit të saktë, nëse është sjellja e njeriut shkak determinues e i drejtpërdrejtë i pasojës së ardhur, në praktikën gjyqësore duhet pasur kujdes për të dalluar lidhjet e rastit e të mundshme nga ajo e domosdoshme e realisht të sigurt. Kjo e bën të nevojshme analizën e kujdesshme të të gjitha rrethanave, pa nënvlerësuar e paragjykuar asnjërën prej tyre (Gjata, 2010:50-51). Kur është folur për sjelljen e kundërligjshme të personit, gjithnjë është marrë parasysh si veprimi, ashtu edhe mosveprimi, megjithëse shkaktimi i dëmit me mosveprimin ose ndryshe, lidhja shkakësore midis mosveprimit dhe pasojës në praktikë ndeshet me rrallë (Gjata, 2010:50). Mosveprimi është një lloj i detyrimit, që qëndron në detyrimin sipas ligjit të veprorë në një mënyrë të caktuar dhe personi nuk vepron. Kur nga mosveprimi i kundërligjshëm ka ardhur pasoja, jemi para lidhjes shkakësore midis mosveprimit dhe pasojës. P.sh. kur pronari i qenit nuk e mban lidhur qenin e tij dhe ky kafshon një ose disa kalimtarë; etj. jemi para lidhjes shkakësore ndërmjet mosveprimit të kundërligjshëm dhe pasojës (Gjata, 2010:50). Derisa faji paraqet kategorinë subjektive, lidhja kauzale paraqet marrëdhënien e pastër objektive (Milosevic, 1977:156). Pra, është kategori objektive, sepse këtu nuk kërkohet ekzistimi dhe vërtetimi i fajit. Vërtetimi i lidhjes shkakësore në disa raste nuk paraqet problem, p.sh: kur dëmtuesi e thyen xhamin e veturës së dikujt, sepse në këtë rast ekziston lidhja shkakësore ndërmjet veprimit të palejuar dhe pasojës së shkaktuar. Lidhja kauzale është e vështirë të vërtetohet për lëndimet trupore dhe dëmet e shkaktuara në trafik etj (Dauti, 2008:154).

Në teorinë juridike ekzistojnë tri mendime për kuptimin e lidhjes kauzale:

1) Sipas mendimit të parë, veprimi është shkak i dëmit, nëse ai është njëri prej kushteve pa të cilin ai nuk do të shkaktohej. Ky mendim është i njohur si teori e kushtit. P.sh: nëse një person e pengon një tjetër që të udhëtojë me tren, ndërkaq ai detyrohet që të kalojë në trenin tjetër, me të cilin ai do të pësonte fatkeqësi. Pra, sipas kësaj teorie (teorisë së kushtit), ai ka për t'u përgjigjur për arsye se, e ka penguar të dëmtuarin që të udhëtojë me trenin e mëparshëm. Kjo teori sot nuk ekziston as në teorinë juridike, as në praktikën gjyqësore, sepse sjell rezultate absurde (të pa kuptimta) (Milosevic, 1977:156):.

2) Sipas mendimit të dytë, çdo kusht nuk mund të merret si shkak i dëmit, por vetëm ai i cili është i drejtpërdrejt dhe i afërm. Për këtë edhe kjo teori njihet si, teori e kauzalitetit të drejtpërdrejtë. Sipas kësaj teorie për lëndimin trupor, që i shkaktohet udhëtarit në fatkeqësinë e komunikacionit, do të përgjigjej ndërmarrja transportuese hekurudhore e jo personi që e ka penguar udhëtarin të udhëtojë me trenin e parë (Milosevic, 1977:157):.

3) Sipas mendimit të tretë, kushtit duhet që t'i pranohet cilësia e shkakut. Cilësia e shkakut të dëmit, vlerësohet vetëm nëse efektit të tij të rregullt, do t'i përgjigjej dëmi konkret. Për këtë edhe kjo teori quhet, “Teori e kauzalitetit adekuat”. Pra, shkak konsiderohet ajo ngjarje, e cila është adekuate për atë dëm. Sipas kësaj teorie, personi i cili e ka penguar tjetrin që të udhëtojë me trenin e parë, do të përgjigjej për dëmin të cilin e ka pësuar, për arsye të vonesës e jo për arsye të lëndimit trupor të shkaktuar në fatkeqësinë e komunikacionit (Milosevic, 1977:156).

Sot teoria e kauzalitetit adekuat, pranohet si kriter për përcaktimin e lidhjes kauzale. Kjo teori duhet pranuar edhe nga LMD edhe nga KCSH. Me ndihmën e kësaj teorie evitohet

mundësia, që çdo kushti t'i jepet karakteri i shkakut. Gjithashtu, lejohet që kushtet e drejtpërdrejta mund të jenë shkak i dëmit, nëse nuk do të ndërpritej lidhja ndërmjet veprimit dhe dëmit.

3.2.6. Përfundim

Gjatë shtjellimit dhe analizës së përgjegjësisë subjektive civile të dëmi jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe në atë të Kosovës, pamë se ky lloj i përgjegjësisë civile është një prej bazave të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar në të dyja vendet tona.

Gjithashtu, erdhëm në përfundim se sipas kësaj përgjegjësie dëmtuesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas fajit dhe faji bie mbi dëmtuesin, përderisa ai nuk provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Pra, gjithnjë duke pasur parasysh faktin se shkaktuesi i dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, me përjashtim vetëm kur provon se ai është shkaktuar pa fajin e tij.

Në bazë të kësaj që u theksua më sipër, lë të nënkuptohet se barra e të provuarit për t'iu shmangur përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, bie mbi shkaktuesin e dëmit, të paraqitur si të tillë nga i dëmtuari.

Në këtë lloj të përgjegjësisë, roli i dëmtuesit do të duhej të ishte aktiv kurse roli i të dëmtuarit pasiv, sepse po të ishte e kundërta do të rëndohej pozita e të dëmtuarit dhe që me të drejtë doktrina juridike këtë pozitë të vështirë të të dëmtuarit e njeh si "vërtetim të gjendjes së mjerueshme". Pra, me arsyen se shpesh ndodhë që i dëmtuari mund të mos jetë

në gjendje të provojë fajin e dëmtuesit dhe do të mbetet pa shpërblimin e dëmit të pësuar. Prandaj edhe për këtë arsye legjislacioni civil si, ai shqiptar dhe ai kosovar në situata të tilla ka filluar ta përkrahë idenë e fajit të supozuar. Pra, kur dëmtuesi i shkakton dëm të dëmtuarit, supozohet faji i dëmtuesit dhe lë të nënkuptohet se dëmtuesi ka të drejtë të pohojë se, nuk është fajtor për dëmin e shkaktuar. Nga kjo shihet se barra e vërtetimit të provës kalon në anën e dëmtuesit, njëherazi një situatë e këtillë tregon edhe një përparim në pikëpamjen e të drejtës.

Nga kjo rrjedh se, përgjegjësia e tij varet nga raporti subjektiv i shkaktuesit të dëmit me dëmin e shkaktuar. Pra, edhe për këtë arsye ky lloj i përgjegjësisë njihet me emrin, “përgjegjësia civile subjektive”, e cila dallohet nga përgjegjësia objektive e cila nënkupton përgjegjësinë pavarësisht nga faji.

Po ashtu gjatë trajtimit të përgjegjësisë subjektive civile të dëmi jashtëkontraktor në dy shtetet tona, pamë se ekzistojnë kritere dhe kushte që duhet të plotësohen për ta pasur përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar. Pa plotësimin e këtyre kritereve dhe kushteve të caktuara, as që mund të bisedohet për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Pra, u pa se këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, për të ekzistuar ky lloj i përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar.

Gjithashtu, qartazi u pa se që të ekzistojë përgjegjësia civile (subjektive) duhet të plotësohen këto kushte: dëmi të jetë i shkaktuar, të jetë i shkaktuar me veprim të kundërligjshëm, të ekzistojë lidhja shkakësore midis veprimit a mosveprimit dhe pasojës, si dhe të ekzistojë faji i dëmtuesit. Këto kushte i njeh edhe KCSH, si dhe LMD në Republikën

e Kosovës. Duke u mbështetur në këtë mendoj se këtyre kushteve duhet që t’ia shtojmë edhe kushtin e aftësisë së deliktit, që nënkupton se, që të përgjigjet subjekti për dëmin e shkaktuar, duhet të jetë i aftë (i përgjegjshëm) dhe të përgjigjet me masën e vet pasurore për dëmet që i shkakton tjerëve. Pra, lypset aftësia e një personi për t’i kuptuar veprimet e veta. Përkitazi për këto arsye dhe për t’u konstatuar përgjegjësia subjektive civile, duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte: dëmi të jetë i shkaktuar, ai të jetë i shkaktuar me veprim të kundërligjshëm, të ekzistojë lidhja shkakësore midis veprimit a mosveprimit dhe pasojës, të ekzistojë faji i dëmtuesit dhe aftësia deliktore (aftësia e përgjegjësisë).

3.2.7. Argument

Pa plotësimin kushtit të aftësisë së deliktit nuk mund të ketë përgjegjësi subjektive civile. Pra, nuk mund të jetë e plotë përgjegjësia sipas fajit, sepse s’mund të ekzistojë ajo subjektive civile pa aftësinë e deliktit e cila ka të bëjë me një njeri të veçantë, si qenie e ndërgjegjshme, që ndien, provon dhe që mendon. E gjithë kjo, ka të bëjë me njeriun si subjekt i cili veprimet e veta i merr nga dëshira vetjake dhe jo nga faktet ose nga gjendja e vërtetë, që mbështetet në mendimet dhe në dëshirat e veçanta të një njeriu.

3.2.8. Rekomandojmë

Në të ardhmen kur flitet për kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, për të ekzistuar përgjegjësia civile te dëmi jashtëkontraktor si në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe në atë të Kosovës, si në doktrinë ashtu edhe në legjislacion, duhet të ekzistojë edhe kushti i aftësisë për përgjegjësi, përkatësisht kushti i aftësisë së deliktit si kusht në vete. Pra, nuk mund të flitet për plotësimin e këtyre kushteve në mënyrë kumulative pa plotësimin e kushtit të aftësisë së deliktit. Në bazë të asaj që u theksua, kuptohet se pa plotësimin e kushtit të tillë, përgjegjësia sipas fajit nuk mundë të ekzistojë. Gjithashtu, edhe përgjegjësia subjektive civile pa praninë e kushtit të aftësisë së deliktit, nuk mund të ekzistojë si njëra prej bazave më të rëndësishme të përgjegjësisë civile te dëmi jashtëkontraktor.

KAPITULLI IV: PËRCAKTIMI I KRITEREVE DHE KUSHTEVE QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË OBJEKTIVE CIVILE TE DËMI JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

4.1. Shqyrtime të përgjithshme

Përgjegjësia e bazuar në fajin që duhet dëshmuar e që bazohet në fajin e shkaktuesit të dëmit, u dëshmuar shpejt si shumë e ngushtë për rregullimin e përgjegjësisë për dëm. Rreziqet nga shkaktimi i dëmit bëheshin gjithnjë më të mëdha dhe gjithnjë më vështirë u bë që të përcaktohet faji i dikujt për shkaktimin e dëmit (Agushi, 2013:10). Përgjegjësia pa faj, e quajtur ndryshe në teori përgjegjësia objektive, konkuron vetëm në ato raste të parashikuara shprehimisht në ligj (Gjata, 2010:10). Pra, përveç përgjegjësisë subjektive të shkaktimi i dëmit dhe kompensimit të tij ekziston edhe përgjegjësia objektive, respektivisht përgjegjësia për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme. Përgjegjësia objektive është përgjegjësi civile e kohës së re. Zakonisht thuhet se, kjo përgjegjësi i ka fillet në zhvillimin e civilizimit teknik. Përkitazi edhe për këtë në doktrinë thuhet se, kjo përgjegjësi si e institucionalizuar zhvillohet prej shekullit XIX (Alishani, 1989:614). Mirëpo fillet e kësaj përgjegjësie i gjejmë edhe në të drejtën romake, në periudhën klasike të së drejtës romake. Edhe në të drejtën e Justinianit, kemi disa raste të përgjegjësisë pa faj (objektive), sepse poseduesi i egërsirës ose i kafshës së zbutur, poseduesi i ndërtesës që mund të rrënohet do të përgjigjet për dëmin me vetë faktin e dëmit të shkaktuar, pa marrë parasysh se kush ka qenë fajtor për atë dëm (Alishani, 1989:614). Pra, ky lloj i përgjegjësisë lidhet me shekullin

e XIX, me shfaqjen e zbulimeve të reja teknike, zbulimin e makinave të reja e të komplikuar dhe zhvillimin masovik të përsosjes teknike në komunikacionin tokësor, ujor e ajror. Si pasojë e kësaj, dëmet janë më të shpeshta dhe gjithnjë e më të mëdha. Ato i pësojnë, si personat që vijnë drejtpërdrejt në kontakt me këto mjete (punëtorët), ashtu edhe personat e tretë dhe rrethina që rrethohet nga këto mjete. Prandaj janë edhe rrjedhojë e zhvillimit të hovshëm teknologjik. Shtrirja e sferës së përgjegjësisë objektive, lidhet me karakterin e civilizimit industrial, të bazuar për përdorimin e mjeteve të prodhimit që në vetvete janë burime rreziku për personat dhe për sendet (impiantet industriale, mjetet motorike etj) të një rreziku shoqërisht të pranuar si një komponent i paevitueshëm, i civilizimit tonë (Galgano, 1999:366). Pra, fillimi i revolucionit industrial solli pasoja në fushën e së drejtës tregtare, të punës, sendeve dhe financiare (Papajorgji, 2012:15).

Përgjegjësia në bazë të fajit ka mbisunduar shekuj më radhë. Mirëpo zhvillimi i shoqërisë moderne, sidomos në fushën e industrisë e bujqësisë, ka determinuar në zgjerimin e përgjegjësisë për dëmin, si në marrëdhëniet kontraktore, ashtu edhe në ato jashtëkontraktore (Gjata, 2010:82). Ky zgjerim ka çuar në kushte të caktuara, d.m.th. të ketë përgjegjësi edhe personi që ka shkaktuar dëmin pa fajin e tij. Në teori, kjo lloj përgjegjësie është quajtur zbatimi i përgjegjësisë objektive në të drejtën ose pa faj. Në legjislacionin bashkëkohor janë parashikuar e rregulluar rastet dhe kushtet e përgjegjësisë objektive. Kështu rregullimi ligjor në kuptimin bashkëkohor, që bën fjalë për përgjegjësinë objektive, e ndeshim që në shekullin e XIX-të. P.sh. i tillë është Ligji Prusian për hekurudhat i vitit 1838, pastaj Ligji Austriak për garancinë e ndërmarrjeve hekurudhore i vitit 1869 etj (Gjata, 2010:82-83).

Në teorinë juridike ekzistojnë kritere të ndryshme, sipas të cilave bëhet klasifikimi i përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar. Përgjegjësia objektive pretendon sot që t'i përgjigjet nevojave të jetës, duke marrë për bazë teknologjitë e avancuara, mjetet moderne të prodhimit, mjetet e komunikacionit, sjelljet e paparashikueshme të kafshëve shtëpiake, rrethana që mund të krijohet ndaj kafshëve të egra që janë të mbrojtura ose jo, etj (Mamuti, 2013:140). Përgjegjësia objektive për shkaktimin e dëmit, si lloj i veçantë i përgjegjësisë juridike civile, paraqet përgjegjësinë civile pa faj të personit. Te ky lloj i përgjegjësisë me rastin e shpërblimit të dëmit, nuk merret aspak parasysh elementi subjektiv i shkaktuesit të dëmit, pasi detyrimi për zhdëmtim e ngarkon edhe pa pasur nevojë që të vërtetohet prezenca e fajit (Mamuti, 2013:82). Prandaj shumë autorë këtë përgjegjësi, shpeshherë e quajnë edhe "përgjegjësi pa faj". Kjo përgjegjësi, gjithmonë shkaktohet nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaritë e rrezikshme. Shoqëria, përkundër rrezikut që ka nga përdorimi i tyre, përsëri pajtohet që t'i përdorë, pasi dobitë që përfiton nga ky përdorim janë shumë më të mëdha se sa dëmet eventuale që mund të ketë (Mamuti, 2013:82). Te përgjegjësia subjektive, rregullat e përgjegjësisë për fajin zbatoheshin në rast të shkaktimit të dëmit me veprimet personale, kurse te ajo objektive për këto dëme nuk mund të konsiderohet fajtor as ai që e kryen veprimtarinë e këtillë e as vetë i dëmtuari. Nga kjo shihet se rregullat ndaj përgjegjësisë për dëmin, duhet të mos bazohen vetëm në faj. Andaj në rast të shkaktimit të dëmit nga sendi i rrezikshëm, duhet që të vërtetohet dëmi dhe lidhja kauzale ndërmjet tij dhe sendit të rrezikshëm (dëmtuesit). Në këto situata nuk është e nevojshme që të konstatohet dhe vërtetohet fjaji i dëmtuesit. Pra, për këtë përgjegjësi për sendet e rrezikshme, quhet edhe përgjegjësi pa faj.

4.2. Përgjegjësia civile për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose veprimtaria e rrezikshme, është një ndër përgjegjësitë civile sipas parimit të përgjegjësisë objektive. Si sende të rrezikshme konsiderohen ato që, për shkak të pozitës së tyre, ndikimit, cilësive ose vetë ekzistimit të sendit, si të tillë, përbëjnë rrezik të shtuar për mjedisin. Më së shpeshti përgjegjësia objektive ka të bëjë me lëmenj, në të cilët punohet me energji elektrike, lëndë shpërthyes, makina me avull ose me gaz; pastaj pajisje me energji nukleare, si dhe instalime për kalimin e energjisë elektrike. Si rrezik i shtuar konsiderohet edhe ndezja e zjarrit në hapësirë të hapur, përhapja e ndotësve dhe ndotja e mjedisit (DPPJ, 2015:514). Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme, konsiderohet se rrjedh nga ai send ose veprimtari, përveçse kur provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit (neni 154 i LMD). Për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të (neni 155 i LMD). Presumimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme, janë: që të jetë shkaktuar dëmi dhe të ekzistojë lidhja shkakësore mes dëmit dhe përdorimit të sendit, përkatësisht ushtrimit të veprimtarisë së rrezikshme që paraqet rrezik të shtuar për mjedisin. Përgjegjësia e pronarit të sendit të rrezikshëm apo veprimtarisë së rrezikshme për shpërblimin e dëmit, përjashtohet nëse dëmi është shkaktuar me ndikimin e forcës madhore, me veprimin e të dëmtuarit apo me veprimet e personave të tretë (DPPJ, 2015:514).

Në zhvillimin e institutit juridik të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga veprimtaria e rrezikshme ose sendet e rrezikshme, kanë ndihmuar shkenca juridike dhe praktika

gjyqësore (Gjata, 2010:83). Ka mendime të ndryshme lidhur me arsyetimin e kësaj përgjegjësie të mbiquajtur objektive. Legjislacioni dhe praktika juridike janë më të përafërta me teorinë e rrezikut, sipas së cilës, ai që përdorë një send të rrezikshëm duke krijuar rrezik për shkaktimin e dëmit, detyrohet të përgjigjet (Gjata, 2010:83).

Në KCSH (neni 622), nuk është dhënë kuptim i plotë i veprimtarisë së rrezikshme dhe sendit të rrezikshëm. Megjithatë, ndryshe nga disa legjislacione të huaja në këtë dispozitë është përfshirë një kriter i rëndësishëm, që është veprimtaria e rrezikshme nga natyra ose sendi i rrezikshëm nga natyra e tij (Gjata, 2010:83). Kështu në disa legjislacione, përgjegjësia në lidhje me veprimtarinë e rrezikshme ose sendin e rrezikshëm, prezumohet se rrjedh nga kjo veprimtari ose ky send, përveç kur provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Kjo është përgjegjësi objektive në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse nuk kushtëzohet me asnjë veprim të personit që ushtron një veprimtari të rrezikshme (Gjata, 2010:83). Përgjegjësi objektive është ai lloj i përgjegjësisë deliktore civile, që mbështetet në faktin e shkaktimit të dëmit nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme. Kjo përgjegjësi ndryshe, quhet edhe përgjegjësi pa faj që mbështetet në teorinë e kauzalitetit (Dauti, 2016:176). Dëmi mund të shkaktohet në mënyra të ndryshme: Shkaktimi i dëmit është rrjedhim a pasojë e veprimit të njerëzve, pra ai ndodhë si pasojë e demonstratave, grevave dhe çrregullimeve tjera në shoqëri. Gjithashtu, shkaktimi i dëmit ndodhë edhe nga veprimtaritë e rrezikshme, si p.sh; dëmi i shkaktuar në xeherore, në ndërtimtari, në trafik, etj. Shkaktimi i dëmit nga sendet, përfshinë të gjitha rastet e dëmit të shkaktuar nga sendet e caktuara, të cilat paraqesin rrezik të shtuar për rrethin e caktuar shoqëror, p.sh: dëmi i shkaktuar nga helmet, eksplozimi i gazrave, rryma elektrike etj (Morina, S, 2014:113).

Burim të rrezikut në këtë përgjegjësi, paraqet sendi i rrezikshëm dhe veprimtaria e rrezikshme.

KCSH lidhur me përgjegjësinë e ushtrimit të një veprimtarie të rrezikshme, në Nenin 622 parasheh se, “Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit”. Në KCSH sipas dispozitës së mësipërme, përjashtimi i dëmtuesit nga përgjegjësia është e kushtëzuar sepse dëmtuesi, pavarësisht se mund të jetë pa faj, për t’u përjashtuar nga përgjegjësia, duhet të provojë se i ka ndërmarrë “të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit” (Gjata, 2010:84). Siç shihet, përgjegjësia e dëmtuesit pranohet dhe që mund të thuhet në njëfarë kuptimi se ky pranim është absolut, d.m.th. nuk mund të kundërshtohet, pavarësisht a konkurren faji ose jo. Madje, elementi faj nuk paraqet asnjë rëndësi. Përjashtim të vetëm përbën kur personi përgjegjës provon se dëmi është shkaktuar nga një forcë madhore” (Gjata, 2010:85). Në nenin 622 të KCSH në fuqi, për sa i përket përgjegjësisë nga ushtrimi i një veprimtarie ose për shkak të sendeve të rrezikshme, në dukje sikur është bërë një tërheqje nga krahasimi me legjislacionin e mëparshëm shqiptar. Për të pasur më të qartë krahasimin, vlen të rikujtojmë dispozitën e nenit 622 të këtij Kodi. Ashtu si në legjislacionin e mëparshëm për këto raste, me këtë dispozitë pranohet po ashtu përgjegjësia pa faj. Por personit përgjegjës për shkak të veprimtarisë ose sendit të rrezikshëm, i njihet mundësia të provojë “se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit”. Ky qëndrim duket mjaft i drejtë (Gjata, 2010:86). E themi këtë, pasi nuk mund të mohohen përpjekjet për

mënjanimin ose zvogëlimin e dëmit. Kur personi i përmendur ka marrë të gjitha masat e duhura, që megjithatë dëmi ka qenë realisht i paevitueshëm, nxjerrim përfundimin se jemi ose përpara një force madhore, ose përpara një rasti fator. Sipas kuptimit të kësaj dispozite, dëmtuesi as për vete nuk do të arrinte ndonjë rezultat (Gjata, 2010:86). Pra, pasojat e rastit fator ose forcës madhore, kanë qenë të pandalshme ose të pamënjatueshme. Në të kundërtën, në qoftë se personi i tillë nuk provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme, do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Për sa i përket këtyre masave, ligji ka parasysh rastet kur objektivisht është e mundur marrja e tyre, pasi shpeshherë, sidomos në rastin e forcës madhore, nuk është e mundur marrja e ndonjë mase, si p.sh. kablloja elektrike e këputur bie në tokë dhe në të ndesh një kafshë, e cila si pasojë ngordhë. Ky është një rast fator, ku subjekti që ka ushtruar veprimtarinë e administrimit të rrymës elektrike, nuk kishte mundësi të ndërmernte masat e nevojshme (Gjata, 2010:86). KCSH nuk e jep kuptimin e nocionit të sendit të rrezikshëm. Andaj këtë kuptim duhet ta kërkojmë në teorinë juridike e praktikën gjyqësore, si njëra prej përgjegjësiive objektive. Send¹⁶ i rrezikshëm, konsiderohet çdo send i luajtshëm ose i paluajtshëm, i cili sipas pozitës së përdorimit ose sipas vetive që ka, paraqet rrezik për rrethin. Prandaj edhe duhet të mbikëqyret me kujdesin më të madh (Dauti, 2016:176). Disa sende janë të rrezikshme sipas vetë pozitës që kanë, si p.sh: saksia me lule në ballkon është send i rrezikshëm, sepse nëse ajo bie mund të shkaktojë dëm ose të lëndojë dikë. Ndërsa, veprimtari e rrezikshme për rrethin, është edhe kanali i hapur në rrugë (Dauti, 2008:168). Disa sende janë të

¹⁶ Sendi në kuptimin juridiko-civil nënkupton atë pjesë materiale të natyrës që mundë të vërehet me shqisa, është i përkufizuar në hapësirë dhe fizikisht ekziston si, dhe mundë të jetë objekt i ndonjë të drejte subjektive ose sipas Kodit Civil Austriak “çdo gjë që nuk është njeri, ndërsa shërben për nevojat e njerëzve quhet send në kuptimin juridik” (Shih më gjërësisht, Prof.dr. Abdullah ALIU, E Drejta Sendore, Prishtinë, 2004).

rrezikshme për nga përbërja e tyre p.sh; helmet, energjia atomike, rryma elektrike etj. Disa sende janë të rrezikshme, kur vihen në përdorim, si p.sh; mjete motorik kur vihet në lëvizje, paraqet rrezik për rrethin. Gjithashtu, rryma elektrike kur vihet në veprim në përçues është send i rrezikshëm. Po ashtu në KCSH nuk është përcaktuar domethënia e veprimtarisë së rrezikshme. Për të nxjerrë kuptimin e këtij termi, duhet t'i referohemi praktikës gjyqësore (Gjata, 2010:87). Prej saj nxjerrim përfundimin se, veprimtaria e rrezikshme është ajo veprimtari që nga ushtrimi i rregullt i së cilës, për shkak të vetë natyrës së saj teknike ose mënyrës së ushtrimit, mund të rrezikohet shëndeti i njerëzve ose pasuria. Rrjedhimisht, ky rrezikim kërkon kujdes të shtuar nga personat që ushtrojnë këtë veprimtari (Gjata, 2010:87). Nga ky përfundim, del se nuk mund të ketë vend emërtimi i veprimtarive konkrete që janë të rrezikshme, sepse ato janë të shumta e të shumëllojshme, madje as që mundet të vihet një kufi i prerë gjithëpërfshirës, pasi numri i tyre shtohet pandërprerë, për shkak të zhvillimit të shoqërisë. Për ta dalluar këtë veprimtari nga ajo e zakonshmja, po japim disa shembuj konkretë të veprimtarisë së rrezikshme. Prerja e drurëve në pyll është veprimtari e rrezikshme, sepse nuk lejon qëndrimin e njerëzve përreth: puna me herbicide, montimi i skelave etj. janë veprimtari të rrezikshme (Gjata, 2010:87). Pra, veprimtari e rrezikshme është ajo veprimtari prej së cilës krijohet rreziku për dëmin, sepse është burim i rrezikut të shtuar. Veprimtari të rrezikshme janë: ndërtimtaria, trafiku hekurudhor, automobilistik, ajror, ujor, veprimtaria në hidrocentrale etj. Rrezik të shtuar për rrethin paraqet edhe organizimi i tubimeve të njerëzve në vend të mbyllur ose të hapur, pastaj rrëzimi i objektit të caktuar, sendi me mungesa në prodhim etj (Dauti, 2008:168).

4.3. Subjekti përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga sendet dhe nga veprimtaritë e rrezikshme

Për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaritë e rrezikshme, përgjigjen subjektet e caktuara (Dauti, 2016:177). P.sh: LMD, në Nenin 155 thekson: “Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të”. Zotërues konsiderohet poseduesi i sendit, si dhe personi shoqëror juridik që ka të drejtë disponimi, respektivisht të drejtë shfrytëzimi të përkohshëm. Sipas nenit 622 të Kodit Civil, “përgjegjës për dëmin e shkaktuar është personi (fizik ose juridik), që ushtron veprimtari të rrezikshme ose përdorë ose mban sende që nga natyra e tyre janë të rrezikshme”. Zakonisht këta persona, si rregull janë pronarët e veprimtarive ose sendeve të tilla. Mirëpo, jo rrallë ndodhë që ushtrues i kësaj veprimtarie të mos jetë pronarë, por qiramarrës, enfiteozëmarrës, sipërmarrës etj., (Gjata, 2010:89). Këta gëzojnë të drejtën e përdorimit (shfrytëzimit) të përkohshëm të sendit. Ushtruesi i veprimtarisë së rrezikshme ose përdoruesi i sendit të rrezikshëm nga natyra e tij, nuk do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar në qoftë se sendi i rrezikshëm është marrë në mënyrë arbitrare (Gjata, 2010:89). Do të përgjigjet ai që e ka marrë sendin në këtë mënyrë. Mirëpo, në qoftë se mbajtësi (poseduesi) është sjellë në atë mënyrë sa që ka ndihmuar që sendi i rrezikshëm të merret si, p.sh. i lë çelësat në derën e makinës, do të përgjigjet solidarisht ndaj të dëmtuarit. Mbajtësi i sendit gëzon të drejtën e regresit ndaj personit që ia ka marrë sendin (Gjata, 2010:89). Personi që ka sendin në gëzim mund t’ia besojë atë një personi të tretë. Në këtë rast, përgjegjës është personi që i’u besua sendi për ta përdorur ose personi që është i detyruar për ta mbikëqyrur sendin, megjithëqë nuk është pranë tij në punë, në vend

të mbajtësit të sendit (të tilla janë p.sh. rastet e kontratës, së qirasë, huapërdorjes), etj (Gjata, 2010:89-90). Në qoftë se, sendi që i dorëzohet personit të tretë ka ndonjë të metë të fshehtë ose cilësi të fshehtë, për të cilin mbajtësi i sendit nuk e ka njoftuar personin e tretë dhe nga kjo është shkaktuar dëmi, personi që ka shpërblyer dëmin; ka të drejtë të kërkojë shumën e paguar nga mbajtësi i sendit. Përgjegjësi ka edhe ai që ia jep sendin e rrezikshëm një personi të pa aftë për ta përdorur, si p.sh. pronari i traktorit i'a ka dhënë këtë të fundit për të punuar me të një personi që nuk e kishte këtë aftësi. Për dëmin do të përgjigjen të dy solidarisht (Gjata, 2010:90). Personat që janë në marrëdhënie pune tek ai që ka sendin e rrezikshëm, nuk përgjigjen për dëmin, si shofer, makinist etj. Për ta përgjigjet ai që e ushtron veprimtarinë. I punësuar do të përgjigjej ndaj të dëmtuarit vetëm po të shkaktonte dëmin me dashje, madje me të do të përgjigjej edhe ushtruesi i veprimtarisë solidarisht (Gjata, 2010:90). Pra, me këtë kuptojmë se, në rast të shkaktimit të dëmit nga sendi i rrezikshëm, përgjigjet pronari i sendit të rrezikshëm, kurse për dëmin e shkaktuar nga veprimtaria e rrezikshme, përgjigjet subjekti që merret me veprimtari të rrezikshme. Në qoftë se sendi i rrezikshëm, është në bashkëpronësi të dy ose më shumë subjekteve, atëherë, solidarisht përgjigjen të gjithë bashkëpronarët. Ka raste, kur pronari mund t'ia dorëzojë sendin e vet të rrezikshëm në posedim ndonjë subjekti tjetër dhe dëmi mund të shkaktohet derisa sendi i rrezikshëm ka qenë te poseduesi tjetër. Këtu duhet dalluar dy situata (Dauti, 2008:169), 1) kur sendi i është dorëzuar subjektit në shërbim të pronari i sendit të rrezikshëm dhe 2) kur sendi i është dorëzuar subjektit i cili nuk është në shërbim të tij. Në rastin e parë, kur dëmi shkaktohet nga sendi i rrezikshëm derisa gjendet në posedim të subjektit në shërbim të pronarit të rrezikshëm, për atë dëm sipas parimit të përgjegjësisë pa faj, do të përgjigjet pronari i sendit të rrezikshëm (Dauti, 2008:169). Në rastin e dytë, kur

pronari i sendit të rrezikshëm ia dorëzon sendin personit që nuk është në shërbimin e tij, ku ai do ta përdorë atë përkohësisht, në bazë të kontratës me shpërblim ose asaj pa të, për dëmin do të përgjigjet ai subjekt që është mbajtës i sendit e jo pronari i tij (Dauti, 2008:169). Kështu, p.sh: qiramarrësi, blerësi i sendeve të rrezikshme, shërbimmarrësi, përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme njësoj si pronari i tyre, sepse atë e përdorin në dobi të tyre. Pronari i sendeve të rrezikshme nuk do të jetë më përgjegjës, sepse sendi më nuk është nën kontrollin e tij (Dauti, 2008:169).

4.4. Baza e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme

Në përgjegjësinë për dëmin nga sendet e rrezikshme, bazë e përgjegjësisë nuk është faj, sepse përgjegjësia është pa faj dhe njihet si përgjegjësi objektive. Ekzistojnë mendime të ndryshme për bazën e kësaj përgjegjësie (Dauti, 2008:170). Mendimi më i vjetër e mbështetë bazën e kësaj përgjegjësie në idenë e kauzalitetit. Sipas këtij mendimi, pronari i sendit të rrezikshëm duhet të përgjigjet për çdo dëm, i cili do të kishte marrëdhënie kauzale me sendin e rrezikshëm (Dauti, 2008:170). Mendimi tjetër, ka të bëjë me teorinë juridike franceze që përfaqëson idenë e rrezikut për bazën e përgjegjësisë për sendet e rrezikshme. Sipas këtij mendimi, rreziku kuptohet si rrezik i dobisë ekonomike, sepse ai subjekt që e përdorë sendin e rrezikshëm, me të realizon fitim ekonomik, prandaj është e arsyeshme që t'i bartë edhe pasojat e dëmshme që do të krijohen me përdorimin e atij sendi (Dauti, 2008:170). Mendimi i tretë është paraqitur në teorinë juridike gjermane, në të cilën baza e përgjegjësisë objektive mbështetet në idenë e interesit. Sipas kësaj teorie, çdo subjekt është

i detyruar të shpërblejë dëmin, të cilin i'a ka shkaktuar tjetrit duke realizuar ndonjë interes të vetin (Dauti, 2016:178). Në lidhje me këtë praktika gjyqësore kosovare në një rast vëren se “lopa ka ngordhur si pasojë e kontaktit me telin e këputur të rrjetit të tensionit të ulët, për mirëmbajtjen e të cilit përgjegjës është i padituri, që nënkupton se dëmi është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm”, në kuptim të nenit 154 para, 2, të LMD të vitit 1978, për dëmin e shkaktuar nga sendi apo nga veprimtaria e rrezikshme, përgjegjësia është objektive¹⁷.

Bazën e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme duhet mbështetur në rrezikun e krijuar, sepse pronari i sendeve të rrezikshme i ka dobritë nga përdorimi i atyre sendeve, prandaj edhe duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të veprimtarisë së tij. Argumenti kryesor i kësaj përgjegjësie është se, kjo përgjegjësi është pa faj, për arsye se për dëmin e shkaktuar dëmtuesi përgjigjet pa u vërtetuar se a është fajtor (Dauti, 2016:179). Për të dëmtuarin është me rëndësi që të shpërblehet dëmi, gjë që arrihet me këtë përgjegjësi. Në dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaria e rrezikshme, shpesh ndodhë që të mos ketë mundësi të vërtetohet fajti ose ndodhë që të mos ekzistojnë prova, p.sh. te dëmet e shkaktuara në trafik (Dauti, 2016:179). Ka raste kur nuk ekziston fajti i askujt për dëmin e shkaktuar, prandaj krijohen rrethana që i dëmtuari të mos ketë mundësi të realizojë

¹⁷Gjykata Supreme e Kosovës, në Revizionin Nr.130/2008, dt/19.09.2011, vendos si të pabazuara theksimet në revizionin e të paditurit se në kuptim të nenit 154 të LMD, dëmi i shkaktuar duhet shpërblyer nga personi i cili e ka shkaktuar atë, fajti i të cilit duhet vërtetuar. Duke pasur parasysh faktin se lopa ka ngordhur si pasojë e kontaktit me telin e këputur të rrjetit të tensionit të ulët, për mirëmbajtjen e të cilit përgjegjës është i padituri, që nënkupton se dëmi është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm, në kuptim të nenit 154 para, 2, të LMD të vitit 1978, për dëmin e shkaktuar nga sendi apo nga veprimtaria e rrezikshme përgjegjësia është objektive. Kjo dispozitë lehtëson pozitën juridike të të dëmtuarit, pasi që barra e të provuarit për t'u liruar nga përgjegjësia në bazë të nenit 177 (tash neni 158 i LMD) i përket zotëruesit të sendit të rrezikshëm, përkatësisht ushtruesit të veprimtarisë së rrezikshme.

shpërblimin e dëmit. Prandaj, për rastet e këtilla për realizimin e shpërblimit të dëmit më e përshtatshme është përgjegjësia objektive.

4.5. Argumentet për dhe kundër kësaj baze të përgjegjësisë

Për përgjegjësinë objektive, në doktrinën juridike ekzistojnë mendime të ndryshme. Këto mendime kanë të bëjnë ose me argumentet se si të arsyetohet kjo përgjegjësi, ose me ato që i kundërvihen ekzistimit të kësaj përgjegjësie (Alishani, 1989:617-618).

4.5.1. Argumentet për (pro) këtë përgjegjësi

Argumentet kryesore që përpiqen të arsyetojnë përgjegjësinë objektive janë:

- Përgjegjësia objektive është përgjegjësi pa faj, që d.m.th. se për dëmin e shkaktuar dëmtuesi përgjigjet, duke mos vërtetuar se a është fajtor.
- Dëmi i shkaktuar nga sendet e rrezikshme a veprimtaria e rrezikshme

Për pikën e parë të kjo përgjegjësi është me rëndësi të ekzistojë dëmi, lidhja kauzale, veprimi antijuridik si dhe të përgjigjet dikush për dëmin. Prandaj, për të dëmtuarin është me rëndësi që dëmi të paguhet, çka edhe arrihet me këtë përgjegjësi (Alishani, 1989:618).

Sa i përket pikës së dytë, te dëmi i shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaria e rrezikshme, shpesh ndodhë që faji të mos ketë mundësi të vërtetohet. P.sh: dëmet në komunikacionin ajror, tokësor dhe ujor. Veçmas ndodhë që të mos ekzistojë prova e

aksidentit në komunikacionin ajror (në shumicën e rasteve), në ndonjë rast edhe në komunikacionin ujor (Alishani, 1989:618). Në këtë fushë të përgjegjësisë, ka raste kur nuk ekziston faji i askujt për dëmin e shkaktuar, sepse është produkt i zhvillimit të teknikës. Po ashtu, rasti kur askush nuk është fajtor për dëmin e shkaktuar, do të krijohen rrethanat që i dëmtuari të mos ketë mundësi të realizojë shpërblimin e dëmit. Për këtë arsye del se në këto dhe raste të tjera, përgjegjësia objektive është më e përshtatshme për realizimin e shpërblimit të dëmit (Alishani, 1989:618).

Pronari, poseduesi, shfrytëzuesi i sendit të rrezikshëm ose organizuesi i veprimtarisë së rrezikshme përgjigjet për dëmin nga këto sende ose veprimtari. Mirëpo, këta persona, në qoftë se nuk dëshirojnë të përgjigjen ose të japin llogari për këto sende ose veprimtari, mund të përkrahen nga veprimet e caktuara ose mund të zhvishën nga përdorimi ose posedimi i atyre sendeve, ose nga aktivizimi i aktivitetit të caktuar (Alishani, 1989:618). Nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaria e rrezikshme pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi i tyre ka dobi ose ka interes, prandaj, në qoftë se nga këto sende ose veprimtari të rrezikshme shkaktohet dëmi, atëherë personi përgjegjës duhet të përgjigjet. Kjo teori në doktrinë quhet teoria e interesit, sipas së cilës, ky person duhet të përgjigjet për dëmin, sepse ka interes, andaj, edhe duhet të ketë përgjegjësinë për dëmin që mund të shkaktohet gjatë realizimit të interesit të caktuar nga këto sende ose veprimtari (Alishani, 1989:618).

Rregullat e përgjegjësisë objektive krijojnë siguri dhe nisen nga ideja e sigurisë. Themel kështu ngase i dëmtuari në këtë lëmë e di se dëmi do të shpaguehet në rast të shkaktit të dëmit dhe atë pavarësisht nga faji i dëmtuesit. Në qoftë se në këtë fushë do të sajohet përgjegjësia në bazë të fajit, atëherë në masë të duhur do të shkaktohet pasiguria juridike e

të dëmtuarit dhe të personave potencialë që dëmtohen nga sendet e rrezikshme dhe aktiviteti i rrezikshëm (Alishani, 1989:618-619). Sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme krijojnë rrezik të caktuar për rrethin e caktuar, andaj, ai që krijon rrezik të shtuar duhet të përgjigjet për dëmin eventual. Këtë teori në doktrinën tonë e kanë quajtur edhe e quajnë teoria e rrezikut. Sipas saj sendi i cili i shërben njeriut e përparimit, në qoftë se është i dobishëm, përdorimi i tij nuk mund të ndalohej. Mirëpo, këto sende nga rreziku që shkaktojnë dhe dëmi që shkaktohet, atëherë është normale që të përgjigjen për ato dëme (Konstantinovic, 1966:129-131).

4.5.2. Argumentet kundër kësaj përgjegjësie

Si argumente kundër kësaj përgjegjësie theksohet se, me aprovimin e përgjegjësisë objektive, do të shkaktohet paralizimi i aktivitetit që është i lidhur me sendin e rrezikshëm ose me aktivitetin e rrezikshëm (Alishani, 1989:619). Thuhet kështu, ngase subjektet e caktuara duke u frikësuar se do të përgjigjen për dëmin që rrjedh nga sendet e tilla ose nga aktiviteti i tillë, s'do të mund t'i kenë këto sende ose s'do të organizojnë aktivitete të caktuara, për shkak se do të përgjigjen për dëmin, pa marrë parasysh fajin. Prandaj, më mirë është që të përkrahet përgjegjësia subjektive, sepse niset nga dija e fajit për dëmin e shkaktohet (Alishani, 1989:619). Përgjegjësia objektive zhvillohet dhe ekziston në ato vende ku ekziston civilizimi i lartë, ku ekziston përparim i madh teknik. Me fjalë të tjera, kjo përgjegjësi u përgjigjet shoqërive që kanë industri dhe teknika të zhvilluar. Kjo përgjegjësi nuk mund të zhvillohet e zbatohet në shoqëritë, ku nuk ekziston progresi i duhur i civilizimit teknik. Pra, në këto vende sipas këtij mendimi duhet të ekzistojë vetëm baza e

përgjegjësisë sipas fajit (Alishani, 1989:619). Ky mendim nuk mund të përkrahet, sepse edhe në shoqëritë më të pazhvilluara ekzistojnë sende dhe veprimtari të rrezikshme, nga të cilat mund të shkaktohet. Prandaj edhe duhet të zbatohet përgjegjësia objektive, sepse me kalimin e kohës gjithnjë e më tepër do të kemi një zhvillim që shpie kah bashkëkohësia e civilizimit teknik dhe atij juridik. Sipas mendimit të disa shkencëtarëve, zbatimi i përgjegjësisë objektive disi po e barazon subjektin që është sjellë me kujdes dhe atë që është sjellë me pakujdesi të rëndë, sepse në çdo rast ai përgjigjet për dëmin që mund të shkaktohet nga këto sende ose veprimtari (Alishani, 1989:619). Për këtë arsye, përgjegjësia sipas fajit këtu është e domosdoshme. Mirëpo sikundër që u theksua ekzistojnë argumentet e teorisë së interesit, teorisë së rrezikut, si dhe fakti se në shumë raste është vështirë të vërtetohet se ekziston faji (mbetet anonim ose është e pamundshme që të provohet). Aprovimi i përgjegjësisë subjektive është i tepërt dhe i panevojshëm edhe në këtë lëmë, sepse përgjegjësia subjektive mund t'i plotësojë të gjitha nevojat e organizimit juridik të përgjegjësisë (Alishani, 1989:620). Ata theksojnë se, përgjegjësia sipas fajit është mjaftë elastike që të mbulojë edhe rastet e përgjegjësisë në këtë lëmë. Madje, tek rastet e fajit të supozuar, ku supozimi është me karakter absolut i cili bën të mundshme që përgjegjësia subjektive të objektivizohet dhe kështu do të lehtësojë zgjidhjen edhe në këtë lëmë. Edhe këtij mendimi mund t'i bëhen vërejtje të njëjta, ngase përgjegjësia objektive e ka arsyetuar dhe po e arsyeton edhe tani ekzistimin e vet të përgjegjësisë, për dëmin e shkaktuar në ato raste, kur ai shkaktohet nga sendet ose veprimtaritë që krijojnë rrezik për rrethin e caktuar (Alishani, 1989:620).

4.5.3. Rekomandojmë

Në lidhje me argumentet për dhe kundër kësaj përgjegjësie duhet të mbështetet teoria juridike franceze dhe ajo gjermane që përfaqësojnë idenë e rrezikut për bazën e përgjegjësisë për sendet e rrezikshme. Sipas kësaj teorie, rreziku kuptohet si rrezik i dobisë ekonomike, sepse ai subjekt që e përdorë sendin e rrezikshëm, me të realizon fitim ekonomik, prandaj është e arsyeshme që t'i bartë edhe pasojat e dëmshme që do të krijohen me përdorimin e atij sendi. Prandaj, përkrahim argumentet pro ekzistimit të kësaj përgjegjësie e cila arsyetohet në idenë e interesit të subjekteve që përdorin këto sende dhe ushtrojnë veprimtari të tilla.

4.5.4. Terminologjia

Terminologjia në këtë fushë nuk është unike si në të drejtën tonë, ashtu edhe në të drejtën krahasuese. Në qoftë se, me kujdes studiohen termet që përdoren në këtë fushë mund të thuhet se përdoren këta terma:

- a)** Përgjegjësia për sendet e rrezikshme
- b)** Përgjegjësia objektive
- c)** Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga një veprimtari e lidhur me një burim të rrezikut të shtuar
- d)** Përgjegjësia pa faj

e) Teoria e rrezikut

f) Veprimtaria me rrezik të shtuar

a) Termi “përgjegjësia për sendet e rrezikshme”, është i mirë, sepse këtu me të vërtetë përgjegjësia sajohet për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme, por vetëm duhet pasur parasysh se kjo përgjegjësi nënkupton edhe përgjegjësinë për veprimtari të rrezikshme (Alishani, 1989:620).

b) Termi, “përgjegjësia objektive”- është i përshtatshëm, sepse shpjegon faktin se në këtë fushë elementet subjektive nuk merren parasysh, përkatësisht nuk është kusht për përgjegjësinë për dëmin, por përgjegjësia është e pa faj, e objektivizuar. Mirëpo, nuk duhet harruar se kjo nuk d.m.th. se këtu nuk ekziston faji (Alishani, 1989:620).

c) Termi, “përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga një veprimtari e lidhur me një burim të rrezikut të shtuar”, nuk është i qëlluar, sepse nuk përmend edhe sendin e rrezikshëm. Pra, këtu përgjegjësia sajohet në dëmin e shkaktuar nga sendet ose veprimtaritë e rrezikshme, meqë zakonisht, veprimtaria e rrezikshme kryhet me sende të rrezikshme (Sallabanda, 1962:329). Sa i përket pjesës tjetër të këtij termi të përdorur, si burim i rrezikut të shtuar duhet të theksohet se, si veprimtaria e caktuar, ashtu edhe sendet e caktuara, duhet t’i krijojnë rrezik të shtuar rrethit të caktuar. Kjo duhet të lidhet edhe për veprimtarinë e rrezikshme ku organizohet, sepse mund të shkaktojë rrezik të shtuar për rrethin e caktuar (Alishani, 1989:620).

d) Në doktrinë përdoret edhe termi “përgjegjësia pa faj”. Ky term përdoret me faktin se te ky lloj i përgjegjësisë nuk merret parasysh përgjegjësia e pronarit, poseduesit,

shfrytëzuesit, për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose veprimtaritë e rrezikshme (Sallabanda, 1962:329).

e) Kurse në doktrinën franceze përdoret termi “teoria e rrezikut”, ku si duket përdoret për arsyetimin e përgjegjësisë për sendet e rrezikshme. Kuptohet se sendet e rrezikshme ose veprimtaria e rrezikshme krijon rrezik të caktuar për një rreth të caktuar (Starck, 1972:30-31).

f) Në disa legjislacione (KCH 339,1,) përdoret termi “veprimtaria me rrezik të shtuar”. Ky term nuk është adekuat, sepse këtu kemi përgjegjësi si për sendet e rrezikshme ashtu edhe për veprimtari të rrezikshme. Andaj, përdorimi i këtij termi është përfshirja e pjesshme e problemeve që i shkakton përgjegjësia objektive (Alishani, 1989:621).

Në fund **konstatojmë** se termet, si: përgjegjësia objektive, përgjegjësia për sendet e rrezikshme dhe përgjegjësia pa faj, janë terme të qëlluara, të cilat pa asnjë mëdyshje mund të përdoren. Kuptohet se për përgjegjësinë e kësaj materie, varësisht prej problemeve që trajtohen bën të shkruhet edhe përgjegjësia për veprimtari të rrezikshme ose përgjegjësia për sende të rrezikshme, meqë ky i dyti është më afër krejt materies së këtij lloji të përgjegjësisë civile.

4.6. Analizë e rasteve të përgjegjësisë civile për sendet dhe veprimtaritë rrezikshme

Në botën bashkëkohore dëmet nga sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme, janë gjithnjë e më të shumta. Sot në nivelin e zhvillimit tekniko-ekonomik që ka arritur shoqëria njerëzore,

nuk mund të mendohet mosparashikimi me norma juridike i përgjegjësisë objektive, madje as në skajet dhe vendet më të pazhvilluara (Gjata, 2010:101). LMD në Kosovë, në nenet 161-168 parasheh 12 raste të veçanta për këtë lloj përgjegjësie, si p.sh; përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në organizatat industriale dhe në vendndërtime; përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në trafik; përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga rrëzimi, hedhja, derdhja nga ndërtesat; ajo për dëmin e shkaktuar nga godina; për dëmin e shkaktuar nga kafshët; për dëmin e shkaktuar me mjetin motorik në lëvizje; e prodhuesit të sendit me mungesa; për dëmin e shkaktuar me akte terroriste, me demonstrata ose manifestime publike; e organizuesit të manifestimit; për dëmin për shkak të mosofrimit të ndihmës së nevojshme; ajo përkitazi me detyrën për lidhjen e kontratës dhe përgjegjësia për dëmin përkitazi me kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm.

Kur flitet për rastet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet ose veprimtaritë e rrezikshme, zakonisht shkenca juridike dhe legjislacioni në këtë lloj të përgjegjësisë civile për objekt trajtimi, ka rastet për dëmet e shkaktuara nga:

- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në organizatat industriale dhe në vendndërtime;
- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në trafik;
- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët - “Damnum per animal”;
- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, me akte terroriste, demonstrata dhe manifestime publike;
- Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar për shkak të mos ofrimit të ndihmës së nevojshme;
- Përgjegjësia lidhur me kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm;

4.6.1. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në organizatat industriale dhe në vendndërtimet

Në kohën e sotme një numër i madh dëmsh shkaktohen nëpër ndërmarrje të ndryshme industriale, në vendndërtime (ndërtimi i godinave, urave, rrugëve, etj.), në xeherore, në fabrika e në punë tjera (Dauti, 2008:171). Ndërmarrjet industriale dhe të ndërtimtarisë merren me veprimtari të rrezikshme, të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha, si personave ashtu edhe pasurisë së tyre. Për çdo dëm që do të shkaktohej në kuadrin e veprimtarisë së organizatës industriale-ndërtimore, do të përgjigjet ajo organizatë sipas rregullave lidhur me përgjegjësinë për sendet e rrezikshme, respektivisht sipas bazës së përgjegjësisë objektive. Ndërtesat nga vetë ekzistimi i tyre paraqesin rrezik për rrethin, kështu që duhet të mbikëqyren me kujdes të veçantë, sepse ndërtimtaria merret me ndërtimin, zgjerimin dhe rindërtimin e objekteve që shërbejnë për nevoja të ndryshme. Në ndërtimtari bëhet, po ashtu edhe kryerja e punëve të specializuara, si montimi, izolimet, rrënimet, etj. Zakonisht, dëmi në këso situatash shkaktohet kur rrëzohet e tërë ndërtesa apo një pjesë e saj, ose ndonjë mënyrë tjetër, si paraqitja e gabimeve në konstruksion, kur objekti ka mungesa në ndërtim etj.

Për dëmin e shkaktuar nga ndërtesa përgjigjet pronari, poseduesi dhe shfrytëzuesi i banesës, ndërtesës. LMD në nenin 164 për këtë lloj përgjegjësie thekson se "Zotëruesi i ndërtesës ose i hapësirës nga e cila ka rënë objekti, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në rast se një objekt i vendosur në mënyrë të rrezikshme ose objekti i hedhur bie nga ndërtesa", ndërsa në nenin 165 një gjë të tillë e parasheh në këtë mënyrë "Zotëruesi i ndërtimit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në rast se, pjesë të një ndërtimi shemben ose rrëzohen,

përveç nëse provohet se ngjarja nuk ka qenë rezultat i cilësisë së papërshtatshme të ndërtimit dhe se zotëruesi ka bërë çdo gjë për të shmangur rrezikun”. Pra nga kjo shihet se, pronarët e ndërtesave ose ndërtuesit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktohen banorëve të tyre nga mungesa e cilësisë së punimeve. Për shembull, nëse një pallat pëson një shembje të pjesshme si rezultat i disa lëkundjeve të lehta prej tërmetit, ndërtuesi ose pronari që ua ka shitur atë banorëve, duhet të mbajë përgjegjësi për çdo dëm që kanë pësuar ata nga tërmeti. Po ashtu, kur ndërtesa është në ndërtim e sipër, shoqëria e ndërtimit mban përgjegjësi për shkaktimin e dëmit në rast se, nga të metat në ndërtim u shkaktohet dëm kalimtarëve apo personave të tjerë. Për shembull, shkëputet një dërrasë nga skela dhe godet një person që është duke ecur në rrugë. Sipas këtyre rregullave do të përgjigjeshin edhe organizatat tjera, të cilat merren me veprimtari të tjera e që paraqesin rrezik për ambientin që i rrethon, p.sh: organizatat për eksploatimin e naftës, organizatat bujqësore si dhe individët (elektroinstaluesit, automekanikët, etj) (Dauti, 2016:180). Kur përmenden organizatat për eksploatimin e naftës duhet pasur parasysh gjithë veprimtarinë rreth nxjerrjes së naftës, përpunimit, dhe distribuimit të saj etj (Alishani, 1989:706). Kurse për organizatat që merren me prodhimin e produkteve bujqësore, duhet theksuar veçmas rastet kur ato, përdorin makinat bujqësore, merren me prodhimin dhe shitjen e atyre, si dhe ato që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për ruajtjen e bimëve industriale nga sëmundjet e ndryshme (Alishani, 1989:706). Sipas nenit 623 paragrafi i parë të KCSH “Pronari i një ndërtese ose ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre”. Kjo dispozitë parashikon dy lloje përgjegjësie për pronarin. E para, është përgjegjësia për dëmet që shkaktohen nga të metat e çdo ves tjetër në ndërtesën e përfunduar, ose në mirëmbajtjen e saj. E dyta, është përgjegjësia për

dëmet e shkaktuara gjatë ndërtimit, për të metat ose veset e tjera që kanë lidhje me ndërtimin (Gjata, 2010:101). Dëmi duhet t'u shkaktohet si punëtorëve, ashtu edhe personave të tretë, si p.sh. qiramarrësve, bujtësve etj. pavarësisht nga koha e kaluar nga ndërtimi i objektit. Zakonisht, dëmet nga të metat ose veset e tjera konstatohen në ndërtimet më të reja në vitet e para pas ndërtimit, si p.sh. nga cilësia e dobët e materialeve ndërtimore rrëzohet një pjesë e murit të banesës ku banon qiramarrësi. Ndërsa në ndërtimet e mëhershme dëmi shkaktohet, kryesisht nga mosmirëmbajtja e tyre, shkalla e lartë e autorizimit etj (Gjata, 2010:101). Subjekti i përgjegjësisë është kurdoherë pronari i ndërtesës i cili gëzon të drejtën e regresit kundër personave që janë përgjegjës ndaj tij.

4.6.2. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në trafik

Me komunikacion nënkuptojmë veprimtarinë, e cila merret me bartjen e njerëzve dhe të mirave materiale, të njerëzve nga një vend në vendin tjetër (Mustafa & Reshiti & Kutllovci, 2004:14). Në trafikun publik si në të kaluarën ashtu edhe në jetën e sotshme bashkëkohore, shpesh janë shkaktuar dhe shkaktohen dëme të ndryshme. Sot numri më i madh i dëmeve shkaktohet në komunikacion, pa marrë parasysh se a është komunikacioni hekurudhor, automobilistik, uJOR apo ajror. Është e nevojshme të vihet në dukje që në fillim se këtu bëhet fjalë vetëm për përgjegjësinë jashtëkontraktore për të gjitha llojet e transportit, tokësor, hekurudhor, uJOR, ajror, me të gjitha veçoritë që kanë (Gjata, 2010:102). Kjo përgjegjësi shtrihet për dëmin që u shkaktohet të tretëve, si persona ose pasurisë së tyre, si pasojë e aksidenteve të ndryshme. Si rregull, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar është objektive, d.m.th. edhe pa fajin e poseduesit të mjetit të transportit, me të cilin është

shkaktuar dëmi, që mund të jetë vetë pronari ose personi, ku i ka kaluar mjeti në posedim me vullnetin e pronarit. Ky përjashtohet nga përgjegjësia, atëherë vetëm kur provohet se dëmi është shkaktuar me dashje prej të dëmtuarit, nga një person i tretë ose nga forca madhore (Gjata, 2010:103). Nga ky rregull ka edhe përjashtime për lloje të veçanta të transportit. Kështu, në transportin ajror, përgjegjësia jashtëkontraktore është rregulluar me Konventën e Romës, fillimisht në vitin 1933, por që ka hyrë në fuqi me hartimin e tekstit të ri, në vitin 1952. Dispozitat e saj dhe ato të mëvonshme bazohen në parimin e përgjegjësisë objektive të pronarit ose bartësit të drejtës së transportit ajror, për dëmet e shkaktuara personave në tokë nga rrëzimi i mjetit ajror ose të sendeve të veçanta prej tij në sipërfaqen e tokës ose në ujë (Gjata, 2010:103). Përgjegjësia për dëmin është shtuar deri në skajshmëri edhe ndaj personave të tretë, për arsye se përgjigjet edhe kur dëmi shkaktohet nga forca madhore. E kundërta ka ndodhur në transportin ujor. Përgjegjësia jashtëkontraktore mbështetet në rregullin se, transportuesi nuk përgjigjet në qoftë se nuk është fajtor. Mirëpo, me shtimin e rrezikut nga zhvillimi industrial ky rregull ka ardhur duke u mënjanuar, sidomos me futjen në përdorim të anijeve nukleare. Sistemi i përgjegjësisë kontraktore e jashtëkontraktore mbështetet në pranimin e përgjegjësisë objektive absolute, që është sanksionuar edhe në Konventën e Brukselit të vitit 1962 (Gjata, 2010:103).

Për sa i përket përgjegjësisë për dëmin, aksidentet për trafik përbëjnë rastet dhe format më të shpeshta, me pasoja të rënda për jetën, shëndetin e pasurisë së njerëzve. Prandaj, dhe disa legjislacione i kanë shkaktuar dispozitat e veçanta të përgjegjësisë në rast aksidenti të shkaktuar me mjete transporti gjatë lëvizjes, që përbënë edhe veçoritë për dëmet nga veprimtaria e rrezikshme. Është dalluar përgjegjësia e ndërsjellë e poseduesve të mjeteve të

transportit dhe përgjegjësia e poseduesve të këtyre mjeteve ndaj personave të tretë (Gjata, 2010:104).

Në komunikacionin *hekurudhor* në aksidente të ndryshme dëmi mund t'i shkaktohet udhëtarëve e personave të tretë. Për dëmin që u shkaktohet udhëtarëve në udhëtim hekurudhor, përgjigjen ndërmarrjet transportuese hekurudhore sipas përgjegjësisë objektive-përgjegjësisë pa faj (Dauti, 2008:172). Kjo përgjegjësi krijohet prej momentit të ardhjes së udhëtarit në lokalet e stacionit të nisjes e deri te dalja nga stacioni hekurudhor i vendit për ku udhëton (Milosevic, 1977:187). Si udhëtar nuk konsiderohet subjekti i cili kryen ndonjë funksion zyrtar, rreth veprimtarisë së hekurudhës ose që ka dalë për të pritur ose përcjellë dikë (Dauti, 2016:181). Në bazë të kësaj nënkuptojmë se, ndërmarrja transportuese hekurudhore do të përgjigjej për udhëtarin, si për dëmin e pësuar para hyrjes në tren, ashtu edhe gjatë kohës së qëndrimit në stacionin hekurudhor. Ngjashëm me hekurudhat edhe në trafikun automobilistik, përgjegjësia është pa faj (objektive). Mjetet motorike, siç janë automjetet, janë sende të rrezikshme, kurse veprimtaria që kryhet me këto mjete është veprimtari e rrezikshme. Siç dihet automjeti është send i rrezikshëm vetëm kur është në përdorim, respektivisht kur vihet në lëvizje, ndërsa kur ky mjet ndodhet i parkuar nuk konsiderohet send i rrezikshëm. Organizata që merret me shërbime publike, përgjigjet për dëmin që u shkaktohet udhëtarëve dhe personave të tretë (Alishani, 1989:706). Në komunikacionin *ujor*, gjithashtu ekzistojnë raste të dëmit të shkaktuar dhe të përgjegjësisë për atë dëm. Për dëmin e shkaktuar në komunikacionin ujqor ekziston përgjegjësia sipas rregullave mbi përgjegjësinë për sendet e rrezikshme përveç në trafikun detar, për të cilin ka përjashtime nga zbatimi i këtyre rregullave, ku detari i anijes për

dëmin e shkaktuar për vdekje dhe lëndim trupor të udhëtarëve, për shkak të përmbytjes së anijes, eksplozimit, do të përgjigjet sipas parimit të fajit të supozuar (Dauti, 2008:172). Për dëmin e shkaktuar në komunikacionin *ajror*, si punëtorëve ashtu edhe personave të tretë, përgjigjet ndërmarrja për komunikacionin ajror, sipas rregullave mbi përgjegjësinë për sendet e rrezikshme. Edhe mjetet e udhëtimit ajror konsiderohen si sende të rrezikshme, nëse janë në lëvizje ose ndodhen në pistë dhe të gatshëm për nisje. Këtu bëhet ashpërsimi i përgjegjësisë për dëmin, aç sa që jepet përgjegjësi edhe për fuqinë madhore (Milosevic, 1977:189). Ndërmarrja për trafikun ajror mund të lirohet nga përgjegjësia, nëse vërteton se subjekti i dëmtuar e ka shkaktuar dëmin me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë (Dauti, 2016:181).

Për dëmin që e pësojnë udhëtarët dhe personat e tretë në komunikacionin publik ekziston sigurimi i detyrueshëm, kështu që personit të dëmtuar i është lehtësuar rruga e marrjes së dëmshpërblimit, ai mund të realizojë dëmshpërblimin ose sipas bazës së sigurimit ose sipas përgjegjësisë për dëmin nga sendet e rrezikshme, por kurrsesi të realizojë dëmshpërblimin nga të dyjat përnjëher (Dauti, 2016:181). Në grupin e sigurimit ligjor ose obligues bëjnë pjesë të gjitha llojet e sigurimit që kryhen (realizohen) vetëm në bazë të obligimit, të rregulluar me ligj (Bakraqi, 2007:289). LMD në nenin 159, paragrafi, 1,2,3 dhe 4, në lidhje me këtë lloj të përgjegjësisë parasheh ”Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotërues i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre. Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet

në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshmërisë nuk kërkojnë diç tjetër. Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht”.

4.6.3. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafshët (Damnum per animal)

Është një rast i përgjegjësisë së veçantë për sendet e rrezikshme, sepse gjatë gjithë zhvillimit të shoqërisë njeriun me kafshën e ka karakterizuar një marrëdhënie e veçantë, marrëdhënie e cila ka ndryshuar dita ditës, nga përdorimi i tyre për përfitime nga kafshët deri te dëmet që mund t’i shkaktoheshin personalitetit të njeriut apo pasurisë së tij (Mamuti, 2013:139). Edhe mundësia e shkaktimit të dëmit nga kafshët ka ndryshuar mjaft nga e kaluara, veçanërisht duke marrë për bazë rrezikun me përmasa të gjera që paraqesin me rastin e përhapjes së sëmundjeve, të cilat mund të jenë me pasoja vdekjeprurëse për njerëzimin (Mamuti, 2013:139). Me rastin e shkaktimit të dëmit nga kafshët, lindin marrëdhënie juridike në mes të subjektit përgjegjës dhe palës së dëmtuar, e cila marrëdhënie nuk ka ekzistuar para shkaktimit të dëmit (Mamuti, 2013:139). Rregullat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga kafshët, për pronarin apo ndonjë subjekt tjetër përgjegjës, krijojnë përgjegjësinë e njëjtë si për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, përkatësisht përgjegjësinë pa faj, objektive, por me një bazë edhe më të zgjeruar (Mamuti, 2013:139). Në kontekst të kësaj, e drejta anglo-sanksone kur bën fjalë për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kafsha, të njëjtën e kualifikon si përgjegjësi objektive, por me një bazë të *përgjegjësisë më të rreptë*-strict liability (Mamuti, 2013:139). Shpeshherë, ndodhë që edhe kafsha ta shkaktojë dëmin në pasurinë ose integritetin trupor të njeriut. Praktika gjyqësore, kur merren për bazë sendet e rrezikshme

dhe veprimtaritë e rrezikshme, zbaton parimin e përgjegjësisë objektive. Bazë e përgjegjësisë për pronarin apo shfrytëzuesin e sendit nuk është faji i tij, por rreziku që rezulton nga mbajtja apo përdorimi i atyre sendeve¹⁸. Përgjegjësia objektive, bazohet në ekzistimin e lidhjes kauzale midis sjelljes së njeriut dhe pasojës së krijuar (Mamuti, 2013:139).

Në të drejtën, teoria juridike dhe praktika gjyqësore nuk janë unike, se a duhet të sajohet përgjegjësia për dëmin nga kafshët në përgjegjësinë sipas bazës së fajësisë ose pafajësisë. Baza e përgjegjësisë në këtë rast nuk është unike, mirëpo dominon mendimi se edhe për dëmin e shkaktuar nga kafshët duhet përgjigjur sipas rregullave të përgjegjësisë për sendet e rrezikshme, pra të përgjegjësisë objektive (pa faj) (Milloshevic, 1977:191). Të dëmtuarit, shpesh gjatë procedimeve gjyqësore nuk i krijohet mundësia të provojë fajin e dëmtuesit, andaj sipas përgjegjësisë subjektive ai mbetet pa kompensim të dëmit të pësuar. Kjo ka bërë që përgjegjësia subjektive të konsiderohet e pamjaftueshme në procesin e realizimit të kompensimit të dëmit të shkaktuar prej kafshëve. Prandaj, vend të rëndësishëm në këto çështje zë përgjegjësia objektive, sipas të cilës për realizimin e të drejtës për kompensim të dëmit, nuk kërkohet që të vërtetohet faji i shkaktuesit të dëmit. Përgjegjësia për dëmin nga kafshët nuk mund të jetë subjektive, pse nuk kërkohen që të plotësohen të gjitha kushtet për ekzistimin e përgjegjësisë deliktore civile, sepse kafshëve u mungon aftësia për gjykim a ajo deliktore. Kodi Civil Gjerman, Austriak, e ai Francez si bazë të përgjegjësisë e parashohin fajin e supozuar, ndërsa disa kode civile bazë të përgjegjësisë e parashohin përgjegjësinë objektive p.sh. LMD dhe Kodi Civil Hungarisë (Dauti, 2016:183). KCSH për

¹⁸ Prania e një kafshe shtëpiake brenda një ambienti banimi është e lejueshme. Por, kjo nuk e pengon gjyqtarin të jap sanksione në lidhje me shqetsime të ndryshme, si për kafshët që janë të rrezikshme ose shumë të zhurmshme, psh; qen agresiv (Shih më gjerësisht, Vermelle, 2008:131)

dëmin e shkaktuar nga kafshët në nenin 621 parasheh: “Pronari i një kafshe ose ai që e përdorë atë është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç kur provon se ka pasur kontrollin e sjelljes së kafshës nga e cila është shkaktuar dëmi dhe nuk ka mundur ta mënjanojë atë”. Pra, për dëmet e shkaktuara nga kafshët mban përgjegjësi pronari i tyre, sipas nenit 621 të KCSH. Edhe LMD në nenin 163, paragrafi, 1,2 për këtë lloj përgjegjësie parasheh: “Zotëruesi i kafshës së rrezikshme është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj. Zotëruesi i kafshës shtëpiake është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç nëse provohet se zotëruesi ka treguar kujdesin dhe mbikëqyrjen e nevojshme”.

Subjekti përgjegjës ka detyrim që t’i marrë të gjitha masat për parandalimin e shkakimit të dëmit nga kafsha shtëpiake ose nga kafsha e egër, pasi pasojat e të njëjtit mund të jenë me përmasa tepër të mëdha (Mamuti, 2013:139). Në qoftë se një kafshë i jepet në përdorim me qira, huapërdorje ose në ndonjë formë tjetër juridike po të shkaktohet dëm, atëherë përgjegjësia rëndon mbi pronarin ose përdoruesin e kafshës. Edhe kjo lloj përgjegjësie është e kushtëzuar. Në qoftë se pronari apo përdoruesi arrin të provojë se i kishte marrë të gjitha masat për të pasur kafshën nën kontroll, atëherë ai shkarkohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit (Tutulani-Semini, 2006:260). Mirëpo lidhur me përgjegjësinë për veprimin e sendeve dhe për veprimin e kafshëve, jurisprudenca i ka shtrirë rregullat edhe e përgjegjësisë për veprimin e kafshëve dhe sendeve. Rregullat e tilla parashikojnë atë që quhet prezumimi i përgjegjësisë ose përgjegjësia e plotë ligjore, jo thjeshtë një prezumim faj, d.m.th. ruajtësi i sendit apo i kafshës nuk mund të shpëtojë nga përgjegjësia duke provuar se ai nuk ka kryer asnjë faj (Legier, 2008:141). Për dëmin e shkaktuar në kopshtin zoologjik përgjigjet ai që e mbikëqyrë atë ose komuna ku ndodhet kopshti zoologjik. Nëse kafsha i jepet për ta mbajtur (ruajtur) diku tjetër dhe tek ai shkaktohet dëmi, përgjigjet

shfrytëzuesi (Dauti, 2008:174). Por nëse kjo kafshë ka pasur ndonjë ves për të cilin nuk ka ditur shfrytëzuesi, për dëmin përgjigjet pronari. Kur dëmin e shkakton *kafsha e egër* në pyllin e ruajtur, për atë eventual përgjigjet ndërmarrja që merret me mbrojtjen e pyjeve, kurse jashtë pyllit të mbrojtur nuk përgjigjet askush (Dauti, 2008:174). Për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga kafsha, duhet që së pari të shkaktohet dëmi, atë ta shkaktojë kafsha si dhe të mos jetë shkaktuar nga kafsha e egër, që nuk është në pyllin e mbrojtur (Alishani, 1989:712).

Ekzistimi i dëmit, është kusht esencial (thelbësor) për këtë përgjegjësi. Në këtë aspekt nuk janë të rralla rastet, kur kafshët shkaktojnë dëm. Dëmi i tyre mund të jetë dëm material si dhe moral. Kështu është p.sh: kur dikush lëndohet, kur dikujt i dëmtohet misri, si dhe kur dikush përjeton frikë të intensitetit të caktuar (lemerisje, tmerrim, trembje e çastit) nga kafsha ose për arsye të shkaktimit të dëmit, subjekti i caktuar pëson vuajtje psikike.

6.4. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, me akte terroriste, demonstrata dhe manifestime publike

Përgjegjësia e përmendur më sipër, paraqitet si rast i veçantë i përgjegjësisë për sende dhe veprimtari të rrezikshme. Akti terrorist ekziston kur shkaktohet eksplodimi, zjarri ose aktet e dhunës, me të cilat te qytetarët shkaktohet pasiguria personale, aktet e tilla janë edhe vepra penale (Dauti, 2016:185). LMD në Nenin 161 këtë përgjegjësi, shprehimisht e parasheh në këtë mënyrë: "Shteti ose personi që është dashur ta parandalojë këtë sipas dispozitave në fuqi, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga vdekja ose lëndimi fizik si rezultat i akteve

të terrorizmit ose gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike”. Po ashtu edhe në nenin 162 të LMD-së thuhet se, “Organizatori i tubimit të një numri të madh njerëzish në ambiente të mbyllura apo të hapura, përgjigjet për dëmin e krijuar me vdekjen ose me lëndimin trupor që pëson dikush, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme që mund të krijohen në situatat e tilla, siç janë lëkundja e masës, çrregullimet e përgjithshme”. Sipas këtyre dispozitave të LMD-së, për dëmin e shkaktuar në këtë rast përgjigjet organizuesi i manifestimit publik. Si organizues të manifestimeve mund të jenë, klubet sportive, shoqatat e ndryshme amatore dhe muzikore, ku me këtë rast mund të ndodhin shtyrje, ndrydhje të njerëzve për shkak të masës së madhe të njerëzve të tubuar. Kjo përgjegjësi konsiderohet si lëshim i organizuesit, për mosndërmarrjen e masave për organizimin e manifestimit. Këtu, baza e përgjegjësisë për dëmin është objektive, sepse masa e tubuar paraqet rrezik të caktuar për rrethin e caktuar. I dëmtuari ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit nga organizuesi, në qoftë se atij i shkaktohet dëmi në integritetin e tij trupor. Dëmi duhet të shkaktohet në vendin ku janë tubuar njerëzit, tubimi duhet të organizohet nga organizuesi, duhet të shkaktohet rrethana e jashtëzakonshme p.sh. në fushë të sportit ose në stadiumin me kapacitet për 5 mijë shikues e organizuesi i lejon të hyjnë në stadium 10 mijë shikues me qëllim të fitimit më të madh (Dauti, 2016:186). Kështu tek i dëmtuari, duhet të shkaktohet lëndimi trupor ose vdekja në këtë rast, si dhe dëmi duhet të shkaktohet në atë vend ku është organizuar tubimi, ose në rrethin e atij organizimi (Alishani, 1989:719).

4.6.5. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar për shkak të mos ofrimit të ndihmës së nevojshme

Gjatë gjithë jetës së tyre, njerëzit duhet të sillen me korrektësi ndaj njëri tjetrit, duke ofruar ndihmën e nevojshme personave tjerë kur të jenë në nevojë apo për shkak të situatës emergjente që krijohet. Nga kjo ndjenjë, duhet të udhëhiqen vazhdimisht, duke ndërtuar raportet shoqërore mbi bazën e parimit të solidaritetit dhe humanitetit (Mamuti, 2013:109). Ndihma që mund t’u jepet personave të caktuar, mund të jetë e natyrave të ndryshme, por si më të shpeshta, paraqiten situatat në aksidentet automobilistike apo të fatkeqësive natyrore (Mamuti, 2013:109). Ndihma e parë për personin e lënduar në aksidentin automobilistik, nënkupton marrjen e masave dhe veprimeve tjera nga çdo person, me qëllim të ruajtjes së jetës të personit të lënduar, për të mbrojtur lëndimin e mëtejshëm, për t’ia zvogëluar dhimbjen dhe frikën, të pengohen komplikimet eventuale dhe të përmirësohet gjendja e përgjithshme e të lënduarit (Mamuti, 2013:109). Një përgjegjësi e këtillë për ofrim të ndihmës dhe trajtim solidar të personit, parashihet edhe në “Deklaratën e Tirolit për praktikim më të mirë të sporteve malore”, në të cilën thuhet, “Ndaj secilit që do ta takojmë në mal apo në ndonjë shkëmb, jemi të detyruar ta trajtojmë me respekt dhe nuk duhet të harrojmë se, duhet të reagojmë në mënyrë të drejtë në situata të paparashikueshme të fatkeqësisë serioze dhe të vdekjes. Secili pjesëmarrës, detyrimisht duhet të jetë i përgatitur për t’i ndihmuar të tjerët të tjerët në raste të fatkeqësisë, njëkohësisht, të jetë i përgatitur për t’u ballafaquar me pasojat e tragjedisë” (Deklarata e Tirolit për Praktikim më të mirë të Sporteve Malore”, miratuar në Konferencën për të ardhmen e sporteve malore, në Insbruk më 6-8 shtator 2002). Po sipas kësaj deklarate, të ndihmosh dikë, i cili është në telashe,

patjetër që duhet të ketë përparësi absolute në raport me arritjen e qëllimeve personale, të shpëtuarit e jetës apo zbutja e dhembjeve të partnerit të lënduar apo anëtarit të grupit, është pakrahasimisht më e vlefshme se sa ngjitja në ndonjë majë (Mamuti, 2013:110). Andaj detyrë e çdo njeriu është të ofrojë ndihmë, e cila është e domosdoshme për jetën dhe shëndetin e subjektit të rrezikuar. Dhënia e ndihmës në këto raste është edhe detyrë humane e domosdoshme (Dauti, 2016:186). Kjo d.m.th. se, njeriu sipas mundësive normale duhet t'i ofrojë ndihmë tjetrit, pra, dikujt që ka nevojë për atë, p.sh: personit të lënduar, njeriut të humbur, foshnjës së lënë nga nëna etj. Këto dhe raste të tjera sa janë morale aq janë edhe juridike në çdo shoqëri. Edhe LMD në Nenin 166, parag. 1, 2 e ka paraparë këtë lloj të përgjegjësisë. Pra, aty thuhet: "Kush pa pasur rrezik për vete e refuzon dhënien e ndihmës personit jeta ose shëndeti i të cilit janë rrezikuar, haptazi përgjigjet për dëmin që ka lindur nga kjo në qoftë se ai këtë dëm sipas rrethanave të rastit është dashur ta parashikonte. Në qoftë se e lyp drejtshmëria, gjykata mund ta ketë parasysh masën e shpërblimit të dëmit". Nga interpretimi i këtyre dipozitave të LMD-së mund të themi se në këtë rast të përgjegjësisë bazë juridike është lëshimi (omissio) i dëmtuesit. Përgjegjësia e tij është objektive, sepse ai nuk ka marrë pjesë në shkaktimin e dëmit, e as që i ka shkaktuar dëm subjektit të rrezikuar. Nëse gjykata vlerëson se veprimi i tij do të jetë në kundërshtim me rregullat e drejtësisë, do ta lirojë nga përgjegjësia. Andaj që të ekzistojë kjo përgjegjësi, duhet të plotësohen këto kushte: a) dëmi të shkaktohet si pasojë e mosfrimit të ndihmës, b) personit të rrezikuar t'i rrezikohet jeta ose shëndeti dhe c) ndihma të mund të ofrohet pa ndonjë rrezik për vete (Dauti, 2016:187).

4.6.6. Përgjegjësia lidhur me kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm

Disa veprimtari ekonomike duhet të kryhen me rregull dhe në mënyrë të pandërprerë, sepse janë me rëndësi për funksionimin e jetës së përgjithshme shoqërore, prandaj edhe quhen kompani të karakterit publik (Dauti, 2008:178). Për këtë arsye LMD, në nenin 168 ka paraparë që, “Organizatrat që ushtrojnë veprimtari komunale ose ndonjë veprimtari tjetër të ngjashme me interes publik përgjigjen për dëmin, në qoftë se pa shkak të arsyeshëm ndërpresin ose kryejnë jo me rregull shërbimin e tyre”. Organizatat e tilla janë, organizata që merren me mirëmbajtjen e rrugëve publike, ndërtesave të banimit, organizatat që furnizojnë me ujë, me energji elektrike etj. Te organizatat që i kryejnë këto veprimtari për të ekzistuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, duhet që së pari të shkaktohet dëmi, që ai të shkaktohet nga ndërprerja e pa arsyeshme e kryerjes së shërbimit dhe kur organizata refuzon t’i kryejë këto shërbime (Dauti, 2016:187). Me plotësimin e këtyre kushteve ndërmarrjet e ndryshme që kryejnë punë me interes të përgjithshëm, përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Pasojat e sjelljes së tillë janë të shumta dhe të rënda, sepse nga kryerja e këtyre veprimtarive varet prodhimtaria, jeta e njeriut bashkëkohor, shëndeti i tij dhe mbarë zhvillimi i shoqërisë në përgjithësi.

4.6.7. Përfundim

Përgjegjësia civile subjektive e cila bazohej në fajin e shkaktuesit të dëmit, me kalimin e kohës dhe me zhvillimin teknologjik u dëshmuar se ishte shumë e ngushtë për rregullimin e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreziqet nga shkaktimi i dëmit janë

gjithnjë e më të mëdha. Po ashtu gjithnjë e më vështirë u bë që të përcaktohej faji i dikujt për shkaktimin e tij. Prandaj lindi nevoja për krijimin e përgjegjësisë objektive civile për dëmin e shkaktuar, e cila ndryshe njihet me emrin si përgjegjësi civile pa faj.

Nga mendimet e sipërpërmendura në këtë kapitull u pa se, baza e përgjegjësisë juridiko civile u zgjerua në rrezikun e krijuar nga përdorimi i sendeve të rrezikshme dhe ushtrimit të veprimtarive të ndryshme jetësore.

Gjatë trajtimit të këtij lloji të përgjegjësisë civile, pamë se dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send apo nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit. Gjithashtu, nga kjo rrjedh edhe përgjegjësia objektive civile për dëmin jashtëkontraktor, e cila parashikon përgjegjësinë civile për dëmin, i cili rrjedh nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme.

Veneruam se sendi i rrezikshëm mund të jetë i luajtshëm ose i paluajtshëm, i cili nga vetë ekzistimi i tij, vetitë që ka, pozita apo përdorimi i tij, përfaqëson rrezikshmëri të shtuar për rrethin. Pra, i duhet kushtuar vëmendje e posaçme, veçanërisht me rastin e përdorimit.

Gjithashtu, nga shpjegimi që u bë në këtë kapitull lidhur për trajtimin e përgjegjësisë objektive civile të dëmi jashtëkontraktor, pamë se ekziston edhe veprimtaria e rrezikshme e cila është një veprimtari e caktuar, ushtrimi i së cilës në kushte normale, për nga mënyra e ushtrimit, paraqet rrezikshmëri për shëndetin dhe pasurinë, për të cilën arsye personi që ushtron atë veprimtari duhet pasur kujdes të shtuar. Prandaj edhe për dëmin e shkaktuar, a për dëmin nga sendet ose veprimtaritë nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmit për rrethin,

ku shkaktuesi i tij përgjigjet pavarësisht nga faji, pra në bazë të përgjegjësisë pa faj (objektive).

Gjithashtu, u vërejt se edhe në rast ekzistimi të përgjegjësisë objektive për dëmin, duhet me doemos të ekzistojë lidhja shkakësore ndërmjet veprimit dhe dëmit të shkaktuar. Nëse kjo lidhje nuk ekziston, nuk ka as përgjegjësi për dëmin.

Sipas dispozitave ligjore të trajtuara në këtë kapitull pamë se, dëmi i shkaktuar në lidhje me sendin e rrezikshëm ose me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedhë nga ai send, a nga ajo veprimtari, përveç nëse argumentohet se ato nuk kanë qenë shkaktare të dëmit. Kjo do të thotë se për dëmin e shkaktuar nga sendi ose veprimtaria e rrezikshme, supozohet se ai rrjedhë nga ai send ose veprimtari e rrezikshme. Pra, supozohet shkakësia ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe sendit, përkatësisht veprimtarisë së rrezikshme. Ky prezumim do të qëndrojë derisa nuk argumentohet se ato nuk kanë qenë shkak të atij.

Gjithashtu, u shtrua edhe pyetja se mbi kë bie barra e të provuarit?

Duke pasur parasysh faktin se për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i tij, ndërsa për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të, barra e të provuarit do të bijë mbi zotëruesin e sendit, përkatësisht mbi personin që merret me veprimtarinë e rrezikshme.

KAPITULLI V: KRITERET DHE KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR EKZISTIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE PËR VEPRIMET E TJETRIT TE DËMI JASHTËKONTRAKTOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

5.1. Shqyrtime të përgjithshme

Përveç përgjegjësisë subjektive (përgjegjësisë sipas fajit) dhe përgjegjësisë objektive (përgjegjësisë pa faj), ekziston edhe përgjegjësia juridiko-civile për veprimet e tjetrit a personave të tretë (përgjegjësia sipas fajit të supozuar). Edhe kjo përgjegjësi deliktore civile, është një lloj i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, është lloji i tretë i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Ky lloj i përgjegjësisë është krijuar në interes të subjektit të dëmtuar që t'i ofrohet mbrojtje më e mirë ndaj shkaktuesit të dëmit, i cili zakonisht nuk ka mjete që të bëjë shpërblimin e dëmit (Dauti, 2016:188). Te kjo përgjegjësi nuk përgjigjet ai që ka shkaktuar dëm, por dikush tjetër që nuk e ka shkaktuar këtë dëm. Pra, kjo përgjegjësi është krijuar në interes të personit të dëmtuar me qëllim që t'i ofrohet mbrojtja më e mirë këtij personi nga shkaktuesi i dëmit, i cili nuk ka mundësi që të kompensojë dëmin e shkaktuar (Morina, S, 2016:216). Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me dy persona të ndryshëm: njëri që shkakton dëmin dhe tjetri që përgjigjet. Në jetën praktike kjo lloj përgjegjësie ndeshet më tepër në rastet që rrjedhin nga marrëdhëniet prindërore, të kujdestarisë e të punës. Në përgjegjësinë për tjetrin kemi ose një shkaktues të dëmit dhe vetëm një person që ka përgjegjësinë për shpërblimin e tij, ose dy persona përgjegjës: në rastin e fundit është shkaktuesi i dëmit dhe më pas personi që përgjigjet për të (Gjata, 2010:64).

Në të drejtën e detyrimeve ekziston rregull e përgjithshme sipas së cilës, çdokush është përgjegjës për veprimet e veta dëmtuese lidhur me shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj personit tjetër. Pra, kush i shkakton dëm tjetrit, ai është i detyruar t'ia shpërblejë atë (neni 136 i LMD). Përgjegjësia për tjetrin në literaturë e në legjislacione të ndryshme, është quajtur edhe përgjegjësi e tërthortë. Kjo lloj përgjegjësie përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm se, kushdo përgjigjet për veprimet e veta. Prandaj, kjo përgjegjësi parashikohet shprehimisht në ligj. Në të gjitha rastet ndërmjet personit përgjegjës dhe dëmtuesit ekziston një marrëdhënie e posaçme juridike, siç janë marrëdhënia prind–fëmijë, kujdestari dhe i pazoti për të vepruar, mësues – nxënës, punëdhënës – punëmarrës, person juridik ose institucion shtetëror dhe organet e tij, etj (Galgano, 1999:363). Mirëpo me qëllim të sigurisë juridike të personit të dëmtuar që t'i shpërblehet dëmi i shkaktuar, nga kjo rregull ligji ka parashikuar përjashtime, kur për të nuk përgjigjet shkaktuesi i dëmit, por personi tjetër, siç është rasti me përgjegjësinë e prindit, përkatësisht kujdestarit për dëmin e shkaktuar nga ana e fëmijës së moshës jomadhore ose personit ndaj të cilit i'u ka besuar kujdesi dhe mbikëqyrja, si dhe në rast të përgjegjësisë së ndërmarrjes, përkatësisht të personit tjetër juridik për dëmin e shkaktuar nga punëtori i tij (DPPJ, 2015:512).

Te ky lloj i përgjegjësisë dallohet shkaktuesi i dëmit (dëmtuesi) nga personi përgjegjës, përkatësisht nga personat që janë përgjegjës për të paguar dëmin e shkaktuar. Qysh në të drejtën romake, kanë qenë të njohura disa raste të përgjegjësisë për të tjerët, si p.sh: i ati ishte përgjegjës për dëmin të cilin do t'ia shkaktonte tjetrit i mituri (Morina, S, 2016:216). Më vonë janë zhvilluar edhe rastet e tjera të përgjegjësisë për të tjerët, si përgjegjësia e shtetit për nëpunësit e vet, përgjegjësia e personave juridikë për organet e veta etj

(Milosevic, 1977:170). Që të përgjigjet tjetri për dëmin e shkaktuar, kjo përgjegjësi duhet të rrjedhë nga e drejta objektive. Ky subjekt që përgjigjet për dëmin e tjetrit, zakonisht është në lidhshmëri juridike me dëmtuesin. Kjo lidhshmëri juridike ekziston sepse përgjegjësi është prind i dëmtuesit, kujdestar, organ i kujdestarisë për të mbrojturin, organ i personit juridik apo nëse është punëtor i punëdhënësit (Morina, S, 2016:217). Te përgjegjësia për veprimet e tjetrit, bazë e përgjegjësisë është faji i supozuar. Derisa përgjegjësia subjektive bazohej në fajin e argumentuar, te përgjegjësia për veprimet e tjetrit, personi i dëmtuar është i liruar nga barra e vërtetimit të fajit të personit përgjegjës, sepse faji i tij supozohet. Mirëpo, ky supozim në disa raste të përgjegjësisë për veprimet e tjetrit, merret si relativ e në disa raste si absolut (Millosevic, 1977:170). Pra, nga kjo rrjedh se ky faj në disa raste, është relativ që d.m.th se, subjekti përgjegjës ka mundësi që me prova të kundërta ta provojë pafajësinë e vet, kurse në disa raste ai është me karakter absolut, që d.m.th se subjekti përgjegjës nuk mund ta provojë se, nuk është fajtorë për dëmin e shkaktuar nga një subjekt tjetër (Morina, S, 2016:217). Arsyeja kryesore e përgjegjësisë për të tjerët, mbështetet në mungesën e mbikëqyrjes së nevojshme të disa subjekteve-*culpa in inspeciendo*, në atë të instruksioneve (udhëzimeve) të nevojshme-*culpa in instruendo*, dhe në zgjedhjen e gabueshme të bashkëpunëtorit tjetër ose të punëtorit-*culpa in eligendo* (Dauti, 2008:183). Përkitazi për këto, që të ekzistojë përgjegjësia për të tjerët të kemi parasysh këto kushte që duhet plotësuar: a) duhet që të shkaktohet dëmi, b) duhet që dëmin ta shkaktojë personi që është në lidhje të veçantë juridike me personin përgjegjës, c) duhet të ekzistojë lidhja kauzale midis veprimit që është ndërmarrë dhe dëmit të shkaktuar dhe d) dëmi duhet që të shkaktohet nga lëshimet e personit përgjegjës.

Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, sepse pa plotësimin e kushteve të lartëpërmendura nuk mund të bisedohet për këtë lloj të përgjegjësisë (Morina, S, 2016:217). Nga ajo që u tha më sipër për përgjegjësinë për tjetrin, në përgjithësi mund të jepet ky përkufizim: “Përgjegjësia për tjetrin është detyrimi i disa subjekteve të shpërblejnë dëmin e shkaktuar nga një ose disa subjekte të tjerë, me të cilët janë në marrëdhënie të caktuara”. Një përgjegjësi të tillë e ka diktuar nevoja e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të të dëmtuarit, pasi në të kundërtën i dëmtuari do të mbetej pa u zhdëmtuar, siç janë rastet kur dëmi shkaktohet nga të miturit nën 14 vjeç dhe personat të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar, ose nga personat e tjerë të parashikuar në ligj (Gjata, 2010:64).

5.2. Analizë e rasteve të përgjegjësisë juridiko civile për veprimet e tjetrit

Ekzistojnë raste të ndryshme të përgjegjësisë juridiko civile për veprimet e tjetrit, por ne në vazhdim do t’i analizojmë këto raste:

- a) përgjegjësinë e prindërve për fëmijë;
- b) përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga personat nën mbikëqyrje.
- c) përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të punësuarit
- d) përgjegjësia e organizatës biznesore për punëtorët e vet dhe
- e) përgjegjësia e personit juridik për organet e veta

5.2.1. Përgjegjësia juridiko civile e prindërve për fëmijë

Marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, janë marrëdhënie shumë të veçanta dhe të rëndësishme. Të qenit prind krijon jo vetëm shumë kënaqësi, por edhe shumë përgjegjësi. Prandaj përgjegjësia e prindërve për fëmijët e mitur, është një rast i përgjegjësisë për të tjerët. Ky lloj i përgjegjësisë, është i njohur në të gjitha të drejtat (Morina, S, 2016:217). Përgjegjësitë e prindërve për fëmijët e tyre janë përgjegjësi ligjore, sepse prindi është personi që i falë fëmijës jetën dhe kujdeset për ta ruajtur atë. Ata përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre për shkak të pozitës së veçantë, të cilën e kanë ndaj tyre. Prindërit përgjigjen për të miturit, sepse ata janë fëmijët e tyre, kujdesen për ta dhe ndikojnë në sjelljen, arsimimin dhe edukimin e tyre (Morina, S, 2016:217). Po ashtu, prindërit kujdesen edhe për shëndetin dhe mbrojtjen e tyre. Prindërit i ushtrojnë të drejtat prindërore me marrëveshje. Në ushtrimin e tyre janë plotësisht të barabartë, d.m.th. kanë të drejta, detyra dhe përgjegjësi të njëjta (Podvorica, 2006:176). Kjo mund të shihet më së miri edhe nga dispozita e Nenit 18 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve e cila thekson se, “dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkëta për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe interesat e fëmijëve paraqesin brengë themelore të tyre”. Por të drejtat dhe detyrat prindërore, nuk janë të përhershme. Ato mbarojnë kur fëmija mbush moshën madhore, kur bëhet i aftë të kujdeset për vete, për të drejtat dhe për interesat e veta (Podvorica, 2006:178). Prindërit janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre deri në moshën shtatëvjeçare, pavarësisht nga atësia. Nga kjo përgjegjësi mund të lirohen vetëm nëse provojnë se ekzistojnë arsye për përjashtimin e përgjegjësisë sipas rregullave për përgjegjësinë, pavarësisht nga faji (DPPJ, 2015:513).

Për të ekzistuar përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre, duhet të përmbushen këto kushte:

- ekzistimi i dëmit;
- dëmi të jetë shkaktuar nga fëmija i mitur;
- në momentin e shkaktimit të dëmit fëmija i mitur të ketë jetuar së bashku me prindin, përkatësisht fëmija të mos jetë nën mbikëqyrjen e një personi tjetër (DPPJ, 2015:513).

LMD, përgjegjësinë e prindërve për fëmijë e parasheh shprehimisht në Nenin 147, ku thekson: “Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkakton tjetrit fëmija i tyre deri në moshën shtatë vjeçare, pavarësisht nga faji i tij. Ata lirohen nga përgjegjësia, në qoftë se ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e përgjegjësise sipas rregullave për përgjegjësinë, pavarësisht nga faji. Ata nuk përgjigjen, në qoftë se dëmi është krijuar gjersa fëmija i është besuar personit tjetër dhe në qoftë se ky person është përgjegjës për dëmin. Prindërit përgjigjen për dëmin që i shkakton tjetrit, kur fëmija i mitur i tyre t’u ketë mbushur moshën shtatë vjeç, përveç në qoftë se provojnë se dëmi është krijuar pa fajin e tyre”. Për dëmin që shkaktojnë fëmijët e mitur, përgjigjen prindërit. Në disa raste prindërit përgjigjen në mënyrë solidare. Kështu në Nenin 148 të LMD-së thuhet: “Në qoftë se përveç prindërve përgjigjet për dëmin edhe fëmija, përgjegjësia e tyre është solidare”.

Detyra e edukimit dhe e kujdesit për persona të mitur u përket të dy prindërve, prandaj në rastin e shkaktimit të dëmit nga i mituri, për të do të përgjigjen të dy prindërit. Përgjegjësia e tyre është solidare, sepse personi i dëmtuar mund t’i drejtohet me kërkesë për dëmshpërblim çdonjërit nga të dy prindërit (Morina, S, 2016:218). Përgjegjësia e prindërve

do të ekzistonte vetëm në atë rast, nëse i mituri do të jetonte me ta. Në rast të shkurorëzimit, personat e mitur i besohen njërit prind, kështu që për dëm do të përgjigjej vetëm prindi, tek i cili jeton fëmija dhe për të cilin do të kujdesej ai. Në rast se, prindërit jetojnë faktikisht ndaras, do të përgjigjej vetëm ai prind, tek i cili i mituri ka jetuar kur është shkaktuar dëmi (Millosevic, 1977:171). Kur edukimi dhe kujdesi i të miturit do t'i besohej personit tjetër me vendimin e organit të kujdestarisë, në atë rast për dëmin që ka shkaktuar ai, do të përgjigjej kujdestari i tij nën kushte të njëjta në të cilat përgjigjen edhe prindërit për të miturin, kurse nëse detyrën e kujdestarisë e kryen drejtëpërdrejtë organi i kujdestarisë, ai do të përgjigjej për veprimet e dëmshme të të miturit, ashtu si vetë prindërit (Milosevic, 1977:171). Një situatë tjetër ekziston edhe në rastin kur prindërit do t'i a besonin kujdesin për personin e mitur ndonjë personi, i cili nuk do të emërohej si kujdestar ligjor (p.sh. prindërve të vet). Në këtë rast ekziston vetëm kujdestari faktik, i cili nuk mund të përgjigjet në vend të prindërve të vet. Pra, ai do të përgjigjej për dëmin, të cilin e ka shkaktuar i mituri, nëse do të vërtetohej faji i tij (Milosevic, 1977:144). Mirëpo ka situata e rrethana, kur prindërit do të përgjigjen për dëmin të cilin e kanë shkaktuar fëmijët e tyre, edhe pse ata nuk e kanë rolin a detyrën e kujdestarisë ndaj tyre, pra atëherë kur kujdestari është i emëruar me ligj (Morina, S, 2016:217). Pasojat për këtë lloj përgjegjësie i bartë prindi për shkak të edukimit të keq të më hershëm, pra të kohës kur fëmija jetonte me prindërit edukatorë të këqij, duke mbëltuar në ta vese dhe energji negative. Andaj, kur kërkohet përgjegjësia në rastet e këtilla hulumtohet shkak (frymëzuesi), ku me këtë rast janë prindërit me të cilët fëmijët e kanë kaluar pjesën më të gjatë të jetës, ndërkaq kujdestari i ri nuk ka pasur kohë as mundësi që ta zëvendësojë edukimin e keq me një edukim qytetërues (Morina, S, 2016:218).

LMD në nenin 150, një situatë të tillë e njeh si përgjegjësi të veçantë të prindërve dhe e ka rregulluar në këtë mënyrë: “Në qoftë se detyra e mbikëqyrjes mbi personin e mitur nuk bie mbi prindërit, por mbi ndonjë person tjetër, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin nga prindërit kur dëmi është krijuar për shkak të edukatës së keqe të të miturit, shembujve të këqij ose të shprehive familjare të cilat ia kanë dhënë prindërit ose kur edhe ashtu dëmi mund t’i dedikohej fajit të prindërve. Personi në të cilin në këtë rast bie përgjegjësi e mbikëqyrjes, ka të drejtë të kërkojë nga prindërit që t’ia shpërblejnë shumën e paguar, në qoftë se ai ia ka paguar shpërblimin dëmtuesit”. Te përgjegjësia e të miturve, edhe pse është rregull që për veprimet e dëmshme të personave të tillë të përgjigjen prindërit e tyre, shtrohet pyetja se a mund të përgjigjen vetë personat e mitur për veprimet e dëmshme të tyre (Morina, S, 2016:218). Kjo çështje është e rregulluar edhe me dispozita të LMD-së, neni 142 parag, 1, 2, 3, ku theksohet: “I mituri deri në moshën shtatë vjeç nuk përgjigjet për dëmin të cilin e shkakton. I mituri prej moshës shtatë vjeç deri në moshën 14 vjeç nuk përgjigjet për dëmin, përveç në qoftë se provohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i zoti për të gjykuar. I mituri mbasi t’i ketë mbushur 14 vjet përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme mbi përgjegjësinë e dëmit”. Pra, i mituri prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare përgjigjet për dëmin e shkaktuar, sepse merret se ai në këtë kohë të zhvillimit mund t’i kuptojë veprimet e veta. Mirëpo prindërit ende mbeten përgjegjës gjer në moshën madhore të tyre, sepse zakonisht këta nuk kanë pasuri, ende janë nën ndikimin e prindërve, por edhe nga fakti se ekziston interesi i të dëmtuarit që prindërit të përgjigjen për atë dëm (Morina, S, 2016:218). Pra, kur dëmin e shkakton fëmija prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, baza e përgjegjësisë është sipas fajit të supozuar.

Për të ekzistuar përgjegjësia e prindërve për dëmin që e shkaktojnë fëmijët e tyre duhet që dëmin ta ketë shkaktuar personi i mitur dhe që ai të jetojë përherë me prindërit, apo ata të kujdesen për të ose të jetojë me njërin prej tyre (Morina, S, 2016:218). Kushti që dëmi duhet të jetë shkaktuar, është kusht i përgjithshëm i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar në të gjitha llojet e përgjegjësisë. Për këtë arsye, këtë kusht të përgjegjësisë, duhet theksuar si kusht themelor, sepse nuk mund të ekzistojë asnjë përgjegjësi pa ekzistimin e dëmit. Gjithashtu, kushti tjetër është se fëmija i mitur duhet të jetojë me të dy prindërit ose me njërin prej tyre. Në rastin e parë prindërit përgjigjen në mënyrë solidare për dëmin që e bën fëmija i tyre, kurse në rastin e dytë për dëmin përgjigjet prindi te kush gjendet fëmija ose kujt i është besuar fëmija me vendim të gjykatës (Alishani, 1989:665).

Në fund mund të konkludojmë se, te përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmijet e tyre, zbatohen rregullat e përgjegjësisë për të tjerët, mirëpo kjo nuk e përjashton edhe mundësinë e zbatimit të rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Prindërit ose prindi përgjigjen për dëmin e shkaktuar, sepse nuk kanë bërë mbikëqyrje të duhur ose nuk e kanë ngritur te fëmijët nivelin e edukimit në frymën e një qenieje shoqërore, dhe i kanë mësuar me shembuj të këqij. Te kjo përgjegjësi zbatohen si rregullat e bazës së përgjegjësisë subjektive, ashtu edhe rregullat e bazës së përgjegjësisë objektive (Morina, S, 2016:219).

5.2.2. Përgjegjësia e personit tjetër për dëmin e shkaktuar nga i mituri (mbikëqyrja)

Te kjo përgjegjësi kemi të bëjmë me rastet kur i mituri i është besuar dikujt për mbikëqyrje, ose në rastet kur i mituri për arsye të caktuara gjendet nën kujdesin e dikujt tjetër. Kjo përgjegjësi, mund të manifestohet në dy pikëpamje. Pikëpamja e parë është kur kujdestari i ka shkaktuar dëm të miturit, përkatësisht pasurisë së tij, kurse pikëpamja e dytë është rasti kur i mituri i ka shkaktuar dëm personave të tretë (Morina, S, 2016:219). Të tjerët që mund të përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga i mituri janë shkollat, shoqatat, etj. Këto raste janë kur dëmi i shkaktohet të miturit derisa ai ndodhet në shkollë ose kur ai ia shkakton dëmin personit të tretë, derisa është duke vijuar në shkollë apo duke qëndruar në konvikt etj. (Alishani, 1989:666). Që kujdestari ose të tjerët të përgjigjen për dëmin e shkaktuar duhet: që dëmi të jetë shkaktuar, dëmi të jetë shkaktuar nga i mituri dhe dëmi të shkaktohet nga i mituri derisa ai, ka qenë nën mbikëqyrje ose në shkollë apo në konvikt etj.

Në KCSH (neni 615) është parashikuar edhe një përgjegjësi e posaçme: “Mësuesit dhe personat e tjerë, që kanë nën mbikëqyrje të mitur (nën 18 vjeç) ose persona që ua mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar ndaj të tjerëve nga nxënësit ose personat që janë nën mbikëqyrje, personat që mësojnë mjeshtëri ose profesion. Pra, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar ndaj të tjerëve nga nxënësit ose personat që i kanë nën mbikëqyrje, personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pran tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit”(Gjata, 2010:69). Ndryshe nga dispozitat e mëparshme që rregullojnë përgjegjësinë e prindërve, kujdestarëve dhe prindërve që u janë besuar ose kanë nën mbikëqyrje persona të

pazakontë për të vepruar, për dëmin e shkaktuar nga të miturit nën 14 vjeç dhe të pazotët për të vepruar me dispozitën e mësipërme, përgjegjësia shtrihet, posaçërisht mbi mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur, p.sh. edukatorët e kopshteve, kujdestarët e konvikteve, punonjësit e shëndetësisë, për dëmin e paligjshëm shkaktuar prej të miturve (Gjata, 2010:69). Këta përgjigjen, vetëm kur dëmi është shkaktuar gjatë mbikëqyrjes së tyre të drejtpërdrejtë. Këtu bëhet fjalë për të miturit që ndodhen në shkolla, konvikte, spitale, në ekskursion etj (Gjata, 2010:69). Për personat e tjerë, gjatë kohës që mësojnë një mjeshtëri ose profesion, (p.sh. këpucëtarë, rrobaqepës, kamerier etj), pavarësisht nga mosha (të mitur apo madhorë), kur shkaktojnë një dëm të paligjshëm, për dëmin përgjigjen ata që i kanë pasur nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë. Përfshihen nga përgjegjësia vetëm kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit. P.sh. një kursant i fuqishëm i mposhtë përpjekjet e mësimit për ta ndaluar gjatë dëmtimit të sendeve të ndryshme në godinën mësimore (Gjata, 2010:69). Në këtë lëmë (fushëveprimtari), ekzistojnë raste të shumta të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga personat nën mbikëqyrje¹⁹. Prandaj, sa herë që dëmi shkaktohet nga një person i cili është lënë nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e një institucioni apo personi përgjegjës, përgjegjësi mban institucioni ose personi i ngarkuar me mbikëqyrjen .

¹⁹ Ekzistojnë raste të shumta të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga personat nën mbikëqyrje. Me qëllim të të kuptuarit të kësaj përgjegjësie do t'i marrim disa shembuj. P.sh; Një grup balerinash të vogla shkojnë të japin shfaqje jashtë shtetit. Njëra prej tyre, duke parë një dyqan, rrëzon një vitrinë dhe thyen disa sende. Atëherë, përgjegjësi për shpërblimin e dëmit mban personi që është i ngarkuar për mbikëqyrjen e tyre. Një person që është duke mësuar të vozisë makinën në një autoshkollë, gjatë praktikës mësimore përplaslet me një makinë tjetër. Në këtë rast, përgjegjësi ndaj personit të dëmtuar do të mbajë pronari i autoshkollës që është duke mbikëqyrur mësimin e praktikës. Një i sëmurë mendor del nga spitali ku mjekohet pa lejen e mjekut, ku në rrugë plagosë një kalimtar. Përgjegjësi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar mban mjekun, nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e të cilit është lënë personi i sëmurë (Tutulani-Semini, 2001:149-150).

Sipas nenit 613 paragrafi i parë të KCSH, “I mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar, nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, del qartë se kjo kategori personash nuk përgjigjen vetë për dëmin e shkaktuar nga vetë ata, pasi mungon elementi faj. Fajtorë mund të jenë vetëm personat që kanë zotësi për të vepruar. Në paragrafin e dytë të nenit të mësipërm, janë përcaktuar subjektet që përgjigjen për dëmin e shkaktuar nga të miturit nën 14 vjeç dhe ata që u është hequr zotësia për të vepruar (personat që për shkak të sëmundjes psikike ose zhvillimit mendor të metë, janë të pazotë të kujdesen për punët e tyre (neni 10 i KCSH). Këta janë prindërit, kujdestarë ose ata të cilëve u janë besuar, ose që i kanë në mbikëqyrje e me të cilët banojnë (Gjata, 2010:65). Kjo përgjegjësi e pakushtëzuar e prindërve, kujdestarëve ose atyre që i’u janë besuar ose i kanë nën mbikëqyrje bazohet jo vetëm në fajin e prezumuar të tyre, por edhe në përgjegjësinë objektive, kështu që i dëmtuari nuk është i detyruar të provojë fajësinë e tyre (Gjata, 2010:65). Kur prindërit janë të divorcuar, përgjigjet ai prind të cilit i janë besuar fëmijët për rritje dhe edukim. Në veçanti prindërit dhe kujdestarët përgjigjen për të miturit në fjalë, si për mungesën e edukimit të nevojshëm, ashtu edhe të mos ushtrimit të kontrollit, ndërsa ata që i kanë pasur nën mbikëqyrje kur kanë bashkëjetuar me të miturit ose të pazotët për të vepruar (p.sh. vëllai, motra e tjerë, të caktuar kujdestarë), përgjigjen për ta, ashtu si prindërit dhe kujdestarët. Mirëpo, për dallim nga legjislacioni i mëparshëm në Republikën e Shqipërisë, prezumimi i përgjegjësisë së tyre nuk është absolut (i parrëzueshëm), që do të thotë se prindërit, kujdestarët e ata “që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë”, do të lirohen nga përgjegjësia “kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit”. (Fjalja e fundit e dispozitës së mësipërme) (Gjata, 2010:65). Kjo do të thotë se mund të provojnë, se në ushtrimin e

mbikëqyrjes kanë treguar gjithë kujdesin e nevojshëm e si rrjedhojë ndalimi i shkaktimit të dëmit ishte tej mundësive të tyre, duke u liruar nga përgjegjësia (Gjata, 2010:66).

Në legjislacionin e mëparshëm shqiptar, qoftë në LVJD, neni 475 paragrafi i parë, qoftë në Kodin Civil të vitit 1981, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Janar 1982 (neni 338 paragrafi i parë), është pranuar prezumimi absolut i përgjegjësisë së prindërve e kujdestarëve, këtu që këta nuk mund të provonin të kundërtën për vete (Gjata, 2010:66). Përgjegjësia e tyre praktikisht nuk dallon nga përgjegjësia objektive, që do të thotë se mund të lirohen nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, vetëm po të provojnë se dëmi ka ardhur për shkak të një rasti fator (rasti madhor), ose vetëm për fajin e të dëmtuarit apo të një personi të tretë, prindërit kanë vuajtur nga sëmundja e gjatë dhe e rëndë etj. Kjo çështje praktike zgjidhet rast pas rasti (Gjata, 2010:66). Për dëmin e shkaktuar nga fëmijët nën 14 vjeç përgjigjen të dy prindërit solidarisht. Kur prindërit janë të ndarë, për dëmin përgjigjet prindi pranë të cilit ka jetuar i mituri që ka shkaktuar dëmin. Përgjegjësia e prindërve pushon kur u hiqet e drejta prindërore, kur me vendim të gjykatës fëmija merret nga prindërit dhe i lihet një personi tjetër, si p.sh. gjyshit a gjyshes, ose një institucionit publik ose privat për mbikëqyrje dhe edukim, ose kur prindërit ia kanë lënë fëmijën në mbikëqyrje një personi të tretë (Gjata, 2010:66). Në raste të tilla përgjigjen këto subjekte. Dhe përgjegjësia e tyre prezumohet ashtu si e prindërve. Edhe këta lirohen nga përgjegjësia kur provojnë se, nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit nga të miturit nën 14 vjeç ose personat që nuk kanë zotësi për të vepruar (Gjata, 2010:66). Pra, dëmin që e shkakton i mituri deri në moshën 7 vjeçare përgjigjet kujdestari ose të tjerët, pa marrë parasysh se a ka qenë i mituri fajtor. Për dëmin që e shkakton i mituri prej moshës 7 deri 18 vjeçare, baza e përgjegjësisë është sipas fajit të supozuar. Mirëpo kujdestari nuk do të përgjigjet në këtë rast, në qoftë se

provon se i mituri vërtetë e ka shkaktuar dëmin edhe pos kujdesit të duhur të tij. Edhe LMD në Nenin 149 për këtë çështje thekson: “Për dëmin të cilin i shkakton i mituri tjetrit, gjersa ndodhet në mbikëqyrjen e kujdestarit të shkollës ose të institucionit tjetër, përgjigjet kujdestari, shkolla, përkatësisht institucioni tjetër, përveç nëse provojnë se mbikëqyrjen e kanë kryer sipas mënyrës në të cilën kanë qenë të detyruar, apo se dëmi do të shkactohej edhe me kryerjen e kujdesshme të mbikëqyrjes”. Nga kjo dispozitë rrjedh se, supozimi i fajit ka karakter relativ, që d.m.th se, ekziston mundësia që kujdestari ose të tjerët ta provojnë se mbikëqyrjen e kanë bërë si duhet ose sipas rregullave që vlejnë në këtë fushë (Alishani, 1989:666). Lidhur me këtë, ndodhin raste, kur kujdestari përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga i mituri edhe në situatën kur i mituri e ka shkaktuar dëmin me fajin e vet, sepse nuk e ka ushtruar detyrën si duhet ose për arsye se me dashje ka lëshuar detyrën e kujdestarit, ndërsa nga këto dhe sjelljet tjera është shkaktuar dëmi (Morina, S, 2016:220). Ekziston edhe një rast tjetër kur thuhet se, shkolla detyrohet që gjatë kohës së mësimi të mbikëqyrë nxënësit e vet të mitur. Në rast se i mituri në këtë situatë pëson dëm gjatë orës së edukatës fizike, sepse i ka munguar mbikëqyrja e duhur, atëherë kjo përgjegjësi do të ekzistojë në qoftë se shkolla nuk mund të provojë që shkaktimin e dëmit nuk ka mundur ta pengojë. Me këtë rast shkolla së cilës i është besuar mbikëqyrja për të miturit, përgjigjet për dëmin të cilin e shkakton i mituri në rast se dështon gjatë kryerjes së detyrës së mbikëqyrjes (Morina, S, 2016:220). Në këto raste të përgjegjësisë, në qoftë se përgjigjet kujdestari, shkolla ose institucioni tjetër, që të gjithë përgjigjen sipas rregullave të përgjegjësisë për veprimet e tjetrit. Kurse nëse ndodhë që të përgjigjet vetë i mituri, ai do të përgjigjet në përkim me rregullat e përgjegjësisë subjektive (Alishani, 1989:667).

Po ashtu, vlen të theksohet edhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të miturit mbi 14 vjeç dhe personave që iu është kufizuar zotësia për të vepruar, si dhe një situatë e tillë është rregulluar në nenin 614 paragrafi i parë të KCSH, ku theksohet se: “i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, përgjigjet vetë për dëmin e shkaktuar në mënyrë të paligjshme”. Në këtë dispozitë nuk bëhet fjalë për personat që iu është kufizuar zotësia për të vepruar, por duke u bazuar në dispozitat e përgjithshme të KCSH (nenet 9-10) dhe ato të Kodit të Familjes (nenet 307-313), del qartë se këta barazohen me të miturit mbi 14 vjeç. Mirëpo mund të ndodhë që i mituri ose personi me zotësi të kufizuar të mos kenë të ardhura, ngaqë nuk janë në marrëdhënie pune dhe nuk kanë pasuri të tyre. Në raste të tilla, për ta përgjigjen prindërit ose kujdestarët, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit (Gjata, 2010:66-67). Edhe në këto raste, përgjegjësia bazohet në prezumimin e fajit të prindërve ose kujdestarëve. Këta detyrohen të provojnë se, nuk kanë mundur ta ndalojnë shkaktimin e dëmit në rrethanat e ndodhisë. Prindërit do të përgjigjen për personat që u është kufizuar (ose hequr) zotësia për të vepruar edhe pasi këta bëhen madhorë dhe me vendim të gjykatës u është zgjatur e drejta prindërore (Gjata, 2010:67). Ndërsa kur ata janë nën kujdestari të një personi fizik apo të institucionit shtetëror ose privat, ose janë vendosur në spital, për dëmin e shkaktuar prej tyre përgjigjen këto subjekte, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalojnë shkaktimin e dëmit. Pra, përgjigjen edhe pa faj (përgjegjësi objektive) (Gjata, 2010:67).

5.2.3. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar duke u ndodhur në gjendjen që nuk ishte i ndërgjegjshëm për veprimet që kryente

Legjislacioni i mëparshëm shqiptar, personin që ka shkaktuar dëmin e paligjshëm në gjendjen që nuk ishte i ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve që po kryente, sa i përket përgjegjësisë civile, e barazonte me personin të cilit i është hequr zotësia për të vepruar (Gjata, 2010:70). Kështu, sipas nenit 478 të LVJD dhe nenit 340 të KCSH-së, të vitit 1982 “Personi që nuk ka ndërgjegjen (që nuk është i vetëdijshëm) për veprimet e tij, nuk përgjigjet për dëmin që u ka shkaktuar duke u ndodhur në këtë gjendje, përveçse kur për faj të vetë e ka sjellë vetën në këtë gjendje”. Në KCSH të tanishëm, mbahet qëndrim i kundërt. Kështu, sipas nenit 616 të këtij Kodi “Për dëmin përgjigjet edhe personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka pasur ndërgjegjen e veprimeve të tij”. Këtu bëhet fjalë për personin, të cilit nuk i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar dhe është mungesa e vetëdijes kalimtare e jo e përhershme, pra ajo që e ka çuar në kryerjen e veprimit të dëmshëm kundër tjetrit. Zakonisht, në këtë gjendje kalimtare ose të përkohshme vijnë personat e prirë ndaj pijeve të forta alkoolike, ose për shkak të afektit patologjik etj (Gjata, 2010:70). Mirëpo legjislacioni shqiptar nuk bën fjalë, shprehimisht për personin që në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka vetëdijen e veprimeve që kryen, për shkak të sëmundjes psikike etj. mirëpo nuk i është hequr zotësia për të vepruar. Lind pyetja, kur një person i tillë kryen një dëm të paligjshëm, a do të barazohet me personin që i është hequr zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës (Gjata, 2010:70)? Për sa i përket veprimeve juridike, personat që nuk i është hequr zotësia për të vepruar, nuk do të quhen të pazotë për të vepruar, por persona që në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre (neni 94 shkronjat “b” dhe “c” të KCSH) (Gjata,

2010:71). Nga një interpretim i gjerë i dispozitës së nenit 613 paragrafi i parë, mund të arrihet në përfundim se personat që janë krejt të pazotë për të vepruar, duhet të përfshihen si atyre, të cilëve me vendim të gjykatës u është hequr zotësia për të vepruar, ashtu edhe atyre që vuajnë nga një sëmundje psikike ose kanë zhvillimi mendor të metë, pra nuk e kanë vetëdijen e veprimeve që kryejnë (Gjata, 2010:71). Po të mbahet qëndrim i kundërt, të mos barazohet me ata që u është hequr zotësia për të vepruar, detyrimisht do të vihen në pozitën e atyre personave që nuk vuajnë nga sëmundjet kronike dhe as që janë të metë mendërisht, por që në çastin kur kanë shkaktuar dëmin “nuk e kanë pasur ndërgjegjen e veprimeve” të tyre, të parashikuar në nenin 616 të KCSH (Gjata, 2010:71). Rrjedhimisht, do të përgjigjen për dëmin e shkaktuar edhe sikur të jenë në gjendje të degraduar mendërisht. Jo rastësisht ligjvënësi në nenin 616 ka kufizuar efektet vetëm në personat, “që në momentin që e ka shkaktuar dëmin, nuk kanë pasur ndërgjegjen e veprimeve” të tyre. Pra, i ka përjashtuar nga përgjegjësia vetëm ata që mungesa e vetëdijes për veprimet e kryera është jo momentale, por e vazhdueshme. Megjithatë, duke marrë parasysh moshën, shkallën e ndërgjegjes për veprimet e kryera, si dhe kushtet ekonomike të palëve, gjykatës i është njohur e drejta të ulë masën e dëmshpërblimit, por jo ta përjashtojë nga përgjegjësia (paragrafi i dytë i nenit 616 të KCSH) përveç kur për fajin e tij e ka sjellë vetën në këtë gjendje (Gjata, 2010:71).

Rast tjetër i ngjashëm me këtë, lidhur me përgjegjësinë për veprimet e tjetrit është edhe përgjegjësia e kujdestarit për të miturin ose e organit të kujdestarisë për dëmin e shkaktuar nga *personat tërësisht të zhveshur nga aftësia për të vepruar*. Kujdestaria është një nga format e mbrojtjes sociale sipas së cilës bashkësia shoqërore u siguron mbrojtje të veçantë

të miturve për të cilët nuk kujdesen prindërit, si dhe personave tjerë për shkak të pa aftësisë ose nga arsyet tjera nuk janë në gjendje të kujdesen vetë dhe të mbrojnë të drejtat a interesat e veta (Bicaj, 2010:347). Kujdestari përgjigjet për kryerjen e detyrave të veta, si në bazë të rregullave të së drejtës civile juridike, po ashtu edhe në bazë të dispozitave të Kodit Penal. Në çoftë se, nuk e kryen detyrën me ndershmëri dhe të kujdesurit i shkakton dëm, ai ka për detyrë që ta shpërblejë dëmin e shkaktuar. Kujdestari përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas rregullave të përgjegjësisë subjektive, që d.m.th. se ai detyrohet ta shpërblejë atë. Ai nuk do të përgjigjet vetëm nëse vërtetohet se, dëmi është shkaktuar me fajin e vet të kujdesurit (Podvorica, 2006:261). Gjithashtu, për dëmin ku personat madhorë janë të zhveshur plotësisht nga aftësia punuese që ia kanë shkaktuar tjetrit nuk do të përgjigjen. Për të përgjigjen kujdestarët e tyre, sepse personat e këtillë nuk kanë aftësi për t'i kuptuar pasojat e sjelljeve të tyre, ngase janë të pa aftë për të gjykuar. Baza e përgjegjësisë së kujdestarit për dëmin e shkaktuar nga personi i zhveshur nga aftësia punuese, është sipas fajit të supozuar (përgjegjësisë për veprimet e tjetrit). Faji i supozuar është me karakter relativ, sepse kujdestari mund të provojë se obligimin e vet e ka kryer si duhet. Duhet theksuar se kujdestaria ndaj personave me zotësi të hequr për të vepruar, dallon dukshëm nga kujdestaria për personat e mitur. I mituri vihet në kujdestari sapo të vërtetohet se ka ngelur pa kujdesin prindëror, sepse është e natyrshme që një person i moshës së njomë të mos jetë në gjendje të kujdeset për të drejtat dhe interesat e veta (Podvorica, 2006:270). Nga ana tjetër, personi me zotësi të hequr veprimi, vihet në kujdestari vetëm me vendim të formës së prerë të gjykatës për heqjen e zotësisë për të vepruar. Nga momenti i formës së prerë të vendimit, konsiderohet se personat e tillë më nuk janë të zotë që të kujdesen për veten e tyre (Podvorica, 2006:270). Është rregull

tradicionale në këtë fushë se për dëmin e shkaktuar, parimisht përgjigjen personat që kanë aftësi punuese, kurse personat që nuk kanë aftësi ata nuk përgjigjen për shkak se nuk mund t'i kuptojnë veprimet që ndërmarrin (Morina, S, 2016:221). Sipas rregullave personat që kanë mungesa mentale, atyre u merret aftësia punuese. Marrja e aftësisë së tillë, bëhet me vendim të gjykatës. Varësisht nga sëmundja që ekziston, marrja e aftësisë mund të jetë e pjesshme ose e plotë, ku për të gjitha këto vendosë gjykata me ndihmën e raportit të ekspertit gjyqësor (Morina, S, 2016:221). Personit madhor, të cilit pjesërisht i merret aftësia punuese, ka disa ingerenca të caktuara në kryerjen e punëve juridike, kurse personit madhor të cilit i merret tërësisht aftësia punuese për shkak të sëmundjes psikike, i caktohet kujdestari, dhe ky për kah aftësia punuese krahasohet me të miturit deri në moshën 7 vjeçare (Morina, S, 2016:221). Caktim të kujdestarit kemi edhe në rastin kur bëhet heqja e pjesshme e aftësisë punuese (Alishani, 1985:668). Mirëpo, përgjegjësia e kujdestarëve nuk do të ekzistonte kur do ta shkaktonte dëmin personi i zhveshur pjesërisht nga aftësia punuese, sepse kujdestari i këtillë nuk ka detyrë që të kujdeset mbi personalitetin e të mbrojturit të vet. Ai është i emëruar, që ta mbrojë pasurinë e tij dhe nuk përgjigjet për veprimet e tjera të dëmshme të tij (Morina, S, 2016:221). Personi i zhveshur pjesërisht nga aftësia punuese, do të përgjigjej vetë për dëmin që i shkakton tjetrit, nën kushtet e përgjithshme të përgjegjësisë për veprimet e veta (përgjegjësia subjektive). Kurse kujdestari i personit të cilit i është hequr zotësia në tërësi, ai kujdeset si për pasurinë e tij, ashtu edhe për sjelljet dhe personalitetin e tij (Morina, S, 2016:221). Kujdestari i personit të zhveshur plotësisht nga aftësia punuese, përgjigjet për dëmin sipas parimeve të fajit të supozuar (përgjegjësisë për veprimet e tjetrit) (Milosevic, 1977:175).

LMD në Nenin 141, parag 1,2, dhe 3, thekson se, “Personi i cili për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit të metë mendor apo të shkaqeve të tjera nuk është i aftë të gjykojë, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar përveç nëse provohet që dëmin e shkaktuar në kohën kur ka qenë i aftë për të gjykuar”. Kush i shkakton dëm tjetrit në gjendje të pa aftësisë së përkohshme për gjykim, është përgjegjës për atë, përveç nëse provon se pa fajin e tij është sjellë në një gjendje të tillë. Në qoftë se në këtë gjendje është sjellë me faj të dikujt, për dëmin do të përgjigjet ai që e ka sjellë në gjendje të tillë”. Ai mund të lirohet nga përgjegjësia, në qoftë se provon se ka kryer mbikëqyrjen për të cilën është i obliguar, ose dëmi do të shkaktohej edhe po të zhvillohej mbikëqyrja e kujdesshme. Ka situata në të cilat edhe personi i zhveshur plotësisht nga aftësia punuese, mund të përgjigjet vetë për dëmin e shkaktuar. Kjo paraqitet në rastin kur dëmi shkaktohet në çastin kur ai ka qenë i aftë për të gjykuar (*lucidum intervalum*-çasti i ndriquar). Në këtë rast i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga dëmtuesi (Dauti, 2008:185).

5.2.4. Baza e përgjegjësisë së prindërve, kujdestarëve dhe personave që u janë besuar të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar

Në teori dhe në praktikë ka lindur diskutimi për kuptimin e pamundësisë së prindërve, kujdestarëve e personave të tjerë për të ndaluar shkaktimin e dëmit. Vështirësia më e madhe është, atëherë kur kemi të bëjmë me prindërit e të miturit ose të pazotët për të vepruar. Siç dihet, në radhë të parë prindërit përgjigjen për edukimin e fëmijëve të tyre të mitur dhe kur ata kanë shkaktuar një dëm kundërligjor. Pra, ata do të përgjigjen për “mungesën e edukimit të tyre”-“*culpa in educando*” (Gjata, 2010:67). Kjo nuk do të thotë

se nuk përgjigjen për mungesën e ushtrimit të mbikëqyrjes, por duke qenë mbikëqyrja e sjelljes së fëmijëve të tyre të mitur një nga detyrat prindërore, d.m.th se është pjesë përbërëse e edukimit të tyre. Ndërsa për personat e pazotë për të vepruar, detyra kryesore e prindërve është mbikëqyrja e tyre, pasi këta janë më të prirë për të kryer veprime të pakontrolluara. Pra, për këtë përgjigjen për ushtrimin e nevojshëm të mbikëqyrjes së tyre- “*culpa in vigilando*” (Gjata, 2010:68). P.sh. prindërit do të përgjigjen, atëherë kur fëmija i tyre i vë zjarrin mullarit të sanës (barit të thatë) të fqinjit për arsye se janë fajtorë për mos edukimin e duhur të tij. Ndërsa kur i pazoti (i pa afti) për të vepruar i vë zjarrin e mullarit të tjetrit, prindërit do të përgjigjen për shkak se janë fajtorë për mos mbikëqyrjen e tij (Gjata, 2010:68). Po kështu, janë përgjegjës për ta edhe kujdestarët dhe ata që u janë besuar ose kanë nën mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar edhe fëmijët nën 14 vjeç, në kushtet e nenit 613 të KCSH dhe vetëm prindërit ose kujdestarët në kushtet e nenit 614 (Gjata, 2010:68). Kur ndodh që dëmin e paligjshëm e shkakton i mituri nën 14 vjeç duke qenë nën kujdestarinë e një personi fizik ose një institucioni, këta përgjigjen ashtu si prindërit. Por në qoftë se i mituri e ka shkaktuar dëmin për shkak të edukimit të keq, shembullit të keq të sjelljes së prindërve ose zakoneve të tyre negative që vetë i’a kanë kultivuar, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit ose nga prindi i tij ose nga kujdestari. Ky i fundit, po të ketë shpërblyer dëmin gëzon të drejtën e regresit ndaj prindërve të fëmijës, për shkak të mangësive të tyre në edukimin e fëmijës (Gjata, 2010:68).

Në legjislacionet e ndryshme, për çështjen e moshës së të miturit, nga e cila përgjigjet ky vetë, ka qëndrime të ndryshme. Në disa vende të miturit nën 7 vjeç, nuk kanë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar, ndërsa mbi këtë moshë përgjigjen vetë për dëmin. Lidhur me këtë, përgjegjësia e prindërve ose kujdestarëve është subsidiare, d.m.th. kur të miturit nuk kanë

pasuri ose të ardhura, si p.sh. legjislacioni kroat, etj. Mirëpo në shumicën e vendeve merret parasysh edhe inteligjenca e të miturit, si në Kodin Civil Gjerman, Austriak, Zvicëran etj. Legjislacioni Shqiptar nuk e ka pranuar përgjegjësinë e personit të pazotë për të vepruar, as kur dëmin e ka shkaktuar në çastet e qartësisë mendore “*lucide intervala*” (Gjata, 2010:68).

5.2.5. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të punësuarit ndaj personave të tretë

Përgjegjësia juridike civile për dëmin që shkakton punëtori nga marrëdhënia e punës ndaj personave të tretë, paraqet rast të veçantë të përgjegjësisë civile, pasi edhe në këtë rast punëdhënësi do të përgjigjet mbi bazën e rregullave të përgjegjësisë për të tjerët (Mamuti, 2013:113). Në një rast Gjykata Supreme e Kosovës në vendimin e saj AC. Nr.167/84, dt/27.11.1984 thekson se është zbatuar drejtë, e drejta materiale me rastin e detyrimit të Qendrës Mjekësore, që t’ua shpërblejë paditësve dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar me rastin e vdekjes së bashkëshortes, përkatësisht nënës së tyre, për fajin e punonjësit të kësaj Qendre²⁰. Kur punëtori i shkakton dëm personit të tretë duke kryer veprimtarinë e punëdhënësit, atëherë punëdhënësi përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Përgjegjësia e punëdhënësit për dëmin e shkaktuar personit të tretë nga punëtori duhet të ekzistojë, sepse punëdhënësi nga veprimtaria e vet ka dobi të caktuar ekonomike dhe do të jetë e drejtë që ta ketë rrezikun e dëmit eventual (Mamuti, 2013:113). Që të lindë përgjegjësia e punëdhënësit, është e nevojshme që të ekzistojë lidhja formale juridike,

²⁰ Gjykata Supreme e Kosovës vendimi, AC. Nr.167/84, dt/27.11.1984. Sipas nenit 170 të LMD, viti 1978, parashikohet përgjegjësia e organizatës punuese për dëmin të cilin punonjësi i saj ua shkakton personave të tretë (Komentari i LMD, 2013:190).

kontrata e punës për kryerjen e punëve të caktuara ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit. Pra, punëtori duhet të jetë i punësuar dhe të kryejë detyra që i janë besuar nga punëdhënësi. Kjo përgjegjësi ekziston, sepse punëdhënësi është fajtor për shkak të zgjedhjes së gabuar të punëtorit të cilit i është besuar kryerja e punëve, apo për shkak se nuk i ka mbikëqyrur si duhet punët që i'a ka besuar atij, ose për shkak se nuk i ka dhënë instruksione të duhura atij ose nuk e ka aftësuar punëtorin për atë punë (Morina, S, 2016:223). Pra, punëdhënësi duhet të kujdeset që puna të ketë karakter mbrojtës dhe të sigurt ndërsa i punësuar duhet që të kryej sa më mir punën që ka marrë përsipër (Mjeldheim & Lillejord & Solvberg, 2006:110).

Punëtori duke kryer punë të caktuara për punëdhënësin, mund të ndodhë t'u shkaktojë dëm personave të tretë. Për dëmin të cilin i'a shkakton personit të tretë punëmarrësi në punë ose lidhur me punën, përgjigjet punëdhënësi ku punëmarrësi ka punuar në momentin e shkakimit të dëmit, përveç nëse provon se ai ka vepruar ashtu siç është dashur të veprohet. P.sh. kur një pronar lokali punëson një kamarier dhe ky i fundit, duke shërbyer i derdh një gotë me pije një klienti duke i'a dëmtuar kostumin, atëherë themi se për dëmin e shkakuar nga pakujdesia e kamarierit, përgjegjësi do të mbajë pronari i lokalit që e ka marrë në punë. Kjo përgjegjësi buron nga fakti që punëdhënësi është ai që zgjedh personin që e punëson. Për këtë arsye ai duhet të marrë në punë persona të aftë dhe të kualifikuar, në të kundërtën, ai përgjigjet për dëmet që të punësuarit e tij u shkaktojnë personave tjerë²¹ (Morina I, 2010:39). Mirëpo nëse punëmarrësi e ka shkakuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia

²¹ Harrison & Michelin Tyre Co. Ltd (1985) 1 All ER 918.

ekstreme, i dëmtuari mund të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt edhe nga ai. Kjo do të thotë se, në kushte të caktuara, mund të jetë përgjegjësia solidare e punëdhënësit dhe punëmarrësit për shpërblimin e dëmit personit të tretë (DPPJ, 2015:514). Sipas të njëjtit parim, sikurse punëdhënësi edhe personat e tjerë juridik, përgjigjen për dëmin të cilin organi i tyre i'a shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij (neni 153 i LMD). Për të ekzistuar përgjegjësia e punëdhënësit ose e personave të tjerë juridik për dëmin të cilin e shkaktojnë punonjësit, përkatësisht organet e tyre në kushtet e përmendura më sipër duhet të plotësohen këto kushte:

- të jetë shkaktuar dëmi;
- dëmi të jetë shkaktuar nga punonjësi në punë ose lidhur me punën, përkatësisht gjatë ushtrimit të funksionit ose lidhur me funksionin dhe
- dëmi të mos jetë shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia ekstreme (DPPJ, 2015:514).

Me nenin 618 të KCSH, është rregulluar posaçërisht, si përgjegjësia e punëdhënësit për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, ashtu edhe përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre. Me punonjës kuptohet punëmarrësit (të punësuarit), pavarësisht nga profesioni e kualifikimi që kanë pranë punëdhënësit (Gjata, 2010:72). Për kuptimin e këtyre termave i referohemi ligjit “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare (nr. 9901, datë 14.04.2008). Ku thekson se “Për dëmin që i punësuarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe në lidhje me detyrën që i është besuar, i shkakton dëm të tretëve me fajin e tij, do të përgjigjet punëdhënësit në mënyrë të pakushtëzuar”. Në këtë dispozitë termi “punëdhënësi” i jepet kuptimi i gjerë:

mund të jetë punëdhënës një individ, një person juridik, privat ose shoqëri e përzier publiko-private (Gjata, 2010:72).

Përgjegjësia e punëdhënësit është e pakushtëzuar dhe përgjegjësia e tij presumohet, d.m.th. është fjala për kriterin e prezumimit të fajit. Atij i bije barra për të provuar se i punësuar i tij në ato rrethana ka vepruar, ashtu siç kërkohet në bazë të këtij kriteri. Barra e të provuarit do të çojë në të provuarit se, në sjelljet e të punësuarit nuk ka pasur veprime apo shmangie nga rregullat e profesionit (Gjata, 2010:72). Po të provojë këto pretendime punëdhënësi nuk do të përgjigjet, për arsye se sipas paragrafit të parë të nenit 618 përgjegjësia e tij kushtëzohet me fajin e të punësuarit të tij në shkaktimin e dëmit. Prandaj, punëdhënësi është i interesuar të provojë mungesën e fajit të punësuarit të tij, pasi në të kundërt jo vetëm që përgjigjet për shpërblimin e dëmit, por nuk përjashtohet mundësia që edhe ai vetë të ketë faj për marrjen në punë të personave të papërshtatshëm për punën “*culpa in eligendo*”, ose për shkak të mos mbikëqyrjes së duhur të veprimtarisë së tyre (*cupla in custodiendo*) (Gjata, 2010:72).

P.sh. punëtorët e pastrimit të kanaleve në një zonë të qytetit, kanë harruar të vendosin kapakun e pusëtës dhe në errësi një kalimtar bie në të dhe thyen këmbën. Në këtë rast për dëmin e shkaktuar nga pakujdesia e punonjësve (për mjekim, për humbjen përkohësisht të aftësisë për punë etj), do të përgjigjet punëdhënësi (Gjata, 2010:73). Pra, në bazë të kontratës për riparimin e automjetit, punëdhënësi përgjigjet ndaj personit të tretë edhe kur punonjësi ka vepruar tej detyrës së ngarkuar për dëmin e shkaktuar nga një punë e tillë. P.sh; punëdhënësi i ka dhënë buldozherin punëtorit, me të cilin ky ka kryer detyrën për hapjen e kanalit. Mirëpo ai gjatë punës ka hapur kanal më të gjerë se urdhri që ka marrë, duke dëmtuar kështu tokën e paditëses (Gjata, 2010:73). Edhe në raste të tilla, punëdhënësi

do të përgjigjet në bazë të nenit 618 paragrafi i parë të Kodit Civil, sepse dëmi është shkaktuar me fajin e punëtorit që është në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrës për hapjen e kanalit. Në zbatimin e kësaj dispozite shtrohet çështja: po kur punonjësi gjatë punës ose veprimtarisë së tij i ka shkaktuar dëm me dashje një personi të tretë, kush do të përgjigjet, punonjësi apo punëdhënësi, apo të dy së bashku solidarisht? (Gjata, 2010:73). Nga analiza e qëllimit dhe interpretimi i kësaj dispozite arrijmë në këtë përfundim: kur dëmi është shkaktuar me faj, në formën më të rëndë, me dashje, gjatë ushtrimit të detyrës që i është besuar, punëdhënësi nuk mund të lirohet nga përgjegjësia. Në këtë dispozitë kërkohet faji, me dashje ose nga pakujdesia, prandaj punëdhënësi do të përgjigjet për dëmin e shkaktuar (Gjata, 2010:73). Mirëpo, në praktikë ka lindur pyetja: A mund të paditet vetëm punonjësi që ka shkaktuar dëmin? Përgjigjja e dhënë ka qenë pozitive, d.m.th. mund të paditet vetëm ky, sepse ka përgjegjësi për të dyja nivelet e dashjes, asaj direkte (të drejtpërdrejtë) dhe dashjes indirekte (të tërthortë). Sipas arsyetimit të gjykatës, të dëmtuarit i takon të zgjedhë, a do të kërkojë shpërblimin vetëm nga punëdhënësi, nga dëmtuesi i punësuar, apo nga të dy subjektet. Dhe është pranuar, se po të paditen të dy së bashku, këta do të përgjigjen solidarisht si të paditur (Gjata, 2010:73-74). Në qoftë se punëdhënësi e ndryshon statusin juridik, p.sh. e bashkon punën me një punëdhënës tjetër, ose veprimtaria e tij i kalon një punëdhënës tjetër, këtij të fundit i kalojnë edhe detyrimet ndaj të tretëve, duke përfshirë këtu edhe shpërblimin e dëmit të personave të tretë. Punëdhënësi që e ka shpërblyer dëmin, ka të drejtën e regresit kundër punonjësit që ka shkaktuar dëmin me faj (Gjata, 2010:74). Mirëpo në qoftë se për urdhrat a porositë e dhëna, punëdhënësi është me faj, d.m.th., në qoftë se nga zbatimi i tyre, personit të tretë i është shkaktuar një dëm i paligjshëm nuk do të zbatohet kjo dispozitë, por dispozita që parashikon përgjegjësinë e

personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre, parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 618 të KCSH (Gjata, 2010:74).

Disa pikëpamje dhe legjislacione, duke përfshirë edhe legjislacionin e mëparshëm shqiptar, e kanë ngushtuar përgjegjësinë e punëdhënësit për dëmin e shkaktuar me faj nga punonjësit e tij në dy drejtime: së pari, kur punëdhënësi provon se punonjësi i tij e ka shkaktuar dëmin me qëllim, lirohet nga përgjegjësia dhe i dëmtuari e realizon shpërblimin e dëmit, drejtpërdrejt nga punonjësi që ka shkaktuar dëmin. Ky rregullim i heq të dëmtuarit mundësinë për t'iu drejtuar në çdo rast punëdhënësit (Alishani, 1989:673). Drejtimi i dytë është ndeshur me legjislacionet e disa vendeve socialiste në të kaluarën, si dhe në vendin tonë. Kështu, sipas nenit 480 paragrafi i dytë të LVJD dhe neni 341 të Kodit Civil të vitit 1982, përgjegjësia është e punëdhënësit (personit juridik ose çdo personi tjetër), për dëmin e shkaktuar me faj nga punonjësit e tij, në lidhjen me kryerjen e shërbimit të tyre, vetëm kur për fajin e vet ose të organeve të tij janë marrë në shërbim punonjës (nëpunës ose punëtorë) të papërshtatshëm, ose nuk është ushtruar mbikëqyrja e duhur mbi veprimet e tyre (Gjata, 2010:74-75). Shumica prej atyre vendeve kanë hequr dorë nga ky qëndrim dhe qoftë literatura, qoftë praktika gjyqësore, kanë pranuar se punëdhënësi ka përgjegjësi në çdo rast, në mënyrë të pakushtëzuar, mjafton që dëmi të jetë shkaktuar me faj nga punonjësi. Kjo pikëpamje, është përkrahur edhe nga literatura jonë juridike, duke i bërë kritikë me gjuhën e Ezopit, por mjaft të argumentuar legjislacionit të kohës dhe duke vënë në pah ndryshimet e bëra në vendet e tjera të lindjes (Salabanda, 1962:314-317). Mirëpo qoftë në legjislacion, qoftë në praktikën gjyqësore, është mbajtur qëndrimi i njëjt deri në fuqizimin e tij, me hyrjen në fuqi të KCSH: (1 Nëntor 1994) (Gjata, 2010:74).

Vënia si kusht për përgjegjësinë e punëdhënësit, vetëm kur me fajin e vet ka marrë në punë persona jo adekuat ose kur nuk ka bërë ushtrimin e mbikëqyrjes së duhur mbi veprimet e tyre, të dëmtuarin e bie në situata të vështira e diskriminuese. Ai e kishte shumë të vështirë, madje pothuajse të pamundur ta provonte papërshtatshmërinë e punëtorit që i kishte shkaktuar dëmin gjatë kryerjes së punës ose detyrës (Gjata, 2010:75). Aq më tepër rëndohej pozita e tij kur bëhej fjalë për mos ushtrimin e mbikëqyrjes së duhur të punonjësit-dëmtuesit nga ana e punëdhënësit, sepse i dëmtuari në të shumtën e rasteve e ka pasur të pamundur për ta provuar këtë fakt (Gjata, 2010:75). Lidhur me pikëpamjen se, kur punonjësi gjatë ushtrimit të detyrës i shkaktonte dëm me qëllim personit të tretë, punëdhënësi shkarkohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit dhe i dëmtuari mund ta realizojë shpërblimin e drejtpërdrejtë nga punonjësi dëmtues, mendojmë se nuk ka gjetur përkrahje. Madje, në legjislacionet e reja të disa vendeve ish-socialiste, jo vetëm që nuk është pranuar lirimi i punëdhënësit nga detyrimi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me qëllim nga punonjësi i tij gjatë ushtrimit të detyrës, por i është njohur e drejta të dëmtuarit që në raste të tilla të zgjedhë, duke kërkuar shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi dëmtues, ose vetëm nga punëdhënësi, ose ta kërkojë nga të dy subjektet (Gjata, 2010:76). Pra, në shumë legjislacione supozimi për fajin e punëdhënësit kuptohet në mënyra të ndryshme. Në të drejtën franceze, punëdhënësi përgjigjet sipas parimit të supozimit absolut për fajin e sipas të drejtës gjermane dhe zvicerane, ai supozim për fajin e punëdhënësit është relativ, gjë që do të thotë se punëdhënësi mund të lirohet nga përgjegjësia, nëse vërtetohet se nuk ka faj për dëmin e shkaktuar (Milosevic, 1977:177).

Në të drejtën kosovaare, baza e përgjegjësisë së punëdhënësit për dëmin e shkaktuar personit të tretë nga punëtori i tij, është rregulluar sipas rregullave të përgjegjësisë për

veprimet e tjetrit (faji i supozuar) të karakterit relativ. Kështu, LMD në Nenin 152, parag, 1, 2 dhe 3 thekson: “Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkaktimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete. Praktika gjyqësore Britanike një situatë të tillë në një rast gjyqësor e zgjidh në këtë mënyrë: E hedhë poshtë padinë e paditësit me arsyetimin se kompania nuk ka qenë e detyruar ta parashikojë këtë rrezik të mundshëm. Detyrimi i kompanisë do të mund të krijohej, nëse do të ekzistonte lidhja e kompanisë me personin që ka vepruar²² (Morina, I, 2010:38). LMD në Nenin 156 ku thekson se, “në qoftë se pronarit i është marrë sendi i rrezikshëm në mënyrë të kundërligjshme, për dëmin që rrjedh nga kjo, nuk përgjigjet ai, por ai që i’a ka marrë sendin e rrezikshëm, në qoftë se pronari nuk është përgjegjës për këtë”. Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje. Secili person që dëmshpërblen palën e dëmtuar për dëmin e shkaktuar nga punonjësi me dashje apo nga pakujdesia e rëndë ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga punonjësi”. Pra, nga kjo shihet se përveç punëdhënësit për dëmin e

²² Në lidhje me përgjegjësinë e punëdhënësit për punëtorët, është e nevojshme të analizojmë një rast nga praktika gjyqësore në UK: Topp/London Country Bus Co. ”Shoferi i autobusit ka parkuar në stacionin e autobusave në një rrugë. Ai shkon në pijetore të afërt për kafe dhe lë çelësat në prizë. Më vonë, një person tjetër e vozitë autobusin dhe gjatë udhëtimit shkakton vdekjen e një personi. Bashkëshorti i viktimës paditë kompaninë e autobusëve lidhur me kompensimin e dëmit për shkak të vdekjes së bashkëshortes. Paditësi ka argumentuar kërkesën se në kompani është dashur të dinë se, autobusi ka mbetur pa mbikëqyrje dhe ekziston rreziku permanent (i përhershëm) ku dikush mund ta marrë autobusin dhe të vozitet me të, edhe pse kompania e ka ditur për këtë nuk ka ndërmarrë masa ndëshkuese. Është vendosur (CA): Padia hedhet poshtë, me arsyetimin se kompania nuk ka qenë e detyruar ta parashikojë këtë rrezik të mundshëm. Detyrimi i kompanisë do të mund të krijohej, nëse do të ekzistonte lidhja e kompanisë me personin që ka vepruar. Një situatë të tillë në mënyrë të njëjtë e rregullon edhe LMD në Nenin 156 ku thekson se, “në qoftë se pronarit i është marrë sendi i rrezikshëm në mënyrë të kundërligjshme, për dëmin që rrjedh nga kjo, nuk përgjigjet ai, por ai që ia ka marrë sendin e rrezikshëm, në qoftë se pronari nuk është përgjegjës për këtë”.

shkaktuar, duhet të përgjigjet edhe vetë punëtori sipas rregullave të përgjegjësisë subjektive. Edhe KCSH në Nenin 618 parag.1, për këtë përgjegjësi parasheh se, “Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij”. Në një rast gjyqësor paditësi ishte shërbyer tek e paditura me gjëra ushqimore në njësinë e saj dhe kur ka shkuar në arkë për të bërë pagesën, punëtorja e të paditurës e ka prekur arkën dhe e njëjta i ka rënë në këmbë paditësit, ku nga rënia e arkës në këmbën e paditësit, i njëjti kishte pësuar lëndim të rëndë trupor me thyerje të këmbës. I autorizuari i të paditurës në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes, pretendonte se lëndimin trupor e ka shkaktuar punëtorja e të paditurës e cila edhe do të duhej të mbante përgjegjësi për kompensimin e dëmit ndaj paditësit, me arsyen se punën e ka kryer në mënyrë të pakujdesshme. Gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, sepse në bazë të LMD-së, përcaktohet saktë se për dëmin të cilin punëtori në punë ose lidhur me punën i shkakton personit të tretë përgjigjet organizata, përkatësisht personi juridik ku ka punuar punëtori në momentin e shkaktimit të dëmit²³. Përgjegjësia objektive e punëdhënësit për të shpërblyer

²³Gjykata Komunale në Kamenicë në Vendimin e saj C.nr.83/2011 të datës 28.03.2012 në çështjen kontestimore lidhur me kompensimin e dëmit jashtëkontraktor të paditësit S. M kundër të paditurës “ETC”-ELKOS-SH.P.K, njësia në Kamenicë, kishte vendosur pranimin pjesërisht të padisë si dhe detyrimin e të paditurës të shpërblejë palës paditëse dëmin pasuror dhe jopasuror, shumën prej 261. 00 € në emër të dëmit material dhe shumën prej 2000.00 € në emër të dëmit jomaterial. Paditësi ishte shërbyer tek e paditura me gjëra ushqimore në njësinë e saj në Kamenicë dhe kur ka shkuar në arkë për të bërë pagesën, punëtorja e të paditurës e ka prekur arkën dhe e njëjta i ka rënë në këmbë paditësit, ku nga rënia e arkës në këmbën e paditësit, i njëjti kishte pësuar lëndim të rëndë trupor me thyerje të këmbës së djathtë. I autorizuari i të paditurës në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes, pretendonte se lëndimin trupor e ka shkaktuar punëtorja e të paditurës e cila edhe do të duhej të mbante përgjegjësi për kompensimin e dëmit ndaj paditësit, me arsyen se punën e ka kryer në mënyrë të pakujdesshme. Gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, sepse në bazë të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve përcaktohet saktë se për dëmin të cilin punëtori në punë ose lidhur me punën i shkakton personit të tretë përgjigjet organizata, përkatësisht personi juridik ku ka punuar punëtori në momentin e shkaktimit të dëmit. Më këtë rast qartazi kuptohet se, përgjegjësia i takon të paditurës. Raste të këtilla a të ngjashme janë të përcaktuara edhe me LMD. Në rastin konkret punëtorja nuk e ka shkaktuar dëmin me dashje dhe as me pakujdesi të rëndë pasi që arka që

dëmin ndaj personit të tretë, nuk vlerësohet çdo herë duke u bazuar në përgjegjësinë subjektive të punëtorit si shkaktar i dëmit, mirëpo duhet të shikohet se sjellja e punëtorit a ka qenë në përkim me rregullat e kërkuara prej punës së tillë. Gjithashtu, ai a ka kryer punën duke u shërbyer me mjete (sende) të rrezikshme ose ushtron veprimtarinë të cilat kanë burim rrezikun, ku në rastin e këtillë përgjegjësia merr trajtë objektive (Mamuti, 2013:115).

Që punëdhënësi të përgjigjet për dëmin e shkaktuar duhet që të shkaktohet dëmi, pra ai duhet të jetë i shkaktuar nga punëtori i tij, të shkaktohet në punë ose lidhur me punën, gjatë orarit të punës dhe duke kryer veprimtarinë e punëdhënësit.

5.2.6. Përgjegjësia juridiko civile e personit juridik për organet e veta

Përgjegjësia e personit juridik për organet e veta, është një rast i veçantë i përgjegjësisë për të tjerët. Personi juridik përgjigjet për dëmin që mund t'i shkaktohet personit të tretë, ose vetë punëtorit të personit juridik nga organi i tij në kryerjen ose në lidhje me kryerjen e funksioneve të veta (Dauti, 2008:187). Duhet theksuar se personi juridik, funksionimin e vet e realizon nëpërmjet organeve të veta inokose (drejtorit) ose kolegjiale (bordi i ndërmarrjes). Këto organe ndodhë që duke kryer veprimtarinë e tyre, t'u shkaktojnë dëm

i ka rënë paditësit në këmbë për shkak të prekjes, përkatësisht shtyrjes për mbyllje të sirtarit të arkës nuk konsiderohet dashje e as pakujdesi e rëndë. Thuhet kështu, sepse edhe vetë punëdhënësi është dashur të marrë masa për të siguruar mjetet adekuate të punës, ashtu që ta sigurojë me mjete mekanike në mënyrë që nga një prekje e lehtë, përkatësisht mbyllja e sirtarit të mos bjerë nga tavolina. Përkitazi për këtë konstatoj se, me vendimin e saj gjykata për çaktimin e shpërblimit për format e dëmit jo material dhe material ka arritur qëllimin e caktuar. Pra, për shpërblimin e dëmit me qëllim të mënjanimit të pasojave të dëmshme, si satisfaksion për të.

personave të tretë ose punëtorit të vet. Personi juridik duhet të përgjigjet për organet e veta, sepse ka bërë zgjidhjen e gabuar të organit të vet (culpa in eligendo) ose për shkak se, personi juridik nuk e ka bërë mbikëqyrjen e organeve të veta (culpa in inspeciendo) (Dauti, 2016:193). Baza e përgjegjësisë së personit juridik për organet e veta është faj i supozuar. Kushtet e përgjegjësisë në këtë rast janë: dëmi i shkaktuar të jetë pasojë e veprimit të organit inokos ose kolegjal të personit juridik. I dëmtuari mund të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi juridik (Dauti, 2016:193). Në qoftë se për rastin e caktuar nuk është parashikuar ndryshe me ligj, personi juridik ka të drejtë në shpërblim nga personi i cili ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia e rëndë (neni 153 paragrafi 2 i LMD). Nëse këtë dëm e shpërblen personi juridik dhe nuk kërkon brenda afatit prej 6 muajve, kjo kërkesë parashkruhet.

Në nenin 618 paragrafi i dytë të KCSH, është parashikuar: “Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre”. Kjo dispozitë është përsëritje e paragrafit të parë të nenit 32 të këtij Kodi, me titull “Përgjegjësia e personit juridik”. Edhe në legjislacionin e mëparshëm në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përgjegjësinë e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organet e tij, në kryerjen e detyrave të tyre, është mbajtur qëndrimi i njëjtë (neni 480 paragrafi i parë i LVJD dhe neni 31 paragrafi i parë i KCSH). Për ta pasur të qartë kuptimin dhe rëndësinë e organit të personit juridik, sidomos arsyen e përgjegjësisë së pakushtëzuar të personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre, duhet t’i referohemi nenit 31 të KCSH, në të cilin thuhet se, “Personi juridik vepron me anën e organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij.

Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik”. Nga kjo dispozitë kuptojmë, gjithashtu se organet shprehin dhe realizojnë vullnetin e personit juridik. Këto veçori e bëjnë të dallueshëm, thelbësisht organet nga punonjësit (punëtorët e nëpunësit) e personit juridik. Ky dallim shprehet edhe në përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit si ndaj personave të tretë, ashtu edhe ndaj punonjësve të tij nga ana e organeve të veta (Gjata, 2010:76-77).

Organet e personave juridikë mund të jenë si individuale, ashtu edhe kolektive. A do të ketë një organ të vetëm apo disa organe, a do të jenë individuale apo kolektive, caktohet në ligj në aktin e krijimit ose në statutin e personit juridik. P.sh. në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (Nr.9901/datë:14.04.2008), për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, janë caktuar këto organe: asambleja e përgjithshme dhe administratorët; për shoqëritë aksionare: asambleja e përgjithshme, këshilli i administrimit dhe këshilli i mbikëqyrjes. Në marrëdhëniet midis tyre ekziston një hierarki vertikale, me detyra të parashikuara për secilin prej tyre (Gjata, 2010:77). Përgjegjësia e personit juridik për veprimtarinë e organeve të veta presumohet. Por ky prezumim është relativ, që do të thotë se, lejohet të provojë të kundërtën (që nuk është fajtor për dëmin e shkaktuar). Po të jetë shkaktuar dëmi me faj të organit ose njërit prej tyre kur janë më shumë, personi juridik gëzon të drejtën e regresit ndaj tij (Gjata, 2010:78). Praktika gjyqësore në Francë në një rast vëren se punonjësi i një kompanie të sigurimit ka abuzuar funksionet e tij. Ai, shiti një policë të sigurimit duke e mbajtur preminë për vete. Ai nuk kishte qenë i caktuar për të lidhur kontrata, por përdori pushtetin e tij për ta bërë këtë, në mënyrë që të arrijë përfitime personale. Fakti se ai nuk kishte leje për të lidhur kontratën, nuk e përjashtoj përgjegjësinë

e kompanisë për këtë, pasi që punonjësi e përdori pushtetin, që i është dhënë nga kompania²⁴. Legjislacioni shqiptar nuk e ka kufizuar përgjegjësinë me lloje të fajit të organit, si p.sh. vetëm me dashje, ose me dashje dhe pakujdesi të rëndë, siç ndahet në disa legjislacione të huaja. Lidhur me regresin, linden vështirësi kur organi është kolektiv, pasi që duhet individualizuar faji secilit anëtar të organit. Në qoftë se fajësia e të gjithë anëtarëve të organit është provuar, do të përgjigjen solidarisht. Kjo është çështje fakti, që zgjidhet rast pas rasti në praktikë (Gjata, 2010:78). Por tendenca e përgjithshme është drejtë kufizimit, madje dhe përjashtimit nga përgjegjësia e organit kolektiv të personit juridik (Crnic, 1995:83). Përgjegjësia e personit juridik arsyetohet me atë se, personi juridik vepron nëpërmjet organeve të veta dhe se për këtë arsye veprimet e tij kanë për t'u konsideruar si veprime të vet personit juridik (Milosevic, 1977:175). Në rast se nuk do të krijohej përgjegjësia e personit juridik për dëmin, por vetëm e organit të tij, i dëmtuari do të vihej në pozitë të vështirë për ta realizuar dëmshpërblimin, sepse nuk do të përcaktohej organi që do të përgjigjej për dëmin e shkaktuar ose nuk mundë të paguhej nga ai organ, për shkak se nuk ka mjete për dëmshpërblim. Prandaj edhe kjo e arsyeton përgjegjësinë e personave juridikë për veprimet e dëmshme të organeve të veta (Milosevic, 1977:175). Ekzistojnë mendime të ndryshme, sa i përket bazës së përgjegjësisë jashtëkontraktore civile të personit juridik për organet e veta. Sipas një mendimi, baza e përgjegjësisë deliktore civile e personit juridik për organet e veta është faji i supozuar (Dauti, 2008:188). Faji, këtu ka të bëjë me sjelljen e personave në cilësinë e kryesit të punëve që hyjnë në kompetencën e organit të personit juridik. Sipas një mendimi tjetër, përgjegjësia e personit juridik për

²⁴Compagnie La Cite/Hero, Cour de Cassation (Ass. plen.) 19 May 1988, D, 513 (Morina, I, 2010:36).

veprimet e dëmshme të organit të vet mund të krijohej, ose në parimin e fajit të supozuar ose në përgjegjësin e pa faj (Milosevic, 1977:177). Botëkuptimet e vjetra e bazojnë këtë përgjegjësi në parimin e supozimit absolut për fajin, prandaj edhe për shumë arsye mund të mbrohet qëndrimi se personat juridik duhet të përgjigjen ndaj organeve të veta sipas përgjegjësisë pa faj, si dhe parimit të ashtuquajtur përgjegjësi objektive. Ndërsa sipas mendimit të tretë, baza e kësaj përgjegjësie duhet të jetë e përgjegjësisë pa faj. Ky mendim arsyetohet në atë se, te kjo përgjegjësi vërtetimi i fajit është i vështirë. Vërtetimi i fajit të organit inokos (individual) është më afër logjikës juridike, por realizimi është pak më i vështirë, kurse vërtetimi i tij ndaj organit kolegjal është më se i vështirë. Kuptohet në qoftë se i dëmtuari kërkon dëmin nga organi i personit juridik, atëherë duhet të provojë fajin e atij organi, ndërsa në qoftë se kërkon shpërblimin e dëmit nga personi juridik, atëherë atë e realizon sipas rregullave të përgjegjësisë për veprimet e tjetrit (Alishani, 1989:678)²⁵.

Në fund për të ekzistuar përgjegjësia e personit juridik për organet e veta, duhet të shkaktohet dëmi. Ai duhet të jetë pasojë e veprimit të organit individual ose kolegjal të personit juridik, atëherë kur organi i personit juridik të ketë shkaktuar dëmin duke kryer funksionin ose rreth kryerjes së funksioneve të veta. Gjithashtu, lidhur me këtë, dëmi duhet të shkaktohet nga organi i personit juridik personit të tretë ose vetë punëtorit të personit juridik.

²⁵ Në nenin 619 të KCSH, rregullohet për herë të parë përgjegjësia e personit që ushtron veprimtari në kuadrin e detyrës së një tjetri dhe sipas udhëzimeve të tij, pa qenë punonjësi i tij. Ai është përgjegjës për dëmin e shkaktuar gjatë kësaj veprimtarie ndaj të tretit. Personi tjetër është, gjithashtu përgjegjës ndaj të tretit. Raste të tilla ndeshen në praktikë. Marrim një shembull: Personi A në kontratën e lidhur ka marrë përsipër të rregullojë televizorin e personit B. Gjatë punës i ofron ndihmë personi C. Mirëpo ky i fundit i shkakton një dëm tjetër televizorit, megjithëse ka vepruar sipas udhëzimeve të personit A. Personi C do të përgjigjet ndaj të tretit, por edhe personi A nuk shkarkohet nga përgjegjësia ndaj B-së (Gjata, 2010:78).

5.2.7. Përfundim

Te përgjegjësia subjektive civile (përgjegjësia në bazë të fajësisë) pamë se ajo nënkupton rastet, kur shkaktuesi i dëmit mban vetë pasojat e dëmit të shkaktuar me veprim apo mos veprim. Përgjegjësia subjektive civile nënkuptonte përgjegjësinë personale të personit për dëmin e shkaktuar ndaj tjetrit me fajin e tij. Ndërsa dispozitat ligjore të kësaj përgjegjësie juridiko civile, rregullojnë përgjegjësinë për veprimet e tjetrit e jo për atë personale, të cilat janë rregulluar me dispozitat paraprake përkitazi me përgjegjësinë në bazë të fajësisë.

Këto dispozita ligjore kufizohen në përgjegjësinë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar nga persona të caktuar, të cilët nga gjendja shëndetësore ose shkalla e zhvillimit mendor apo për ndonjë shkak tjetër, janë prekur në aftësinë e tyre për të gjykuar. Në këtë mënyrë, për dëmin të cilin e ka shkaktuar personi i cili për shkak të sëmundjes shpirtërore ose zhvillimit të ngecur mendor ose nga ndonjë shkak tjetër nuk është i aftë për të gjykuar, përgjigjet personi tjetër dhe jo vetë shkaktuesi i dëmit. Pra fjala është për përgjegjësinë e tjetrit e jo të personit që e ka shkaktuar dëmin.

Sëmundja shpirtërore mund të jetë e përhershme ose një çrregullim momental shpirtëror apo zhvillim i ngecur mendor. Shkaqet e tjera mund të jenë ndër më të ndryshmet, me rëndësi është që njëri apo tjetri shkak të ketë ndikuar që personi i caktuar nuk është i aftë për të gjykuar për veprimet e veta që do të ndërmarrë.

Përgjegjësia për tjetrin nënkupton përgjegjësinë e një personi për dëmin e shkaktuar nga një tjetër person. Pra, personi përgjegjës dhe shkaktuesi i dëmit janë dy persona të ndryshëm. Në këtë mënyrë, për dëmin e shkaktuar nga personi i pa aftë për të gjykuar është përgjegjës

ai që, në bazë të ligjit, në bazë të kontratës ose në bazë të vendimit të ndonjë organi, ka për detyrë të përkujdeset për atë.

Personat të cilëve me vendim të gjykatës, pjesërisht apo plotësisht i është hequr zotësia për të vepruar, vihen nën kujdestari. Kujdestari është ai që duhet të përkujdeset për këtë person, ndonjëherë edhe ta edukojë atë. Prandaj, edhe ai është përgjegjës për dëmin që e ka shkaktuar personi nën përkujdesjen e tij.

Te ky lloj i përgjegjësisë civile prindërit janë përgjegjës për dëmin që e ka shkaktuar fëmija i tyre i rritur, i cili është mendërisht i sëmurë dhe nuk është i aftë për të gjykuar, por me kusht që të ndodhet nën përkujdesjen dhe ushqimin e tyre. Kujdesi prindëror mund të zgjatet edhe pas moshës madhore të fëmijës për shkak të sëmundjes psikike ose zhvillimi psikik të ngecur.

Në këtë lloj përgjegjësie civile është parashikuar edhe lirimi nga përgjegjësia e personit tjetër për dëmin e shkaktuar nga personi i pa aftë për të gjykuar. Kështu, personi i cili në bazë të ligjit, vendimit të organit kompetent apo të kontratës, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga personi të cilin e ka nën mbikëqyrje, do të lirohet nga përgjegjësia, nëse provon se e ka ushtruar mbikëqyrjen ashtu siç ka qenë i detyruar, apo që dëmi do të shkactohej me gjithë ushtrimin e kujdesshëm të mbikëqyrjes.

KAPITULLI VI: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1. Përfundime

Nga trajtimi i tezave të këtij punimi pamë se, shkaktimi i dëmit si fakt relevant krijon edhe përgjegjësinë për të. Dëmtuesi përgjigjet për dëmin e shkaktuar ndaj të dëmtuarit, prandaj edhe thuhet se përgjegjësia për dëmin paraqitet si pasojë e dëmit të shkaktuar. Një gjë e tillë është edhe normale në këto marrëdhënie, sepse çdokush duhet t'i ketë pasojat nga sjelljet e veta.

Nga tezat e shtjelluara më lartë veneruam se, përgjegjës mund të jetë si subjekti që është shkaktues i dëmit apo edhe dikush tjetër që është në marrëdhënie të veçantë me shkaktuesin e tij. Përgjegjës konsiderohet edhe poseduesi i sendit të rrezikshëm ose organizuesi i aktivitetit të rrezikshëm. Prandaj, funksionimi i përgjegjësisë në këto dhe në raste të tjera u ofron mbrojtje të caktuar viktimave, si dhe dënon dëmtuesin potencial.

Gjithashtu pamë se, që të lindin detyrimet nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte të caktuara, të cilat ishin: a) ekzistenca e dëmit; b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit; c) ekzistenca e fajit si dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Në rast se mungon cilido prej këtyre kushteve, si rregull nuk lind përgjegjësia nga shkaktimi i dëmit.

Pra, për këto dhe arsye të tjera nga kjo që u pa dhe u shtjellua në këtë punim, lidhur me çaktimin e kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile të dëmit jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe të Kosovës, mund të themi se, rregullat lidhur me bazën e kësaj përgjegjësie duhet të mbarështrohen dhe analizohen me kujdes të veçantë, kur dihet se shoqëria e jonë ende nuk ka arritur në atë nivel të zhvillimit që të sigurojë mbrojtje për të gjithë qytetarët e saj nga dëmet eventuale që mund të shkaktohen.

Përkitazi për kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë subjektive civile të dëmi jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, nga e gjithë ajo që u theksua gjatë trajtimit të kësaj teme, **vijmë në këto përfundime:**

- Detyrimet për kompensimin e dëmit sipas përgjegjësisë subjektive realizohen, atëherë kur plotësohen kushtet e caktuara ligjore si: faji i subjektit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, veprimi apo mosveprimi të jetë me iniciativë të subjektit, t'i jetë shkaktuar dëm personit të dëmtuar me pranimë e lidhjes shkakësore, në mes të veprimit të subjektit dhe pasojës së shkaktuar.
- Rregullat e kësaj baze të përgjegjësisë civile, duhet të mbështeten në fajin e provuar.
- Përgjegjësia subjektive civile për dëmin e shkaktuar është lloj i përgjegjësisë juridiko civile, në të cilën personi përgjegjës përgjigjet për dëmin që e ka shkaktuar me veprimin e tij deliktor, sepse ai është fajtor për dëmin e shkaktuar. Kjo

përgjegjësi ndryshe quhej përgjegjësi sipas fajit, për shkak se mbështetej në fajin e subjektit që e ka shkaktuar dëmin.

- Përgjegjësia subjektive civile te dëmi jashtëkontraktor, është njëra prej bazave të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, e cila ka ekzistuar në të kaluarën dhe ekziston në të drejtën bashkëkohore si në të drejtën e dy shteteve tona ashtu edhe në të drejtën krahasuese.
- Përgjegjësia sipas fajit, është trashëgimi e madhe qytetëruese, sepse ka bazën më të fortë në lëmin e përgjegjësisë juridiko civile. Kjo përgjegjësi ka gëzuar dhe gëzon respekt të merituar si në aspektin e drejtshmërisë, ashtu edhe në aspektin moral. Ajo është një imperativ shoqëror që çdokush t'i ketë edhe pasojat e veprimit të vet gjatë të cilit mund t'i ngarkohet faji për dëmin që i shkakton tjetrit.
- Në përgjegjësinë subjektive civile shpesh ndodhë në përditshmëri, që i dëmtuari të mos provojë fajin e dëmtuesit dhe të mbetet pa shpërblim të dëmit të pësuar. Ai duke mos qenë fare fajtorë për dëmin që ka pësuar, nuk mund të realizojë shpërblimin e tij ngase nuk ka mundur ta provojë fajin e dëmtuesit. Në rastet kur i dëmtuari nuk ka mundur ta provojë fajin e dëmtuesit ka mbetur pa shpërblim, andaj kjo bazë e përgjegjësisë është dëshmuar e pamjaftueshme.
- Në këtë lloj të përgjegjësisë i dëmtuari në shumë situata mbetet në pozitë të vështirë për t'u zhdëmtuar. Për këtë arsye e drejta e dy vendeve tona, në disa raste te shkaktimi i dëmit, ka filluar të përkrah idenë e fajit të supozuar. Pra, kur dëmtuesi i'a shkakton dëmin të dëmtuarit, supozohet faji i tij, që lë të kuptohet se ai ka të

drejtë të pohojë dhe provojë pafajsinë për dëmin e shkaktuar. Prandaj, barra e argumentimit të pafajësisë kalon në anën e dëmtuesit dhe shënon një përparim në aspektin e zhvillimit të së drejtës.

- Në këtë drejtim të zhvillimit të së drejtës veprojnë edhe e drejta në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Kështu LMD në Kosovë në nenin 136 thekson se: “kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. KCSH në Nenin 608 thekson se “Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblej dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.....” Këto dispozita e lirojnë të dëmtuarin që të provojë se, ekziston faji i dëmtuesit ose personit përgjegjës për veprime të dëmtuesit.
- Në fund për këtë bazë të përgjegjësisë civile mund të konstatohet se, ajo e ka arsyen e ekzistimit dhe se do ta ketë edhe në të ardhmen. Gjithashtu, ajo ka fushën e vet të zbatimit dhe ka rregullat e caktuara. Me një fjalë mohohet mendimi, se kjo bazë e përgjegjësisë të mos ekzistojë.

Si përmbyllje lidhur me caktimin kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë objektive civile të dëmi jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe atë të Kosovës, **mund të nxirren këto përfundime:**

- Përgjegjësia objektive civile është përgjegjësi që nisët nga fakti i shkaktimit të dëmit, që kuptohet se te ky lloj i përgjegjësisë nuk nevojitet të provohet faji i

pronarit, poseduesit, shfrytëzuesit të sendit të rrezikshëm me të cilin është shkaktuar dëmi. Prandaj edhe kjo përgjegjësi quhet përgjegjësi pa faj, e cila si e tillë njihet edhe në të drejtën tonë.

- Përgjegjësia objektive ose ndryshe ajo pa faj, është përgjegjësi për sende të rrezikshme ose veprimtari të rrezikshme, sepse këto shpeshherë në jetën e përditshme shkaktojnë dëme të mëdha, ngjarje të dëmshme, ku shpesh shkaku i vërtetë i tyre mbetet i pa njohur .
- Për të ekzistuar përgjegjësia objektive civile të dëmi jashtëkontraktor në dy shtetet tona duhet të plotësohen këto kushte: dëmi të jetë shkaktuar nga sendet dhe veprimtaria e rrezikshme; të ekzistojë kundërligjshmëria dhe të ekzistojë lidhja shkakësore apo kauzale.
- Te dëmi jashtëkontraktor në dy vendet tona shihet se në komunikacionin rrugor, ajror e ujor shpesh rrezikohet jeta e njeriut dhe shkaktohen dëme të mëdha, me ç'rast dëmi duhet të shpërblehet dhe ky lloj i përgjegjësisë civile shërben për kompensimin e tij.
- Në këtë lloj të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, përgjigjet ai që sendin e rrezikshëm e ka vënë në lëvizje ose ka organizuar veprimtari të rrezikshme, sepse nga këto aktivitete krijohet rreziku për rrethin e caktuar. Pra, lartësia e shpërblimit të dëmit varet nga lartësia e dëmit e jo nga faji i pronarit, poseduesit, shfrytëzuesit, udhëheqësit të sendit të rrezikshëm.

- Edhe në këtë lloj të përgjegjësisë civile, përgjegjësia individualizohet edhe pse nuk përgjigjet sipas fajit. Për këtë jep llogari subjekti i caktuar, sepse përgjigjet për dëmin e caktuar që rrjedh nga këto sende dhe veprimtari.
- Veprimtaritë tjera që rrezikojnë e do të rrezikojnë njeriun dhe pasurinë e tij, si dhe shoqërinë në përgjithësi, kërkojnë që e drejta për këto raste të parashohë zgjidhje dhe përgjegjësi të caktuara, gjë që ka bërë edhe legjislacioni shqiptar dhe ai kosovar. Pra, për të gjitha këto ligjvënësit e Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës, kanë paraparë ligje të veçanta si, kodin civil, dhe dispozitat e ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, të mbështetura në praktikën gjyqësore dhe doktrinën juridike.
- Te ky lloj i përgjegjësisë juridiko civile, në rast se dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme, personi i dëmtuar duhet të provojë, vetëm dëmin që e ka pësuar dhe që ai është shkaktuar nga sendi i rrezikshëm. Ai nuk do të jetë i detyruar që të provojë fajin e personit përgjegjës, sepse përgjegjësia për dëmin nga sendet e rrezikshme është përgjegjësi pa faj, pra është përgjegjësi objektive.

Gjatë trajtimit të kriterëve dhe kushteve që duhet të plotësohen për ekzistimin e përgjegjësisë civile për veprimet e tjetrit te dëmi jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, **vijmë në këto përfundime:**

- Përgjegjësia juridiko civile për veprimet e tjetrit nënkupton përgjegjësinë e një personi për dëmin e shkaktuar nga dikush tjetër, ku personi përgjegjës dhe shkaktuesi i dëmit janë dy persona të ndryshëm, pra njëri që shkakton dëmin dhe

tjetri që përgjigjet. Kjo përgjegjësi juridiko civile ekziston, nëse ekziston fajësia për dëmin e shkaktuar.

- Në sistemin e fajit të supozuar dëmtuesi nuk do të përgjigjet, në qoftë se provon se nuk ka qenë fajtor për dëmin e shkaktuar.
- Në të gjitha rastet ndërmjet personit përgjegjës dhe dëmtuesit, ekziston një marrëdhënie e posaçme juridike siç është ajo prind-fëmijë, kujdestari dhe ai me pazotësi për të vepruar, mësues-nxënës, punëdhënës-punëmarrës, etj.
- Dëmtuesi dhe personi përgjegjës dallohen te përgjegjësia për të tjerët. Dëmtuesi edhe pse nuk përgjigjet, prapëseprapë ai nuk përjashtohet nga përgjegjësia, sepse mund të përgjigjet sipas rregullave të përgjegjësisë subjektive ose objektive. Pra, gjithnjë duke pasur parasysh që për këto baza të përgjegjësisë duhet të jenë plotësuar kushtet e caktuara.
- Në këtë lloj të përgjegjësisë i dëmtuari si kreditor, ka të drejtë të zgjedhë se me cilat rregulla të përgjegjësisë civile do të kërkojë shpërblimin e dëmit. Është kështu sepse te kjo përgjegjësi juridiko civile nuk ekziston bazë unike, por ka vend për të dy bazat e përgjegjësisë civile lidhur me dëmin jashtëkontraktor
- Që të ekzistojë përgjegjësia për të tjerët duhet plotësuar këto kushte: a) duhet që të shkaktohet dëmi, b) duhet që dëmin ta shkaktojë personi që është në lidhje të veçantë juridike me personin përgjegjës, c) duhet të ekzistojë lidhja kauzale midis veprimit që është ndërmarrë dhe dëmit të shkaktuar dhe d) dëmi duhet që të shkaktohet nga lëshimet e personit përgjegjës.

- Te përgjegjësia për veprimet e tjetrit, është obligimi i disa subjekteve të shpërblejnë dëmin e shkaktuar nga disa subjekte tjera, me të cilat janë në marrëdhënie të caktuara juridike. Një situatë të tillë është imponuar nga nevoja e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave ndaj të dëmtuarit. Në të kundërtën ai do të mbetet pa u kompensuar.

6.2. Rekomandime

Nga e gjithë ajo që u tha më sipër mund të nxirren këto rekomandime

- Në të ardhmen kur flitet për kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për të ekzistuar përgjegjësia civile te dëmi jashtëkontraktor në dy vendet tona, si në doktrinë ashtu edhe në legjislacion duhet të ekzistojë edhe kriteri i aftësisë për përgjegjësi, përkatësisht i aftësisë së deliktit si kusht në vete. Pa plotësimin e këtij kushti nuk mund të ketë përgjegjësi subjektive civile. Ajo nuk mund të jetë e plotë sipas fajit, sepse s'mund të ekzistojë përgjegjësia subjektive civile pa aftësinë e deliktit, e cila ka të bëjë me një njeri të veçantë si qenie e ndërgjegjshme, që ndien, provon e mendon. Pra, ka të bëjë me njeriun si subjekt i cili veprimet e veta i merr nga dëshira vetjake, që mbështetet në mendimet dhe në dëshirat e veçanta të tij.
- Në të ardhmen në dy vendet tona, të përcaktohen në mënyrë të veçantë kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për lindjen e përgjegjësisë jashtëkontraktore civile, si për dëmin e shkaktuar nga baza e përgjegjësisë subjektive civile, objektive civile dhe ajo e përgjegjësisë për të tjerët, e jo të flitet në mënyrë të përgjithësuar.

- Të ketë përgjegjësi më të lartë nga ana e gjyqësorit në lidhje me zgjidhjen e rasteve të përgjegjësisë civile lidhur me dëmin e shkaktuar, si garanci për investorët e huaj për të krijuar mirëbesimin e një shteti të së drejtës dhe të barabartë, që do të ndihmonte edhe në zhvillimin ekonomik të dy vendeve tona!
- Dispozitat ligjore lidhur me përgjegjësinë juridiko civile, t'i adaptohen realitetit shoqëror dhe zhvillimit ekonomik në të dyja vendet e tona!
- Gjyqësori, të vendosë në mënyrë të drejtë për kërkespaditë e palëve të dëmtuara me anë të gjykimeve brenda afateve të arsyeshme kohore lidhur me konstatimin e përgjegjësisë civile për dëmin e shkaktuar, sepse vetëm një zgjidhje e tillë, paraqet gurthemelin e një shoqërie demokratike drejt zbatimit të sundimit të së drejtës dhe aspiratave të vendeve tona lidhur me integrimet euroatlantike!
- Të miratohen masa ligjore dhe masa tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe sanksione ndaj gjyqësorit lidhur me vonesat në marrjen e vendimeve gjyqësore, për rastet e përgjegjësisë civile të dëmi jashtëkontraktor si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.
- Të ndërmerren veprime dhe të përdoren mjete juridike në kuadër të të drejtave dhe detyrave nga ana e avokatëve publik që mbrojnë interesin publik lidhur me dëmet e shkaktuara institucioneve nga vendimet e marra në dëm të institucioneve, si pasojë e tekave personale të personave që i drejtojnë ato. Përdorimi i këtyre mjeteve juridike duhet të jetë i shpejtë dhe me kohë, sepse çdo veprim jo me kohë, si dhe çdo pasivitet dhe veprim i njëanshëm, mundë të ketë pasoja të rënda për të mirën e

përgjithshme në dy vendet tona. Kjo, presupozon mundësinë e zhvillimit të sanksioneve përkatëse ndaj tyre. Sanksioni për çdo formë të përgjegjësisë duhet të ekzistojë. Ai, duhet t'u përshtatet rrethanave aktuale dhe reale sepse të mohosh sanksionin do të thotë mohosh përgjegjësinë si të këtillë.

- Nxjerrjen e një Kodi Civil në Kosovë, që do të mundësonte lehtësimin e zbatimit të dispozitave ligjore nga aspekti praktik, i cili edhe do të shërbente për të shmangur kundërthëniet e dispozitave ligjore në fushën e së drejtës civile!

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Burime parësore

- Deklarata e Tirolit për Praktikim më të mirë të Sporteve Malore”, miratuar në Konferencën për të ardhmen e sporteve malore, në Insbruk më 6-8 shtator 2002
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 2001.
- Kodi Civil Austriak, 1871, Zbornik Gradjanski Zakonika, Stare Jugosllavije, Titograd 1960.
- Kodi civil Gjerman, 1896 i cili ka hyrë në fuqi më 1900, botimi i 30, Auflage Stand, 1 Februar 1987.
- Kodi Civil i Francës, i vitit 1804, Dalloz, Paris, 1985 dhe 2002.
- Kodi Civil i Italisë.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.7850, datë 29.7.1994, ndryshuar me ligjin Nr.8536, datë 18.10.1999 ligjin Nr.8781, datë 3.5.2001 dhe ligjin Nr.17/2012.
- Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1929 (Kodi i Ahmet Zogut).
- Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1981.
- Kodi Civil i Zvicrës i vitit 1907, Bernë, 1985.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, Nr.9062, datë 08.05.2003.
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, i ndryshuar me: Ligjin nr.8181, datë 23.12.1996, Ligjin nr.8431, datë 14.12.1998, Ligjin nr.8491, datë 27.05.1999, Ligjin nr.8535, datë 18.10.1999,

Ligjin nr.8601, datë 10.04.2000, Ligjin nr.8812, datë 17.05.2001, Ligjin nr.9062, datë 08.03.2003, Ligjin nr.9953, datë 14.07.2008, Ligjin nr.10052, datë 29.12.2008, Ligjin 49/1012, FZ 53, datë 16.05.2012

- Kodi i Procedurës Civile, Tiranë, 1958.
- Kodi i Procedurës Civile, Tiranë, 1981.
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Nr.7961, datë 12.07.1995, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996 si dhe ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.07.2003.
- Komentar, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Libri i Parë, Ministria e Drejtësisë, Republika e Kosovës, UNDP, Prishtinë, 2013.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1950 me të gjitha protokolet e saj, teksti i hartuar nga sekretaria e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nëntor 1998.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, miratuar me 19 Prill 2008 e cila ka hyrë në fuqi më 15 Qershor 2008.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me Ligjin nr.8417, dt/21.10.1998.
- Ligji “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”, i miratuar me ndryshime në Ligjin Nr.7641, datë 01.12.1992, ndryshuar me Ligjin Nr.8729, datë 19.01.2001.
- Ligji Civil kundër shpifjes dhe fyerjes Nr.02/L-65.
- Ligji i punës në Kosovë Nr.03/L-2012.
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorëve, i nxjerrë nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.81912 të datës 06.02.1997.

- Ligji mbi pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil (LPPKC), 1955.
- Ligji Nr. 8510, datë 15.7.1999, Për Përgjegjësinë Jashtëkontraktore të Organeve të Administratës Shtetërore, Republika e Shqipërisë.
- Ligji nr.9901, datë 28.04.2003, për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të.
- Ligji për familjen i Kosovës Nr.2004/32.
- Ligji Për Komunikimet Elektronike, Nr.9918, dt.19.05.2008, Republika e Shqipërisë.
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.04/L-077, Nëntor 2012.
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore, i Kosovës, Ligji nr.03/L-154, 25.06.2009.
- Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta Nr.04/L065.
- Ligji për Veprimet Juridike dhe Detyrimet, Tiranë, 1956.
- Ligjin për organizatave biznesore, ligji nr. 02/L-123, 27.05. 2008, Kosovë.
- Rregullorja Nr.622/1, datë 15.12.1992 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë”.
- Zakon o autorskom i srodnim pravima republike Hrvatske, Zagreb, 2003.
- Zakon o Obligacionim Odnosima Gazeta Zyrtare SFRJ, nr. 29/78, 39/85, 45/89 dhe 57/89.
- Zakon o obligacionim odnosima SFRJ, br.29/1978.

- Zakon o obligacionim odnosima XV, Beograd, 2003.
- Zakon o obveznim odnosima (Autorski procisceni tekst), Narodne novine, Zagreb, 1999.

Burime dytësore

- Agushi, Arben, Sigurimet dhe Shpërblimi i dëmit, Prishtina PRESS, Prishtinë, 2013.
- Alishani, Alajdin, E drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme, ETMM, Prishtinë, 1989.
- Alishani, Alajdin, Studime nga Drejta e Detyrimeve III, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008.
- Aliu, Abdullah, E drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2013.
- Aliu, Abdullah, E drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 2008.
- Aliu, Abdullah, E Drejta Sendore (Pronësia), UP, Prishtinë, 2004.
- Aliu, Abdullah, E Drejta Sendore, UP, Prishtinë, 2014.
- Bakraqi, Xhevat, Menaxhmenti i Rrezikut dhe Sigurimet, Prishtinë/Republika e Kosovës, 2007.
- Baraliu, Mazllum, E Drejta Biznesore, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 2010.
- Bicaj, Kadri, E Drejta Familjare, Leksione të autorizuara, Prishtinë, 2010.
- Bicaj, Kadri, Metodologjia e Shkrimit Ligjor, (Teknika legislative-ligjërata të

autorizuara), Prishtinë, 2011.

- *Bilalli Asllan & Kuçi Hajredin*, E drejta ndërkombëtare private, UP, Prishtinë, 2009.
- *Bob, Matthews & Liz, Ross*, Metodatat e Hulumtimit, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, Tiranë, 2010.
- *Borkowski Andrew & Du Plessis Paul*, E Drejta Romake, UET Press, Tiranë, 2004.
- *Crnić, Ivica*, “Odštetno pravo” (E drejta për shpërblim të dëmit), Zagreb / Republika e Kroacisë, 2008.
- *Crnic, Ivica*, Naknada stete, Zagreb/Republika e Kroacisë, 1995.
- *Dauti, Nerxhivane*, E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë / Republika e Kosovës, 2008.
- *Dauti, Nerxhivane*, E drejta e detyrimeve, Pjesa e përgjithshme, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë / Republika e Kosovës, 2016.
- *Enciklopedija imovinskog prava udruzenog rada III*, Beograd 1978.
- *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, grup autorësh, Rilindja, Prishtinë më 1981.
- *Fjalorth Terminologjik i të Drejtave të Njeriut*, Shqip-Anglisht & Anglisht Shqip, Unesco, Projekti Finlandez për të Drejtat e Njeriut –Kosovë, Tiranë 2002.
- *François, Givord*, “La Reparation du prejudice moral” I cthèse pour le doctorat présentée et soutenue le lundi 14 novembre 1938, à 14 h. Université de Grenoble, Dalloz, Paris.
- *Fromont, Michel*, Grands systemes de droit etrangers, Dalloz, 2005, (Sistemet e huaja më të mëdha të të drejtës), Papirus, Tiranë, 2009.

- Gale, Galev & Jadranka Daboviq, Anastasovska, “Obligaciono pravo”, Shkup, 2009.
- Galgano, Françesko, E drejta Private, 1. Hyrje-Pronësia, Tiranë, 2003
- Gams, Andrija, Hyrje në të Drejtën Civile, Përktheu, Faruk Presheva, ETMM i KSAK, pallati i shtypit, Prishtinë, 1981.
- Georgiev, Dimitar, Obligaciono pravo, Shkup / Republika e Maqedonisë, 1985.
- Gojani, Skender, Fjalor i terminologjisë juridike, Kolegji Biznesi, Prishtinë, 2013.
- Gorenci, Vilim, Bazat e së Drejtës Tregtare Statusore dhe Kontraktore, Viktory, Prishtinë / Republika e Kosovës, 2010.
- Gjata, Rustem, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, “albPAPER”, Tiranë, 2010.
- Gjata, Rustem, Detyrimet Jashtëkontraktore, ”Muza”, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 2010.
- Gjilani, Fehti “Mbi disa çështje të përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara nga të miturit” Drejtësia Popullore nr3, 1958.
- Hetemi, Mehdi, Detyrimet dhe kontratat, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 1998.
- <http://www.fjalori.shkenca.org/>.
- Ismaili, Osman, Fillet e së Drejtës, UP, Prishtinë, 2014.
- Jakupi, Ali, Metodologjia e punës Shkencore Kërkimore, Ligjërata të autorizuara, UP, Prishtinë, 2005.

- *Kabashi, Shyqeri & Shehu, Izet & Lama, Kudusi, Fjalor Shpjegues i Termave të Menaxhimit të Emergjencave, Prishtinë, 2015.*
- *Kadriu, Osman, Shkaktimi i dëmit dhe përgjegjësia civile juridike, Tringa, Shkup, 2003.*
- *Kiril, Çavdar & Kimo, Çavdar, “Ligji për marrëdhënie të Detyrimeve” - komente, sqarime, praktik gjyqësore dhe regjistri i lëndëve, Agencija “Akademik”, Shkup, 2008.*
- *Kodi Civil dhe i Procedurës Civile i pasuruar me praktikë Gjyqësore, i përditësuar me ndryshimet e vitit 2012, Alb Juris, 2012.*
- *Konstantinovic, Mihailo, “Gradjanska odgovornost”, Beograd, 1966.*
- *Krasniqi, Armand, E Drejta Biznesore, Dukagjini, Pejë, 2014.*
- *Latifi, Juliana, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, “albPAPER”, Tiranë, 2009.*
- *Legier, Gerard, E drejta civile-Detyrimet, Papirus, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 2008.*
- *Legier, Gerard, Profesor në Universitetin “Paul-Cezanne” (Aix-Marseille III), “E Drejta Civile, Detyrimet” botimi i 19-të 2008.*
- *Llukiç, Radomir & Koshutiç, Budimir, Fillet e së Drejtës, UP, Prishtinë, 1986.*
- *Machiedo, Dimitar, Osnov odgovornosti za prouzrokovanu stet, “Gradjanska odgovornost”, Beograd, 1966.*
- *Mataj, Rezarta, Rishikimi i dispozitave të dëmit jashtëkontraktor, kërkesë e kohës, Tiranë, 2015.*

- Milosevic, Ljubisha, E Drejta e Detyrimeve, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë, 1977.
- *Mjeldheim Leiv & Lillejord Solvi & Solvberg Erik*, Spektri, Rozafa, Prishtinë, 2006.
- Morina, Iset, E drejta Komparative në Fushën e së Drejtës Private, UP, Prishtinë / Republika e Kosovës, 2010.
- Muskaj, Aleksandër, Përgjegjësia civile nga shkaktimi i dëmit jo pasuror, Universiteti i Tiranës / Republika e Shqipërisë, 2013.
- *Mustafa, Isa & Reshiti, Nail & Kutllovci, Enver*, Ekonomia, Libri Shkollor, Prishtinë 2004.
- Mustafaj, Ilir, Detyrimet dhe Kontratat, Aron Print, Tiranë, 2016.
- *Nuni, Ardian & Mustafaj, Ilir & Vokshi, Asim*, E Drejta e Detyrimeve I, Tiranë, 2008.
- Papajorgji, Endri, E drejta ndërkombëtare tregtare dhe e biznesit, Ilar, Tiranë, 2012.
- Përmbledhje tematike vendimesh unifikuese të Gjykatës së Lartë, 2000-2008, Alb Juris, Tiranë, Nëntor 2008.
- Podvorica Hamdi, E Drejta Familjare, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2006.
- Podvorica, Hamdi, E Drejta Trashëgimore, Trend, Prishtinë, 2010.
- Puhan, Ivo, E Drejta Romake, ETMM, Prishtinë, 1968.
- Radisic, Jakov, Obligacije i obligacioni odnosi, Glasnik Pravnog Fakulteta, Kragujevac, 1980.
- Salihu, Ismet, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, UP, Prishtinë, 2005,
- Sallabanda, Andon, E drejta e detyrimeve, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 1962.

- Sallabanda, Andon, E drejta e detyrimeve, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 1961.
- Semini (Tutulani) Mariana, E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, Real-Stamp, Tiranë/Republika e Shqipërisë, 2016.
- Semini (Tutulani) Mariana, Shkaktimi i dëmit dhe Kontrata, Njohuri për Ligjin, Horizont, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 2001.
- Semini (Tutulani), Mariana, “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave” (pjesa e përgjithshme), Botimi i tretë, Tiranë / Republika e Shqipërisë, 2002.
- Semini (Tutulani), Mariana, E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, Pjesa e përgjithshme, Real- Stamp, Tiranë/Republika e Shqipërisë, 2006.
- Skrame, Olti, Komentar i Kodit Civil, të Republikës së Shqipërisë, Vëllimi i dytë, Onufri 2011.
- Smaka Riza & Gojani, Skender, E Drejta Biznesore, Prishtinë / Republika e Kosovës, 2012.
- Smaka, Riza, E Drejta, Fakulteti Ekonomik,UP, Prishtinë, 1996.
- Smaka, Riza, E Drejta Biznesore, Universiteti Mbretëror Iliria, Prishtinë / Republika e Kosovës, 2008.
- Starck, Boris, Droit Civil, les obligations, Paris, 1972.
- Stojanovic, Dragoljub, Osnov gradjanske odgovornosti u pravu, “Gradjanska odgovornost” Beograd, 1966.
- Swegert & H. Kotz, Njohuri për të drejtën e krahasuar (Parimet themelore) SHBLU, Republika e Shqipërisë, 1994.

- Taleska, Pop-Marjana, “Dëmet ndërkombëtare bazuar në kartonin e gjelbërt”, Sigurimi Vardar, sh.a., Dëmi jomaterial, Revistë shkencore “Akademik”, Shkup, 2006.
- Vendime unifikuese civile dhe penale të Gjykatës së Lartë, Tiranë, 2009.
- Vendime Unifikuese të Gjykatës së Lartë për vitet 2010-2011, Alb Juris, Tiranë, 2012.
- Vermelle, Georges, E Drejta Civile, Kontratat, Pjesa e Posaqme, Papirus, Tiranë, 2008.
- Vuković, Mihajlo, “Përgjegjësia për dëmin”, Zagreb / Republika e Kroacisë, 1971.
- Weil, Alex, Droit Civil, les obligations, Paris, 1971.
- William Waller Hening, “Maxims in Law and Equity - comprising Noy's maxims, Francis's maxims, and Branch's Principia legis et æquitatis, with a translation of the Latin maxims and references to modern authorities both British and American, Volumes 1-3, The author is Counsellor at Law (Author of the Virginia Justice, The Lawyer's Guide, Editor of the Statutes at Large of Virginia), Richmond, 1824.

Vendime gjyqësore

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimi Nr. 12, Nr. 3 i Regjistrimit Themeltar, Tiranë, 2007.
- Gjykata e Apelit Tiranë, vendimi nr.74, datë, 24.01.2006.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 1053, datë 28.02.2005.
- Gjykata e Apelit, Tiranë, Vendimi Nr.1210, Akti Nr.4145 / 1126, datë / 23.05.2013.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Vendimi nr. 6468, dt. 22.06.2012.
- Gjykata e Apelit, Tiranë, Vendimi Nr.89 / 150, Nr. 3434 / 639 i Regjistrat Themeltar, datë / 19.01.2012.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Vendimi, nr. 2323, dt. 28.03.2011.
- Gjykata e Apelit në Tiranë, Nr.1032. Regjisitri Themeltar, Vendimi Nr. 1138, me datë. 11.05.2012.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Vendimi Nr. 429, dt. 24.05.2011.
- Gjykata Supreme e Kosovës, Revizioni. Nr. 130 / 2008, dt / 19.09.2011.
- Gjykata Supreme e Kosovës, Vendimi AC. Nr.167 / 84, dt / 27.11.1984.
- Gjykata e Qarkut Prizren, Vendimi, C.nr. 246 / 82 (Aktgjykim i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.
- Gjykata e Qarkut Prizren, Vendimi, C.nr.78 / 81, dt / 03.10.1983.
- Gjykata e Apelit e Kosovës, Vendimi CA. nr. 3585 / 2012, datë / 17.11.2014.
- Gjykata Komunale në Kamenicë, Vendimi C. nr. 83/2011, datë/ 28.03.2012.
- Gjykata Komunale në Kamenicë, Vendimi C. nr. 29 / 08, datë / 26.01.2008.
- UK: Topp / London Country Bus Co
- *Harrison & Michelin Tyre Co. Ltd* (1985) 1 All ER 918
- *Compagnie La Cite / Hero*, Cour de Cassation (Ass.plen.) 19 May 1988,D, 513

Artikuj shkencor:

- Belegu, Majlinda, (2015), Përgjegjësia e shitësit për dorëzimin e mallit në të drejtën ndërkombëtare dhe vendore, Tiranë.

- *Delia, H & Mitrushi, (2009), “Dëmi Ekzistencial, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi i IV, Instituti Alb-Shkenca, Tiranë.*
- *Mamuti, Afet, (2013), “Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni”, Punim doktrate, Universiteti i Tiranës.*
- *Morina, Sevdai, (2014), ”Baza e përgjegjësise deliktore civile te shkaktimi i dëmit”, Vizione Nr.22 (1) Shkup.*
- *Morina, Sevdai, Basis of civil responsibility from the noncontractual damage, Journal of European Academic Research, Praha, Czech Republik, Euro Union, Vol VI, Issue 1, September, 2016.*
- *Morina, Sevdai, Civil responsibility and dangerous activities from the noncontractual damage, European Scientific Journal, Vol.11, No.26 (2015) Portugal.*
- *Morina, Sevdai. 11 June (2016) “Përgjegjësia Civile për veprimet e tjetrit”, Fourth International Conference on: “Interdisciplinary Studies” Tirana-Bialystok (Poland).*
- *Muçmataj, Ilda, (2015), Shitja Ndërkombëtare e Mallrave, Tiranë.*
- *Teliti, Ersida, (2013), Kontratat Konsumatore, Tiranë.*